monumentet



DO NOT COPY

1 /1984

DO NOT COPY

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURES
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURES
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

1 / 1984 (27)

REDAKSIA

SOTIR KOSTA (KRYEREDAKTOR)
APOLLON BAÇE (ZËV. KRYEREDAKTOR)
ALEKSANDËR MEKSI, ALI MUKA, EMIN RIZA, GJERAK KARAISKAJ,
HASAN NALLBANI

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
Pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës

Adresa e Redaksisë: Rruga «Alqi Kondi» Nr. 7

Tirazhi 1200 Formati 70x100/12 Stash: 2204-

Shtypur: Kombinati Poligrafik. Shtypshkronja «Mihal Duri» – Tiranë

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

ARTIKUJ

Emin RIZA

Historia e arkitekturës dhe restaurimi dy disiplina plotësuese 5

Selami PULAHA

Qytetet shqiptare nën regjimin feudal ushtarak osman gjatë shekujve XV-XVI 17

Vera BUSHATI

Mbi tipologjinë e banesës antike në vendin tonë 51

Apollon BAÇE

Rrugët shqiptare në mesjetë (shek. VII-XV) 59

Mustafa ARAPI

Konservimi dhe restaurimi i pjesës qëndrore të ikonabartësit të kishës së Evangjelizmos të kalasë së Beratit 69

MATERIALE

Gjerak KARAISKAJ, Skënder ALIU

Vendbanime të fortifikuara në pllajën e Kolonjës e në rrjedhjen e sipërme të luginës së Osumit 81

Aleksandër MEKSI

Kishat e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut 103

Bep JUBANI

Monumente arkeologjike në Mbishkodër 127

Kronikat e punimeve restauruese për vitin 1982 143

JETA SHKENCORE

Ali MUKA

Simpoziumi «Epika heroike shqiptare» 151

DO NOT COPY

TABLES DES MATIERES

DO NOT COPY

Page

ARTICLES

Emin Riza

L'histoire de l'architecture et la restauration deux disciplines complémentaires 12

Selami Pulaha

Les villes albanaises sous le régime féodal militaire Ottoman au cours des XVe et XVIe siècles. 43

Vera Bushati

Sur la typologie de l'habitation antique en Albanie 58

Apollon Baçe

Les routes albanaises au moyen-âge (du VIIe au XVe siècle) 65

Mustafa Arapi

La conservation et la restauration de la partie centrale de l'iconostase de l'église évangélique dans la citadelle de Berat 79

MATERIAUX

Gjerak Karaiskaj

Cités fortifiées sur le plateau de Kolonjë et dans la partie supérieure de la vallée d'Osum 98

Aleksandër Meksi

Les églises de l'Albanie Centrale et du Nord (suite) 123

Bep Jubani

Monuments archéologiques à Mbishkodër. 140

Les travaux de restauration effectués en 1982 147

COMMUNICATIONS

Ali Muka

Un symposium «L'épos héroïque albanais» 154

Nr. 1 1984

monumentet

ARTIKUJ

DO NOT COPY

Emin RIZA

HISTORIA E ARKITEKTURËS DHE RESTAURIMI, DY DISIPLINA PLOTËSUESE

Në vendin tonë, veçanërisht pas krijimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës, në vitin 1965, është kryer një veprimtari e rëndësishme për gjurmimin, studimin dhe restaurimin e monumenteve të arkitekturës. Objekt trajtimi dhe përkujdesjesh janë bërë një numër krahasimisht i madh veprash ndërtimore, që shquhen për diapazonin e gjërë kohor dhe larminë e madhe të gjinive. Megjithëse puna me monumentet nuk ka pasur asnjë traditë në vendin tonë, por është e lidhur vetëm me përkujdesjen e madhe të rendit socialist dhe personalisht të udhëheqësit të Partisë dhe popullit shokut Enver Hoxha, përfundimet e derisotme flasin qartë për një ecuri me hapa të shpejta në këtë fushë. Këto arritje kanë në bazën e tyre metodologjinë marksiste-leniniste dhe zbatimin rigoroz të metodikës shkencore. Puna me monumentet në tre hallkat themelore të gjurmimit, studimit dhe restaurimit ka prurë deri më sot, një përvojë të mirë, e cila e bën të mundur shtrimin dhe vrojtimin e bashkëmarrëdhënieve ndërmjet dy disiplinave, historisë së arkitekturës dhe restaurimit në kuadrin shqiptar në planin teorik, edhe atë praktik. Përsa i përket gjurmimit të monumenteve, si një veprimtari vlerësuese dhe zgjedhëse, nëpërmjet njohjes së kategorive të ndryshme për nga gjinia dhe koha, është jashtë çdo dyshimi se ajo i përket sferës së historianit të arkitekturës, prandaj nuk do të ndalemi në këtë çështje.

Historia e arkitekturës dhe restaurimi i monumenteve të arkitekturës si disiplina kanë fillesa të ndryshme në kohë, e para mjaft të hershme, e dyta shumë më të vonë. Ata që punuan më shumë në fushën e restaurimit për të përcaktuar kriteret bazë të shkallës dhe mënyrës së ndërhyrjes qenë historianët e arkitekturës. Shpjegimi është i qartë, ndërhyrja restauruese në një vepër arkitektonike të parë në vlerën e saj të dyfishtë si dokument historik dhe vepër arti, presupozon njohjen e thellë të karakteristikave të veprës konkrete, si edhe të mbarë ndërtimeve të së njëjtës gjini, dhe më tej jo vetëm të këtyre. Restaurimi, në kuptimin e mirëfillt të termit, përfshin qëndrimin karshi monumentit si produkt i rrethanave historike të caktuara në përgjithësi dhe atyre konkrete, të cilat e individualizojnë veprën në kuadrin e një tipologjie të caktuar. Ky qëndrim vlerësues i përgjithshëm, i cili e sheh monumentin e dhënë në kuadrin e bashkësisë së së njëjtës gjini, ndërthuret me aspektin e vlerësimit të gjendjes teknike të tij, si një preokupim i rëndësishëm lidhur me ruajtjen e veprës arkitektonike për sot dhe për të ardhmen. Pra ndërhyrja restauruese përfshin dy aspekte. I pari lidhet me qëndrimin ndaj veprës, duke pasur parasysh zhvillimin e saj në kohë, zhvillim i cili jo gjithmon bie kontribute, që meritojnë cilësimin dëshmi historiko-artistike. I dyti lidhet me konsolidimin e qëndrueshmërisë statike të veprës, dhe në përgjithësi të shëndetësimit të saj, të cilat sigurohen me mirëmbajtje të vazhdueshme. Rrjedhimisht qëndrimi karshi monumentit kërkon njohuri që përmblidhen në disiplinën e historisë së arkitekturës dhe asaj të konstruksionit e madje në disa raste dhe të shkencave të tjera.

Disiplina e restaurimit, shtron si problem themelor të çdo ndërhyrjeje në monument, qëndrimin karshi fazave të ndërtimit. Ky problem për tu zgjidhur sa më drejt, kërkon së pari njohjen e plotë të zhvillimit në kohë të monumentit, shtesat që ka pësuar ai, ndry-

shimet në formulimin arkitektonik dhe atë konstruktiv, zëvendësimet e elementeve të ndryshëm përbërës etj. Por njohja e plotë e këtyre, nuk është e mjaftueshme për të marrë një vendim të drejtë mbi shkallën dhe mënyrën e ndërhyrjes restauruese. Është e domosdoshme që vendimi të këtë parasysh dhe një sërë të dhënash të tjera, si përhapjen e tipit, apo variantit në fjalë, vendin e monumentit në gjeografinë tipologjike, qënien e tij si dëshmi të vetme, etj. Të gjitha këto presupozojnë njohuri që përfshihen në sferën e mirëfilltë të historisë së arkitekturës. Është e kuptueshme pra se pa këto restauratori nuk mund të marrë një vendim të drejtë lidhur me ndërhyrjet në një monument, i cili nuk është një krijim i izoluar por jeton në një kontekst shumë të gjërë territorial dhe kohor. Ai është pjesë e trashëgimisë kulturore në përgjithësi, dhe si dëshmi historike, bart vulën e kohës, të kushteve ekonomiko-shoqërore dhe të rrethanave specifike të krijimit. Konsolidimi i monumentit vetëm si vepër ndërtimore që kërkon përkujdesje teknike, do të ishte një kuptim tepër i ngushtë i restaurimit me pasoja negative për trajtimin e tij si dëshmi historike.

Më prekshëm le të ndalemi në rrugët dhe njohuritë që duhet të ketë restauratori për të arrirë në përcaktimin e njërës prej detyrave themelore studimore, e cila paraprin domosdoshmërisht hartimin e projektit të restaurimit, atë të përcaktimit të fazave të ndërtimit. Treguesi kryesor dhe i parë në orientimin e restauratorit drejt përcaktimit të fazave të ndërtimit, në mungesë të dhënash dokumentare, që përgjithësisht përbën dukurinë e zakonshme, është ai tipologjik. Çdo shmangie nga tipologjia, është një tregues që duhet mbajtur si i rëndësishëm, në kërkimin e zhvillimit në kohë të monumentit. Këtij treguesi i shtohen dy të tjerë, shpesh tepër të rëndësishëm, formulimi arkitektonik-dekorativ i elementeve formues të veprës, si dhe teknika e ndërtimit. Është e kuptueshme se të tre këta përbërës të marrë veças, si dëshmi kryesore, apo siç ndodh zakonisht bashkërisht, me ndërvarësi plotësuese ndaj njëri tjetrit, kanë parësi të ndryshme sipas gjinive të monumenteve. Përgjithësisht tipologjia shprehet me një qëndrueshmëri krahasimisht të spikatur në monumentet e kultit, me program që shquhet për konservatorizëm të theksuar. Në ndërtimet popullore, tipologjia dhe trajtimi arkitektoniko-dekorativ janë thuajse të barasvlershëm, ndërsa në monumentet e gjinisë së fortifikimeve parësinë e ka teknika e ndërtimit dhe tipologjia e elementeve. Të tre këta tregues kryesorë, në përcaktimin e zhvillimit në kohë të monumentit, i përkasin historisë së arkitekturës. Është e kuptueshme se njohja e tyre, në mbarë evolucionin kohor, kërkon dije të gjëra e të sakta nga ana e restauratorit.

Edhe aspekti tjetër i qëndrimit karshi monumen në planin konstruktiv, teorikisht dhe praktikisht, n është një problem thjeshtë teknik. Mënyrat e ndë hyrjeve për ruajtjen e qëndrueshmërisë statike të m numentit, teknikat për zbatimin e këtyre ndërhyrjev teknika dhe materialet e ndërtimit, që për arsye domosdoshme do të prekin monumentin, do ti në shtrohen gjykimit të restauratorit, në aspektin e ruc tjes së vlerave dokumentore-arkitektonike të veprës. të tilla ato nuk duhet të tjetërsojnë vlerat autenti për të cilat vepra është vënë në mbrojtje. Kuptoh se edhe në këtë këndvështrim njohuritë e thella lëmin e historisë së arkitekturës janë një prej prem save për të siguruar përfundime të kënaqshme.

Praktikisht kur restauratori fillon vrojtimin an litik të monumentit, për të arritur në zhvillimin me k hë të tij, duhet të gjurmojë me kujdes çdo tregues cili drejtpërdrejt apo tërthorazi sqaron ndryshimet kohë të monumentit. Njohja teorike dhe praktike morfologjisë tipologjike dhe asaj arkitektonike-ko struktive, është një premisë e rëndësishme për arritur në përfundime të drejta, pa lënë mënjanë dhënat burimore e shkrimore dhe shpesh ato gojor të cilat veçanërisht në monumentet e gjinisë së ndë timeve popullore dhe atyre historike, ngrenë mjc peshë.

Nga sa u parashtrua më sipër, mund të arrih në përfundimin se për të kryer një ndërhyrje r stauruese në një shkallë të mjaftueshme kompeten profesionale, është e domosdoshme zotërimi i njoh rive që përfshihen në sferën e historisë së arkite turës.

Vimë tashti në mënyrën konkrete të zgjidhjes problemit, në kuptimin se nga cila fushë dijesh d het të jetë restauratori. Është e kuptueshme se zg dhja e parë, e do të thoshim më e drejta do të ish ajo që restauratori të ishte njëherazi historian ark tekture, apo njohës i mirë i historisë së arkitektur si dhe i teorisë dhe teknikës së restaurimit. Zgjidh e dytë do të ishte ajo e një veprimtarie të përb shkët ndërmjet historianit të arkitekturës dhe resta ratorit, i cili në këtë rast do të ishte praktikisht i dre tuar nga i pari në problemet thelbësore, dhe do përqëndrohej kryesisht në zgjidhjen teknike të pr blemeve të restaurimit. Në të dyja rastet, shfrytëzir i burimeve dhe botimeve të ndryshme që lidhen m monumentin dhe veçanërisht i atyre të historisë arkitekturës, është një premisë e vetkuptueshme. P këto burime, apo studime të bëra qoftë edhe për n objekt të vetëm, thuajse asnjëherë nuk mund të jer të mjaftueshme, për t'u mbështetur plotësisht në t lidhur me ndërhyrjen restauruese, sepse rrallë mur të përputhen plotësisht me kërkesat konkrete spec fike të ndërhyrjes. Prandaj një studim i veçantë hist

DO NOT COPY

riko-arkitektonik, plotësues, që ti përgjigjet kërkesave të restaurimit është i domosdoshëm. Zgjedhja e njërës nga të dy rrugët e mësipërme lidhur me profilin e kualifikimit të kuadrit, mendojmë se nuk duhet mbajtur si një çështje, e cila mund të zgjidhet paraprakisht, ashtu siç veprohet kur paraqiten dy variante, prej të cilit mund të zgjidhet njëri duke përjashtuar tjetrin. Këtu ndërthuren faktorë të shumtë të traditës, të volumit të punës, të shkallës së lëvrimit të disiplinave të historisë së arkitekturës dhe asaj të restaurimit, të formave konkrete organizative të veprimtarisë, si në fushën e studimit dhe atë të mbrojtjes së monumenteve etj.

Përvoja shqiptare e derisotme, e cila përfshin tashmë një veprimtari rreth 25 vjeçare, paraqet interes, sepse ajo ka treguar një efikacitet të padyshimtë në zgjidhjen e një mori problemesh, krahasimisht shpejt dhe me kompetencë në dallim nga vende të tjera me tradita të hershme në këto çështje.

Së pari puna me monumentet në vendin tonë nisi si veprimtari gjurmuese, pra zgjedhëse dhe klasifikuese. Kuadrot që kryen këto punë të gjerë dhe do të thoshim themelore për të ardhmen e pasurisë në fushën e arkitekturës dhe artit, me shumicën e tyre ishin ngarkuar drejtpërdrejt me problemet e restaurimit të këtyre vlerave, ndërsa një pjesë më e vogël ishin arkeologë, historianë apo historianë arkitekturë. Puna gjurmuese dhe zgjedhëse e vlerave të arkitekturës qe një shkollë e vërtetë për kuadrot e reja, të cilat në këtë veprimtari u njohën, brenda një kohe të shkurtër me pasurinë e madhe në këtë fushë, duke hyrë kështu, shkallërisht, në problematikën tipologjike dhe atë të çështjeve të tjera të sferës së historisë së arkitekturës. Po këto kuadro u muarrën aktivisht me botimet e para, e përherë në rritje të vlerave të kësaj trashëgimie, krahas punës gjithashtu përherë në rritje në fushën e restaurimit të monumenteve të gjinive të ndryshme, veçanërisht pas krijimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës në vitin 1965.

Me zgjerimin e ndërhyrjeve restauruese u rritën përpjekjet për thellimin në shkencën e restaurimit, e cila shkallërisht po formohej mbi bazën e traditës sonë kulturore dhe koncepteve tona mbi vlerën e monumentit në jetën shoqërore. Krahas përpjekjeve për studime në fushën e kritereve dhe metodologjisë së restaurimit, vetë ecuria e veprimtarisë për ndërhyrjet konkrete në monument u mpleks ngjeshurazi si me studime përgjithësuese mbi gjini dhe lloje monumentesh ashtu dhe studime mbi monumente të veçanta. Praktikisht mbi restauratorët tanë, ra detyra e krijimit të atij fondi të domosdoshëm studimesh të përgjithshme e të veçanta të historisë së arkitekturës, mbi të cilët u mbështetën restaurimet. Në disa fusha të caktuara, si në ndërtimet e kultit dhe ato popullore studimet përgjithësuese tipologjike ecën më përpara, ndërsa për vetë natyrën e monumenteve në ndërtimet mbrojtëse zhvillim më të madh muarën studimet mbi monumente të veçantë. Autorët e këtyre studimeve, njëkohësisht dhe restauratorë të gjinive përkatëse, arritën kështu që brenda një kohe të shkurtër të zotërojnë problematikën e fushës, në sajë edhe të një qëndrimi të drejtë e largpamës lidhur me specializimin e kuadrit sipas gjinive kryesore të monumenteve. Praktikisht, pra, detyrat kryesore që shtroheshin lidhur me studimin dhe restaurimin e monumenteve të kulturës në vendin tonë diktuan si zgjidhje më racionale atë të shkrirjes së problematikës së historisë së arkitekturës me atë të restaurimit, me të njëjtët specialistë. Kështu Instituti i Monumenteve të Kulturës u bë realisht edhe qendra kryesore e studimit të arkitekturës shqiptare. Përvoja e derisotme, e kushtëzuar natyrisht nga detyrat dhe mundësitë konkrete për zgjidhjen e tyre, padyshim përbën një arritje e cila nuk duhet mbajtur si e vetmja. Dialektika e zhvillimit të njohurive dhe forcave shkencore në dy disiplinat në shqyrtim, mund të bjerë zgjidhje të reja, të cilat do të ishin të pranueshme vetëm kur të siguronin plotësisht ndërhyrje në monumentet mbi baza shkencore. Rëndësi ka që të dy këto disiplina, vërtet të veçanta, por njëherazi të lidhura ngushtë me marrëdhënje kontributesh të ndërsjellta, të mbajnë parasysh domosdoshmërinë e zgjidhjes së drejtë të problematikës restauruese në monumentet.

Parashtrimi në planin teoriko-praktik i lidhjeve të ngushta ndërndihmuese në mes disiplinës së historisë së arkitekturës dhe restaurimit, si dhe përvoja e jonë në zgjidhjen e këtyre bashkëmarrëdhënieve do të mbetej disi didaktike nëse nuk do të ndaleshim më konkretisht mbi një çështje tjetër. Është fjala për shembujt konkretë të përvojës sonë lidhur me ndihmesën që kanë dhënë njohuritë e historisë së arkitekturës për restaurimin e monumenteve dhe anasjelltas, ndihmesën që kanë dhënë punimet e restaurimit në saktësimin dhe pasurimin e disa problemeve të historisë së arkitekturës.

Studimet e punonjësve të Institutit të Monumenteve në fushën e historisë së arkitekturës, në përgjithësi, kanë pasur në bazën e tyre synimin për ti shërbyer ndërhyrjeve sa më të shëndosha restauruese. Pra në këta artikuj krahas trajtimit të problematikës arkitektonike, të themi me mënyrën tradicionale të studimeve në këtë fushë, vërehet një prirje e qartë drejt analizës së zhvillimit në kohë të monumentit, duke prurë kështu një ndihmesë të prekshme lidhur me qëndrimin gjatë ndërhyrjeve restauruese. Artikulli «Monumenti i Agonotetëve» (rikonstruksioni i pamjes

DOKTORATURA

kryesore)[1] mbi bazën e një studimi të imët të materialeve të dala nga gërmimi arkeologjik i këtij monumenti, si në planin arkitektonik ashtu edhe në atë teknik, arrin në përfundime konkrete mbi anastilozën e pamjes kryesore të këtij monumenti të rëndësishëm. Ai korigjoi në mënyrë të argumentuar edhe disa pasaktësi të një studimi të mëparshëm[2], duke mundësuar kështu kryerjen me sukses të anastilozës së këtij monumenti. Në artikullin «Shetitoret e periudhës qytetare ilire»[3] shohim qartë përkujdesjen e studjuesve të arkitekturës për problemet që lidhen drejtpërdrejt me restaurimin e këtyre ndërtimeve. Arritje me përfundime të rëndësishme lidhur me formën origjinale, veçanërisht të shetitores së Apollonisë shprehin qartë këtë këndvështrim të veçantë. «Muret rrethues të Butrintit në Mesjetë shek. XIII-XIV»,[4] është një artikull tjetër i cili duke dhënë një ndihmesë me rëndësi për kronologjinë e teknikave të ndërtimit për periudhën në shqyrtim në këtë monument, përbën një bazë të shëndoshë për qëndrimin restaurues ndaj tij. Artikujt «Arkitektura e Kishës së Mesopotamit» dhe «Të dhëna të reja për Kishën e Mesopotamit»[5], janë nga shembujt më të spikaturë të studimeve që i shërbejnë drejtpërdrejtë restaurimit, sepse përveç trajtimit analitik të arkitekturës, me përkujdesjen e veçantë për zbulimin e fazave të ndërtimit, ai shoqërohet me një dokumentacion të pasur dhe me sondazhet arkitektonike. «Kështjella e Petrelës»[6] gjithashtu shquhet për ndihmesën e rëndësishme lidhur me problemet e restaurimit, sepse aty paraqiten në mënyrë të argumentuar fazat e shumta të ndërtimit të këtij fortifikimi. «Kullat mesjetare të sahateve»[7] e trajton problemin e vlerave arkitektonike me ndërlidhje të ngushtë me zhvillimin kohor të këtyre monumenteve. Monografia «Qyteti-muze i Gjirokastrës»[8], me analizën morfologjike dhe kronologjike të ambienteve dhe elementeve arkitektonike-konstruktive të banesës gjirokastrite, dhe dhënien e fazave të ndërtimit të monumenteve të kategorisë së parë, jep një ndihmesë të dukshme në zgjidhjen e problematikës restauruese të banesave të këtij qyteti-muze. Natyrisht këtu nuk mund të përmenden artikujt e shumtë të botuar në revistën «Monumentet», të cilët kush më shumë e kush më pak, në përputhje me tiparet dhe problematikën e monume
tit, si dhe me synimet edhe përgatitjen e autorëv
krijojnë atë bazë të domosdoshme për të arritur
ndërhyrje të drejta restauruese.

Përpara se të kalojmë në shqyrtimin e disa sh
mbujve tipikë, që ilustrojnë ndihmesën e njohuri
tona mbi historinë e arkitekturës, për restaurime
drejta, po ndalemi mbi një problem tjetër, i cili
thelb lidhet me bashkëmarrëdhëniet e dy disiplina
në shqyrtim. Është fjala për zbatimin e parimit të nj
hur të disiplinës së restaurimit, se ndërhyrjet resta
ruese në një monument të mbuluar pjesërisht ap
plotësisht, duhet të bëhen vetëm pas zbulimit të pl
të të tij. Nëse nuk zbatohet ky parim, ka shum
mundësi që të kryen ndërhyrje të gabuara, sepse a
bazohen mbi të dhëna të pjesëshme mbi monumenti
Në vitet e para të punës restauruese në vendin ton
ka pasur edhe ndonjë rast të tillë, kur mungesa
njohurive në fushën e arkitekturës nuk ka tërheq
vemendjen e restauratorëve mbi gjendjen e monu
mentit i cili nga mbushje të mëvonshme krijonte n
pasqyrë të shtrembëruar të gjendjes origjinale. Kë
shtu në një pjesë të mureve rrethues verilindorë dh
veriperëndimorë të kalasë së Beratit, janë kryer ndë
hyrje të gabuara me restaurimin e bedenave dh
trapit të kalimit, sepse nuk janë marrë parasysh mbu
shjet e mëvonshme, të cilat kanë fshehur gjurmët or
gjinale të këtyre elementeve. Gjithashtu një ng
shkaqet kryesore që e ka çuar arkitektin francez Em
Grand, i cili bënte pjesë në misionin arkeologj
francez që gërmonte në Apolloni, nën drejtimin
arkeologut Leon Rej, në një rikonstruksion të gabu
të pamjes kryesore të monumentit, të Agonotetëve, ish
gërmimi jo i plotë i tij. Në mjaft raste në muret rre
thuese të ndërtimit mbrojtës, ndeshen trakte të vogl
të rrënuara deri në nivelin e truallit. Është e kuptue
shme se mendimi i parë që do ti vinte restauratori
do të ishte ai i mbushjes së këtij boshllëku, për t
mos lejuar dëmtimin e mëtejshëm të monumentit. Po
shpesh ndodh që rrëzimi i një trakti relativisht të vo
gël të shkaktohet nga qënia aty e një dere, apo ho
pësire tjetër. Prandaj përpara ndërhyrjes restaurues
duhet të bëhet largimi i mbushjeve, për t'u siguru

1) K. Zheku, **Monumenti i Agonotetesë (rikonstruksioni i pamjes kryesore),** «Monumentet» 4/1972.
2) L. Rey, **Le monument des Agonothètés,** Albania, 5/1935.
3) A. Baçe, N. Ceka, **Shëtitoret e periudhës qytetare ilire,** Monumentet, 2/1981.
4) Gj. Karaiskaj, **Muret rrethues të Butrintit në mesjetë shek. XVIII-XV,** Monumentet 20/1980.
5) A. Meksi, **Arkitektura e kishës së Mesopotamit,** Monumentet 3/1972. A. Meksi, **Të dhëna të reja për kishën e Mesopotamit,** 10/1975.
6) A. Baçe, Gj. Karaiskaj, **Kështjella e Petrelës,** Monumentet 5-6/1973.
7) S. Dashi, **Kullat mesjetare të sahatit në vendin tonë,** Monumentet, 12/1976.
8) E. Riza, **Qyteti muze i Gjirokastrës,** Tiranë, 1981.

DO NOT COPY

se nën to nuk ruhen pragje apo patura, të cilat do të kërkonin një ndërhyrje tjetër restauruese. Shembuj të tillë janë ndeshur në praktikën tonë në kalatë e Lezhës, Durrësit, Paleokastrës etj.

Le të shtjellojmë tashti disa shembuj tipikë të ndihmesës së njohurive mbi historinë e arkitekturës në qëndrimin restaurues karshi monumentit. Në qytetin antik të Butrintit, mbi portën «Skea» mbi një mur të periudhës antike ngrihej një trakt i vogël muri, i periudhës romake. Gjendja e murit antik ishte i tillë që kërkonte ndërhyrje restauruese, e cila do të kryhej në kushte mjaft të favorshme nëse ky trakt i vonë do të hiqej. Por kjo fazë u ruajt, sepse ajo paraqiste një interes të madh si dëshmi e ndërtimeve në kohën romake dhe më ngushtë e funksionit të kësaj porte në këtë kohë. Në këtë rast shmangia nga restaurimi çlirues, u arrit mbi bazën e një njohje të mirë të teknikave të mureve.

Në një rast tjetër, gjithashtu në Butrint, në murin rrethues[9], ndërmjet portës «Skea» dhe portës së «Luanit» mbi një trakt krahasimisht të gjatë muri me teknikën e zakonshme me gur të shrregullt, e cila ka një diapazon shumë të gjërë datimi, ruhet një trakt i vogël me teknikën «opus reticulatum». Për historianin e arkitekturës kjo dëshmi është e një vlere të jashtëzakonshme, sepse duke qenë teknikë e datueshme saktë, ajo lejon edhe një kufi kohor për datimin e murit mbi të cilin ngrihet. Në këtë rast restauratori duhet ti kushtojë një përkujdesje të madhe ruajtjes me çdo kusht të kësaj gjurme. Në kalanë e Elbasanit ruhen trakte muresh të shek. IV. Krahas tyre në disa pjesë mbi ta, ruhen edhe gjurmë të një teknike tjetër që datohet e shek. VI. Traktet e fundit janë mjaft të dëmtuara nga koha, veçanërisht në të dy faqet e jashtme të trashësisë së murit, duke mbetur në këmbë vetëm bërthama e murit. Për të konsoliduar këto trakte, ndërhyrjet restauruese kërkojnë mbushjen e boshllëqeve anësore. Por nëse restauratori nuk do të dallonte ndryshimet e vogla, por domethënëse ndërmjet të dy teknikave të shek. IV dhe VI, ai do ta bënte mbushjen me teknikën më të hershme dhe praktikisht, gjithë duke konsoliduar traktin e murit në fjalë, do të zhdukte një gjurmë të rëndësishme dokumentare.

Në kalanë e Rodonit[10] ruhet një frëngji topi, balli i së cilës është pjesërisht i rënuar. Në pjesën e poshtme të kësaj pjese, ruhet një trakt cilindrik, pra me seksion rrethor, në rreth dy të tretat e tij. Datimi i këtij fortifikimi në shek. XV, i lejon historianit të arkitekturës të arrijë menjëherë përfundimin se kemi të bëjmë me një frëngji topi të tipit në formë çelsi. Mosnjohja e morfologjisë dhe kronologjisë së këtij elementi, mund të çonte lehtë në konsiderimin e kësaj gjurme si një frëngji me seksion rrethor. Një rast mjaft tregues është edhe vlerësimi i kishës së Perhondisë[11] (shën Kolli) e cila me kohë, dhe veçanërisht me ndërhyrjet pa kriter në fillimet e shekullit tonë, kishte marrë një pamje që fshihte thuajse gjithshka nga vlerat e saj të vërteta. Vetëm familjarizimi i restauratorit me tiparet arkitektonike të kësaj gjinie, bëri që ky monument me rëndësi të madhe, dhe me këmbanoren unikale në vendin tonë, të vlerësohej dhe të restaurohej me sukses të plotë. Pas një studimi të imtë arkitektonik u vunë në pah fazat e ndërtimit me rëndësi të veçantë dhe pikërisht ato të fillimit të shek. XI, fillimit të shek. XIII dhe të shek. XIII-XIV. Njohuritë në lëmin e historisë së arkitekturës, i lejuan gjithashtu restauratorit përfundime të bazuara në restaurimin e kishave të Shën Mëhillit (shek. XIV) dhe Shën Triadhës (shek. XIII-XIX) në Berat[12].

Në ndërtimet popullore dhe veçanërisht në gjininë e banesës, shembujt e vendimeve të drejta restauruese mbi bazën e njohjes së tipareve dhe karakteristikave të kësaj kategorie ndërtimore, janë të shumta. Mjafton të përmendim ndeshjen, me rastet krahasimisht të dendura, të ndryshimeve që kanë pësuar ndërtimet e periudhës prej shek. XVIII deri në gjysmën e parë të shek. XIX, gjatë gjysmës së dytë të këtij shekullit dhe më vonë. Mbyllja e çardaqeve dhe ndryshimet në formulimin arkitektonik në përgjithësi, tashmë të njohura nga studimet tona, kanë mundësuar qëndrime të drejta në ndërhyrjet restauruese në këta monumente.

Por rëndësi të veçantë marrin dijet mbi njohjen e tipologjisë morfologjisë së elementeve arkitektonike-konstruktive dhe shpërndarjes gjeografike të shembujve të ndryshëm kur është fjala për ndërhyrjet restauruese në monumentet e kategorisë së dytë. Në bazë të legjislacionit tonë në këta monumente, pjesë të ansambleve urbanistiko-arkitektonike duhet vlerësuar pamja e jashtme, ndërsa në brendësi, ndërtesat mund të pësojnë ndryshime funksionale dhe të natyrave të tjera për të plotësuar kërkesat e jetës bashkëkohore.

9) Gj. Karaiskaj, **Fortifikimet në Shqipëri gjatë periudhës së hershme të sundimit romak,** Monumentet, 17/1979.

10) Gj. Karaiskaj, **(Materiali ruhet në arkivin e Institutit të Monumenteve të Kulturës).**

11) A. Meksi, **Probleme dhe aspekte të restaurimit të kishave bizantine në Shqipëri,** Monumentet, 12/1976.

12) A. Meksi, **Po aty,**

Por në mjaft raste në këta monumente fshihen vlera të rëndësishme, të cilat kërkojnë ruajtjen e ambienteve ose elementeve të veçantë dhe në ndonjë rast rikategorizimin e monumentit. Vetkuptohet se nëse nuk krijohen kushtet që punimet e restaurimit të ndiqen nga kuadro me kompetencë të gjërë shkencore, pra jo vetëm me njohuritë e teorisë dhe teknikës së restaurimit, dëmet mund të jenë të mëdha.

Shembujt e prurë, krahasimisht të pakët, po të kemi parasysh rastet e shumtë të ndeshura në praktikën e derisotme restauruese në vendin tonë, tregojnë si në planin teorik, ashtu edhe në atë praktik domosdoshmërinë e kontributit të historisë së arkitekturës për restaurime vërtet shkencore. Ata provojnë më së miri se pa njohur tiparet dhe historikun e zhvillimit në kohë të monumentit, ndërhyrjet restauruese bartin rreziqe të mëdha, duke mbajtur parasysh vlerën e dyfishtë të monumentit si dëshmi historike dhe vepër arti. Në bashkëmarrëdhëniet ndërmjet disiplinave të historisë së arkitekturës dhe asaj të restaurimit nuk kemi vartësi nga një kah i vetëm, d.m.th. historinë e arkitekturës si udhëheqëse për restaurime të bazuara. Gjatë kryerjes së punimeve të restaurimit, dhe veçanërisht në ato të hapjes e çveshjes dhe sondazheve, monumenti shpesh ofron të dhëna me rëndësi të jashtëzakonshme për historinë e monumentit dhe për pasojë për historinë e arkitekturës. Kjo dukuri është e kuptueshme po të kemi parasysh rrethanën se shumë rrallë, monumenti i arkitekturës, me histori shpesh shumëshekullore vjen pa ndryshime në kohë. Për arsye nga më të ndryshmet, që lidhen me zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi dhe kërkesave të ndryshueshme në kohë ndaj monumenteve, përveç shumë të tjerave, si shkatërrimet për shkak luftrash, fatkeqësish natyrore etj, që kanë detyruar rindërtime të shkallëve të ndryshme, monumentet e kulturës vijnë në momentin e mbrojtjes si një mozaik duarësh ndërtimi. Kuptohet se krahas rasteve kur prekjet e reja janë bërë në mënyrë të tillë që lejojnë lehtësisht të ndiqen fazat e ndërtimit, pa hyrë në strukturat e fshehura, nuk janë të pakta rastet kur gjurmët e këtyre ndryshimeve i fshehin suvatimit, ose në përgjithësi riprekjet, apo shtesat, duke mos i lejuar as studjuesit të specializuar të arrijë në përfundime të sakta mbi zhvillimin në kohë të monumentit dhe vlerat e vërteta të tij. Ndërhyrja restauruese jep rastin ideal për të depërtuar thellë në strukturën e monumentit, për të vrojtuar dhe interpretuar të dhënat e reja, për të lidhur treguesit e d shimtë në një fill të vetëm dhe të pakundërshtu shëm. Shumë hipoteza e dyshime, që shpesh nuk sqarojnë as sondazhet, i qartëson ndërhyrja restau ruese, e cila depërton thellë në të fshehtat e m numentit. Ndihmesa e restaurimit në historinë e ark tekturës në këto raste është shpesh e një rëndësie madhe. Lidhur me këtë është e domosdoshme ngulim këmbë edhe mbi një aspekt me rëndësi, d është e domosdoshme të konsiderohet me serioz tetin e duhur. Është fjala që këto të dhëna të rr ken mirë, e të mos humbasin në veprimtarinë kor krete ndërhyrëse në monument, e cila përfshin pra tikisht jo vetëm specialistë të lartë e të mesëm, p edhe mjeshtra ndërtimi e punëtorë. Është e d mosdoshme që punimet e hapjes së monumentit ndiqen nga një njohës i mirë e tipareve arkitekto nike të gjinisë që përket monumenti që preke qoftë ky historian arkitekture, apo historian arkite ture dhe restaurator njëherazi. Mosndjekja e gju mëve dhe dëshmive të reja, ose moskuptimi i tyr do të binin padyshim pasoja të parregullueshme p historinë e monumentit. Edhe në këtë këndvështri shihet qartë se restaurimi është një proçes i gjër veprimtarie, i cili veçanërisht në disa momente, kë kon njohuri të thella e të sakta, që përfshihen n fushën e historisë së arkitekturës.

Në praktikën tonë restauruese, ku më pak e k më shumë shembujt e ndihmës së ndërhyrjeve re stauruese për historinë e arkitekturës nëpërmjet zbu limit të dëshmive të panjohura, janë krahasimish të shumtë. Së pari po përmendim punimet e restau rimit në kishën e Perhondisë[13]. Gjatë punimeve t çlirimit dualën në dritë vlera shumë të rëndësishm për historinë e monumenteve të kultit të vendit ton Këto vlera të fshehura nga riprekje pa kriter, iu r kthyen fondit të trashëgimisë sonë kulturore. Edh punimet e restaurimit në kishën e Shën Todrit[14] në kalanë e Beratit prunë të reja të rëndësishme l dhur me zhvillimin në kohë të këtij monumenti, duk zbuluar rindërtime, të cilat tregojnë qartë se kish që ruajmë sot është ringritur mbi një ndërtim më t hershëm kulti. Gjurmët e këtij të fundit janë lën të dukshme si dokument me vlerë për historinë e kë tij monumenti. Punimet e restaurimit në xhaminë Allajbegisë[15] në fshatin Burim, të rrethit të Dibrës nxorrën në dritë mbështetëset trekëndëshe, nën ni

13) A. Meksi, **Arkitektura dhe restaurimi i kishës së Perhondisë,** Monumentet, 5-6, 1973.
14) S. Dashi, (Materiali ruhet në arkivin e Institutit të Monumenteve të Kulturës).
15) A. Meksi, L. Suli, — **Punimet konservuese dhe arkitektura e xhamisë Allajbegisë në Burim të Dibrës,** Monumentet 17/1979.

DO NOT COPY

velin e kupolës, të cilat ishin murosur. Mbi to u zbuluan gjurmët origjinale të muraturës dhe kornizave, të cilat ishin mbuluar nga një fazë e dytë. Kështu u arrit të zbulohej forma origjinale e këtaj pjese të rëndësishme të strukturës konstruktive të xhamisë në fjalë.

Në gjininë e banesës popullore shembujt e dëshmive të reja, të cilat dalin në dritë gjatë punimeve të restaurimit janë vërtet të shumta. Ndryshimet e mëdha që pëson kjo gjini monumentesh në kohë, e bëjnë të kuptueshme ruajtjen e shumë gjurmëve që të çojnë te këto ndryshime. Për arsye të kuptueshme, zakonisht, rindërtimi i mbyll këto dëshmi, të cilat i nxjerr sërish në shesh restaurimi, kur ai prek strukturat e ndryshuara. Me interes është të përmendim punimet e restaurimit në një banesë[16] të vitit 1842, në qytetin e Korçës. Këtu gjatë punimeve të restaurimit dolën qartë elemente origjinalë, të mbyllur, të cilët tregonin se pjesa qendrore e katit të parë ishte një qoshk i hapur, shembull ky me interes të veçantë për këtë qendër ku mbizotëron banesa e mbyllur. Të shumta janë edhe rastet e zbulimit të vlerave të rëndësishme të pikturave murale në banesa, gjatë punimeve të pastrimit. Shembullin më të spikatur në këtë drejtim e japin punimet e restaurimit në një ndërtim të tipit kullë në Berat[17]. Për tu përmendur janë edhe punimet e pastrimit në tamburin e oxhakut, të odës së miqve, në banesën e Skëndulajve (1823) në Gjirokastër, të cilat nxorrën në dritë një dekor të pasur. Edhe në restaurimet e banesave fshatare punimet e restaurimit kanë prurë kontribute me vlerë për çështje që lidhen me historinë e arkitekturës. Kështu në një banesë trekullëshe[18], në fshatin Klos-Katund të rrethit të Matit, gjatë ndërhyrjes restauruese në kullën më të vjetër, dolën të qarta gjurmët e një telizi, i cili ishte në vazhdim të qoshkut të katit të sipërm. Ky fakt ka rëndësi për tipologjinë e kësaj banese.

Për tu theksuar është edhe një aspekt tjetër i rëndësishëm, i ndihmesës së punimeve restauruese në sferën e teknikës së ndërtimit. Në shumicën e rasteve teknika e shumë elementeve konstruktive të monumenteve, është fshehur nga suvatime, mbushje, apo veshje të ndryshme, të cilat praktikisht nuk lejojnë të vrojtohet teknika e konstruksioneve të ndryshme dhe kryesisht e mureve. Punimet e restaurimit, krijojnë një rast shumë të volitshëm për të vrojtuar teknikën e ndërtimit, e cila shpesh bart tregues të rëndësishëm datues, përveç vlerave për historinë e zhvillimit të teknikës së ndërtimit në shekuj.

Përfundimisht theksojmë se historia e arkitekturës dhe restaurimi janë dy disiplina komplementare, të cilat i bashkon objekti i njëjtë i studimit dhe ndërhyrjes. Këto dy shkenca ndihmojnë njëra tjetrën, në faza të ndryshme të asaj veprimtarie të gjërë teoriko-studimore dhe praktiko-zbatuese që emërtohet restaurim i monumenteve. Megjithëse me pikësynime të ndryshme, të dy këto disiplina kanë përkujdesje të njëllojtë për ruajtjen e monumentit si dokument historik dhe vepër arti. Vetëm ndërveprimi ndërmjet këtyre mund të garantojë ndërhyrje të drejta, për ti pasur sot e përgjithmonë monumentet dëshmi të prekshme të një periudhe të caktuar, në shkallën më të lartë të vërtetësisë së tyre. Një restaurim i gabuar i cili tjetërson pjesë të monumentit, ose zhduk gjurmë që dëshmojnë për zhvillimin në kohë të tij, objektivisht ka zhdukur në mënyrë të pakthyeshme një dokument historik. Është krejt e kuptueshme pra se ndërhyrjet në monument duhet të bëhen me metoda sa më rigorozisht shkencore që prej studimit, projektimit dhe më tej të zbatimit të punimeve. Një artikull i gabuar për probleme të ndryshme mbi arkitekturën e monumentit, nesër do të korigjohet, ndërsa një restaurim i gabuar është shpesh i pakorigjueshëm.

Kolektivi i Institutit të Monumenteve të Kulturës, përherë e më tepër po përpiqet për të zbatuar siç duhet kërkesat shkencore për ndërhyrjet në monument. Atij për këtë i janë krijuar të gjitha kushtet. Fjala e udhëheqësit të dashur të Partisë dhe të popullit, shokut Enver Hoxha, në diskutimin e bërë në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH më 9 Maj 1983, ku ai thekson «mbrojtja dhe restaurimi bëhen dhe duhet të bëhen mbi baza shkencore»[19] na bën të shumfishojmë forcat dhe të përpiqemi që të rrisim njohuritë tona mbi monumentet, për t'i studjuar, mirëmbajtur dhe restauruar ato, si dëshmi të historisë mijravjeçare të etnosit dhe popullit tonë, që nuk rreshti së krijuari, krahas luftës shekullore për pavarësi dhe drejtësi shoqërore.

16) P. Thomo, **Banesat e hapura në qytetin e Korçës dhe disa probleme të restaurimit të tyre,** Monumentet /1/1982 (banesa Nr. 6).

17) E. Riza, H. Nallbani — **Një ndërtim i tipit kullë në Berat, (Arkitektura, dekoracioni dhe restaurimi)** Monumentet /10/1975.

18) L. Suli, **Një banesë karakteristike trikullëshe në Klos-Katund të Matit,** në «Tradita ndërtimore në Shqipëri», Tiranë, 1981.

19) Enver Hoxha, **Të ngrihen në një nivel më të lartë shkencat që studjojnë historinë, gjuhën dhe kulturën tonë kombëtare,** «Studime-politiko-shoqërore» 4/1983.

DO NOT COPY

Emin RIZA

DO NOT COPY

L'HISTOIRE DE L'ARCHITECTURE ET LA RESTAURATION, DEUX DISCIPLINES COMPLEMENTAIRES

RESUME

Une activité importante pour la découverte, l'étude et la restauration des monument de l'architecture a été déployée dans notre pays, particulièrement après la création de l'Institut des Monuments Culturels en 1965. Un nombre relativement élevé d'oeuvres de la construction, qui se distinguent par le vaste diapason temporel et la grande variété des genres, a fait l'objet de cette activité. Les conclusions, auxquelles l'on est arrivé jusqu'à ce jour témoignent de l'évolution à pas rapide du travail dans ce domaine, bien que l'on n'ait hérité d'aucune tradition. Tout a été le résultat des soins particuliers, que l'ordre socialiste et personnellement le guide du Parti et du peuple albanais, le camarade Enver Hoxha ont prêté à ce travail. Dans le travail pour la découverte, l'étude et la restauration des monuments, on a acquis une bonne expérience, laquelle rend possible l'analyse des corrélations entre les deux disciplines, l'histoire de l'architecture et la restauration, sur le plan téorique et pratique, dans le cadre albanais.

L'histoire de l'architecture et la restauration des monuments de l'architecture, en tant que disciplines, ont des débuts qui diffèrent dans le temps. Les débuts de la première sont assez anciens, ceux de la seconde très tardives. Ceux qui ont contribué le plus dans le domaine de la restauration, en vue de la détermination des critères de base du degré et du mode d'intervention, ont été les historiens de l'architecture. L'explication en est claire. L'intervention des restaurateurs dans une oeuvre architectonique, vue dans sa double valeur, en tant que document historique et en tant qu'oeuvre d'art, suppose une connaissance profonde des caractéristiques de l'oeuvre concrète, ainsi que de toutes les constructions du même genre, et encore davantage. La restauration, dans l'acceptation propre du mot, inclue l'attitude à prendre envers le monument, en tant que produit des circonstances historiques déterminées en général et de celles concrètes, lesquelles individualisent l'oeuvre dans le cadre d'une typologie déterminée. Cette attitude d'appréciation générale, qui considère un monument donné dans le cadre de tout un genre, est réliée à l'aspect de l'appréciation de son état technique, comme une préoccupation importante, quant à la conservation de l'oeuvre architectonique pour le moment et pour l'avenir. Donc l'intervention des restaurateurs présente deux aspects. Le premier relève de l'attitude à prendre envers l'oeuvre, en tenant en considération son évolution dans le temps. Le seco est lié à la consolidation de la résistance statique de l'oeuv et en général au renforcement de son ossature, qu'on peut a surer par une manutention continuelle. En conséquence, l'at tude à l'égard du monument exige des connaissances, qu'engl bent la discipline de l'histoire de l'architecture et celle de construction, et même, dans certains cas, les autres sciences.

Le problème fondamental de toute intervention de resta ration dans un monument, que pose la discipline de la resta ration, est l'attitude à l'égard des phases de construction. solution exacte de ce problème nécessite la connaissance int grale de l'évolution du monument dans le temps, les rajou qu'il a eu, les modifications dans la formulation architectoniq et constructionnelle, la substitution de divers éléments cons tuants etc. Mais cette connaissance ne suffit pas pour la pri d'une décision juste sur le degré et le mode de l'interventi de restauration. Cette décision doit prendre en considérati aussi une série d'autres données, comme l'étèndue du type, de la variante en question, la place du monument dans la gé graphie typologique, son existence en tant que témoigna unique etc. Tout ceci présuppose des connaissances ne releva que de la sphère propre de l'histoire de l'architecture. Bi entendu, sans cela, le restaurateur ne peut prendre une décisi juste, quant aux interventions à effectuer sur un monume lequel n'est pas une création isolée, mais vit dans un contex territoriel et temporel très vaste. Il fait partie de l'héritage cu turel en général, et en tant que témoignage historique, il por le sceau du temps, des conditions économiques et sociales des circonstances spécifiques de sa création.

Nous allons mettre l'accent surtout sur les connaissanc que doit avoir le restaurateur, en vue de la fixation de l'une d tâches fondamentales de l'étude, qui précède la nécessité d projet de restauration, celle de la détermination des phas de construction. Le premier critère à suivre par le restaurateu en vue de la détermination des phases de construction, à d faut de données documentaires, est celui typologique. Tou déviation de la typologie est un élément important dans la r cherches de l'évolution du monument dans le temps. A ce s'ajoutent deux autres éléments, la formulation architectoniqu et décorative des constituantes de l'oeuvre, ainsi que la techn

que de construction. Les trois éléments constituants pris séparément, comme témoignages principaux, ou, comme il advient d'habitude, tous ensemble, dans leurs corrélations avec l'un l'autre, selon le genre du monument revêtent des importances différentes l'un par rapport à l'autre. Généralement la typologie est très soulignée dans les monuments de culte, dont il programmés, lesquels se distingue par son conservatisme accentué. Dans les constructions populaires, la typologie et le traitement architectonique et décoratif sont de valeur presqu'égale, tandis que dans les monuments du genre de fortifications, c'est la technique de construction et la typologie des éléments qui ont la priorité. Ces trois éléments principaux, nécessaires à la détermination de l'évolution des monuments dans le temps, appartiennent à l'histoire de l'architecture. Bien entendu, leur connaissance, dans toute l'évolution temporelle, exige un savoir vaste et exact des restaurateurs.

De même, l'aspect de l'attiude à observer à l'égard du monument sur le plan constructionnel, en théorie et en pratique, n'est pas un problème tout simplement technique. Les modes d'intervention pour la conservation de la résistance statique du monument, les techniques d'application de ces interventions, la technique et les matériaux de construction, qui, pour des raisons de nécessité vont porter atteinte au monument, se soumettront au jugement du restaurateur, dans le sens de la conservation des valeurs documentaires et architectoniques de l'oeuvre. Tout cela ne doit toucher aux valeurs autentiques pour lesquelles l'oeuvre a été mise sous protection. Il va de soi que même dans ce sens, les connaissances profondes dans le domaine de l'histoire de l'architecture sont des prémisses de conclusions satisfaisantes.

Pratiquement, lorsque le restaurateur commence l'observation analytique du monument, afin de suivre son évolution dans le temps, doit examiner avec soin tout indice, qui directement ou indirectement jette de la lumière sur les changements du monument dans le temps. La connaissance théorique et pratique de la morphologie typologique et de celle architectonique et constructionnelle, constitue une premisse importante pour l'obtention de résultats justes, sans laisser de côté les données écrites et souvent orales, lesquelles ont assez de poids lorsqu'il s'agit particulièrement de monuments du genre des constructions populaires et historiques.

De ce qu'on vient d'exposer plus haut, l'on arrive à la conclusion que pour entreprendre une intervention de conservation à un degré de compétence professionnelle satisfaisante, il est nécessaire de posséder des connaissances relevant de la sphère de l'histoire de l'architecture.

Revenons maintenant à la manière concrète de résoudre le problème, à savoir dans quelle domaine de la science le restaurateur doit être spécialisé. Il va de soi que la première solution, la plus juste dirions-nous, serait que le restaurateur fût à la fois historien de l'architecture, ou bien un bon connaisseur de l'histoire de l'architecture et de la théorie et de la technique de restauration. La seconde solution serait celle d'une activité commune entre l'historien de l'architecture et le restaurateur. Celui-ci serait alors pratiquement adonné vers les problèmes fondamentaux, il se concentrerait principalement à la solution technique des problèmes de la restauration. Dans les deux cas, la mise à profit des sources et des diverses publications relatives au monument, et tout particulièrement de celles de l'histoire de l'architecture est une bonne premisse. Mais ces sources ou études effectuées même sur un objet unique, ne pourraient presque jamais être suffisantes, pour s'y appuyer complètement, lors d'une intervention de restauration, parce que rarement elles pourraient s'adapter tout à fait aux exigences concrètes et spécifiques de cette intervention. C'est pourquoi une étude particulière historique et architectonique, complémentaire, qui réponde aux exigences de la restauration est indispensable.

L'expérience albanaise acquise jusqu'à ce jour, qui comporte déjà une activité d'environ 25 ans, présent de l'intérêt, parce qu'elle a fait preuve d'une efficacité certaine dans la solution d'une foule de problèmes, relativement avec rapidité et compétence, différemment à certains autres pays ayant des traditions anciennes dans ce domaine.

Au début, le ravail avec les monuments dans notre pays a commencé avec une activité de recherche, donc de sélection et de classification. Les cadres, qui ont effectué ce vaste travail, qu'on pourrait considérer fondamental pour l'avenir de la richesse relevant du domaine de l'architecture et de l'art, étaient en majorité chargés directement des problèmes de la restauration des monuments. Une partie moindre deux étaient des archéologues, des historiens ou des historiens de l'architecture. Le travail de recherche et de sélection des valeurs de l'architecture a été une véritable école pour les nouveaux cadres. Ces derniers, en un temps trop court, ont fait connaissance avec la grande richesse existant dans ce domaine, en entrant ainsi, graduellement, dans la problématique typologique et dans celle des autres questions de la sphère de l'histoire de l'architecture. Ces mêmes cadres ont travaillé activement pour l'apparition des premières publications, qui se multiplieraient par la suite, sur les valeurs de cet héritage, de pair avec le travail, allant aussi toujours croissant, dans le domaine de la restauration des monuments de divers genres, surtout après la création de l'Institut des Monuments Culturels en 1965.

Les efforts visant l'approfondissement des connaissances dans la science de la restauration se sont accrus de pair avec l'élargissement des interventions de restauration. Cette science s'est formée graduellement sur la base de notre tradition culturelle et de nos conceptions sur la valeur des monuments dans la vie sociale. Les interventions concrètes de restauration sont combinées non seulement avec les études effectuées dans le domaine des critères et de la méthodologie de la restauration, mais aussi avec des études généralisatrices sur des genres

DO NOT COPY

et des types de monuments et avec des études effectués sur des monuments particuliers. C'est pratiquement à nos restaurateurs qu'a incombé la tâche de la création de ce fonds indispensable d'études générales et particulières, sur l'histoire de l'architecure, sur lesquelles se sont basées les restaurations. Dans certains domaines bien déterminés, comme dans les édifices de culte ou populaires, les études typologiques généralisatrices ont bien avancé. Tandis que dans d'autres domaines, en raison de la nature même des monuments, comme les fortifications, ce sont plutôt des études particulières qui se sont efffectuées. Les auteurs de ces études, ainsi que les restaurateurs des genres respectifs, ont réussi à connait la problématique du domaine respectif. Ceci a été rendu possible aussi grâce à l'attitude adopté quant à la spécialisation du personnel selon les genres principaux des monuments.

Les études que les spécialistes de l'Institut des Monuments de Culture ont effectuées dans le domaine de l'histoire de l'architecture, en général, ont ue pour but de servir aux mieux aux interventions de restauration. Dans ces études, de pair avec le traitement de la problématique architectonique selon la manière traditionnelle des études effectuées dans ce domaine, on a relevé aussi la tendance nette à analyser l'évolution du monument dans le temps, en donnant ainsi une contribution concrète dans la définition de l'attitude à adopter au cours des interventions de restauration. Dans la pratique de notre travail de restauration, les exemples, qui témoignent de la contribution de l'histoire de l'architecture, en vue de l'entreprise de restaurations justes, sont nombreux et incluent tous les genres de monuments. Ils prouvent que sans connaître les traits et l'historique de l'évolution du monument dans le temps, les restaurations comportent de grands dangers en tenant en considération la valeur double du monument en tant que témoignage historique et en tant qu'oeuvre d'art. Dans les corrélations entre la discipline de l'histoire de l'architecture et celle de la restauration, il ne s'agit pas d'une dépendance unilatérale, c'est-à-dire de l'architecture comme guide pour des restaurations bien basées. Au cours des travaux de restauration, le monument fournit souvent des données d'importance extraordinaire sur l'histoire du monument et en conséquence sur l'histoire de l'architecture. Ce phénomène est compréhensible si l'on prend en considération le fait que très rarement un monument d'architecture, d'une histoire propre souvent longue de plusieurs siècles, vient jusqu'à nous sans avoir subi des modifications dans le temps. Pour des raisons des plus diverses, liées au développement de la société en général et aux exigences envers les monuments changeant avec le temps, à part tant d'autres, comme les destructions advenues à la suite de guerres, catastrophes naturelles etc., qui ont provoqué des reconstructions à divers niveaux, les monuments de culture se présentent au moment de la mise sous protecion comme une mosaïque des phases de construction. Il va de soi que parallèlement au cas où les nouvelles retouches sont faites de manière à permettre de suivre facilement les diverses phases de construction, sans pénétrer dans les structures cachées, il n sont pas rares les cas où les traces de ces changements son couvertes par les crépis, ou, en général, par les retouches o les rajouts, ne permettant pas ainsi aux hommes d'étud spécialisés d'arriver à des conclusions justes sur l'évolution d monument dans le temps et sur ses valeurs véritables. L'inter vention de restauration fournit l'occasion idéale en vue d pénétrer profondément dans la structure du monument, en vu d'examiner et d'interpréter les nouvelles données, en vue d relier les indices douteux d'un fil unique et incontestable. Beau coup d'hypothèses douteuses, que souvent les sondages n réussissent pas à clarifier, l'intervention de restauration le clarifie. Cette dernière pénètre dans les profondeurs des mys tères du monuments. La contribution de la restauration dan l'histoire de l'architecture dans ces cas est souvent d'un grande importance. Quant à ceci, il est indispensable d'in sister aussi sur un autre aspect important, qu'il est nécessair de considérer avec le sérieux dû. Il s'agit d'accumuler ce données et ne pas les laisser se perdre dans l'activité con crète de la restauration du monument. Il est indispen sable que les travaux de restauration du monument soien suivis par un bon connaisseur des traits architectonique du genre, auquel appartient le monument qui fait l'objet d la restauration. Il peut être soit un historien de l'architecture soit un historien architecte et restaurateur en même temps. L fait de ne pas suivre les traces, de ne pas identifier les té moignages, ou de ne pas les comprendre aurait des consé quences irrémédiables pour l'histoire du monument. Même a ce point de vue, la restauration est un vaste processus d'act vité, qui à des moments précis, exige des connaissances pro fondes et justes relevant du domaine de l'histoire de l'arch tecture.

Dans notre pratique de travail, les exemples où les inte ventions de restauration ont apporté leur aide dans le do maine de l'histoire de l'architecture, au moyen de la découver de témoignages inconnus, sont relativement nombreux.

Il convient de souligner aussi un autre aspect importan celui de la contribution des travaux de restauration dans l sphère de la technique de construction. Dans la plupart de cas la technique de nombreux éléments constructionnels de monuments est cachée sous les crépis etc., qui ne perme tent pas d'examiner la technique de construction, surtout cell des murs. Les travaux de restauration donnent une occasio favorable pour examiner la technique de construction, qui sou vent fournit des indices importants sur la datation, à part le valeurs pour l'histoire de l'évolution de la technique de con truction au cours des siècles.

Enfin il convient de souligner que l'histoire de l'architectu et la restauration sont deux disciplines complémentaires, q sont unies par le fait qu'il s'agit du même objet d'étude de restauration. Ces deux sciences aident l'une l'autre, à d

DO NOT COPY

phases différentes de cette vaste activité théorique et d'étude ainsi que pratique et d'application, qu'on appelle restauration des monuments. Bien qu'ayant des visées différentes, ces deux disciplines prêtent les mêmes soins pour la conservation du monument, soit en tant que document historique, soit en tant qu'oeuvre d'art. L'interférence entre elles seulement peut garantir des interventions justes, pour que les monuments demeurent toujours des témoignages matériels d'une période déterminée. Une restauration erronée, qui modifie des parties du monument, ou bien fait disparaître des traces témoignant de son évolution dans le temps, en réalité élimine de façon irrémédiable un document historique. Il va de soi donc que les interventions dans un monument doivent être opérées selon des méthodes rigoureusement scientifiques, depuis l'étude du projet et jusqu'à l'entreprise effective des travaux. Un article erroné sur divers problèmes de l'architecture du monument, sera corrigé le lendemain, tandis qu'une restauration erronée est souvent incorrigible.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Selami PULAHA

QYTETET SHQIPTARE NËN REGJIMIN FEUDAL USHTARAK OSMAN GJATË SHEKUJVE XV-XVI

Njohja e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe politike të qyteteve shqiptare gjatë shekujve të parë të sundimit osman është bërë tashmë një nevojë e domosdoshme për kërkimet në fushën e historisë mesjetare të trevave shqiptare për arsye se nëpërmjet saj mund të zbulohen më qartë se deri tani disa çështje të rëndësishme siç janë ndryshimet që solli pushtimi osman dhe ndikimi i pushtetit të ri në jetën e qyteteve, tiparet e gjendjes së re të tyre në kuadrin e regjimit feudal osman, gjallërimi i jetës urbane në shek. XVI i lidhur ngushtë me zhvillimin e ekonomisë fshatare, struktura e re shoqërore, proçesi i islamizimit etj. Studimet e deritanishme megjithë kontributin e rëndësishëm që kanë sjellë[1], për shkak të mungesës të të dhënave dokumentare nuk kanë patur mundësi të ndriçonin në shkallën e duhur këto probleme. Për këtë arsye në këtë punim, do të përpiqemi të hedhim dritë më tej dhe të plotësojmë boshllëkun që ekziston lidhur me gjendjen e qyteteve në shek. XV-XVI, duke përdorur në radhë të parë të dhënat mjaft të pasura që gjenden për qytetet në regjistrimet e hollësishme kadastrale të kryera gjatë kësaj periudhe nga sunduesit osmanë[2], të cilat në përgjithësi ende janë shfrytëzuar pak nga historiografia e jonë.

Gjendja e qyteteve gjatë shek. XV dhe statusi i tyre në kuadrin e regjimit feudal osman.

Qyteti shqiptar vinte nga periudha e para pushtimit osman me një nivel të lartë zhvillimi, si qendër prodhimi e shkëmbimi, si qendër ekonomike e një hinterlandi bujqësor, si fortesë dhe qendër ushtarake-administrative, si udhëkryqe në arteret kryesore tregëtare që lidhnin krahinat shqiptare midis tyre si dhe tokat shqiptare në tërësi me vendet fqinje ballkanike dhe me ato evropiane perëndimore. Por pushtimi osman që arriti të vendosej në shumicën e viseve shqiptare në vitin 1479, shënoi ndërmjet të tjerash, ndryshime të mëdha negative në gjendjen ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore të tyre. Fushatat dhe inkursionet shkatërrimtare, luftërat e mëdha, grabitjet e plaçkitjet, shpopullimi i vendit i shkaktuar nga dhuna që përdorën pushtuesit osmanë, sollën si pasojë rrënimin dhe kthimin e tyre për mjaft kohë në gjendje të pabanueshme ose në qendra që nuk luanin më rolin ekonomik-shoqëror të qytetit. Disa qytete dhe kështjella të lulëzuara si Drishti, Deja, Shurdhahu, Sfetigradi u rrënuan thuajse krejtësisht, kurse qytetet e mëdha si Kruja, Shkodra, Lezha, Durrësi, Berati, Vlora, Gjirokastra etj u kthyen

1) **Historia e Shqipërisë,** v. I, Tiranë 1959. Z. Shkodra, **Esnafët shqiptarë,** Tiranë 1973.

2) Kemi parasysh defterët kadastralë të regjistrimeve të kryera në gjithë tokat shqiptare fill pas pushtimit në shek. XV dhe në mënyrë të veçantë regjistrimet e fundit të shek. XVI, me që përmbajnë më shumë të dhëna. Krahas tyre kemi përdorur edhe të dhënat e protokolleve (sixhilet) të gjykatave të kadinjve të Beratit dhe Elbasanit. Por siç dihet të dhënat e këtyre për shek. XVI janë të vanëra, me që sixhilatet e mbetura nga kjo periudhë janë shumë të pakta.

në gjendje fshati. Këto të fundit luajtën për mjaft kohë rolin e kështjellave strategjike ku u vendosën garnizone të fuqishme ushtarake dhe administrata qeveritare.

Burimet dokumentare bashkëkohore pasqyrojnë qartë gjendjen e mjerueshme dhe rrënimin e qyteteve, zhveshjen e tyre nga pjesa më e madhe e forcave të gjalla njerëzore, nga shtresat e zejtarëve, tregtarëve dhe inteligjencës. Kjo duket së pari në pakësimin e madh të sasisë së familjeve (shtëpiave-hane) që kishin qytetet në prak të pushtimit osman[3]. Kështu në vitin 1431[4] Berati kishte 175 shtëpi, Gjirokastra 121, Kanina 216, Korça 26, Himara 117, Kruja 125; në vitin 1485[5] Shkodra kishte 80 shtëpi, Peja 138, Drishti 15, Podgorica 40, Durrësi, një nga qytetet më të lulëzuara, në vitin 1501 nuk kishte asnjë familje përveç atyre të ushtarëve të garnizonit-gjendje që vazhdoi edhe gjatë shek. XVI. Tivari pas pushtimit në vitin 1570 kishte vetëm 77 shtëpi. Rrënimet dhe shpopullimi në qytetet e Kosovës, të cilat u pushtuan më 1445, ishin më të pakta. Ato ruajtën një numër të konsiderueshëm banorësh si p.sh. Prishtina kishte në vitin 1477 401 shtëpi, kurse Novobërda në vitin 1498/9 kishte 887 shtëpi[6].

Pushtimi osman e solli qytetin në një gjendje thuajse të shpopulluar, me aq banorë sa kishte një fshat madje edhe më pak. Kështu p.sh. në vitin 1431 fshati Labova e Madhe kishte 104 shtëpi, Labova e Vogël 93 shtëpi[7], Mborja 89 shtëpi etj.[8]. Një pjesë e banorëve e humbën jetën e tyre gjatë luftës për të mbrojtur lirinë, kurse të tjerët, për të mos qëndruar nën zgjedhën osmane, u detyruan të merrnin rrugën e mërgimit duke shkuar në Dalmaci dhe Itali. Bashkë me njerëzit e thjeshtë emigroi edhe një pjesë e madhe e zejtarëve, tregtarëve, njerëzve të shkencës, artit dhe të kulturës. Rrënimet dhe zbrazja e qyteteve ndërprenë përkohësisht zhvillimin e forcave prodhuese dhe i çuan ato në një nivel të kapërxyer me kohë. Zejtaria dhe tregtia ranë në një gjendje të ulët ose u shkatërruan fare[9]. Bashkë me to u eliminua edhe organizimi i vjetër qytetar dhe sistemi i lulëzuar i korporatave që ekzistonin para pushtimit osman në qytetet kryesore si Shkodra, Prizreni, Drishti, Kruja, Durrësi etj[10]. Si rrjedhim për mjaft kohë u paralizua jeta ekonomike-shoqërore që ishte shumë e gjallë në periudhën para pushtimit. Përveç zbrazjes së qyteteve u prishën edhe thesare më të çmuara të kulturës së kaluar, u rrëzuan përdhe veprat më të mira të arkitekturës, pallatet, monumentet, një pjesë e kishave dhe e katedraleve etj.

Pushtimi osman e ndryshoi krejtësisht fizionominë e organizimit të jetës qytetare. Me vendosjen e administratës së re osmane dhe të garnizoneve ushtarake qytetet, nga qytete të lira të administratuara në bazë të statuteve të tyre të veçantë, u kthyen në qendra administrative ushtarake dhe fetare. Në qytetet që shërbenin si qendra të njësive administrative bazë-sanxhakëve, u vendosën sanxhabejlerët-qeveritarë dhe komandantë të forcave ushtarake të sanxhakut si p.sh. në Gjirokastër, Shkodër, Elbasan, Prizren, Vuçitern, Ohër etj., kadinjtë-gjykatësit, allabejtë--komandantët e forcave ushtarake të spahinjve pas sanxhakbejlerëve, klerikët islamë, dizdarët-komandantë të garnizoneve të kalave, kurse në qendrat e njësive më të vogla administrative-nahijeve u vendosën funksionarët e një rangu më të ulët si subashët-funksionarë ushtarakë administrativë të një vilajeti ose qyteti, naibët-zëvëndësit e kadinjve etj. Në çdo kala qëndronin garnizonet e ushtarëve, të cilëve zakonisht iu ishin dhënë në zotërim timare të vegjël në vend të rrogave, dizdarët etj.

Gjatë etapës fillestare të pushtimit osman, qytetet duke pasur forca shumë të pakta njerëzore dhe duke rënë në gjendjen e fshatrave përsa i përket nivelit të zhvillimit ekonomik-shoqëror, luanin kryesisht rolin e qendrave administrative-ushtarake dhe të kështjellave.

---

3) Në të dhënat për numrin e shtëpive që do të japim nuk përfshihet sasia e familjeve të ushtarëve të garnizoneve të vendosura në qytete. Këto nuk janë shënuar në defterët kadastralë. Në këta zakonisht është regjistruar popullsia e ngarkuar me detyrime feudale si dhe zotëruesit e haseve, timareve, ziameteve.

4) H. Inalcik, **Sureti defteri sancaki arvanid,** Ankara 1954, shih timaret nr. 1 (f. 1b, 7b), 67, 75, 145, 276.

5) S. Pulaha, **Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485,** v. I, Tiranë 1974, f. 210-215, 314, 316-319.

6) A. Handžić, **Nekoliko vijesti o arbanasima,** Simpozium për Skënderbeun (9-12 maj 1968), Prishtinë 1969, f. 209; M. Dinić, **Za istoriju rudarstva u sredne vekovnoj Srbiji i Bosni,** II, Beograd 1962, f. 81.

7) H. Inalcik, **Sureti defteri...,** shih timaret nr. 1, 3, 7, 56.

8) Başbakanlik Arşivi, maliyeden müdevver, defter nr. 231, f. 69-84.

9) Z. Shkodra, **Esnafët shqiptarë,** Tiranë 1973, f. 22-23.

10) M. Šufflay, **Städte und Bürgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters,** Wien und Leipizg 1924, f. 30, Z. Shkodra, **Esnafët shqiptarë,** f. 24.

DOKUMENT

Pushteti osman qysh në fillim ndoqi kundrejt qyteteve një politikë që synonte të angazhonte një pjesë të madhe të banorëve të tyre me detyrime ushtarake ose me shërbime për mirëmbajtjen e kështjellave, të urave dhe të rrugëve pranë tyre etj., duke i falur nga një pjesë e rentës shtetërore. Kështu p.sh. sipas regjistrimit të vitit 1431, banorët e Krujës ishin ngarkuar me detyrimin për të ruajtur kështjellën[11]. Sipas regjistrimit të vitit 1583, 71 familje myslimane që banonin në varoshin e Krujës ishin ngarkuar me detyrimin për të ruajtur kështjellën dhe për të ndihmuar sanxhakbejlerët, eminët dhe mbledhësit e haraçit në vjeljen e detyrimeve dhe në punë të tjera shtetërore; 10 familje ishin ngarkuar me shërbimin për të mirëmbajtur rrugën që çonte në Sari Salltëk, kurse 47 të tjera të krishtera kryenin shërbime për mirëmbajtjen e ambienteve si të vendrojeve, tophanesë, hambarëve etj., të armatimeve të kalasë dhe të urave që ndodheshin në afërsitë e saj[12].

Banorët e Beratit, qysh nga koha e pushtimit në fillim të shek. XV, ishin ngarkuar me detyrimin për të marrë pjesë me armatimet e veta në luftërat për mbrojtjen e Vlorës nga sulmet e mundshme të armiqve të Perandorisë Osmane nga deti, dhe për shtypjen e kryengritjeve në Kurvelesh. Ata duhet të ndihmonin gjithashtu funksionarët në vjeljen e xhizjes, taksës së dhenve (adeti agnam) dhe të taksave të tjera shtetërore. Në shek. XVI ky detyrim iu ngarkua vetëm pjesës myslimane të popullsisë të qytetit.[13]

Banorët myslimanë të Elbasanit, sipas regjistrimit të vitit 1583, ishin ngarkuar me detyrimin për të marrë pjesë në luftërat për nënshtrimin e kryengritësve të krahinave të sanxhakut dhe për mbrojtjen e kalave të Durrësit dhe të Bashtovës nga sulmet e mundshme të armiave të perandorisë nëpërmjet detit. Po kështu ata duhet të ndihmonin autoritetet në vjeljen e taksave të xhizjes, të taksës së dhenve dhe të taksave të tjera shtetërore. Banorët e krishterë të këtij qyteti ishin ngarkuar për të mirëmbajtur dhe merremetuar vendrojet, tophanenë, kullat, hambaret dhe ambientet e tjera të kalasë, urat, xhaminë e qytetit.[14]

Popullsia myslimane dhe e krishterë e kalasë së Korçës sipas regjistrimit të vitit 1431, ishte ngarkuar me detyrimin për të meremetuar dhe mirëmbajtur kalanë dhe pajisjet e saj[15]

Popullsia e qytetit të Shkodrës ishte ngarkuar të mirëmbante, meremetonte dhe ruante urën e Bunës të ndërtuar nga sulltan Mehmeti II, si dhe të kryente shërbime të tjera shtetërore. Për meremetimin e kalasë ishin ngarkuar gjashtë burra-neferë (si meremetxhinj) dhe 26 të tjerë si hekurpunues dhe punëtorë[16]. Po kështu edhe banorët e varoshit të Drishtit ishin ngarkuar me detyrimin për të mirëmbajtur dhe meremetuar kalanë.[17]

57 familje nga qyteza e Rahonikut në Dibrën e Sipërme ishin ngarkuar të ndihmonin sanxhakbejlerët në punët shtetërore, tagrambledhësit dhe eminët për vjeljen e haraçit etj[18].

Banorët myslimanë të Gjirokastrës, sipas regjistrimit të vitit 1583, ishin ngarkuar me detyrimin për të mirëmbajtur kalatë të ndërtuara rishtas në Kurvelesh dhe për të ndihmuar në shtypjen e kryengritjeve të banorëve të kësaj krahine[19]; ata të Përmetit për të marrë pjesë në luftërat për nënshtrimin e kryengritësve të krahinës dhe për të ruajtur urat mbi lumin e Vjosës, kurse banorët e krishterë të po këtij qyteti, për të mirëmbajtur dhe për të meremetuar urën e sipërme dhe urën e ndërtuar nga çashnegjir Ajdin beu.[20]

Banorët e kalave të Këlcyrës, Skraparit dhe disa nga ata të Delvinës ishin ngarkuar për të meremetuar dhe ruajtur kalatë në fjalë,[21] kurse ata të Stelushit për të meremetuar e për të mirëmbajtur shkallët e depozitën e ujit në kala.[22]. Banorët e varoshit të kalasë së Petrelës ishin ngarkuar të ndihmonin

11) H. Inalcik, **Sureti defteri....,** timar nr. 276.
12) **Defteri mufassal liva-i Ohri,** cilt II, në Tapu ve kadastro umum müdürlügünün arşivi (TK,A), defter nr. 27, fl. 117, 119.
13) Sipas regjistrimit të vitit 1583 qyteti kishte 650 burra (nefer) myslimanë. Shih: **Defteri mufassal liva-i Avlonya, TK.A**, defter nr. 62, fl. 250, **Sixhilati i Beratit,** dosja 16, fl. 93a.
14) TK.A. **Defteri mufassal liva-i Ilbasan,** defteri nr. 66, fl. 10, 11; AQSH i RPSSH, Fondi i esnafit të tabakëve të Elbasanit, dok. nr. 801, 307.
15) Basbakanlik arşivi, maliyeden müdevver, defter nr. 231, f. 92.
Defteri mufassal liva-i Paşa, cilt. II, TK.A., defter nr. 52, viti 1568, fq. 74.
16) S. Pulaha, **Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485,** f. 317; TK.A., **defteri mufassal liva-i Iskenderiye,** defter nr. 59, fl. 5, 9, 291.
17) S. Pulaha, **Defteri i regjistrimit....,** f. 318.
18) TK.A, **defteri mufassal liva-i Ohri,** cild II, nr. 27, fl. 122.
19) TK.A. **Defteri mufassal liva-i Avlonya,** defter nr. 62, fl. 126.
20) **Po aty,** fl. 92.
21) **Po aty,** fl. 10, 171, 321, **Defteri mufassal liva-i Delvina,** defter nr. 91, fl. 10.
22) TK.A, **Defteri mufassal liva-i Ohri,** cild II, defter nr. 27; fl. 43.

PO KOPJE

DO NOT COPY

sanxhakbejlerët dhe bejlerët në rast nevoje (yoldaşlîgî hizmeti) dhe të shërbenin si udhërrëfyes për karvanet që kalonin në rrugën pranë kalasë.[23]

Sipas regjistrimit të vitit 1582, banorët e kalave të Medunit, Zhabjakut e Podgoricës ishin ngarkuar të meremetonin kalatë në fjalë dhe të ruanin grykat (derbendxhinj) në rrugën që çonte për në Plavë, Budimile, Pejë e Kosovë (banorët e Medunit), të mirëmbanin dhe të meremetonin urat që ndodheshin pranë, të punonin si hekurpunues (banorët e Zhabjakut dhe të Podgoricës). Përveç kësaj, 18 familje myslimane nga Podgorica ishin ngarkuar të ndihmonin në kryerjen e punëve shtetërore dhe sidomos për nënshtrimin e kryengritësve të Kelmendit, të Kuçit, të Pipërit, të Bratonozhiqit dhe të Palabardhit.[24]

Përkundrejt këtyre shërbimeve banorët e lartpërmendur të Krujës, të Beratit, të Elbasanit, të Korçës, të Shkodrës, të Drishtit, të Gjirokastrës, të Këlcyrës, të Skraparit, të Delvinës, të Stelushit, të Petrelës, të Tivarit, ishin falur zakonisht nga **taksat e jashtëzakonshme shtetërore-avarizi divaniye ve tekâlifi öfiye**. Në disa prej qyteteve, ishin falur edhe nga taksa të tjera p.sh. ata të Elbasanit nga detyrimi për të dhënë rentarë për flotën (kyrekxhi), të Krujës nga ispenxhja dhe të dhjetat, të Korçës nga ispenxhja, të Shkodrës nga taksat për vreshtat, kopshtet, bletët, livadhet pranë kalasë, mermetxhinjtë e Shkodrës nga xhizja dhe ispenxhja, banorët e Tivarit kryesisht nga detyrimet për zotëruesit e feudeve-taksat e mbështetura në sheriat (hukukî şeriye)[25], kurse banorët e kështjellave të Medunit dhe Zhabjakut që goditeshin shpeshherë nga kryengritësit, i kishin falur edhe nga ispenxhja, taksa e dhenve, e dhjeta e gjakut (yeniçeri oglani) (për Zhabjakun) ose i kishin vendosur në statusin e vllehëve, duke vjelë për çdo shtëpi nga 80 akçe (për Medunin), me qëllim që të popullonin më shumë varoshet e kalave në fjalë.[26]

Në caktimin e detyrimeve për qytetarët, sunduesit osmanë bënë dallime midis banorëve myslimanë dhe atyre të krishterë: zakonisht ata e ngarkuan popullsinë myslimane me detyrime ushtarake si ato për ruajtjen e kalave, shtypjen e kryengritjeve, vjeljen e rentës shtetërore si p.sh. në Berat, Elbasan, Gjirokastër, kurse popullsinë e krishterë me detyrime për mirëmbajtjen dhe merametimin e kalave, urave, rrugëve (si merametxhinj, urandreqës, hekurpunues, karpentier), të cilat në fakt ishin një lloj pune angari në dobi të shtetit. Kjo tregon se ata e konsideronin popullsinë e islamizuar si mbështetje të pushtetit të tyre pranda edhe i besonin detyra të karakterit ushtarak, kurse nga ana tjetër, se ata ndiqnin një politikë diskriminimi shoqëror e fetar ndaj të pafeve siç i quanin ata të krishterët, me qëllim që të arrinin në islamizimin e tyre. Kjo shihet qartë edhe nga fakti se në fillimet e pushtimit në shek. XV kur nuk kishte filluar proçesi i islamizimit, me detyrë ushtarake ishte ngarkuar popullsia e krishterë, kurse në shek. XVI këto detyra iu besuan pjesës së islamizuar të saj.

Nëpërmjet kësaj politike, sunduesit osmanë, synonin nga një anë të siguronin mirëmbajtjen dhe ndreqjen e kështjellave, urave, rrugëve, kryesore që përshkonin vendin si dhe të çdo objekti të nevojshëm për ruajtjen e sundimit, dhe nga ana tjetër të krijonin një mbështetje shoqërore në qytetet për t'i ndihmuar në vjeljen e rentës nga fshatarësia, për të shtypur kryengritjet në vatrat e rëndësishme të qëndresës së armatosur si në Malësinë e Madhe, Kurvelesh, Dukagjin, etj. Në këtë mënyrë ata shtonin forcat ushtarake të përhershme, përforconin pushtetit dhe futnin armiqësi midis qytetarëve dhe fshatarëve, duke synuar të arrinin përçarjen e qëndresës antifeudale dhe çlirimtare të popullit shqiptar. Dokumentet e sixhilatëve të Elbasanit dhe Beratit që i përkasin shek. XVI dhe veçanërisht ato të shekujve XVII-XVIII dëshmojnë qartë se kjo politikë kishte dhënë frutet e saj. Nuk janë të pakta rastet kur popullsia e Elbasanit dhe sidomos ajo e Beratit, morën pjesë në shtypjen e kryengritjeve të zhvilluara gjatë kësaj periudhe, veçanërisht të atyre që ndodhën në krahinën e Kurveleshit, si dhe në mbrojtjen e kështjellës së Vlorës, të Durrësit, të Bashtovës[27]. Kështu u forcua karakteri ushtarak politik e fetar i qyteteve dhe një pjesë e banorëve të tyre u kthyen në mbështetje edhe pse e përkohëshme, të pushtetit osman.

Këtë politikë sunduesit osmanë ishin detyruar ta ndiqnin qysh në fillim të pushtimit për shkak të qëndresës së ashpër të armatosur të popullit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut gjatë shek. XV e të vazhdimit të saj në forma jo të organizuara shtetërore gjatë shekullit pasues, si dhe të nevojës për të ruajtur sundimin e tyre në këto territore kufitare. Një qëndrim tjetër mbajtën ata ndaj qyteteve

23) **Po aty,** fl. 115.
24) TK.A., **Defteri mufassal liva-i Iskenderiye,** defter nr. 59, fl. 96-97, 293-295.
25) Shih shënimet nga numri 11-23.
26) TK.A **Defteri mufassal liva-i Iskenderiye,** defter nr. 59, fl. 96-97, 106, 109.
27) AQSH, **Fondi i esnafit të tabakëve të Elbasanit,** dok. nr. 801-307; **Sixhilati i Beratit,** dosja 16, fl. 93a; dosja 3, fl. 140b; dosja 10, fl. 85a; dosja 2, fl. 13a; dosja 49, fl. 127a etj.

të Rrafshit të Dukagjinit dhe Kosovës, ku e konsoliduan relativisht më lehtë pushtetin e tyre pas shkatërrimit të shtetit serb në kuadrin e të cilit bënin pjesë këto treva shqiptare. Popullsia e tyre nuk u ngarkua me shërbime ushtarake dhe pjesërisht u lidh me punën për shfrytëzimin e minierave.

Përveç rolit si qëndra administrative-ushtarake të pushtetit osman, qytetet gjatë shek. XV e fillimit të shek. XVI luanin edhe rolin e tregjeve lokale me gjithëse ekonomia qytetare dhe fshatare ishin të rrënuara. Kjo duket qartë nga taksat që sunduesit osmanë vilnin për shitblerjen e mallrave në tregjet e qyteteve të njohur me emrin taksa për tregun (kisti pazar ose baci pazar). Të ardhurat nga kjo taksë ishin të pakta, tregues ky për nivelin e ulët në të cilën kishte rënë tregtia e brendëshme. Kështu psh në vitin 1431 nga tregu i Krujës vileshin si taksë pazari 1600 akçe, nga ai i Kaninës 700 akçe; në Gjirokastër kjo taksë së bashku me atë të nijabetit arrinte shumën 4000 akçe[28]. Si duket aktiviteti ekonomik i qyteteve si tregje lokale gjatë periudhës fillestare të pushtimit ishte ende i dobët, pothuajse i njëjtë me atë të fshatrave të mëdha që ishin qëndra pazari.

Qytetet shqiptare, të quajtura tashmë me emrin **shehir** ose **kasaba,** ashtu si në viset e tjera të Perandorisë Osmane, u përfshinë në organizimin feudal ushtarak të timareve, por me një status të veçantë, të dalluar nga statusi i timareve të krijuara në vendbanimet fshatare, i cili e vendoste qytetarin-shehirliun nën shfrytëzimin feudal osman. Zakonisht qytetet u përfshinë në feudet e mëdha-në hasset e sanxhakbejlerëve si p.sh. Gjirokastra (1431), Peja, Shkodra, Drishti (më 1485), Berati, Elbasani, Delvina, Shkodra, Kruja, Peja, Prizreni, Vuçiterni (në fund të shek. XVI), në hasset e sulltanëve si Vlora, Gjirokastra, Lezha, Durrësi, Prishtina, Novoberda, Janjeva, Trepça (në fund të shek. XVI), në hasset e subashëve si Këlcyra, Kanina, Berati, Kruja (më 1431); në ziamete si Kanina, Përmeti etj. (në fund të shek. XVI).

Në hasset, veçanërisht në ato të sulltanit ishin përfshirë zakonisht të ardhura të rëndësishme të vendit që vinin nga taksat e vjela gjatë shitblerjes të mallrave në tregjet kryesore, nga doganat në skelat e Vlorës, Durrësit, Lezhës, Shkodrës, nga monopoli i kripës në kriporet e bregdetit, nga peshkimi, nga minierat, veçanërisht ato të Kosovës, si dhe të ardhurat nga shfrytëzimi feudal i banorëve të qyteteve. Në fazën e parë të pushtimit kur ekonomia e qytetit ishte thuajse një ekonomi agrare dhe numri i zejtarëve ishte mjaft i kufizuar, qytetarët shlyenin një rentë feudale thuajse të njëjtë me atë të fshatarësisë raja. Populllsia e qyteteve, në fillim kryejtësisht e krishterë, ishte e detyruar t'i jepte si rentë zotëruesit të feudit, siç na e pasqyrojnë qartë regjistrat e hollësishëm kadastralë të shekujve XV-XVI, po ato detyrime që jepte rajaja: taksën e rajallëkut ose siç quhej ndryshe ispenxhën[29] në madhësinë 25 akçe nga çdo kryefamiljar, 6 akçe nga çdo të rritur beqar (mücerred) dhe 12 akçe nga çdo grua e ve (bive), të dhjetën e prodhimeve bujqësore (ösri müstagallât) si të grurit, elbit, thekrit, okrës, linit, zarzavateve, bathëve, frutave, ullinjve, të mushtit, të vreshtave, të blatëve, taksën e bostanit (për kopshtet) 2 akçe për çdo shtëpi, taksën e pojakut, taksën për kullotat, taksën e dynymit për vreshtat e myslimanëve, badihavatë etj.[30] Është e kuptueshme se këto prodhime qytetarët nuk i nxirrnin vetëm nga kopshtet, vreshtat, ullinjtë që ata zotëronin si pronë private (mylk) pranë shtëpive të tyre. Grurin, elbin, thekrën ata e prodhonin në tokat shtetërore (mirie) pranë qyteteve, që

28) H. Inalçik, **Sureti defteri...**, f. 1b, 108b, timaret nr. 75, 276.

29) Sipas kanunnamesë së Mehmetit II, nga zanatçinjtë e krishterë si robaqepësit, papuxhinjtë, çprishësit e leshit, etj. taksa e ispenxhës vilej në sasinë 25 akçe për çdo zanatçi kryefamiljar. Shih: F. Kraelitz-Greinfenhorst, **Kanunname-i sultan Mehmeds des Erobereres, në** «Mitteilungen zur Osmanischen Geschichte, Wien 1922, Bd. I. f. 29-30.

30) Po japim këtu listën e plotë të detyrimeve ndaj zotëruesit të fundit që shlyenin në gjysmën e dytë të shek. XVI banorët e Beratit: 650 burra myslimanë, 412 të krishterë, 11 çifutë, 21 jevgj së bashku me të dhjetën e çifligjeve të zaimëve, zotëruesve të timareve, ruajtësve të kalasë, të cilat ndodheshin në afërsi të qytetit dhe në fshatin Lapardha (147 çifligje):.
taksa e pendës dhe benakut (familje myslimane pa tokë) 782 akçe; ispenxhe 10.125 akçe.
e dhjeta e grurit: barrë 400 = 17.200 akçe
e dhjeta e elbit: barrë 100 = 2800 akçe
e dhjeta e thekrit: barrë 50 = 1400 akçe
e dhjeta e tagjisë: barrë 20 = 380 akçe
e dhjeta e mushtit: medre 430 = 4300 akçe
Ky shënim vijon në faqen 22.

Do not copy

i merrnin në përdorim nga spahinjtë. Kjo dëshmohet qartë nga fakti se në të ardhurat që nxirreshin nga qytetarët përfshihej edhe taksa e tapisë që ata duhet të paguanin për tokat mirie që punonin ose nga shënime të veçanta të regjistrave kadastralë dhe të kanunnameve. Kështu p.sh. nga banorët e Lezhës në vitin 1570 ishte vjelë në dobi të arkës shtetërore taksa e tapisë (resmi tapu) për truallishten (mezraa) Ishulla, të cilën e punonin pa patur tapinë përkatëse.[31]

Tokat mirie pranë qyteteve nuk kishin të njëjtin status juridik me tokat në përdorim të fshatarëve raja. Për punimin e mbjelljen e tyre qytetarët qofshin zanatçinj, qofshin pjestarë të klasës feudale, ishin të detyruar t'i paguanin zotëruesit feudal të këtyre tokave vetëm taksat e së dhjetës dhe të salarijes (e dhjeta për kashtën), të cilat zakonisht fshatari raja i a paguante spahiut si zotërues i tokës (sahibi erz). Ato nuk ishin ngarkuar me detyrimet që i jepte fshatari raja spahiut si zotërues i personit të rajasë (sahibi reaya), siç janë taksat e rajallëkut (rusumi raiyet), midis të cilave vendin kryesor e zinte ispenxhja për të krishterët ose taksa e pendës (resmi çift) për myslimanët.

Në rast se qytetarët merrnin në përdorim toka të fshatarëve raja, ishin të detyruar të paguanin detyrimet përkatëse të tyre, d.m.th. të dhjetën, salarijen, taksat e rajallëkut (ispenxhe, taksa e pendës), për veç detyrimeve që jepnin si qytetarë[32]. Kështu p.sh në kanunnametë e Selimit I (1512-1520) dhe të Sulejman Ligjëvënësit (1520-1566) thuhet se qytetarë mund të mbillnin toka mirie, përveç atyre që jan mylk dhe vakuf, por duhet të paguanin taksën e pen dës (për çifligun) në proporcion me madhësinë e si përfaqes së tokës: taksën e pendës për çifligun e plo të ose taksën e gjysëm pendës për gjysëm çifligur Në qoftë se ata e braktisnin çifligun spahiu nuk mun të vilte prej tyre taksën e pendës, nënkuptohet s edhe as taksën e pendëprishjes (çift bozan resmi), si bëhej zakonisht për rajatë[33]. Pra qytetari mund t braktiste çifligun pa ndonjë sanksion nga ana e spa hiut.

Përveç rentës në dobi të zotëruesit të feudit, qyte tarët ishin të detyruar të paguanin edhe rentën n dobi të fiskut me detyrimet e zakonshme. Nga shë nimet e regjistrave kadastralë dhe sixhilatet del qart se ata paguanin taksat e zhizjes, taksat e jashtëza konshme shtetërore (avarizi, nuzuli, sursati etj), dety rimin për dhënien e remtarëve, të dhjetën e gjaku (acemi oglanï, yeniçerï oglanï), taksën për dhentë etj Këto detyrime përmenden shprehimisht në shënimet e regjistrave kadastralë të gjysmës së dytë të shek. XV për statusin e qytetarëve të Krujës, të Beratit, të Elbasanit, të Përmetit, të Shkodrës, të Tivarit, të Zhabjakut[34], të cilëve u ishin falur taksat shtetërore përkundrejt shërbimeve të caktuara, dhe në dokumente

---

Ky shënim vijon nga faqja 21.

nga vreshtat e myslimanëve 45, taksë 400
e dhjeta e linit 290 akçe
e dhjeta e ullinjve 100 akçe
mullinj 32, punojnë gjithë vitin, taksë 960 akçe
taksa e kullotës 2200 akçe
taksa e bostanit 882 akçe
pula dhe elb 1764 akçe.
badinavatë, baxhi pazari, taksa e martesës dhe nijabeti 11.657 akçe. Shuma gjithsej 55,140 akçe (në regjistër mbledhja është bërë gabim 52.610 akçe).
Shih. TK.A, **Defteri mufassal liva-i Avlonya, defter nr. 62, fl. 256.**

31) TK.A., **Defteri mufassal liva-i Paşa,** cild II, defter nr. 59, fl. 74.

32) Në kësi rastesh një qytetar i krishterë duhet të paguante dy herë ispenxhen; një herë si qytetar dhe një herë për tokën e fshatarit raja që mori në përdorim.

33) M. Arif, **Kanun-name-i al-i osman,** në Tarihi Osmani Encümeni Mecmuasi (TOEM), cüz 18, f. 52; H. Hadžibegić, **Kanun-nama sultan Sulejmana Zakonodavca,** në Glasnik zemljskog muzeja u Sarajevu, sveska IV-V, Sarajevo 1950, f. 360.

Përmbledhja e kanunnameve të shek. XVI ku një vend qëndror zë kanunnameja e sulltan Sulejman Ligjëvënësit në një variant mjaft të ndryshëm nga ai që njihet në literaturën historiografike, gjendet në dy dorëshkrime me titull: **Kanun-name-i Osmani,** në AQSH, fondi jurisprudencës, dok. 710.067, dorëshkrim i përdorur nga myftiu i Shkodrës Ahmeti (1720), dhe në Bibliotekën Kombëtare, me shifrën 15-G-25. Shih këtë të fundit faqe 13.

34) Përmenden si taksa që u ishin falur grupeve të veçanta të qytetarëve përkundrejt shërbimeve shih.: TK.A, **Defteri mufassal liva-i Ohri,** cild. II, defter nr. 27, fl. 117; **Defteri mufassal liva-i Avlonya,** defter nr. 62, fl. 92, 250; **Defteri mufassal liva-i Elbasan,** defter nr. 66, fl. 10; **Defteri mufassal liva-i Iskenderiye,** defter nr. 59, fl. 5, 109, 293-295.

DO NOT COPY

e sixhilateve të Elbasanit e Beratit të shek. XVI--XVIII.[35]

Duke qenë të përfshirë në feude qytetarët i nënshtroheshin shfrytëzimit feudal. Megjithëkëtë, nga burimet sidomos ato të gjysmës së dytë të shek. XVI, konstatohet se ata nuk i nënshtroheshin të gjithë të njëjtit shfrytëzim. Midis tyre bëheshin diferencime. Shtresa e qytetarëve e regjistruar në defterët kadastralë, përbëhej nga katër grupe kryesorë: nga zanatçinjtë myslimanë, zanatçinjtë e krishterë, zanatçinjtë shtegëtarë (haymanegan) të ardhur nga fshati, qytetarë që merreshin me bujqësi. Pozitën e këtyre grupeve mund ta hetojmë në regjistrimet kadastrale për qytetet e Elbasanit, Beratit e të Prizrenit në fund të shek. XVI. Vendin më të privelegjuar në qytetet e zinte grupi i zanatçinjve myslymanë. Këta në përgjithësi ishin falur nga pjesa më e rëndësishme e rentës shtetërore përkundrejt shërbimeve ushtarake dhe paguanin më pak detyrime se zanatçinjtë dhe banorët e tjerë të krishterë të qytetit. Ata nuk jepnin as taksën e xhizjes, as ispenxhen ose taksën e pendës që zakonisht vilej nga rajatë myslymanë si ekuivalent i ispenxhes të të krishterëve.[36]. Kjo dëshmon për diskriminimin ekonomik që zbatonin sunduesit osmanë për të arritur në islamizimin e popullsisë së qyteteve dhe rrjedhimisht në krijimin e një mbështetjeje të gjërë shoqërore për ta. Në regjistrimet konstatohet edhe një fakt tjetër me rëndësi. Zejtarët fshatarë haymanegan) të Beratit dhe Elbasanit janë myslymanë por, në shumicë të sapo islamizuar[37]. Kjo dhe fakti se në qytetet ekzistojnë shumë pak zejtarë të krishterë tregojnë se në kuadrin e përgjithshëm të politikës së diskriminimit fetar, përfaqimi i islamizimit nga zejtarët fshatarë duhet të ketë qenë një kusht lehtësues për hyrjen e tyre në qytet dhe për sigurimin e pozitës më të mirë të zanatçinjve myslimanë.

Pozitën e qytetarit-shehirliut në të vërtetë e gëzonin zanatçinjtë e tregtarët myslymanë dhe pas tyre ata të krishterë, ndonëse këta paguanin më shumë detyrime, kryesisht xhizjen dhe ispenxhen.

Përveç këtyre në qytetet kishte edhe një shtresë tjetër, ajo e zanatçinjve shtegtarë të ardhur nga fshati. Është e qartë se dyndja e tyre ishte shkaku kryesor i shtimit të popullsisë së qyteteve. Dispozitat e legjislacionit lidhur me detyrimet e bujkut të kthyer gradualisht në zejtar, tregojnë se në fshat në shek. XVI ekzistonte një ndarje shoqërore e punës mjaft e avancuar. Ato parashikojnë që zejtari fshatar mund të qëndronte në fshat pa ushtruar bujqësinë, duke u mbajtur me të ardhurat e zanatit të vet. Sipas kanunamesë të Mehmetit II të vitit 1488 zanatçinjtë e fshatit të regjistruar si qiraxhinj e arabaxhinj nuk ishin të detyruar të punonin tokën, mund të braktisnin bujqësinë, por duhet të ushtronin zanatin e tyre dhe t'u jepnin spahinjve nga 50 akçe në vit (si taksë për pendëprishjen). Në rast se punonin tokën atëhere prej tyre vileshin e dhjeta dhe taksat e rajallëkut. Në qoftë se ata ushtronin zanatin në qytet, nuk paguanin asgjë. Në rast se për shkak të pleqërisë, sëmundjeve dhe varfërisë nuk punonin çifligjet, por merreshin me zanatin e qiraxhiut, arabaxhiut, karpentierit, spahiu mund t'u merrte çifligun dhe të vilte prej tyre

35) P.sh. sipas një dokumenti të datës 27 korrik 1686 del se banorët e kalasë së Beratit ishin të detyruar të paguanin taksën e bedeli sursatit, peshqeshe për mirmiranët, mirlivatë si dhe shpenzime për mirëmbajtjen e urës të qytetit. Po kështu ekzistojnë edhe listat për shpërndarjen e taksave të sursatit dhe të xhizjes midis lagjeve të qytetit të Beratit në proporcion me numrin e vatrave për vitet 1677, 1681, 1684-1688 etj.

AQSH, **Sixhilati i Beratit,** dosja 15, fl. 18a; dosja 16, fl. 96a, dosja 49, fl. 117b, dosjt 19, fl. 22a; dosja 3, fl. 103b, 105a; dosja 10, fl. 11a.

36) P.sh. sipas regjistrimeve të fundit të shek. XVI në detyrimet e zanatçinjve myslymanë të Shkodrës, Beratit, Elbasanit, Prizrenit nuk është llogaritur taksa e pendës (TK.A., **Defteri mufassal liva-i Iskenderiye,** defter nr. 59, fl. 7-9; **Defteri mufassal liva-i Elbasan,** defter nr. 66, fl. 8-12; **Defteri mufassal liva-i Avlonya,** defter nr. 62, fl. 250-256; **Defteri mufassal liva-i Prizrin,** defter nr. 55, fl. 13-17.

Në regjistrimin e qytetit të Prishtinës janë shënuar 418 akçe si e ardhur nga taksa që duhet të paguanin banorët myslymanë për 19 bashtina që qenë në zotërim të tyre. (TK.A. **Defteri mufassal liva-i Vuçitern,** defter nr. 124, fl. 313-315).

Për qytetin e Elbasanit janë shënuar 498 akçe nga taksat e pendës, e të martuarve pa tokë (benak) dhe beqarëve nga 7 familje që zotëronin nga një çiflig tokë, 25 të martuar pa tokë dhe 7 beqarë. Pra madhësia e taksës së pendës ishte 22 akçe, e benakut 12 akçe dhe beqarëve 6 akçe. (TK.A, **Defteri mufassal liva-i Ilbasan,** defter nr. 66, fl. 8-12).

37) Psh, nga 185 zejtarë fshatarë të Beratit në fund të shek. XVI 39 prej tyre mbanin si mbiemra emrat shqipe të prindërve të krishterë dhe 30 mbanin cilësimin Abdullah-rob i allahut që zakonisht u vihej të sapo islamizuarve. Shih: TK.A **Defteri mufassal liva-i Avlonya,** defter nr. 62, fl. 251-252.

DO NOT COPY

taksën që merrej nga të martuarit pa tokë (benak)[38]. Me fjalë të tjera spahiu nuk kishte të drejtë të merrte një dëmshpërblim nga të ardhurat e tij si zanatçi. Ai mund të nxirrte të ardhura vetëm duke ia dhënë çifligun një rajaja tjetër.

Zanatçinjtë në fshat si p.sh. pëlhurëendësit, terzitë, qymyrxhinjtë etj, ishin të detyruar të punonin angari 3 dit në vit për spahiun ose të paguanin 3 akçe në vend të saj.[39] Zejtarët fshatarë kur kalonin në qytete dhe regjistroheshin atje si zanatçinj shtegtarë dhe ushtronin zanate ose merreshin me tregti siç është p.sh. rasti i 185 zejtarëve në Berat dhe i 39 zejtarëve në Elbasan gjatë fundit të shek. XVI[40], ishin të detyruar t'u paguanin spahinjve të fshatrave nga kishin ardhur taksën e pendëprishjes për çifligjet që kishin braktisur. Me zhvillimin e forcave prodhuese, me ndarjen më të madhe të zejtarisë nga bujqësia në fshat, dyndjet e zanatçinjve fshatarë për në qytet u bënë më të shpeshta. Në një ferman lëshuar në muajin shkurt të vitit 1647 me ankesën e vojvodës së hasit të fshatrave Kuta dhe Belanshik të kazasë së Beratit për rënimin e çifligjeve të shkaktuar nga ikjet e shumta të zanatçinjve në qytete, është urdhëruar që prej këtyre të vilet çdo vit taksa e pendërpirshjes në një sasi më të rënduar: nga 75 akçe që vilej më përpara në 300 akçe për një çiflig, 150 akçe për gjysmë çifligu dhe 75 akçe për ata që kishin tokë më pak se gjysëm çifligu.[41] E njëjta gjë dëshmohet dhe në kanunnamenë e re të Sulejman ligjvënësit.[42]. Kështu taksa ishte rritur nga 50 akçe që përmendet në kanunamenë e Mehmetit II në 75 akçe dhe më vonë në 300 akçe.

Megjithëse vinte këtë masë të rëndë ekonomike që pengonte dyndjen e fshatarëve në qytete, legjislacioni osman nuk e ndalonte krejtësisht vendosjen e zejtarëve të fshatit në qytet, por linte një farë shtegu ligjor. Duke paguar rregullisht taksën e pendëprishjes që ishte një shprehje e qartë e vartësisë feudale të rajasë, zejtari fshatar mund të ushtronte në qytet zejtarinë ose tregtinë, të vendosej me banim në të dhe me kalimin e kohës, të paktën deri në 10 vjet ose deri sa të gjente raja që të blinte të drejtën e zotërimit (tesarrufit) të çifligut të tij, ai mund të shkëputej nga vartësia ndaj spahiut si raja dhe të fitonte statusin e shehirliut si zanatçi qytetar.[43] Kjo mund të ndodhte në se zejtaria do t'i siguronte më shumë të ardhura se bujqësia. Zanatçiut i duhej të ishte në gjendje të plotësonte nevojat e familjes dhe të paguante taksën e pendëprishjes si dhe taksat që lidheshin me profesionin e tij të ri.

Vendosja në qytete e zanatçinjve fshatarë nuk mjafton për të shpjeguar rritjen e popullsisë qytetare. Qytetet tërhoqën edhe njerëz që nuk kishin kualifikim të veçantë. Nga dokumentacioni veçanërisht ai pas shek. XVII, del se në qytetet kishin shkuar edhe fshatarë të ikur nga fshati, që kishin braktisur tokat e tyre. Këta, spahinjtë, me ndërmjetësinë e kadiut, mund t'i kthenin në fshatrat e tyre dhe vetëm po të kishin kaluar një kohë prej 10-15 vjetësh në qytet, mund t'i shpëtonin ndjekjeve. Shtegtarët që banonin nëpër qytete qofshin zanatçinj ose jo duhet të paguanin taksën për dimërim (resmi duhan) 6 akçe për çdo kryefamiljar. Por kjo taksë nuk është shënuar gjithnjë si e ardhur për

38) F. Kraelitz-Greifenhorst, **Kanun-name-i sultan Mehmed...,** Bd. I, f. 24.

39) **Po aty;** f. 26, Shih. edhe B. Djurdjev, **O uticaju turske vladavine na razvitak naših naroda,** në Godišnjak istoriskog društva Bosne i Hercegovine, Sarajevo 1950, II, f. 73-74.

40) TK.A **Defteri mufassal liva-i Avlonya,** defteri nr. 62, fl. 251-252; **Defteri mufassal liva-i Ilbasan;** defter nr. 66, fl. 11-12.

41) AQSH, **Sinxhilati i Beratit,** dosja 10, fl. 21b. Të njëjtin status kishin edhe zanatçinjtë fshatarë në viset e tjera të Ballkanit. Sipas kanunnamesë së Sremit të vitit 1588/9 drupunuesit, poçarët, peshkatarët, mullixhinjtë e zanatçinj të tjerë që janë regjistruar si raja dhe kanë braktisur bujqësinë duhet t'i paguanin spahiut taksën e pendëprishjes në sasinë 120 akçe nga të pasurit dhe 80 akçe nga ata më të varfër. (B. Djurdjev, **O uticaju turske vladavine... f. 74).** Sipas kanunnamesë të sanxhakut të Silistrës të shek. XVI, taksa e pendëprishjes për fshatarët zanatçinj vilej 72 akçe në rast se ishin myslimanë (nga këto 50 akçe merreshin si e dhjetë dhe 25 akçe si ispenxhe). Shih.: V. Mutafčieva, **Feudalnata renta, prisvojavana ot lennija daržatel v Osmanska imperija s ogled na našite zemi prez XV-XVI vek,** në Izvestija na Instituta za balgarska istorija, Sofije 1957, f. 26-27; Ö.L. Barkan, **Osmanlî imparatorluğunda ziraî ekonominin hukukî ve malî esasları,** I, Kanunlar, Istanbul 1945, f. 288.

42) Në Bibliotekën Kombëtare ekziston një variant i kanunnamesë së Sulejman Ligjëvënësit paraqitur atij nga Ebussudi, i cili është disa i ndryshëm nga varianti i njohur në literaturën historiografike. Fondi i Antikuarit, An VII/10g, fl. 52a.

43) A. Matkovski, **Krepostničestvo vo Makedonija vo vreme na turskoto vladenje,** Skoplje 1978, f. 65, 87-88, 296.

DO NOT COPY

zotëruesit feudalë të qytetshin në Pejë e Prizren, vjelë për shtegtarët që gjatë Elbasanit[44]).
por jo nga ata të Beratit.

Një grup të veçantë të popullsinë e qyteteve, përbënin banorët që nin tokën në rrethinën e qytetit ose që kishin rajaje në ndonjë fshat të afërt. Këta, duke u ideruar raja dhe si të tillë në defterë, i paguanin zotërojanë regjistruar edhe detyrimet e zakonshme të ruesit feudal të qytetishin myslimanë, në regjistrirajasë. Në rastet martuar pa tokë (benak) ose rues çifligu (çift), shek. XVI janë shënuar si zotëmet kadastrale të beqarë.[45]). Megjithatë, këta banorë gjendeshin në një pozitë më favorshme nga ajo e fshatarëve raja, sepse kishin mundësi më të mëdha për t'u shkëputur nga detyrimet karakteristike për tokat e rajave dhe për t'u bërë qytetarë.

Pozita e qytetarit-shehirliut ishte më e favorshme se ajo e rajasë së fshatit, ndonëse edhe ky i nënshtrohej shfrytëzimit feudal. Shehirliu ishte i çliruar nga vartësia feudale që kishte fshatari raja ndaj zotërusit të tokës (sahibi erz), dhe po të përqafonte fenë islame mund t'i shmangej pagesës së ispenxhes-taksë që i paguhej spahiut si zotërues i rajasë (sahibi raiyet). Shehirliut të çliruar nga vartësia feudale bujkrobërore, ekonomia qytetare i kritjonte mundësi më të mëdha për të siguruar mjetet e jetesës dhe për t'u pasuruar sesa ekonomia fshatare. Duke qenë qendër administrative-ushtarake, qyteti krijonte mundësi më të mëdha se fshati për t'u shpëtuar arbitrariteteve të spahinjve dhe funksionarëve shtetërore dhe për të zhvilluar normalisht zejtarinë e tregtinë. Prandaj, me shpresë se një ditë mund të shpëtonin nga vartësia feudale dhe të bëheshin ekonomikisht të pavarur, filluan të dyndeshin nëpër qytete jo vetëm zejtarët fshatarë por edhe fshatarë të varfër të cilët duke qenë të çveshur nga çifligjet e tyre, nuk kishin mundësi të fitonin mjetet e jetesës në fshat.

Rimëkëmbja e qyteteve në shek. XVI

Nga të dhënat që parashtruam më lart del e qartë se gjatë shek. XV, në kushtet e rënies së përgjithshme të ekonomisë, ndikimi i faktorëve politiko-shtetërore në jetën e qyteteve ishte mjaft i fuqishëm. Në shek. XVI ky ndikim dobësohet dora dorës, duke i a lënë vendin veprimit të faktorëve ekonomikë-shoqërorë.

Gjatë kësaj periudhe qytetet e marrin veten dhe dalngadalë roli ekonomik shoqëror i tyre filloi të rritet. U shtua numri i banorëve dhe sidomos i zejtarëve. Rimëkëmbja e tyre u bë e mundur në sajë të rigjenerimit dhe zhvillimit që patën forcat prodhuese në fshat, përparim ky që u kushtëzua nga niveli i lartë që kishin arritur ato në periudhën para pushtimit osman. Përparimi i ekonomisë fshatare kërkonte zgjerimin e aktivitetit të qyteteve si qendra ekonomike të hinterlandit bujqësor të tyre, si nyje ku realizoheshin lidhjet tregëtare jo vetëm të brendëshme, krahinore e ndërkrahinore, por edhe të jashtme, me vendet e tjera evropiane.

Si nxitje për zhvillimin e zejeve shërbyen edhe nevojat e banorëve të qyteteve për mallra konsumi. Shndërrimi i qyteteve në qendra administrative ushtarake, nevojat për ndërtime ose mirëmbajtjeje objektesh ushtarake ose publike, u shoqëruan me rritjen e kërkesës për mallra dhe me nevojën e shtimit të prodhimit. Kjo bëri të mundshme që nëpër qytetet të tërhiqej një numër i madh krahësh pune nga rajdhët e fshatarëve, veçanërisht nga ata që iknin prej timareve për t'i shpëtuar shfrytëzimit të egër të spahinjve. Nga ana tjetër, tepricat që u krijuan si pasojë e përpjekjeve të fshatarësisë për të përmirësuar gjendjen e vet ekonomike dhe renta në natyrë që grumbullohej nga klasa feudale, u derdhën gjithnjë e më shumë nëpër qytete. Kështu popullsia e tyre filloi të shtohej dhe qarkullimi i mallrave të rritej. Banorët filluan të vendoseshin sidomos jashtë kalave

44) TK.A. **Defteri mufassal liva-i Iskenderiye,** defter nr. 59, fl. 143; **Defteri mufassal liva-i Prizrin,** defter nr. 55, fl. 16; **Defteri mufassal liva-i Avlonya,** defter nr. 62, fl. 276; **Defteri mufassal liva-i Ilbasan,** defter nr. 66, fl. 8-12. Për disa zanatçinj të ardhur në Pejë nga nahija e Shkodrës në fund të shek. XVI resmi duhani është llogaritur 6 akçe. (7 zanatçinj nga 6 akçe gjithsej 42 akçe), kurse në një shënim tjetër thuhet se do t'u vilet 50 akçe secilit. Këtu në fakt kemi të bëjmë me taksën e pendëprishjes në madhësinë që e jep kanunnameja e sulltan Mehmetit II (TK.A., **Defteri mufassal liva-i Iskenderiye,** defter nr. 59, fl. 143).

45) P.sh. Në Gjirokastër kishte 5 zotërues çifligu, 3 benakë dhe 7 beqarë që paguanin detyrimin përkatës prej 188 akçe gjithsej, në Elbasan kishte 7 zotërues çifligu, 25 benakë dhe 7 beqarë që paguanin taksën përkatëse prej 496 akçe. Në Krujë kishte 31 zotërues çifligu, 40 benakë, 34 beqarë, 3 shtëpi të krishtera. Shih: TK.A **Defteri mufassal liva-i Avlonya,** defter nr. 62, fl. 126-127; **Defteri mufassal liva-i Ilbasan;** defter 66, fl. 10-11; **Defteri mufassal liva-i Ohri,** cild II, viti 1583, fl. 119.

BOZIOPY

si p.sh. në Prishtinë, Prizren, ndërtimi i karvansarajeve, tregojnë se tregu lokal kishte marrë hov dhe marrëdhëniet e shkëmbimit fshat-qytet ishin përhapur në një shkallë më të gjerë.

Në përparimin ekonomik dhe shoqëror të qytetit krahas zhvillimit të ekonomisë fshatare, një rol të dorës së parë luajti edhe zejtaria. Zejet e zhvilluara më shumë ishin ato të lidhura me përpunimin e produkteve bujqësore blegtorale, me plotësimin e nevojave për veshmbathje të popullsisë si dhe të nevojave të ushtrisë. Kështu numrin më të madh ndër zejtarët e përbënin lëkurëregjësit, papuxhinjtë, robaqepësit, pashmakçinjtë, takijexhinjtë, mbathëtarët, mëndafshpunuesit, shajakpunuesit, shpatapunuesit, saraçët, kovaçët, arabaxhinjtë, leshpunuesit, samarxhinjtë etj. Nuk mungonin edhe zejtarë që prodhonin artikuj luksi dhe stoli për nevoja të klasës feudale siç qenë argjendarët, gëzoftarët, si dhe zejtarë që kryenin shërbime ndaj popullsisë si berberë, hamaxhinj, t lakë, xherahë etj. Mjaft e zhvilluar duhet të ketë q në prodhimi dhe përpunimi i mëndafshit gjë që kup tohet nga të ardhurat e rëndësishme që vileshin gjc të shitblerjes për peshimin e mëshikzave të mënda shit (resmi mizani harir)[60], veçanërisht në qytetin Prizrenit ku të ardhurat nga kjo taksë arrinin 150.00 akçe në vit[60a]. Ushtrimi i afro 55 zejeve tregon si pë rigjallërimin e zejtarisë në këtë kohë, ashtu edh për traditën e jetës urbane në këto qendra në periu dhën para pushtimit osman-traditë që i jepte mundë si këtij përparimi.

Për të patur një përfytyrim më të plotë mbi zhvillimin e zejtarisë dhe tregtisë, po japim në formë të përmbledhur zejet që ushtroheshin në qytetet kryesore, si pas të dhënave të regjistrave kadastralë të gjysmës së dytë të shek. XVI.

Nr	Emërtimi i zejeve	Berati				Elbasani				Shkodra		
		Zejtarë				Zejtarë				Zejtarë		
		Myslimanë	Myslimanë në shtegtarë	Të krishterë	Gjithsej	Myslimanë	Myslimanë në shtegtarë	Të krishterë	Gjithsej	Myslimanë	Të krishterë	Gjithsej
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1.	Papuxhi (papuçepunues)	89	30	—	119	13	—	—	13	3	—	3
2.	Debag (lëkurëregjës)	81	69	—	150	68	—	—	68	21	—	21
3.	Terzi (robaqepës)	38	1	—	39	29	1	—	30	15	—	15
4.	Pashmakçi (sandalepunues)	47	8	—	55	7	1	—	8	2	—	2
5.	Takijexhi (fespunues)	34	9	—	43	53	—	—	53	1	—	1
6.	Nallban (mbathëtar)	39	12	—	51	24	—	—	24	6	—	6
7.	Kazaz (mëndafshpunues)	22	1	—	23	21	—	—	21	1	—	1
8.	Mujtaf (shajakpunues)	16	6	—	22	8	4	1	13	5	—	5
9.	Taxhir (tregtar)	13	—	—	13	6	2	1	9	8	—	8
10.	Berber	20	16	—	36	15	—	—	15	1	—	1
11.	Kasap	12	—	—	12	3	—	—	3	2	—	2

60) P.sh. në kazanë e Gjirokastrës vileshin për këtë taksë 25.000 akçe në vit, në atë të Vlorës 20.000 akçe, të Përmetit 5000 akçe, të Beratit e Tomoricës 3.300 akçe, të Tepelenës 1000 akçe. Sipas kanunamesë së Vlorës për çdo lidre mëndafsh vileshin 2 akçe nga shitësi dhe 2 akçe nga blerësi.
Shih: H. Inalcik, **Sureti defteri...**, f. 126; TK.A, **defter mufassal liva-i i Avlonya,** defter nr. 62, fl. 8-14.

60a) TK.A, **defter mufassal liva-i Prizrin,** nr. 55, viti 1591, fl. 8.

DO NOT COPY

a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
12.	Saraç (përpunues lëkurash)	11	3	—	14	10	—	—	10	3	—	3
13.	Këllëçxhi (shpatapunues)	8	1	—	9	9	1	1	11	3	—	3
14.	Çullah (leshpunues)	9	7	—	16	49	—	—	49	—	—	—
15.	Hallvaxhi	5	—	—	5	1	—	—	1	1	—	1
16.	Kujumxhi (argjendar)	2	—	—	2	1	5	1	7	—		—
17.	Ekmekxhi (bukëpjekës)	2	7	—	9	13	2	—	15	2	—	2
18.	Merkumashxhi (endës) pëlhurash)	4	—	—	4	—	—	—	—	—	—	—
19.	Hallaç (shkrifës leshi)	—	3	—	3	—	—	—	—	—	—	—
20.	Odunxhu (druvar)	—	—	—	—	—	—	—	—	13	—	13
21.	Bozaxhi	—	1	—	1	2	—	—	2	—	—	—
22.	Samarxhi	—	4	—	4	8	—	1	9	4	—	4
23.	Mumxhi (qiripunues)	—	1	—	1	—	—	—	—	5	—	5
24.	Sikka (bartës uji)	—	6	—	6	—	—	—	—	—	—	—
25.	Temurxhi, hadadan (hekurpunues)	7	—	—	7	11	3	—	14	1	—	1
26.	Çilingjir (bravapunues)	—	—	—	—	6	5	—	11	—	—	—
27.	Hamamxhi	—	—	—	—	15	—	—	15	1	—	1
28.	Tellall	—	—	—	—	5	—	—	5	1	—	1
29.	Arabaxhi (karrocapunues)	—	—	—	—	4	—	—	4	4	—	4
30.	Ashçi (gjellëbërës)	—	—	—	—	4	—	—	4	1	—	1
31.	Dylgjer (karpentier)	—	—	—	—	3	—	—	3	—	—	—
32.	Derudgjer	—	—	—	—	3	2	—	5	—	—	—
33.	Bakall	—	—	—	—	9	—	—	9	4	—	4
34.	Sapunxhi	—	—	—	—	4	—	—	4	—	—	—
35.	Degirmenxhi (muilis)	—	—	—	—	1	1	—	2	—	—	—
36.	(elmuhur)	7	—	—	7	—	—	—	—	—	—	—
37.	Çirçi (çikërrimtar)	—	—	—	—	1	—	—	1	—	—	—
38.	Jajxhi (harqe punues)	—	—	—	—	1	3	1	5	—	—	—
39.			—	—	—	6	—	—	6	—	—	—
40.	Otlukxhi	—	—	—	—	1	—	—	1	—	—	—
41.	Jazixhi (shkrues)	—	—	—	—	2	—	—	2	—	—	—
42.	Molozxhi (kalldrëmxhi)	—	—	—	—	1	—	—	1	—	—	—
43.	Çarëkxhinj (opingar)	—	—	—	—	1	—	—	1	—	—	—
44.	Qyrkxhi (gëzoftar)	—	—	—	—		4	4	8	1		1
45.	Kazganxhi (kazanxhi)	—	—	—	—	—	2	1	3	—	—	—

DO NOT COPY

a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
46.	Okçu (shigjetapunues)	—	—	—	—	—	1	2	3	—	—	—
47.	Nekerezen (daullxhi)	—	—	—	—	—	1	—	1	1	—	1
48.	Çoban	—	—	—	—	—	2	—	2	—	—	—
49.	Bardakxhi	—	—	—	—	—	—	2	2	—	—	—
50.	Keçexhi (shajakpunues qilimapunues)	—	—	—	—	—	—	1	1	—	—	—
51.	Çizmexhi	—	—	—	—	1	—	—	1	—	—	—
52.	Dellak	—	—	—	—	—	—	—	—	8	—	8
53.	Xherrah	—	—	—	—	—	—	—	—	2	—	2
		466	185	—	615	419	39	16	474	120	—	120

Zejet në qytetet e Prizrenit, Prishtinës, Pejës e Vuçiternit.

	Emërtimi i zejeve	Prizreni			Prishtina			Peja			Vuçiterni		
		Zejtarë			Zejtarë			Zejtarë			Zejtarë		
		Myslimanë	Të krishterë	Gjithsej	Muslimanë	Të krishterë	Gjithsej	Myslimanë	Të krishterë	Gjithsej	Myslimanë	Të krishterë	Gjithsej
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1.	Hajat (robaqepës)	24	3	27	19	1	20	18	1	19	14	—	14
2.	Mujtaf (shajakpunues)	23	—	23	1	—	1	—	—	—	—	—	—
3.	Debag (lëkurëregjës)	19	—	19	10	—	10	8	—	8	1	—	1
4.	Arabaxhi (karrocapunues)	17	—	17	1	—	1	—	—	—	—	—	—
5.	Shuster (këpucar)	14	3	17	—	—	—	—	—	—	—	—	—
6.	Kasap	14	—	14	1	—	1	2	—	2	3	—	3
7.	Nallban (mbathëtar)	12	—	12	4	—	4	3	—	3	10	—	10
8.	Kazaz dhe Ipekçi (mëndafshpunues)	15	1	16	—	—	—	—	—	—	1	—	1
9.	Habbaz (bukëpjekës)	6	—	6	—	—	—	1	—	1	—	—	—
10.	Tregtar	5	—	5	8	—	8	6	—	6	—	—	—
11.	Bakall	—	—	—	6	—	6	—	—	—	3	—	3
12.	Dylgjer (karpentier)	5	—	5	—	—	—	—	—	—	—	—	—
13.	Çilingjir (bravapunues)	5	—	5	4	—	4	1	—	1	—	—	—
14.	Samarxhi	4	—	4	—	—	—	—	—	—	—	—	—

DO NOT COPY

a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
15.	Kujumxhi (argjendar)	1	4	5	—	—	—	1	—	1	1	—	1
16.	Qyrkxhi (gëzoftar)	2	3	5	—	—	—	2	—	2	2	—	2
17.	Berber	4	—	4	1	—	1	—	—	—	—	—	—
18.	Papuxhi (papuçe-punues)	1	3	4	—	—	—	5	—	5	—	—	—
19.	Pashmakçi (sandale-punues)	4	—	4	—	—	—	1	—	1	—	—	—
20.	Çizmexhi	4	—	4	—	—	—	1	—	1	2	—	2
21.	Saraç (përpunues lëkurash)	3	—	3	1	—	1	4	—	4	1	—	1
22.	Telak	3	—	3	6	—	6	5	—	5	6	—	6
23.	Boruzan	3	—	3	—	—	—	—	—	—	—	—	—
24.	Sapunxhi	3	—	3	3	—	3	1	—	1	1	—	1
25.	Bojaxhi	3	—	3	—	—	—	—	—	—	1	—	1
26.	Ashçi (Gjellëbërës)	3	—	3	—	—	—	—	—	—	2	—	2
27.	Kebexhi (gunëpunues)	3	—	3	—	—	—	—	—	—	—	—	—
28.	Kepçexhi (lugëpunues)	2	—	2	—	—	—	—	—	—	—	—	—
29.	Halvaxhi	2	—	2	—	—	—	—	—	—	—	—	—
30.	Sarëkçi (punues sarëkësh)	2	—	2	—	—	—	—	—	—	—	—	—
31.	Degirmenxhi (mullis)	1	1	2	—	—	—	—	—	—	—	—	—
32.	Attar (çikërrimtar shitës bimësh mjekësore)	1	—	1	—	—	—	—	—	—	—	—	—
33.	Messah (matës tokash)	1	—	1	—	—	—	—	—	—	—	—	—
34.	Këllëkçi (shpata-punues)	1	—	1	1	—	1	1	—	1	—	—	—
35.	Sagrakçi (shqyrtar)	1	—	1	—	—	—	—	—	—	—	—	—
36.	Çirçi (çikërrimtar)	1	—	1	—	—	—	—	—	—	—	—	—
37.	Xhezvexhi	1	—	1	—	—	—	—	—	—	—	—	—
38.	Kovaç (farkëtar)	1	1	2	—	1	1	—	—	—	—	—	—
39.	Qiraxhi (karvanexhi)	1	—	1	1	—	1	—	—	—	—	—	—
40.	Tellall (kasnec)	1	—	1	3	—	3	—	—	—	1	—	1
41.	Mumxhi (qiripunues)	1	—	1	—	—	—	—	—	—	—	—	—
42.	Takijexhi (fespunues)	1	—	1	—	—	—	—	—	—	2	—	2

DO NOT COPY

a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
43.	Saraf	—	—	—	1	—	1	—	—	—	—	—	—
44.	Hamamxhi	1	—	1	3	—	3	1	—	1	2	—	2
45.	Kemangjir (shigjeta-punues)	—	—	—	1	—	1	—	—	—	—	—	—
46.	Madeni (xehëtar)	—	—	—	12	—	12	—	—	—	—	—	—
47.	Renxhber (zotërues, pronar i një fonderie)	—	—	—	6	—	6	—	—	—	—	—	—
48.	Hallaç (shkrifës leshi)	—	—	—	2	—	2	1	—	1	1	—	1
49.	Bazhdar (peshues)	6	—	6	5	1	6	1	—	1	—	—	—
50.	Haffaf (shitës këpucësh)	—	—	—	1	—	1	1	—	1	—	—	—
51.	Tuzxhi ((kripë-shitës)	—	—	—	1	—	1	—	—	1	1	—	1
52.	Xherrah (kirurg)	—	—	—	2	—	2	—	—	—	—	—	—
53.	Nalçexhi	—	—	—	1	—	1	—	—	—	—	—	—
54.	Syrixhi (karvanexhi ose devexhi)	—	—	—	—	—	—	3	—	3	3	—	3
55.	Bozaxhi	—	—	—	—	—	—	—	—	—	1	—	1
56.	Opon (opingar)	2	—	2	—	—	—	—	—	—	—	—	—
		227	19	246	105	3	108	67	1	68	59	—	59

Po të vështrojmë nga pikpamja fetare përbërjen e shtresës zejtaro-tregtare në qytetet bie në sy mbizotërimi i plotë në të i elementeve të islamizuar. Kështu p.sh. qytetet kryesore si ai i Beratit, Elbasanit, Shkodrës, Prizrenit, Prishtinës, Pejës, Vuçiternit në fund të shek. XVI të marrë së bashku kishin gjithsej 1686 zejtarë myslimanë përkundrejt 39 zejtarëve të krishterë, kur popullsia myslimane arrinte në 2570 shtëpi dhe ajo e krishterë, në 1121 shtëpi. Në raport me sasinë e përgjithshme të popullsisë në këto qytete (3691 shtëpi), zejtarët e tregëtarët myslimanë zinin 45,7% dhe së bashku me banorët myslimanë të tjerë 70% të saj, kurse ata të krishterë zinin 1% dhe së bashku me të krishterët e tjerë përbënin 30% të saj[60b]. Këto të dhëna tregojnë qartë se shteti osman e rezervonte sferën e veprimtarisë zejtaro-tregtare në qytetet për myslimanët, duke u krijuar atyre një pozitë ekonomike-shoqërore më të privilegjuar se ajo e të krishterëve. Ato lenë të nënkuptohet se aktiviteti kryesor i shumicës së banorëve të krishterë në qytetet duhet të ketë qenë i përqendruar kryesisht në sferën e prodhimit bujqësor.

Qytetet	Shtresa zejtaro-tregtare		Sasia totale e shtëpive	
	Shtëpi myslimane	Shtëpi të krishtere	Myslimane	të krishtere
1. Berati	650	—	650	444
2 Elbasani	458	16	640	168
3. Shkodra	120	—	282	—
4. Prizreni	227	19	320	237
5. Prishtina	105	3	307	199
6. Peja	67	1	228	58
7. Vuçiterni	59	—	143	15
Gjithsej	1686	39	2570	1121

60b) Më poshtë po japim të dhënat përkatëse për çdo qytet të nxjerra nga regjistrimet kadastrale të fundit të shek. XVI.

DO NOT COPY

Rimëkëmbja graduale e qyteteve gjatë shek. XVI dhe shtimi i prodhimit të mallrave për treg solli si rezultat përparimin e tregjeve lokale, zhvillimin e marrëdhënieve monetare dhe forcimin e lidhjeve të ekonomisë fshatare me qytetin. Ky rigjallërim i jetës ekonomike dhe interesi i shtetit për të nxjerrë prej tij të ardhura, bënë të nevojshme nxjerrjen e dispozitave shtetërore për rregullimin nga ana juridike të jetës ekonomike të pazareve lokalë. Këto dispozita u dhanë pak a shumë në formë të përmbledhur në kanunamenë e nxjerrë nga Selimi I (1512-1520) dhe më vonë, në formë më të hollësishme në kanunametë e sanxhakëve, të cilat i përkasin kryesisht gjysmës së dytë të shek. XVI siç janë p.sh. kanunametë e Vuçiternit (1525-30), Vlorës (1583), Shkodrës (1529, 1570), Elbasanit (1569), Prizrenit (1570), Ohrit (1583). Në këto kanunname janë dhënë dispozita të rëndësishme për rregullimin e jetës ekonomike të tregjeve lokale, në përputhje me kushtet e zhvillimi ekonomik-shoqëror të secilës krahinë. Nëpërmjet tyre rregulloheshin marrëdhëniet e shkëmbimit të produkteve bujqësore, blegtorale dhe zejtare, përcaktoheshin masat, peshat, çmimet, taksat që vileshin në treg (baci pazar, ihtisab ve ihzariye), taksa e doganës (gümrük resmi) dhe taksat që vileshin nga anijet që hynin në limanet e bregdetit (resmi kapudani) etj. Në to janë përcaktuar detyrat e muhtesibëve-mbikqyrësit e pazareve që kontrollonin cilësinë e produkteve bujqësore-blegtorale dhe zejtare, saktësinë e peshave dhe njësive të tjera matëse që përdoreshin në treg, përcaktonin nëpërmjet kadiut çmimet e mallrave etj. Muhtesibët vilnin taksën për llogaritjen dhe për çuarjen e kundravajtësve në gjyqin e kadiut (ihtisab ve ihzariye), e cila shkonte në favor të zotëruesit feudal të qytetit.[61] Rregullat e vendosura në përgjithësi synonin të sigurojnin të ardhura nga qytetet për klasën feudale si dhe të realizonin shfrytëzimin e banorëve të tyre.

Gjallërimi i tregut lokal dhe përhapja e marrëdhënieve monetare dëshmohen edhe nga shtimi i të ardhurave të vjela për shitblerje në treg siç janë taksat e baxhi pazarit (ose baxhi sijah) dhe ihtisab e ihzarije.[62] Po të krahasojmë madhësitë e këtyre taksave dhe sasitë e të ardhurave që formoheshin prej tyre sipas të dhënave të regjistrave kadastralë, konstatohet lehtë se qarkullimi i mallrave ishte rritur mjaftë në krahasim me gjendjen në shek. XV kur të ardhurat nga këto taksa ishin të pakta. Kështu p.sh. në gjysmën e dytë të shek. XVI mblidheshin nga taksa e baxhi pazarit në Gjirokastër 2000 akçe, në Lezhë 8167 akçe, në Janjevë 10.000 akçe, në Pejë

61) Kështu p.sh. për çdo barrë mall si drithi, orizi, kripe, mjalti, vaji etj, që hynte në treg dhe muhtesibi i caktonte çmimin, vilej 1 akçe si taksë përllogaritjeje (ihtisab). Nga kundravajtësit vileshin gjoba (cerime) të caktuara, kurse për çuarjen e tyre në gjyq vileshin 2 akçe.

Shih: kanunnamenë e sanxhakut të Vuçiternit të vitit 1525-30 H. Kaleshi, **Jedna Prizrenska i dve Vučitrnske kanunname,** në Glasnik muzeja Kosova i Metohije, Prishtinë 1957, v. II, f. 296; H. Hadžibeğič, **Kanunnama sultan Sulejmana...,** f. 373, Kanunameja e Sulejman Ligjëvënësit në përmbledhjen **Kanunname Osmani,** të Bibliotekës Kombëtare, shifra 15g, 25, f. 51; kanunameja e sanxhakut të Elbasanit e vitit 1583 në TK.A., **Defteri mufassal liva-i Ilbasan,** defter nr. 66.

62) Pothuajse në shumicën e sanxhakëve shqiptarë baxhi pazari vilej në këtë madhësi: për një barrë drithi, frutash, orizi, qiqrash, bathësh, thjerzash, gështenjash, pjepër e shalqini, verë, mjalti, vaji, peshku, kripë, dylli, djalli, vileshin 2 akçe; për një barrë musht 2-3 akçe, për valanidh 1 akçe, për cohë 2 akçe, për një fuçi verë në Vlorë 7 akçe kurse në Shkodër 15 akçe, për një kalë 4 akçe, për një gjedh 2 akçe, për dy dele kur therren 1 akçe, për një barrë arra 1 akçe, për një astar vaj ulliri 1 akçe, për një gunë 1 akçe etj.

Shih kanunametë për sanxhakët e Vlorës, Shkodrës, Elbasanit, Vuçiternit: Ö.L. Barkan, **Kanunlar,** f. 292; H. Inalcik **Sureti defteri...,** f. 123-124, **Kanuni i kanunname za bosanski, hercegovački, kliški, crnogorski i skadarski sandžak,** saopštavaja B. Djurdjev, N. Filipović, H. Hadžibeğić, M. Mujić, H. Šabanović, Sarajevo 1957, f. 179-180; H. Kaleshi **Jedna Prizrenska....** f. 295-298. Başbakanlık arşivi, tapu defterleri, defter nr. 99; TK.A, defter nr. 66.

Në kanunamenë e Mehmetit II është përcaktuar për çdo mall që shitet në treg taksa e baxhi pazarit. Shih: F. Kraelitz-Greifenhorst, **vep. përm.,** 30.

DO NOT COPY

3000 akçe, në Prishtinë vetëm nga panairi 2000 akçe[63], nga ihtisabi dhe ihzarije në Vlorë 10.000 akçe, në Tivar 8816 akçe (bashkë me baxhi pazarin)[64].

Me zhvillimin e zejtarisë dhe rritjen e tregut lokal u ndje nevoja që zejtarët dhe tregtarët të vendosnin disa norma për të rregulluar prodhimin dhe për të mbrojtur interesat e tyre nga konkurenca dhe nga dëmtimet e ndërhyrjet arbitrare të feudalëve. Në dokumentet e kohës bëhet fjalë për grupe zejtarësh (tajfa) dhe për rregulla të vendosura midis tyre për të mënjanuar konfliktet. Këto ishin hapat e para drejt bashkimit të tyre në organizatat e esnafëve. Të dhënat e dokumentacionit lejojnë të konkludohet se në qytetet më të zhvilluara aty nga fundi i shek. XVI ishin krijuar esnafët e zejeve më të rëndësishme. Zakonisht në regjistrat kadastrale të shek. XV nuk gjenden të dhëna mbi organizimin e brendshëm esnafor, mbi ekzistencën e drejtuesve të esnafëve si p.sh. ahive, kethydave, jegitbashëve, ustabashëve etj. Siç duket ky organizim nuk iu interesonte eminëve të kadastrës për ta regjistruar. Por në regjistrat e zyrës së kadinjve, p.sh. në ato të Elbasanit, gjenden të dhëna që tregojnë se në këtë qytet ishin krijuar esnafët e lëkurëregjësve, papuxhinjve, leshpunuesve, terzive. Në një akt (huruf) të kadiut të Elbasanit shkruar nga fundi i muajit prill 1580, përmenden ahitë dhe jegitbashët e esnafit të lëkurëregjësve të quajtur Sefer Halife, Mustafa, Selanikli Hyseini, Elhaxh Mustafa[65]. Ndonëse mungojnë të dhënat, mund të supozohet se edhe në qytetet e tjera si në Berat, Prizren, Prishtinë, Vlorë, të cilët kishin pak a shumë të njëjtin nivel të zhvillimit ekonomik-shoqëror me atë të Elbasanit, duhet të jenë krijuar organizatat e esnafëve. Por ky organizim, siç e ka vënë në dukje për herë të parë Z. Shkodra, ishte në një fazë embrionale dhe do të marrë formë të plotë në shek. XVII[66]. Kjo shkallë fillestare organizimi i përgjigjej zhvillimit ende të pakët ekonomik-shoqëror të qyteteve shqiptare në shek. XVI.

Zhvillimit të qyteteve iu përgjigjej edhe pamja e jashtme e tyre. Në përgjithësi ato përbëheshin nga dy pjesë kryesore: nga kalatë e rrethuara me mure të larta, ku përveç garnizoneve ushtarake dhe administratës qeveritare osmane, ishin vendosur edhe banorë të sferave ekonomike kryesisht të islamizuarit dhe nga lagjet e jashtme (varoshet) të banuara nga zejtarët, bujqit etj. Brenda kalave ndodheshin kryesisht banesat qeveritare. Por meqenëse muret rrethuese nuk lejonin shtrirjen e banesave, rrugët brenda kalave bëheshin gjithnjë e më të ngushta dhe çatitë e shtëpive shpeshherë mbulonin edhe rrugët publike. Tregu ndodhej gjithmonë jashtë mureve të kalasë, në varoshet. Në afërsi të këtyre u ndërtuan dyqane dhe magazina sipas llojeve të zejeve, të cilat përbënin rrugët zejtaro-tregtare.

Mëkëmbja e ekonomisë fshatare e qytetare gjatë shek. XVI solli krahas zhvillimit të tregut të brendshëm, edhe zgjerimin e tregtisë së jashtme. Për këtë ndihmoi gjithashtu përfundimi i traktatit të paqes midis Perandorisë Osmane e Venedikut në vitin 1502 dhe lidhja e marrëveshjeve tregtare me Francën, Hollandën, Anglinë, në vitin 1535, që garantonin lirinë e lundrimit dhe të tregtisë me tokat e Perandorisë Osmane. Këto marrëveshje, të quajtura «kapitulacione» kishin fuqi edhe për tokat shqiptare ku lidhje e rregullta ekonomike me vendet perëndimore ishin dobësuar së tepërmi. Qëllimi kryesor i marrëdhënieve ekonomike me perëndimin ishte në radhë të parë shitja e tepricave të prodhimeve bujqësore e blegtorale të klasës feudale, të cilat qytetet nuk ishin në gjendje t'i konsumonin dhe as t'i përpunonin, kundrejt blerjes së artikujve industrialë për prodhim e konsum ndër të cilat artikujt e luksit që i blinte kryesisht aristokracia feudale, zinin një vend me rëndësi.

Qytetet bregdetare si Vlora dhe Shkodra u shpallën «Porte të hapura», gjë që padyshim ndihmoi në gjallërimin e marrëdhënieve ekonomike të krejt vendit me botën e jashtme. Tregtia dhe tranziti me perëndimin dhe me viset e tjera të Ballkanit hynë në një fazë të re zhvillimi aty nga mesi i shek. XVI[67]. Kjo duket qartë nga shtimi i lëvizjeve të tregtarëve vendës e të huaj në qytetet e bregdetit shqiptar dhe veçanërisht në rritjen e taksës së doganës dhe tak

63) Në regjistrime kadastrale të gjysmës së dytë të shek. XVI të ardhurat nga baxhi pazari ose resmi sijah rallë herë janë llogaritur veças. Për shumicën e qyteteve ato janë shënuar së bashku me të ardhurat nga taksat e nijabetit, badihavatë, ihtisabin etj. gjë që nuk na lejon të nxjerrim sa vileshin nga kjo taksë:
shih: TK.A, **Defteri mufassal liva-i Dukagjin,** defter nr. 63, f. 65-66; **Defter mufassal liva-i Avlonya,** defter nr. 62, fl. 126-127, **Defteri mufassal liva-i Iskenderiye,** defter nr. 59, f. 293-295; **Defter mufassal liva-i Vuçitern,** defter nr. 124, fl. 315.

64) TK.A. **Defteri mufassal liva-i Avlonya,** defter nr. 62, fl. 8-14; **Defteri mufassal liva-i Iskenderiye,** defter nr. 59, fl. 293-295.

65) AQSH. **Sixhilati i Elbasanit,** dosja nr. 1, dok. nr. 801307.

66) Z. Shkodra, **Esnafët shqiptarë,** f. 36.

67) Po aty, f. 38.

DOKTORATURA

sës së portit që vileshin në skelat kryesore.[68]. Kështu, sipas regjistrimeve të gjysmës së dytë të shek. XVI në skelat kryesore të bregdetit vileshin këto të ardhura: si taksë dogane në Vlorë 80000 akçe, në Shkodër 10500 akçe, në Lezhë 270339 akçe; si taksë porti në Vlorë 10000 akçe, në Lezhë 100724 akçe. Në Durrës për të dy taksat vileshin 80000 akçe.[69]. Në rast se marrim në mënyrë të përafërt taksën e doganës të vjelë në masën 4% të vlerës së mallit, mund të thuhet se vetëm në skelat e Vlorës, Lezhës, Shkodrës me 360500 akçe të ardhura nga kjo taksë, kanë hyrë e dalë mallra me vleftën 9.012.500 akçe. Po kështu po të përpjestojmë të ardhurat e taksës së portit në skelat e Vlorës dhe Lezhës gjithsej 110724 akçe me sasinë e taksës që vilej për një anije me dy direkë (100 akçe), mund të thuhet se në to kanë hyrë e dalë gjatë vitit afro 1100 anije të tilla[70]. Në krahasim me gjendjen në shek. XV, taksa e doganës ishte rritur disa herë, p.sh. më 1485 nga dogana e Shkodrës (e Bunës) vileshin 10000 akçe në tre vjet, kurse tashmë vileshin 10500 akçe në vit[71].

Vëllimi më i madh i tregtisë së jashtme e i tranzitit kryhej në skelat e Vlorës, Lezhës, Durrësit. Ndonëse nuk kishin popullsi të shumtë Lezha dhe Durrësi, si skela vazhduan të luanin rol të rëndësishëm në shkëmbimet tregëtare të prodhimeve bujqësore-blegtorale të viseve shqiptare dhe të atyre ballkanike fqinje me botën e jashtme. Në Lezhë ishte përqendruar një pjesë e madhe e shkëmbimit të trevave veriore me vendet e huaja, gjë që kuptohet nga fakti se të ardhurat e kësaj skele nga taksat e doganës e të portit janë disa herë më të mëdha se ato të Vlorës, Durrësit e Shkodrës. Lëvizja e gjallë eksporti dhe tranziti kryhej gjithashtu në portet e tjerë më të vegjël si në Shirgj, Bashtovë, etj. Nga Shqipëria eksportoheshin drithë, dru, lëkurë, peshk, kripë, zift, lesh, kuaj etj. Kështu p.sh. sipas një raporti të vitit 1553, eksportoheshin në Dalmaci, Venedik, Ankonë e Spanjë 150000 stara drithëra në vit[72]. Një shumë të konsiderueshme të ardhurash vjetore prej 295000 akçe në vit nxirrte shteti nga shitja e ziftit që nxirrej nga minierat e krahinës së Vlorës[73]. Kjo dëshmon se ka patur një eksportim të madh të këtij produkti. Një nyje e rëndësishme tregëtare ishte bërë Elbasani duke lidhur viset e brendshme shqiptare e ballkanike me portet e bregdetit. Kjo shprehet qartë nga fakti se një pjesë e mëhallave të qytetit mbanin emrat e qyteteve me të cilët mbante lidhje ekonomike Elbasani si p.sh. të Korçës, të Vlorës, të Ohrit, të Shkupit, të Sofjes, të Kosturit, të Janinës, të Serezit etj.

Tregjet shqiptare tërhoqën vëmëndjen e tregtarëve të huaj venecianë, raguzanë, fiorentinë. Këta sillnin zakonisht mallra artizanale si përhurë, cohë, kadife, stofra të leshta, qilima e lëkurë të përpunuara dhe blinin zakonisht produkte bujqësore-blegtorale[74]. Ishin krijuar edhe shoqëri të përbashkëta të tregëtarëve vendës me tregëtarë të huaj për të kryer eksport-import mallrash[75]. Për strehimin e tregtarëve vendës e të huaj gjatë rrugëve dhe në qytetet kryesore si në Prizren, Elbasan, Berat, Lezhë etj. ishin ndërtuar karvan saraje.

Me gjithë përparimin dhe rigjallërimin e ekonomisë zejtaro-tregtare qytetet ende nuk kishin tërhequr në sferën e prodhimit të mallrave një pjesë të konsiderueshme të popullsisë që vazhdonte të lidhej me ekonominë bujqësore. Madje këto lidhje ishin mjaft të forta. Kjo shprehet qartë nga të dhënat e regjistrimeve të gjysmës së dytë të shek. XVI mbi vjeljen

68) Sipas kanunamesë së Vlorës dhe të Elbasanit, për mallrat që importoheshin ose eksportoheshin vilej si taksë dogane nga tregtarët myslimanë 2%, të krishterë 4% dhe të huaj 5% e vlerës së mallit; për anijet që hynin në port, nga ato me një direk vileshin 50 akçe, me dy direkë 100 akçe, me tre direkë 150 akçe si taksë porti. Për varkat pa direkë vileshin 10-15 akçe, për varkat me një velë 5 akçe, për ato me dy vela 10 akçe (resmi badban).

Shih: H. Inalcik, **Sureti defteri...**, f. 123, 126; TK.A, **Defteri mufassal liva i Ilbasan,** defter nr. 66.

69) TK.A, **Defteri mufassal liva-i Avlonya,** defter nr. 62, fl. 8-14; **Defteri mufassal liva-i Iskenderiye,** Defter nr. 59, fl. 6; **Defteri mufassal liva-i Ilbasan,** defter nr. 66, fl. 8-12; **Dèfteri mufassal liva-i Dukagin,** defter nr. 63, f. 65-66.

70) **Po aty,**

71) S. Pulaha, **Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës në vitin 1485,** f. 210; TK.A, **Defteri mufassal liva-i Iskenderiye,** defter nr. 59, f. 6.

72) Shih: V. Vinaver, **Dubrovačko – albanski ekonomski odnosi krajem XVI veka,** në Anali historiskog Instituta jug. akademia znanosti i umjetnosti u Dubrovniku, v. I, Dubrovnik 1952, f. 217; Z. Shkodra, **Esnafët shqiptarë,** f. 39, (1 starë = 50,5 litra).

73) TK.A. **Defteri mufassal liva-i Avloniya,** defter nr. 62, fl. 8-14. Sipas kanunnamesë së këtij sanxhaku punëtorëve që nxirrnin ziftin dhe ia dorzonin shtetit u paguheshin 20 akçe për 1000 litra zift.

74) Z. Shkodra, **Esnafët shqiptarë,** f. 39-40; H. Inalcik, **Sureti defteri...,** f. 123-124.

75) H. Inalcik, **Sureti defteri...,** f 123.

nga qytetarët të taksës të së dhjetës të prodhimeve bujqësore si gruri, elbi, thekri, meli, lini, perimet etj. Këto detyrime sillnin të ardhura jo të pakta për klasën sunduese osmane. Për qytetet kryesore ato paraqiten si më poshtë:

Nr.	Qytetet	Të ardhura nga e dhjeta në akçe	Prej këtyre të ardhurave nga e dhjeta e mushtit	Të ardhurat totale përfshirë e taksat e tjera si ispenxhe, badihava, baxhi pazar.
1.	Vlora	35 222	23 400	51 382
2.	Berati	30 852	4 300	52 610
3.	Elbasani	32 796	6 000	57 638
4.	Shkodra	9 726	530	29 200
5.	Peja	13 862	10 240	32 000
6.	Prizreni	22 194	8 704	50 900
7.	Prishtina	56 614	26 800	94 781
8.	Vuçiterni	8 825	2 240	25 000
9.	Gjirokastra	9 854	—	22 760

Në të ardhurat nga e dhjeta një vend të rëndë sishëm zinin të ardhurat nga e dhjeta e mushti që nxirrej nga rrushi i prodhuar në vreshtat e qy teteve. Kjo do të thotë se aty kishte një vreshtar të zhvilluar si shprehje e traditës së jetës urbane Të dhënat e mësipërme dëshmojnë qartë se eko nomia qytetare ruante ende karakter agrar me për jashtim të qyteteve të Janjevës, Trepçës e Novo bërdës, ku popullsia merrej kryesisht me xehëtar dhe nuk kishte ekonomi bujqësore. Të ardhurat ng të dhjetat në këto qytete ishin fare të pakta si p.sh në Trepçë ose mungonin krejt si në Novobërdë. Kla sa feudale osmane nxirrte të ardhurat kryesore ng taksat që lidheshin me minierat. Në Novobërdë vi leshin 33730 akçe nga e dhjeta e argjendit të shkri të të xeherorëve dhe nga taksa e kalhanesë[76], n Trepçë 117666 akçe, në Janjevë 144833 akçe. Të ar dhura të mëdha merreshin nga e dhjeta e darbha nesë së Novobërdës që arrinin në 1595176 akçe.

I njëjti raport midis ekonomisë zejtaro-tregtar dhe asaj bujqësore shprehet edhe në strukturën sho qërore të qyteteve. Kjo, sipas të dhënave të regjistri meve të gjysmës së dytë të shek. XVI, për qytete kryesore paraqitet si më poshtë:

Nr.	Shtresat e popullsisë qytetare.	Berati		Elbasani		Shkodra		Gjirokastra	
		Sasia	Kundrejt sasisë së shtëpive (1094) në %	Sasia	Kundrejt sasisë së shtëpive (808) në %	Sasia	Kundrejt sasisë së shtëpive (282) në %	Sasia	Kundrejt sasisë së shtëpiv (302) në %
1.	Zejtarë	624	57	456	56,4	108	38	19	6
2.	Tregtarë, bakej, zejtarë-tregtarë.	13	1,2	18	2,2	12	4	—	—
3.	Klerikë, administratorë të vakëfeve (imamë, hatibë, myezinë, dervishë, mytevelinj, xhabinj, shehlerë, sofi, mualimë, danishmendë).	—	—	8	0,8	9	2,4	6	2
4.	Të pa përcaktuar, një pjesë e të cilëve mund të merren me bujqësi.	457	41,5	326	40,8	148	52	277	91
5.	Zotërues çifligjesh (kryesisht nga zaimët, zotëruesit e timareve dhe ruajtësit e kalave timarlinj)	147	13,4	78	9,6	18	6,3	26	8,6

75) Kalhane resmi – taksë që mblidhej për të mbuluar shpenzimet e rafinerimit (pastrimit) të argjendit. Shuma e saj ndryshonte sipas minierave dhe u paguhej amilëve të rafinerisë.

77) Në regjistrimet për Beratin, Elbasanin, Shkodrën, Gjirokastrën nuk janë shënuar me emra pjesëtarë e klasës feudale që banonin në qytet, por janë dhënë zakonisht çifligjet me emrat e zotëruesve të tyre që ishin zaimë, zotërues timari, ruajtës të kalave etj. Nënkuptohet se këta banonin në qytet. Nuk i kemi përfshirë në numrin total të banorëve, të cilët i përkasin vetëm shtresave të shfrytëzuara të qytetit. Përveç këtyre duhet të ketë patur dhe feudalë të tjerë pa çifligje. Për të përcaktuar këtë nuk disponojmë të dhëna.

DO NOT COPY

Nr	Shtresat e popullsisë qytetare	Peja		Prizreni		Prishtina		Vuçiterni	
		Sasia	Kundrejt sasisë së shtëpive (158) në %	Sasia	Kundrejt sasisë së shtëpive (557) në %	Sasia	Kundrejt sasisë së shtëpive (506) në %	Sasia	Kundrejt sasisë së shtëpive (286) në %
1.	Zejtarë	62	39	238	42,7	99	19,5	56	19,5
2.	Tregtarë, bakej, zejtarë-tregtarë	6	3,8	5	0,9	8	1,5	3	1
3.	Klerikë, administratorë të vakëfeve (imamë, hatibë, myezinë, dervishë, mytevelinj, xhabinj, shehlerë, sofi, mualimë, danishmendë)	32	20,3	12	2	26	5	18	6
4.	Nëpunës të administratës (kadinj, naibë, eminë, qatibë, myhzirë, çaushë, muhtesibë)	3	1,8	8	1,5	22	4,3	7	2,4
5.	Feudalë (zaimë, jeniçerë, kalorës ushtarakë, seraskerë, gulamë, shërbyes kalorsi).	1	0,6	—	—	85	16,7	32	11
6.	Të papërcaktuar që mund të merren me bujqësi.	51	32	270	48,4	199	39	124	43,3
7.	Zotërues bashtinash	—	—	11	1,9	56	12	32	11
8.	Klerikë ortodoksë	2	1,2	12	2	9	1,7	14	4,8
9.	Klerikë katolikë	1	0,6	1	0,1	2	0,3	—	—

Struktura shoqërore e qyteteve në këtë periudhë paraqitet e tillë: elementi zejtar-tregtar i marrë së bashku përbënte shtresën kryesore sidomos në Berat e Elbasan ku përfshinte 58% të popullsisë, në Prizren e Pejë 43%, në Shkodër 38% ndërsa në Prishtinë e Vuçitern 21% të saj. Elementi tregtar që vepronte në fushën e qarkullimit të mallrave zinte një vend më të pakët që lëvizte nga 1-3% të popullsisë dhe ende nuk dallohej qartë nga prodhuesit meqë shpesh gjejmë zejtarë të cilësuar edhe si tregtarë (shih regjistrimin e Pejës)[78]. Në regjistrimet shpesh nuk jepet cilësimi për banorët që merreshin me bujqësi, ashtu siç bëhet për zejtarët, funksionarët etj. Megjithkëtë me siguri mund të thuhet se prodhimi bujqësor i qyteteve vinte nga fakti se shumica e banorëve për të cilët nuk është përcaktuar profesioni dhe zotëruesit e bashtinave ishin të lidhur me ekonominë bujqësore. Këta formonin një shtresë shoqërore që arrinte në 50-54% të popullsisë në Prizren, Prishtinë, Vuçitern dhe 40-41% në Berat e Elbasan, 32% në Pejë.[79] Ky fakt dëshmon qartë se ekonomia e qyteteve në fjalë ruante në përgjithësi karakter agrar, se ende në pjesën më të madhe të tyre nuk ishte tërhequr në sferën e prodhimit të mallrave shumica dërrmuese e popullsisë dhe se në mos merreshin me punë bujqësore një pjesë e zejtarëve apo tregtarëve, të paktën pjesëtarë të familjeve të tyre, punonin tokën dhe mbanin bagëtitë. Ka të dhëna që tregojnë se kishte banorë që merreshin edhe me blegtori. P.sh. në Trepçë përmenden katër lopçarë (govedar), në Janjevë një bari (ovçar), në Elbasan dy barinj (çobanë) etj.

Në krye të këtyre shtresave prodhuese të shfrytëzuara qëndronte paria qytetare: feudalët, funksionarët, klerikët e institucioneve fetare islamike, administratorët e vakëfeve, ushtarakët, klerikët e lartë ortodoksë e katolikë. Në qendrat e mëdha administrative si në Prishtinë e Vuçitern këta zinin respektivisht 28%

78) TK.A **Defteri mufassal liva-i Iskenderiye,** defter nr. 59, fl. 141-144.

79) Mendojmë se jo të gjithë këta merreshin me bujqësi. Në regjistrimet nuk gjejmë të shënuar kallfë e çirakë dhe herë-herë përmenden kryefamiljarë të cilësuar lypës ose të varfër.

DO NOT COPY

dhe 24%, në Pejë 24% (shumica ishin klerikë myslimanë), në Prizren 5.6%.[80]

Krahas përparimit ekonomik-shoqëror në qytetet kishte depërtuar me ritme mjaft të shpejta procesi i islamizimit. Popullsia e Shkodrës ishte islamizuar krejtësisht, kurse e Pejës 90%, Vuçiternit 80%, Elbasanit 79%, Beratit e Prishtinës 60%, Prizrenit 56%, Krujës 63%. Qytetet e tjera ishin islamizuar më pak: Gjirokastra 23%, Tivari 26%, Trepça 21%, Janjeva 14%, Delvina 4%, Kanina 0,3%, kurse Vlora 0%[81]. Në qytetet e islamizuara sidomos në ato të Rrafshit të Dukagjinit e të Kosovës ishin ndërtuar mjaft godina të kultit islamik si psh. xhami, të cilat u kishin dhënë edhe emrin e lagjeve. Xhami me emrin Xhamia Sherif, gjendeshin në Shkodër, Pejë, Vuçitern, Novobërdë. Xhamia e Gjylgem Hatunit ishte ndërtuar në Pejë, Xhamia Atik (e vjetër) në Prizren, Xhamia me emrin e sulltan Mehmetit II dhe Jonuz Kadiut në Prishtinë. Mesxhide kishte 1 në Pejë, 9 në Prishtinë përveç hamameve, teqeve etj. Lagjet kishin ndryshuar emërtimet duke marrë emra të rinj islamikë. Ndeshen gjithashtu një numër i madh klerikësh islamikë si imamë, hatibë, shehlerë, myezinë, dervishë, mualimë, administratorë të vakëfeve, mytevelinj e xhabinj, veçanërisht në Prishtinë, Pejë, Vuçitern, Shkodër, Elbasan etj. Islamizimi i këtyre qyteteve ishte një goditje e rëndë për pozitat e kishës katolike ashtu dhe për ato të kishës ortodokse të ritit bizantino-grek dhe sllav.

Për islamizimin e popullsisë qytetare luajti rol politika e rëndë fiskale dhe masat diskriminuese ekonomike-shoqërore ndaj popullsisë së krishterë. Midis këtyre më kryesore ishin ngarkimi i banorëve të krishterë të qyteteve me detyrime më të rënda (xhizja, ispenxhe) se ato që shlyenin myslimanët, njohja zanatçinjve myslimanë e një pozite më të privilegjuar ekonomike-shoqërore e politike në krahasim me ata të krishterë, monopolizimi i zejtarisë dhe tregtisë kryesisht për qytetarët myslimanë, falja e këtyre nga detyrimet shtetërore përkundrejt shërbimeve të karakterit ushtarak etj.

Nga analiza që parashtruam më sipër, mund të arrihet në përfundimin se gjatë shek. XVI me shtimin e popullsisë së qyteteve, me daljen në skenë të shu
më zejeve dhe aktivizimin e tregjeve lokalë, të cilë
e bënë të domosdoshme ringjalljen e korporatave t
periudhës së para pushtimit osman, tashmë në for
mën orientale të esnafit, me rimëkëmbjen e tregtis
së brendshme dhe të jashtme, prodhimi i mallrav
për treg dhe jeta qytetare po hynin në një fazë të re
zhvillimi. Duke kapërxyer rrënimet dhe pengesat që
solli me vete pushtimi osman, vetëm pas një shekull
forcat prodhuese e rimorën veten, u rigjallëruan dhe
krijuan premisat për një zhvillim të mëtejshëm.

Më poshtë po japim listat për mëhallat dhe nu
mrin e banorëve të qyteteve më kryesorë në fund t
shek. XVI[82].

Qytetet dhe mëhallat	Sasia e burrave (neferë)	
	Të krishterë	Myslimanë
a	b	c
Berati		
1. Popullsia myslimane e ka lasë.	—	650
2. Papa Kondi	7	—
3. Dhimo Papa	4	—
4. Dhimo Nikolla	8	—
5. Nikolla Kamino	8	—
6. Komnin Jani	10	—
7. Dhimo Niko Nika	13	—
8. Jano Nikolla	16	—
9. Jani Celengjiri	20	—
10. Stojo Kondi	7	—
11. Novak	2	—
12. Dimitri Skura	6	—
13. Proto Papa	6	—
14. Jani Papa	6	—
15. Dhimo Bojko	6	—
16. Papa Dhimo	6	—
17. Menksh Kaiça	14	—
18. Miço Gremenar	10	—
19. Papa Lalthi	8	—
20. Dhimo Komnino	11	—
21. Jano Todori	6	—
22. Terzi Nikolla	9	—
23. Komnin Papa	9	—

80) Këtu nuk kemi përfshirë ruajtësit e kalavbe që zotëronin timare. Nuk disponojmë të dhëna për ta.

81) Shih tabelën mbi rritjen e popullsisë së qyteteve që e kemi dhënë më përpara.

82) Në regjistrimet për qytetet e Beratit, Elbasanit, Gjirokastrës, Kaninës, Vlorës nuk është dhënë sasia e shtëpive për çdo mëhallë, por sasia e burrave (neferë), e cila zakonisht është pak më e madhe se sasia e shtëpive. Në pamundësi të veçojmë sasinë e kryefamiljarëve që përfaqësonin shtëpitë, nga beqarët, po japim këtu sasinë e përgjithshme të burrave (neferëve). Për disa nga këto qytete është shënuar sasia e përgjithshme e shtëpive për krejt qytetin e pa ndarë për secilën mëhallë. Këto i kemi dhënë në tabelën për sasinë e shtëpiave të qytetit. Për Shkodrën, Prizrenin, Prishtinën, Pejën, Vuçiternin në regjistrimet është shënuar sasia për çdo mëhallë.

DO NOT COPY

a	b	c
24. Stavro Jani	10	—
25. Dhimo Niko	6	—
26. Dhimo Komnini	5	—
27. Todor Nika	6	—
28. Staso Zoti	17	—
29. Papa Andrea	6	—
30. Staso Jani	24	—
31. Baliksina (?)	3	—
32. Andrea Jani	5	—
33. Dhimo Papa	14	—
34. Bard	6	—
35. Kostandin Andrea	8	—
36. Papa Saia (?)	6	—
37. (e pa emërtuar)	9	—
38. Dhimo Staso	4	—
39. Harmilos (Çermilos ?)	47	—
40. Mëhalla e jashtme	44	—
41. Çifutët	11	—
42. Jevgjit	21	—
Gjithsejt	444	650

Elbasani

1. Populisia myslimane brenda kalasë	—	79
2. Çavushlu	—	319
3. Hazinedaran	—	76
4. Debaghane	—	133
5. Banorët raja	—	8
6. Bulkiz	—	15
7. Bozaxhiler	—	5
8. Dubçijas	—	11
9. Kesrije (Kosturi)	9	—
10. Janja (Janina)	12	—
11. Ohri	3	—
12. Vlora	8	—
13. Shkupi	5	—
14. Sofja	5	—
15. Siroz (Serez)	5	—
16. Ukça	14	—
17. Goricë (Korça)	9	—
18. Vafika (Vaska ?)	10	—
19. Istenko (?)	8	—
20. Barda	5	—
21. Shtegëtarët	86	—
Gjithsejt	179	646

Vlora

1. Hase të Sulltanit	244	—
2. Urana Mahale	194	—
3. Tuzla	184	—
4. Çifutët	247	—
Gjithësej	869	

a	b	c
Kanina		
1. Paskal	51	—
2. Çurkan	25	—
3. Bogo	25	—
4. Nikskur	72	—
5. Maramasto	58	—
6. Andoniko	39	—
7. Mallondroto	58	—
Gjithsej	328	—
Gjirokastra		
1. Populisia myslimane	—	65
2. Depknez (?) ose Dhimo Laluci	38	—
3. Niko Behoja (?)	49	—
4. Dhimo Janaco	28	—
5. Niko Çervi	16	—
6. Ifilo Kojak	63	—
7. Staso Kuçi	18	—
8. Kristo Tërbuqi së bashku me mëhallën Deda Kola	64	—
9. Martolos	14	—
Gjithsej	241	65

Qytetet dhe mëhallat	Myslimanë	Të krishterë		
	Shtëpi	Shtëpi	Beqarë	Të veja
a	b	c	ç	d
Shkodra				
1. Xhamia Sherif	61	—	—	—
2. Velixhan bej	35	—	—	—
3. Tophane ose Hasan Marshejn	46	—	—	—
4. Sulejman Emin ose Haxhi Resul	60	—	—	—
5. Ali bej	62	—	—	—
6. Pumla (?) (Plumb)	18	—	—	—
7. Smir (e braktisur)	—	—	—	—
8. Bërdica ose Hojamir (?) e braktisur	—	—	—	—
Gjithsej	282	—	—	—
Peja				
1. Xhamia Sherif	24	—	—	—
2. Sinan Vojvoda	13	—	—	—

DO NOT COPY

a	b	c	ç	d
3. Piri bej	2	—	—	—
4. Ahmet bej	17	—	—	—
5. Hysein	6	—	—	—
6. Hasan Çelebi	7	—	—	—
7. Mustafa bej	5	—	—	—
8. Muhamed Kadi	10	—	—	—
9. Osman	19	—	—	—
10. Kapishnica ose xhamia e Gjylgem Hatunit	15	—	—	—
11. Mesxhidi Haxhi Mahmud	7	—	—	—
12. Bali bej	10	—	—	—
13. Çeribash	8	—	—	—
14. Gjura Papuxhi	—	6	2	—
15. Olivir	—	2	—	—
16. Mëhalla e Shtegtarëve	—	7	—	—
17. Nikolla (e braktisur)	—	—	—	—
18. Nikolla Vukman (e braktisur)	—	—	—	—
19. Andrija (e braktisur)	—	—	—	—
Gjithsej	143	15	2	
Prizreni				
1. Xhamia e Vjetër	53	—	—	—
2. Levisha	50	—	—	—
3. Ajas beu	15	—	—	—
4. Haxhi Kasëm	48	—	—	—
5. Jazixh Sinan ose Emin Mehmed	71	—	—	—
6. Çarshia ose Jakub beu	18	—	—	—
7. Kurila	31	—	—	—
8. Debaganëve (lëkurë-regjësve)	34	—	—	—
9. Pazari i vjetër	—	8	2	—
10. Madhiq ose Isa Çelebi	—	37	5	—
11. Vasil	—	27	4	
12. Kodha ose Kurila	—	13	2	—
13. Çarshia ose Pjetër Nikolla	—	14	—	—
14. Bogoi Ribara	—	11	4	—
15. Radmir	—	46	7	—
16. Jazixhi Sinani ose Emin Mehmedi	—	24	9	—
17. Pandalja	—	29	2	—
18. Prend Vriça (Pridvori ça)		9	1	—
19. Ajas ose Izkuqan	—	13	1	—
20. Pandalja (shtegtarë)	—	6	—	—
Gjithsej	320	237	37	—

a	b	c	ç	d
Prishtina				
1. Xhami e Sulltan Mehmed Han Gaziut	44	—	—	—
2. Mesxhidi i Mehmed beut	29	—	—	—
3. Mesxhidi i Sinan bej Jaraluit	24	—	—	—
4. Mesxhidi i Çarshisë	12	—	—	—
5. Mesxhidi i Hasan Beut	30	—	—	—
6. Mesxhidi i Emin Alaedinit	48	—	—	—
7. Xhamia e Jonus Kadiut	34	—	—	—
8. Mesxhidi i Jusuf Çelebiut	38	—	—	—
9. Mesxhidi i Hasan Eminit	16	—	—	—
10. Mesxhidi Hatunije	12	—	—	—
11. Mesxhidi i Ramazan Çavushit	20	—	—	—
12. Mëhalla e Metropolitit	—	4	2	—
13. Koçanoviq	—	54	24	—
14. Botoçishta	—	26	2	
15. Giehriq (Kehriq)	—	12	7	—
16. Bojasar	—	29	15	—
17. Vinlaçka	—	35	23	—
18. Mohalla e latinëve (katolikëve)	—	4	1	—
19. Shtitar	—	29	13	—
20. Lukar	—	22	6	—
Gjithsej	307	199	93	—
Vuçiterni				
1. Xhamia Sherif dhe Hisar	38	—	—	—
2. Kadi	63	—	—	—
3. Zaganos	47	—	—	—
4. Shtëpitë pranë vakëfëve	18	—	—	—
5. Hurrem Çavush	21	—	—	—
6. Doganxhi	18	—	—	—
7. Tahir	23	—	—	—
8. Gradeçka	—	18	6	—
9. Tërgovishta	—	13	4	—
10. Kataj	—	23	6	—
11. Shuster	—	4	1	—
Gjithsej	228	58	17	—

DO NOT COPY

Selami PULAHA

DO NOT COPY

LES VILLES ALBANAISES SOUS LE REGIME FEODAL MILITAIRE OTTOMAN AU COURS DES XVe ET XVIe SIECLES.

Connaître la situation économique, sociale et politique des villes albanaises, au cours des premiers siècles de la domination ottomane, est devenu actuellement un besoin impérieux pour l'entreprise de recherches dans le domaine de l'histoire médiévale des contrées albanaises, parce qu'ainsi on mettrait mieux au jour certaines questions importantes, tels les changements qu'a apportés l'occupation ottomane et les influences du nouveau pouvoir sur la vie des villes, les traits de leur nouvelle situation dans le cadre du régime féodal ottoman, l'animation de la vie urbaine durant le XVIe siècle, vue étroitement liée avec le développement de l'économie paysanne, la nouvelle structure sociale, le processus d'islamisation etc. Les études faites jusqu'à ce jour, malgré leur contribution importante, en raison du manque de données documentaires, n'ont pas pu éclairer comme il faut ces problèmes. C'est pour cette raison que, dans cet article, nous allons essayer d'y jeter d'avantage de lumière et de remplir les lacunes qui existent quant à la situation des villes pendant le XVe et le XVIe siècle, en mettant à profit tout d'abord les données assez riches sur les villes, figurant dans les registres cadastraux de la période de la domination ottomane, ce qui, en général, n'a encore été que peu exploité par l'historiographie albanaise.

La situation des villes au cours du XVe siècle et leur statut dans le cadre du régime féodal ottoman.

La ville albanaise venait de la période d'avant l'occupation ottomane avec un haut niveau de développement, en tant que centre de production et d'échanges, en tant que centre économique d'un intérieur agricole, en tant que forteresse et centre militaire et administratif comme un carrefour dans les artères principales commerciales reliant les régions albanaises entre elles et avec celles de l'Europe Occidentale. Mais l'occupation ottomane, qui s'est installée dans la plupart des régions albanaises en 1479, marque, entre autres, de grands changements négatifs quant à la situation économique, sociale, politique et culturelle. Les campagnes et les incursions destructrices, les longues guerres de rapine et de dévastation, la dépopulation du pays causée par la violence des envahisseurs ottomans, ont eu pour conséquence la destruction des villes, leur transformation en centres inhabitables, ou en centres qui ne jouaient plus le rôle économique et social d'une ville. Certaines villes et forteresses épanouies comme Drisht, Deje, Shurdhah, Sfetigrad ont été presque complétement ruinées, tandis que de grandes villes comme Krujë, Shkodër, Lezhë, Durrës, Berat, Vlorë, Gjirokaster etc. ont été réduites en villages.

Les sources documentaire de l'époque reflètent clairement la situation misérable et la dégradation des villes, leur privation de la plus grande partie des forces humaines des couches d'artisans, de commerçants et de l'intélligentia. Ceci ressort surtout de la grande réduction du nombre de familles.

Une partie des habitants de ville ont péri dans la lutte pour la défense de la liberté, alors que d'autres, afin de ne pas supporter le joug ottoman se sont vus forcés de prendre le chemin de l'émigration, pour aller en Dalmatie et en Italie.

La destruction et l'abandon des villes ont interrompu temporairement le développement des forces productrices, qui sont retombées à un niveau dépassé depuis longtemps. L'artisanat et le commerce son rétombé à des niveau très bas ou bien ont complétement disparu. En même temps, l'ancienne organisation citadine et le système épanoui des corporations, qui existaient avant l'occupation ottomane dans les villes principales comme Shkodër, Prizren, Drisht, Krujë, Durrës etc., ont été supprimés. En conséquence, la vie économique et sociale était paralysée pour longtemps. A part l'abandon des villes, on a détruit les grands trésors culturels du passé; les meilleures oeuvres de l'architecture, des palais, des monuments, une partie des églises et des cathédrales, etc., ont été rasés à terre.

L'occupation ottomane a changé complétement la physionomie de l'organisation de la vie urbaine. Avec l'installation de la nouvelle administration ottomane et des garnisons militaires, les villes se sont transformées de villes libres, administrées sur la base de leur statut particulier, en centres administratifs militaires et religieux. Dans les villes, servant de centres aux corps administratifs à base de sandjak, *se sont installés les* sandjakbey *– gouverneurs et commandants des forces armées des* sandjaks *comme p.ex. à Gjirokastër, Shkodër, Elbasan, Prizren, Vuçitern, Ohër, etc., ... les* kadis *– juges, les* allaybeys *– commandants des forces armées des spahis, après les* sandjakbeys, *le clergé islamique, les* dizdars *–* commandants des garnisons des forteresses, *les* soubashe *gouverneurs militaires administratifs d'un vilayet ou d'une ville, les* naibs *– adjoints des* kadis *etc. Dans chaque forteresse il y avait des*

garnisons de soldats, auxquels on donnait d'habitude de petits timars à exploiter au lieu des salaires, des dizdars, etc.

Pendant la première étape de l'invasion ottomane, les villes, ayant de petites forces humaines et en se réduisent à l'état de villages quant au niveau de développement économique et social, jouaient principalement le rôle de centres administratifs et militaires et de forteresses.

Dès le début, le pouvoir ottoman a mené, à l'égard des villes, une politique visant à engager la majorité des habitants par des obligations militaires ou de service; pour l'entretien des forteresses, des ponts et des routes du voisinage.

Pour ces services, les habitants des villes de Krujë, Berat, Elbasan, Korçë, Shkodër, Drisht, Gjirokastër, Këlcyrë, Skrapar, Delvinë, Stelush, Petrelë et Tivar étaient exclus des taxes extraordinaires officielles – avarizi divanye ve tekâlifi örfiye.

3) Përveç gjurmëve materiale dhe vargëzimit të fortifikimeve këto unaza mund të ndiqen dhe nga lëvizjet e trupave ose nga qarkullimi tregtar. Kështu nga Ana Komnena kuptohen traktet Durrës-Dalmaci (Alex. I, I, 16), rruga gjatë Drinit nga Shkodra në Ohër (II, XII, 8,9) e cila del dhe më herët në shek. IX. (shih. shën. 24), rruga Ohër-Deabol (I, V, 1), ajo gjatë Vjosës dhe së fundi rruga Vlorë-Durrës (I, III, 12). Për traktin Medun-Plavë unaza e jashtme plotësohet nga të dhënat e defterit të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 (S. Pulaha, **«Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485»**, Tiranë, 1974, I, fq. 434.... të jenë dervenxhinj dhe të kujdesen e të ruajnë rrugën.... që kalon prej kalasë së Medunit në malet e Kuçit dhe zbret në Plavë – 5.III.1497). Traktin Nish-Prishtinë-Shkup-Ohër-Devoll-Kostur e jep vazhduesi i Skilicës. (Ε. Τσολάχης Η συνέχεια τῆς χρονογράφιά του Ιωάννου Σκυλίτξη Selanik, 1968, f. 162-166). Rrugët Ohër-Janinë dhe Janinë-Vajonetë i gjejmë po tek Ana Komnena (I, V, 4). Për rrugët e Veriut shih dhe C. Jireček **Die Handelsstrassen und Bergwerke von Serbien und Bosnien während des Mittelalters,** Prag, 1879, f. 62-74. Studimi më i plotë për rrugët mesjetare në vendin tonë, nga J. Adhami, **(Historia e rrugëve të Shqipërisë, Rrugët e Shqipërisë gjatë mesjetës dhe pushtimit turk;** «B.SH.SH.» Tiranë, 1953, 3, f. 23 – 29).

4) Në shek. XI abati i Rialtos dërgon njerëz në Durrës dhe Epir për të blerë drithë e bishtaja (A. Ducellier, **L'Albanie entre Orient et Occident aux XIe et XIIe siècles** në «Cahiers de civilisation médiévale» 1, 1976. Për shekujt e mëtejshëm B. Hrabak **(Eksportimi i drithit nga Shqipëria në shek. XIV-XV** në «Konferenca e dytë e studimeve albanologjike», I, 1969, f. 157-161) shënon eksportin gjithnjë e në rritje të këtyre prodhimeve. Ky eksport që kryhej në skelat nga Buna e deri në Vjosë është e qartë se bazohej në të korrat e fushës bregdetare, pasi transporti nga zonat e thella do të qe pa leverdi.

Kënetëzimi i fushës bregdetare mendojmë se është pasojë e zhytjes së saj dhe cektësimit të lumenjve. Kjo zhytje dëshmohet nga një sërë monumentesh. Në verilindje të liqenit të Shkodrës themelet e «kullës së Komnenëve» ndodhen 1.5-2 m nën nivelit e liqenit. Xokoli i një fortifikimi ilir në Rodon ndodhet 2-2,5 m nën nivelin e detit. Në brendi të kënetës së Karavastasë ndodhet rrënoja e një kishe paleokristiane. Në Treport (Aulonë) xokoli i një ndërtimi monumental ndodhet 1.5 m nën nivelin e ujërave nëntokësore, përkatësisht detit (A. Baçe, **Qendrat e fortifikuara të gjirit të Vlorës në antikitet.** «Monumentet» 10, Tiranë, 1976 f. 11). Lumenjtë në mesjetë qenë më të thellë e më të lundrueshëm çka kuptohet nga grindjet e vazhdueshme të raguzinëve, venecianëve për fluminaria-t, traktet e lundrueshme (shih. L. Thalloczy, C. Jirecék, E. Sufflay, **Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia** II, Vindobonae, 1918, më tej **Acta Alb.)** Kështu Vjosa sipas Ana Komnenës lundrohej deri në Ballsh (II, XIII, 5), Drini mbi Vaun e Danjës (**Acta Alb.** II, 339) Osumi në Berat (G. Pachimeres, **«Historiae»,** Bon, 1835, I, VI, 32). Cektësimi dhe zgjerimi i shtratit duket se erdhi si pasojë e prerjes masive të drurëve që nisi nga fundi i shek. XIII (**Acta Alb,** 402, 714). Si rrjedhim i erozionit u rritën prurjet e ngurta, u lartësuan konet e depozitimit në derdhje me pasojë drenazhimin e dobët. Kjo bashkë me zhytjen tektonike sollën kënetëzimin në mesjetën e vonë të fushës bregdetare.

5) Itinerari dhe materiali dokumentar për këtë rrugë tek C. Jireçek, **Vep. e cit,** f. 62-68. Danja në vitin 1477 shënohet si «kalimi kryesor për në Shqipëri» (N. Jorga **Notes et extraits pour servir a l'histoire des croisades au XVe siecle,** Bucarest, 1915, 3 194). Në Flet gjetëm gjurmët e kështjellës mesjetare të përmëndura nga Muzaka si kështjella e Dukagjinëve (C. Hopf, **Chroniques Greco-romanes inédites ou peu connues,** Berlin, 1873, f; 292). Këtu mundëm të ndjekim trasenë e rrugës për disa kilometra deri në kështjellën tjetër të Sakatit. Rruga e punuar në shkëmb dhe e shtruar me zhur, ka pjerrësi 10-12% dhe gjërësi 2-2,20 m, ndërsa vendet e pjerrëta ajo i kalon me serpentina. Siç shihet kjo është një rrugë kuajsh ose qerresh, po jo rrugë për karro (A. Baçe–L. Papajani, **Rezultatet e ekspeditës në rrethet Pukë-Tropojë në vitin 1982,** material në arkivin e I.M.K.)

DONOTCOPY

Prej këtej rrugë të tjera rrezatoheshin në Mitrovicë të Kosovës, Nish e Shkup.

Degëzimet e rrugës së dytë, nga Kruja dhe Tujani, bashkoheshin në kështjellën e Gurit të Bardhë, prej ku rruga vijonte për në Dibër, kështjellat e Sfetigradit e Modricës dhe Ohër. Lëvizjet e shpeshta ushtarake në shekujt XI-XV, e tregojnë atë një rrugë mjaft të rrahur[6].

Rruga e tretë kalonte nga Kanina në Ballsh, Berat dhe kështjellën e Tomorit, prej ku dilte në luminë e Devollit, qytetin e Deabolit (Zvezdë) dhe Ohër[7].

Rruga e fundit arrinte gjatë Vjosës në kështjellën e Tepelenës. Një krah i saj që kthehej në luginën e Drinos, pasi bashkohej në Adrianopol (Melan) me rrugën nga Butrinti, dilte në Janinë[8]. Krahu tjetër që i përmbahej Vjosës, kalonte nën kështjellat e Këlcyrës e Përmetit dhe bashkohej nga fundi me rrugën Janinë-Ohër. Paksa pas Këlcyrës një degë e rëndësishme e tij dilte nëpërmjet Dangëllisë në Kolonjë, mjaft më afër Deabolit.

Përveç këtyre arterieve burimet e mësipërme dëshmojnë dhe një sërë rrugësh të tjera si Shkodër-Medun-Plavë-Prizren ose Mitrovicë e Kosovës; Shkodër-Drisht-Plavë; Vau Spas-Mitrovicë e Kosovës; Lezhë-Stelush-Ohër; Elbasan-Berat; Drino-Vlorë etj.[9] si dhe një rrugë detare nga Budua në Korfuz[10].

Shënimi në Defterin e vitit 1467 sipas të cilit fshati Bulqizë ishte ngarkuar prej shekujsh me ruajtjen dhe mirëmbajtjen e rrugës,[11] dëshmon një institucion të hershëm për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve, rrjedhimisht një rrjet të rregullt të rrugëve mesjetare. Ndjekja nga Akropoliti në muajt më të ftohtë dhe me rreshje të vitit 1258 të njërës nga rrugët më të thyera, asaj Durrës-Mat-Dibër[12], tregon për një lëvizje të përhershme dhe jo stinore. Rrjedhimisht mbyllja në këtë rrjet të bashkërenduar e korridorit më të shkurtër e më të lehtë që të çonte nga Durrësi në Ohër e më tej në Kostandinopol, rrugës gjatë Shkumbinit, në shikim të parë është e papritur dhe e pakuptueshme. Në të vërtetë kjo dukuri e ka shpjegimin e saj: Rrugës në Babje i duhej të vazhdonte për nja 20 km

6) Për lëvizjet ushtarake të bizantinëve dhe normanëve Ana Komnena (II, XII, 8,9, II, XIII, 5) Akropoliti (χρονική συγγραφή), Leipzig, 1903 67), Skutarioti (K. Sathas, **Bibliotheca, Graeca, mediiaevi»** VII, 528-530), Efremi (**Chronographia,** Bon, 1840, 9150-9155). Traseja përvijohet më saktë nga fshatrat dervenë Klos, Gur i Bardhë, Bulqizë (S. Pulaha, **Lufta shqiptaro-turke e shek. XV. XV (burime osmane)** Tiranë, 1968. Regjistri i vitit 1467, vilajeti i Matit, f. 6, 8, vilajeti Gollobordës f. 4).

7) Trakti Kaninë-Ballsh tek Ana Komnena (II, XIII, 5), ai Ballsh-Qafë e Sinjës-Berat tek Pahymeres (VI, 32). Kjo rrugë përmendet në vitin 1417 si via marine, via de Musachia (N. Jorga, **vep. e cit** 2, 560). Për kalimin Berat-lumi i Devollit, itinerarin dhe urat në të. N. Ceka–A. Baçe (**vep. e cit,** f. 205-212). Trakti Gllavinicë-Guri i Prerë-lumi i Devollit-Deabol-Ohër jepet qartë nga Ana Komnena (II, XIII, 5). Itinerarin e kësaj rruge e jep dhe J. Adami, **(vep. e. cit).**

8) Kalimi nga Aulona në Adrionopol dhe Janinë ose Kostur tek Al-Idrizi (795). Rrugën e normanëve Butrint-Janinë e jep Ana Komnena (I. V. 4). Për qendrat dhe rrugën në luginën e Drinos A. Baçe **(Vështrim mbi qendrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos** «Monumentet» 4, 1972, f. 103-131). Rruga Aulonë-Janinë, Janinë-Kostur dhe Tepelenë-Vjosë në J. Adami **(vep. cit)** dhe P. Soustal-J. Koder (**Tabula imperii byzantini** 3, Wien, 1981, f. 88-94). Kalimi i rrugës Tepelenë Përmet-Leskovik dëshmohet dhe nga Defteri i Korçës, Përmetit, Konicës, i vitit 1431 **(Bašbakanlik aršivi maliyeden müderver maliyeden** nr. 231, f. 42» ... banoj në pjesën e sipërme të dervenit të Përmetit. Në qoftëse jepni urdhër do ruaj dervenin dhe do marr pjesë në ndërtimin e kalldrëmeve»).

9) Rrugët Shkodër-Medun dhe Drisht-Plavë piketohen nga fshatrat derven në Rijoll, David, Sunja, Bukmirë (S. Pulaha **Defteri i regjistrit të Sanxhakut të Shkodrës** f. 383, 384, 404). Ajo Vau Spas-Pejë nga derveni i Dragobisë **(Po aty,** f. 136), Lezhë-Stelush-Ohër nga fortifikimet dhe gjetjet e kulturës materiale. Rruga Elbasan-Berat nga urat dhe traseja ndërsa Drino-Vlorë nëpërmjet luginës së Kardhiqit, nga vargëzimi i fortifikimeve (Tavan-Kardhiq-Zhulat) dhe burimet e mëvonshme (shih A. Baçe, **Vështrim....** 103-125).

10) Qiriako i Ankonës jep rrugën detare Jadera-Durrës-Lingua (Kepi i Gjuhëzës)-Korfuz. Në kthim ai shënon dhe Gramatën e Vlorës (E. Bodnar, **Cyriacus of Ancona and Athens,** Brussel, 1960).

11) S. Pulaha; **Lufta shqiptaro-turke e shek. XV, Defteri i vitit 1467** f. 4. Fshati Bulqizë është fshat derven. Kanë në dorë urdhrin e perandorit në gjuhën greqisht».

12) Gj. Akropoliti, **vep e cit.,** 67.

DO NOT COPY

pllajës së Polisit, në vende shumë të rrëshqitshme që kërkonin punime të vëllimshme mirëmbajtjeje[13], por e mirëmbajtur ajo ishte një portë e hapur, pragu i së cilës kalohej lehtë. Nga fundi i shek. VI pa ndonjë detyrë të veçantë dhe e lënë pas dore, ajo u mbyll për lëvizjen e madhe. Gjatë shekujve në vazhdim, administrata bizantine nuk ishte e interesuar që të rihapte një portë, nëpërmjet së cilës mund të vërshonin invazionet si nga lindja në bregdet, ashtu dhe në të kundërt. Ca më pak qenë të interesuar feudalët shqiptarë, kur lëvizja u kalonte luginave e ngushticave të tyre, duke përfituar të mira prej saj dhe duke e mbikqyrur atë. Nga kjo mbikqyrje normanët e anzhuinët nuk kaluan dot Matit e Devollit dhe ushtrive osmane, përderisa e rihapën në vitin 1466 rrugën e Shkumbinit, u duhej të kalonin me telashe e humbje gjatë Matit[14]. Me mungesën e këtij boshti rrugor ndoshta shpjegohet dhe ndasia dialektore dhe e kulturës lëndore midis Shqipërisë Veriore e Jugore, e cila siç e tregojnë studimet e fundit lindi që në shek. VII-VIII[15], kohë që përkon pikërisht me mbylljen e rrugës së Shkumbinit.

Në këta shekuj, në kushtet e rënies së ekonomisë të bazuar në shkëmbimin monetar dhe heshtjes së burimeve historike, bashkësia kulturore dhe rrugët që e siguronin atë, mund të ndiqen nëpërmjet shpërndarjes së objekteve të kulturës së hershme shqiptare[16]. Por duhet vënë në dukje se mangësia e kërkimeve ose më saktë e botimeve arkeologjike jashtë kufijve tanë, veçanërisht në Kosovë, nuk e lejon ripërfytyrimin e plotë të këtij rrjeti.

Vargëzimi në Shqipërinë Veriore i vendgjetjeve të grupit kulturor të Komanit lejon kapjen e tre rrugëve: nga Shkodra ose Lezha në Kukës, prej ku sipas gjithë gjasës vazhdonte në Kosovë gjatë rrjedhjes së Drinit të Bardhë, dhe nga Lezha ose Durrësi në Ohër, nëpërmjet krahinës së Matit. Shtrirja e qendrave të tjera gjatë degëve të lumit Mat dëshmon imtësimin e këtij rrjeti. Ndonëse gjetjet e kësaj kulture janë më të pasura në brendi, veçanërisht në Koman, mendojmë se kjo është e rastësishme dhe kryeqendra të këtij grupi kulturor, përkatësisht kryestacione rrugore, ishin Lezha dhe Shkodra, qendra të fuqishme e me traditë zejtare ku dhe përqëndrohej rrjeti rrugor. Objektet e grupit tjetër të kulturës së hershme shqiptare, po të shek. VII-VIII, lejojnë ndjekjen e vijës gjatë Vjosës[17]. Gjetjet dëshmojnë gjithaq për një rrugë që vazhdonte gjatë bregut, nga veriu i liqenit të Shkodrës e deri në Butrint, prej ku hidhej në Korfuz[18]. Këto gjetje, veçanërisht qeramika, kanë tipare të ndërmjetme midis grupit verior dhe jugor, çka dëshmon për lidhjen e këtyre grupeve nëpërmjet rrugës bregdetare.

Gjetjet monetare në qytetet bregdetare, ndonëse tepër të rralla, stolitë e arta në shpinën e Durrësit (Krujë, Tujan, Remull)[19] dhe stoli të po thjesht bizantine në shpinën e Lezhës dhe Shkodrës[20], dëshmojnë ndërlidhjen e jashtme nëpërmjet rrugëve detare. Stolitë e mësipërme dëshmojnë dhe rrezatimin në brendi, ndonëse të kufizuar në sasi dhe hapësirë, përkatësisht rrugët nga qytetet bregdetare në prapatokë. Ky rrezatim flet në të mirë të mendimit se impulset kulturore nuk lëviznin nga lindja në perëndim me rrugë tokësore me ndërmjetësinë e të dytëve, në këtë rast të sllavëve, por vinin drejtpërdrejt nga qendra me rrugë detare.

---

13) N. Ceka–L. Papajani, **Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike** «Monumentet»; 1, 1971, 45. Këtë gjendje të rrugës e jep dhe fragmenti i Ana Komnenës (I. IV, 8) sipas së cilës Aleks Komneni «Pasi ndaloi pak në Babagora (Mali i Babjes) kaloi nëpër rrugë të panjohura, të braktisura prej kohe ... dhe arriti në Ohër».

14) Shih. I. Bitlisi, f. 1276 dhe kronistët e tjerë turq tek S. Pulaha **Lufta shqiptaro turke**...

15) B. Beci, **Lashtësia e dialekteve të shqipes – dëshmi e vendbanimit të hershëm të shqiptarëve,** Kumtesë e mbajtur në Konferencën Kombëtare të Formimit të Popullit Shqiptar, të Gjuhës e të Kulturës së tij, Tiranë, 2-5,VII,1982, N. Bodinaku, **Gjetje të kulturës së hershme mesjetare në luginën e Sipërme të Vjosës,** Kumtesë e mbajtur në Konferencën Kombëtare të Formimit të Popullit Shqiptar, të Gjuhës e të Kulturës së tij, Tiranë 2-5,VII,1982.

16) Për këto objekte, S. Anamali, **Problemi i kulturës së hershme mesjetare shqiptare në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike,** «Studime Historike», 1967, 2, 29-40.

17) N. Bodinaku, **po aty**

18) J. Korošec, **Datacija slovanskih ostalin v okolici Skodra v Albaniji,** «Archeloski Vestnik» IV, 1, 1953, N. Bulle, **Ausgrabungen bei Aphiona auf Korfu,** «Mitt d. Deutsch Arch. Inst». 1934, 59.

19. Gjetjet e Remullit në D. Kurti, **Gjurmë të kulturës së hershme shqiptare në Mat.** «Iliria» I, f. 269, të Krujës në S. Anamali – H. Spahiu, **Varreza e hershme mesjetare e Krujës,** «BUSHT» ser; Shk. shoq. 1963, 2, të Tujanit në S. Anamali, **vep. e. cit.,** f. 36.

20) H. Spahiu-D. Komata, **Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në kalanë e Shurdhahut,** «Materiale të sesionit arkeologjik», Tiranë, 1968, f. 58-69.

DO NOT COPY

Në shekujt IX-XI, bashkësia kulturore dëshmohet më qartë nga shtrirja më e plotë e objekteve të kulturës së hershme shqiptare[21]. Shtrirja e tyre dhe përmendja jo më e shtigjeve, por e rrugëve të thella malore (Tomor),[22] tregon gjithaq imtësimin e rrjetit në zonat kodrinore të jugut. E thëna e Leon Hierosfaktit në kapërcyellin e shek. IX-X se «hoqa nga goja e luanit 30 kështjella»[23], dëshmon nga ana tjetër shtrirjen e gjerë të temës së Durrësit, shpeshtësinë e vendbanimeve dhe rrjetin e rregullt rrugor që i lidhte detyrimisht këto qendra me njëra-tjetrën. Paraqitja në vitin 820 në Hartën e Botës të Al-Huvarizmit, për herë të parë në hartografi, e rrjedhjes së Drinit, qytetit dhe liqenit të Ohrit,[24] tregon njohjen e rrugës tregtare Shkodër ose Lezhë-Vau Spas-Ohër. Rrugët e tjera tregtare, veçanërisht në Shqipërinë e jugut, kuptohen nga gjetjet monetare,[25] të cilat duke u nisur nga shek. IX rriten në numër dhe shtrihen gjithnjë e më gjerë në brendi. Doganat e shek. XI në tokat mes Durrësit, Ohrit dhe Kaninës tregojnë për gjallërimin në këto rrugë dhe të tregëtisë së jashtme.[26]

Në shek. XII-XIII, të feudalizmit të mirëfilltë dhe fuqizimit të zotërve vendas, zhvillimi i rrjetit rrugor u ndihmua nga mbiprodhimi dhe e ndihmoi qarkullimin e tij. Rrugët mes fshatrave (Libizdë të Kolonjës, Zllatar të Prizrenit etj)[27] ndikuan në krijimin e tregut krahinor, të panaireve (Hoçë të Prizrenit, Shkup, Esahor të Kaninës[28], etj). Ky treg fillimisht i përkohshëm lindi të përhershmin: Në «Qitabi Rozherin» e Al-Idrizit të vitit 1153, përgjatë rrugëve tregtare përmenden 13 qendra tregtimi të pajisura me dyqane, 5 në bregdet dhe 8 në prapatokë.[29] Qënia e tyre kryesisht dy ditë larg njëra-tjetrës i tregon ato qendra të tregtisë krahinore me rreze tregtimi 1 ditë rrugë. Kjo ndarje që shmangte ndërfutjet midis njerës e tjetrës qendër, dëshmon njëkohësisht për një rrjet të menduar të qendrave dhe rrugëve tregtare.

Në shek. XIV-XV tregu dëshmohet thuajse në çdo qytet madje dhe në fshatra[30]. Ndër këto qendra ato të prapatokës i shërbenin më tepër tregtisë së brendshme se të jashtme, ndërsa detyra e qendrave bregdetare ishte e anasjelltë. Ngritja e 8 skelave të reja gjatë këtyre shekujve[31] e lidhur me synimin e çdo zoti feudal për një skelë të tijën, shënon njëkohësisht fuqizimin e tregtisë së jashtme dhe shtytjen e rrugëve të tërthorta në bregdet. Kjo rritje dhe ky fuqizim u shoqërua me lindjen e përfaqsive tregtare dhe zyrave për organizimin e karvaneve dhe korierëve rrugorë (Shkodër, Shirgj, Prizren; Durrës, Vlorë, Gjirokastër, Janinë, etj)[32], çka tregon për një rrjet rrugor tashmë tepër të organizuar. Ky zhvillim i rrjetit rrugor dhe tregtisë solli një ndërlidhje më të mirë të qendrave e trevave dhe bashkimin e njësive ekonomike. Kështu ndonëse Raguza lidhej drejtpërsëdrejti me Prizrenin e Prishtinën, qarkullimi kryesor i mallrave të saj, ndiqte rrugën Shirgj-Prizren, në gjurmë të këmbimeve të

21) S. Anamali, **vep. e. cit.**

22) G. Cedrenus, J. Scylitzae, «Opera», Bonnae, 1939, II, 499.

23) I. Σακκελιώνος Δελτιον τῆς ιστοριχῆς και εφνολογικης ετάιριάς τής Ελλάδος TA, 1883, σελ 377-401, επιστολά IH.

24) Koordinatat e librit të Hartës së Botës tek H. Mžik, **Beitrage zur kartographie Albaniens nach Orientalischen Quellen,** «Geologica Hungarica» III, 1929, 628-632.

25) H. Spahiu, **Monedha bizantine të shek. V-XIII të zbuluara në territorin e Shqipërisë,** «Iliria» IX-X, f. 353-357.

26) Kjo kuptohet nga rikonfirmimi në vitin 1108 i të drejtës së venedikasve për të bërë tregti pa doganë në temat Durrës, Jeriko, Kaninë, Janinë, Drinopojë, Deqbol, Kolonjë, Ohër, Prespë, Kostur (K. Bozhari–F. Liço) **vep. cit.** f. 54).

27) Rruga e Libizdës në K. Bozhori, **Dokumenta të periudhës bizantine për historinë e Shqipërisë,** Tiranë, 1978, f. 97, e Zllatarit në **Acta Alb.** II, 46.

28) Hoça në vitin 1198 **(Acta. Alb** I, 113) Shkupi në vitin 1300 (S. Novakoviç, **Zakonski, spomenici srpskih država srednjega veka** Beograd, 1912, f. 608-620), Esahori i Kaninës në vitin 1307 (K. Alexandër, Byzantion 15, 179).

29) W. Tomaschek, **Zur kunde der Hamus-Halbinsel II. Die Handelswege im 12 Jahrhundert nach den Erkundingungen des Arabers Idrisi,** «Sb. Kaiserl. Akad. d. Wiss. in Wien, Phil. hist. kl. 113», Wien, 1886, Harta e Al-Idrizit në H. Mžik, **vep. e. cit.**

30) Shih H. Inalçik, **Hiçri 835, suret-i defter-i sançak-i Arvanid** Ankara, 1954, S. Pulaha, **«Lufta shqiptaro-turke e shek. XV, Defteri i vitit 1467** f. 9 (fshati Lis është fshat pazari) dhe defterët e tjerë.

31) Këto skela janë Shufadaja, Rodoni, kalaja e Turrës, e Bashtovës, Karavastai (gr. vendqenārim anijesh) Sfinarica (gr. një tip anijeje) Pirgu, Sajadha.

32) Për Shkodrën, Prizrenin dhe qytetet e tjerë të Kosovës. C. Jirecek, **vep. e. cit,** f. 60. Një nga qendrat më kryesore të tregëtisë raguzine ishte Prizreni **(Po aty,** f. 67). Shoqëria doganore e Shirgjit në **Acta Alb** II, 7 (viti 1359), kolonitë tregtare veneciane në Janinë dhe Gjirokastër në F. Thiriet, **Regestes des Délibérations du Senat de Venise concernant la Romanie,** Paris-Haag, 1958-1961, 2201, 2623, 2659.

DO NOT COPY

brendshme tregtare midis këtyre dy skajeve. Natyrshmëria e kësaj lidhjeje kuptohet dhe nga fakti se mbyllja në vitin 1399 e njërit skaj, Shirgjit, solli rënien ekonomike të skajit tjetër Prizrenit[33]. Ky bashkësim ekonomik u ndoq dhe u zgjerua nga bashkësimi politik: principata e Balshajve u zgjerua fillimisht në këtë njësi ekonomike dhe më tej zbriti drejt jugut duke zënë tokat Tivar-Prizren-Vlorë[34]. Krijimin e tregut të përbashkët në të e dëshmojnë dhe 16 prerjet e ndryshme monetare të kësaj principate[35], të cilat dora-dorës nisën ta rrallojnë monedhën e huaj.

Duke i rigrupuar të dhënat e mësipërme mund të vemë në dukje se:

1. Rrjeti i rrugëve mesjetare iu përmbajt me pak ndryshime rrjetit të rrugëve të kohës së vonë antike, por, në përshtatje me kushtet dhe kërkesat e reja, rruga gjatë Shkumbinit u mbyll për transportin e madh dhe në arterie u kthyen rrugë të tjera, diku të dorës së dytë.

2. Rrjeti rrugor mesjetar që siguronte ndërlidhjen e sigurt, të trevave dhe qendrave krijoi kushtet e duhura për bashkësimin ekonomik, shoqëror e më tej politik. Ky bashkësim e zhvilloi më tej rrjetin rrugor.

3. Në sajë të pozitës, skelave dhe rrjetit rrugor Shqipëria u përshkua nga rrymat ekonomike e kulturore të botës mesdhetare. Kalimi i rrugëve kryesore në vende malore lejonte kontrollin e invazioneve ushtarake.

4. Këto të dhëna të rishpien në mendimin «se përgjithësimi i emrit etnik arbër lidhet në radhë të parë me intensifikimin e marrëdhënieve dhe shkëmbimeve midis krahinave me popullsi të njëjtë shqiptare»[36].

DO NOT COPY

33) **Acta. Alb** II 627, 629, 632.
34) G. Gelcich, **La Zedda e la Dinastia dei, Balsidi, studi storici documentati,** Spalato, 1899, 140.
35) L. Nedeljkoviç, **Novčarstvo Balshitca,** «Starinar», a.s. XXIII, 1971 (1974) 111-127.
36) A. Buda, **Vendi i shqiptarëve në historinë evropiane të shekujve VIII-XVIII,** «Studime historike» , 1967, 3.

DO NOT COPY


RRUGET MESJETARE SHQIPTARE
SHEK. VII - XV
PRISHTINE
PEJE
PRIZREN
KAÇANIK
SHKUP
TRESKE
LESHAK
GJILAN
DRISHT
SHKODER
ANTIVAR
ULQIN
BUDUA
LEZHE
KRUJE
DURRES
DIBER
ELBASAN
KORÇE
KOSTUR
KANINE
GJIROKASTER
ADRIANOPOL
BUTRINT
KORFUZ
JANINE
DETI ADRIATIK
Shpjegim

APOLLON BAÇE

DO NOT COPY

LES ROUTES ALBANAISES AU MOYEN-AGE
(Du VIIe au XVe siècle)

RESUME

Au moyen-âge, la formation du peuple et plus tard de la nationalité albanaise, exigeait entre autres, un territoire commun et une bonne communication routière. Ce territoire comprenant, d'une manière quelque peu restreinte, les régions des anciennes provinces des deux Epires, de Dardanie et de Piéval, connut, pendant la basse antiquité, un essor économique fondé sur la circulation monétaire et disposa également d'un vaste réseau routier. Ce dernier fut maintenu même plus tard, car ses noeuds principaux, les villes, à peu d'exceptions près, continuèrent d'exister même au moyen-âge. Sur les 26 villes qui, pendant la basse antiquité, se trouvaient sur les territoires compris entre Tivar, Prishtine, Janina et Ohrid, 17 subsistèrent, 4 furent sujettes à des déplacement insignifiants et 5 autres seulement ne purent survivre. Dans l'essentiel, l'extension du réseau routier ne fut pas affectée, car même cette petite réduction n'eut lieu que dans les régions où il y avait une concentration de villes. Cette continuité se voit dans la réparation et l'utilisation des ponts et des routes pavées pendant la basse antiquité et le moyen-âge (à Patin, dans la région de Mat, à Topias, dans la région d'Elbasan, à Bashtove, dans la région de Kavaje, à Tépélène, à Konice, à Moglice, dans la région de Devoll, à Muzine, dans la région de Gjirokaster) et c'est d'ailleurs ce que montrent des données toponimiques: les tronçons de la route qui passait dans la vallée du Drino pendant la basse antiquité sont connus sous le nom de Basiliki dhromos, et près de Kavaje et de Leskovik sous le nom de «vrome» et de «drome».

Les ponts, les résultats des fouilles archéologiques, la chaîne de fortifications, les documents écrits et les villages de «derven» nous permettent de retracer le réseau routir moyen-âgeux. Le réseau routier intérieur passait par Durrës-Shkodër--Drin-Ohrid-Vjosë-Durrës reliant ainsi 26 agglomérations fortifiées. Le réseau routier extérieur, qui reliait 40 agglomérations, passait par Durrës-Budua-Mitrovice de Kosove-Shkup-Kostur-Janina-Buthrinte-Durrës. Les nombreuses traces architectoniques et archéologiques découvertes ces dernières années, montrent que de Vlore à Lezhe la route longeait la côté, traversant tout les ports. Ces traces, la description que les chroniqueurs firent de la prospérite de la plaine occidentale ainsi que l'exportation de céréales panifiables, qui commença à s'intensifier à partir du XIe siècle, montrent que, contrairement à ce qu a été admis, cette plaine où se croisaient les routes tr versières, fut peu marécageuse et fertile jusqu'au XVIe siècl

Les routes traversières les plus importantes sont au nomb de quatre: deux au nord et deux autres au sud. La premiè traversait les centres fortifiés de Danje, Flet, Vau Spas Prizren, puis passait par Shkodër, Lezhë et Prishtinë. A part de cette route, d'autres routes rayonnaient vers Mitrovicë, K sovë, Nish e Shkup.

Les ramifications de la seconde route, de Kruje et d Tujan convergeaient à la forteresse de Guri i Bardhë, d'où l route menait à Dibër, aux forteresses de Sfetigrad et de Mo dricé, et à Ohrid. Les fréquentes manoeuvres militaires du X au XVe siècle et les diverses inscriptions, y compris celles de croisés, à Guri i Bardhë montrent qu'elle fut une route trè fréquentée.

La troisième route passait par Kanina, Balsh, Berat e la forteresse de Tomor, puis elle débouchait sur le fleuve d Devoll, la ville de Deabole (Zvezde) et Ohrid.

Longeant la Viossa, la dernière route menait à la forte resse de Tépélène. Une de ses ramifications qui traversait l vallée du Drino, rejoignait à Adrianopol (Melan) la route ve nant de Buthrinte et débouchait sur Janina. L'autre qui suivai le cours de la Viossa, passait au pied des forteresses de Këlcyre et de Përmet pour déboucher sur la route reliant Janin à Ohrid. Un peu plus loin de Këlcyre, un de ses tronçon importants menait, à travers Dangëlli à Kolonje, à proximit de Deabol.

A part ces artères, les sources susmentionnées évoquen un grand nombre de routes notamment celles Shkodër-Medun-Plave-Prizren ou bien Mitrovice et Kosove; Shkodër-Drisht--Plave; Vau Spas-Mitrovice et Kosove; Lezhe-Stelush-Ohrid Elbasan-Berat; Drino-Vlore, etc., ainsi qu'un voie maritime d Budua à Corfou.

La note du registre turque de 1467 selon laquelle le village de Bulqize assumait depuis des siècles, la garde et l'entretien des routes, témoigne de l'existence d'une ancienne institution couvrant le réseau routier, par conséquent d'un réseau routier

DO NOT COPY

moyenâgeaux régulier. Le fait qu'Acropolite suivit, pendant les mois les plus froids de 1258, l'une des voies les plus accidentées. Durrës-Mat-Dibër, montre que les mouvements y étaient permanents et non pas saisonniers. Par conséquent, l'intégration dans ce réseau coordonné du corridor le plus court et le plus commode qui menait de Durrës à Ohrid et plus loin à Constantinople, tout au long du Shkumbin, est, à première vue, surprenante et incompréhensible. En fait ce phénomène a sa raison d'être: A Babje, cette route devait continuer sur une longueur de 20 km à travers le plateau du Polis, sur des terrains glissants qui nécessitaient un gros volume de travaux d'entretien, mais si elle était bien entretenue, elle constituait une porte ouverte, dont le seuil était facile à franchir. Vers la fin du VIe siècle, ne remplissant plus sa fonction, elle ne fut plus fréquentée. Dans les siècles qui suivirent, l'administration byzantine n'eut pas intérêt à réouvrir une porte, susceptible à servir de passage aux invasions venant de l'Est vers le littoral et vice-versa. Sachant que les mouvements passaient à travers leurs vallées et vallons, ce qu'ils ne manquaient pas de mettre à profit et de surveiller, les féodaux albanais y avaient encore moins intérêt. Par suite de leur surveillance, les Normands et les Angevins n'arrivèrent pas à passer dans les valées du Devoll et du Shkumbin, alors que les Ottomans furent obligés de suivre la vallée du Mat, en subissant des pertes considérables avant de réussir, en 1466, à réutiliser la route longeant la valiée du Shkumbin. L'absence de cet axe routier peut expliquer la différence de dialecte et de culture matérielle entre l'Albanie du nord et l'Albanie du sud, différence, qui, comme le montrent les études récentes, est apparue depuis les VIIe et VIIIe siècles, période qui coïncide justement avec la fermeture de la route dans la vallée du Shkumbin.

Au cours de ces même siècles, dans les conditions de l'affaiblissement de l'économie fondée sur l'échange monétaire et comme les sources historiques son muettes à cet égard, on peut suivre la communauté culturelle et les voies lui permettant de sa maintenir, à travers la diffusion des objets de l'ancienne culture albanise. Toutefois, il convient de souligner que l'insuffisance de nos fouilles ou plus exactement des publications archéologiques au-delà de nos frontières, surtout en Kosove, ne permet pas d'avoir une idée exhaustive de ce réseau.

Dans l'Albanie septentrionale on a découvert des traces du groupe culturel de Koman qui nous aident à retracer trois routes: de Shkodër ou bien de Lezhe à Kukës, route qui, vraisemblablement continuait en Kosove tout au long du Drin Blanc, et de Lezhe ou bien de Durrës à Ohrid, en passant par la région de Mat. L'extension des autres agglomérations entre les affluents du Mat, atteste que ce réseau de routes était très dense. Bien que les traces de cette culture soient plus riches à l'intérieur du pays, surtout à Koman, nous estimons que c'est là quelque chose de fortuit et que ce groupe culturel avait pour principales stations routières Lezhe et Shkodër, ces importantes agglomérations ayant de riches traditions artisanales et où se concentrait le réseau routier. Les objets appartenant à l'autre groupe de la culture albanaise ancienne, des VIIe et VIIIe siècles également, permettent de suivre l'itinéraire longeant la vallée de la Viossa. Les découvertes effectuées attestent aussi l'existence d'une route qui longeait le littoral, de l'extrémité nord du lac de Shkodër à Buthrinte, et puis à Corfou. Ces découvertes, surtout en matière de céramique, constituent des traits intermédiaires entre le groupe du nord, et celui du sud, ce qui révèle les rapports ayant existe entre eux à travers la route du littoral.

Bien que plutôt rares, les pièces de monnaie découvertes dans les villes côtières, les parures en or retrouvées dans l'hinterland de Durrës (Krujë, Tujan, Remull) et les parures tout simplement byzantine de l'hinterland de Lezhe et de Shkodër, constituent une preuve des relations que les autochtones entretenaient avec l'étranger à travers des voies maritimes. Ces parures témoignent également du rayonnement des routes, bien que limité du point de vue quantitatif et spatial, menant des villes du littoral à l'hinterland. Ce rayonnement vient confirmer l'idée que les impulsions culturelles ne passaient pas de l'Est à l'Ouest par voie terrestre ni par l'intermédiaire d'éléments secondaires, en l'occurrence les Slaves, mais venaient directement du centre par voie maritime.

L'extension plus complète des objets de l'ancienne culture albanaise, atteste plus clairement encore une communauté culturlle au cours de IXe, Xe et XIe siècles. Leur diffusion et l'évocation non plus des chemins, mais des routes de zones reculées (Tomorr), montrent la densité du réseau dans les zones de collines du sud. L'assertion de Léon Hierosfact qui date de la fin du IXe et du début du Xe siècle, «j'ai sauvé de la gueule du lion 30 forteresses», montre la vaste extension du thème de Durrës, la densité des agglomérations et l'existence d'un réseau routier qui reliait régulièrement ces centres entre eux. En 820 dans la «Carte du monde d'Al-Huvarisme» apparait pour la première fois le cours du Drin, la ville et la lac d'Ohrid. Cela montre que l'auteur de cette carte connaissait la route marchande Shkodër ou bien Lezhe-Vau Spas-Ohri. Quant aux autres routes spécialement celles de l'Albanie du Sud, qui à partir du XIe siècles, augmentent en nombre et s'étendent toujours plus à l'intérieur du pays, les pièces de monnaie découvertes se révèlent très édifiantes. Au XIe siècle, les douanes situées dans les régions comprises entre Durrës, Ohrid et Kanina témoignent de l'intensification du commerce extérieur sur ces mêmes routes.

Aux XIIe et XIIIe siècles, siècles du féodalisme proprement dit et de la consolidation des maîtres du pays, le développement du réseau routier profita de la surproduction et profiter à son tour la circulation des marchandises. Les routes reliant divers villages (Libizde de Kolonjë, Zllatar de Prizren, etc.), influèrent sur la création d'un marché régional et de foires (Hoça de Prizren, Shkup, Esanor de Kanina, etc.). Ce marché, initialement provisoire, est à l'origine d'un marché permanent: le «Qitabi Rager» d'Al-Idriz, (1153) évoque 13 centres de commerce dotés de boutiques, 5 sur la côte et 8 à l'hinterland, tous situés

le long de routes marchandes. Le fait que pour aller d'un centre à l'autre il fallait mettre deux jours, prouve que leur rayon d'activité s'étendait sur une distance nécessitant une journée de voyage. Cette division qui évitait les interférences des centres, témoigne d'un réseau commercial et routier bien conçu.

Plus tard, aux XIVe et XVe siècles, le marché s'étendait dans chaque ville et même dans les campagnes. Parmi ces centres, ceux de l'hinterland servaient plus le commerce intérieur, alors que pour les centres de la côte d'était plutôt le contraire. Au cours de ces siècles, la mise sur pied de 8 ports, qui se rattachait à l'objectif de chaque seigneur d'avoir son propre port, marqe dans le même temps le renforcement du commerce extérieur et le déplacement des routes traversières vers la côte. Cette croissance et cette consolidation aboutirent à la mise sur pied des représentaions de commerce et des bureaux d'organisation des caravanes et des courriers routiers (Shkodër, Shirgj, Prizren, Durrës, Vlore, Gjirokaster, Janina, etc.) qui témoigne d'un réseau routier très organisé. Tout ceci permit aux diverses agglomérations et régions d'établir une meilleure communication entre elles et aux centres économiques de mieux coordonner leur activité. Ainsi donc, bien que Raguse eût des communications directes avec Prizren et Prishtine, le groupe de ses marchandises circulait sur la route Shirgj-Prizren, en suivant les traces des échanges commerciaux intérieurs entre ces deux extrémités. La meilleure des preuves de cette communication, c'est que, lorsqu'en 1399 l'une des extrémités, Shirgj, fut fermée, l'extrémité de Prizren, enregistra une récession. Cette coordination de l'activité économique fut suivie et élargie par celle de l'activité politique: la principauté des Balshaj s'élargie d'abord dans cette unité économique et plus tard s'étendit vers le Sud dans les régions de Tivar-Prizren-Vlore. Les 16 diverses émissions monétaires de cette principauté, émissions qui commencèrent à limiter peu à petit la monnaie étrangère, témoignent de la création d'un marché commun.

En regroupant les données sus mentionnées, on peut souligner que:

1. Le réseau routier moyenâgeux s'en tint, à peu de différence près, au réseau routier de la basse antiquité; mais conformément aux conditions et aux exigences nouvelles, la route longeant le Shkumbin se ferma au grand transport. D'autres routes, auparavant secondaires, devinrent des artères importantes.

2. Le réseau routier moyenâgeux qui assurait la communication entre régions et agglomérations, créa les conditions nécessaires à l'union économique, sociale et plus tard politique du pays. Cette unification permit de développer davantage le réseau routier.

3. Grâce à sa position géographique, à ses ports et à son réseau routier, l'Albanie fut parcouru par les courants économiques et culturels du monde méditerranéen. Les routes principales traversant des régions montagneuses, il était ainsi plus facile de surveiller les invasions militaires.

4. Ces données nous renvoient à l'idée avancée que le professeur A. Buda selon laquelle «la généralisation du nom ethnique arbër se rattache en premier lieu à l'intensification des rapports et des échanges entre les régions habitées par la même population albanaise».

DO NOT COPY

Nr. 1 1984

monumentet

DO NOT COPY

Mustafa ARAPI

KONSERVIMI DHE RESTAURIMI I PJESËS QENDRORE TË IKONA-BARTËSIT TË KISHËS SË EVANGJELIZMOS TË KALASË SË BERATIT[1)]

Shumica e ikonave të këtij ikonabartësi që ndodhen në fondin e Muzeut Mesjetar të Korçës[2)] konsiderohen vepra të piktorit tonë të shquar mesjetar Onufri.

Brezi i sipërm i ikonabartësit përbëhet prej tri panove: pjesës qendrore me skenën e Deissis (Lutja) (98 x 77 cm), (Fig. 1 a, b), krahu i djathtë me katër apostuj (144.5 x 53 cm) (Fig. 2) dhe krahu i majtë me pesë apostuj (182 x 54 cm) (Fig. 3). Panotë janë prej druri arre. Gjendja e tyre në përgjithësi nuk është e mirë, me dëmtime nga brejtësit që krijojnë vende-vende një pamje sfungjeroze (Fig. 4) dhe me një të çarë vertikale që përshkon të gjithë panonë nga lart poshtë (Fig. 5). Panotë janë të qarkuara me një kornizë me motiv të gdhendur në formë gërsheti.

Grunti i lidhur mirë me suportin shtrihet mbi të gjithë sipërfaqen e panosë në mënyrë të njëtrajtëshme kurse në vendet ku janë pikturuar apostujt shtrihen mbi kanavacë. Ari i shtrirë në mënyrë të njëtrajtëshme në formë pllakash në të gjithë sipërfaqen me një trashësi 0.5 mm vende-vende është i dëmtuar si rezultat i goditjeve mekanike, kontraksioneve natyrale si dhe nga veprimi i insekteve mbi drurin (Fig. 6,7,8,9). Aureolat e çdo apostuli janë realizuar në tek-



Fig. 1a

1) Në këtë punë ndihmuan: Marita Beci, kimiste, Eduart Sopi, ndihmës restaurator, Vangjush Golloshi radiollog, Kosta Koçi kimist në laboratorin e fizikës bërthamore, Zamir Marika fotograf.

2) Një pjesë e tyre si Dyert e bukura, ikonat, hyrja e krishtit në tempull, krishtlindja, pagëzimi i Krishtit, Shpërfytyrimi, ngjallja e Shën Llazarit, zbritja në ferr dhe Joan Pagëzori u ekspozuan në Paris në vitin 1974.

DO NOT COPY



Fig. 1b



Fig. 2



Fig. 3



Fig. 4

nikën e inçizimit me stampë mbi ar, duke krijuar motive të stilizuara (Fig. 10). Të tria panotë janë të pikturuara me tempera. Gjendja dhe lidhja e ngjyrës me gruntin është e mirë. Ngjyrat e përdorura janë kafeja dhe derivatet e sajë (kryesisht në pjesët e mishta), e kuqja, jeshilja, vishnja, gritë e ngrohta etj. Verniku i shtrirë në të gjithë sipërfaqen e në mënyrë të njëtrajtëshme paraqitet i nxirë dhe i dekompozuar: Mbi ngjyrë ka marë formë bulëzash ndërsa mbi arin paraqitet e plasaritur. (TAB. I, FIG. 11,12,13,14). Në rastin e parë verniku duke gjetur një sipërfaqe më të



Fig. 5



Fig. 6



Fig 7



Fig 8



Fig 9

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 10



Fig. 13

ashpër ka krijuar një lidhje më të mirë se sa në rasti
e dytë ku gjen shtresën e lëmuar të arit. Kontraksio
net e vernikut kanë bërë që në shumë raste ai t
shkëpusë shtratin e ngjyrës. Kjo gjendje e ikonoba
tësit kërkonte një ndërhyrje të shpejtë restauruese

Për të kryer ndërhyrjen restauruese fillimisht
bënë vrojtime dhe shqyrtime, të cilat treguan për nj
prerje vertikale në ikonën e parë e cila ishte shkë
putur 1/3 e saja si dhe shkëputjen ose djegjen t
panosë me dy apostujt e fundit. (Fig. 3). Vrojtimi m
llampë ultraviolet tregoi për dy njolla të zeza prap
figurës së krishtit dhe ritokime me ngjyrë të zezë n
këmbën e djathtë të krishtit dhe tek kryqi i apostull
të parë.

Piktura në dy apostujt e fundit u vrojtua me rre



Fig. 11



Fig. 12



Fig. 14



Fig. 15



Fig. 16

ze X (rëntgen) Vrojtimi përcaktoi plotësisht kufirin e ripikturimit që ishte bërë me beze të ngjyrosur të ngjitur mbi pikturën origjinale (Fig. 15. 16). Para ndërhyrjeve restauruese veprës u krye ekzaminimi fiziko-kimik. Së fundi të tria pjesët u fotografuan me dritë përballë mbrapa si dhe anash.

Nga analiza rezultoi se grunti ishte prej sulfati kalçiumi (Fig. 17), verniku me bazë rrëshire, ndërsa kanavaca prej fijesh lini të ashpër me thurje garniture (Fig. 18). Në mikroskopin binokular me zmadhime të mëdha u bë analiza e shtresëzimit nga ku u pa renditja e shtresave (Fig. 19). Analiza spektrale e pigmenteve me floreshencë të rrezeve «X» (Fig. 20) të kryer në laboratorin e Institutit të Fizikës Bërthamore dha këto rezultate:



Fig. 17



Fig. 18

DO NOT COPY

Pigmenti	elementët përbërës						
	Hg	Cu	Ca	Cr	Fe	Pb	Sr
E Kuqja	+	—	—	—	—	+	—
Vishnja	+	+	—	—	+	—	—
Kafeja	—	—	+	—	—	+	—
Bluja	—	—	—	+	+	+	—
Jeshilja	—	+	—	—	—	+	—
Ari	—	—	+	—	+	+	+

Nga verifikimi i gjurmëve të insekteve: birimet, galeritë, kanalet dhe grryerjet u konstatuan 3 lloje vrimash të cilat duken kjartë mbi sipërfaqen e arit dhe të pikturës. Vrima me diametër 1.3 mm dhe 2 mm janë të shkaktuara nga insektet xestobium rufovillosum ndoshta edhe hylotropus bajalus dhe daktus (TAB. I, 6). Veç përcaktimit të përbërjes së lëndëve që formojnë objektin në tërësi analiza ndihmoi për të përcaktuar radhën e ndërhyrjeve konservuese restauruese.

Fillimisht u hoqën aureolat metalike mbi kokat e shën Mërisë dhe Joan Pagëzorit. Këto aureola nuk paraqisnin interes, pasi vendosja e tyre ishte bërë më vonë pa kriter, duke zënë edhe një pjesë të kokave çka tregon qartë se piktura është konceptuar fillimisht pa aureola metalike. Më tej konsolidimi i gruntit si dhe ai i shtresave mbi pano u bë me një pjesë xhelatinë dhe 5 pjesë ujë të shkrirë në një temperaturë 50°C, kryesisht me letra poroze të njomura me xhelatinë. Në vendet ku konstatoheshin fryrje ose



Fig. 19

SPEKTROGRAFIA ME FLUORESHENCE TE RREZEVE "X„ I PIGMENTIT TE NGJYRES SE KUQE



Fig. 20

xhepa u bënë injektime me anën e shiringave (Fig 21). Pas kësaj u kryen plotësime me 1 pjesë krete dh 2 xhelatinë duke krijuar një sipërfaqe të rrafshtë të lëmuar.

Për pastrimin e pikturës nga verniku i dekompo zuar u bënë disa prova për të konkluduar në solu cionin që do të përdorej. Solucioni më i përshtatë shëm ishte ai i përbërë prej 1 pjese dimethyl formo mid dhe 1 pjesë amil açetat. Pastrimi u bë me tam pon pambuku me kuadrate. Gjatë heqjes së vern kut u hoqën dhe ritokimet.

Në vendet ku paraqitej rënie e shtratit piktur (si p.sh. tek siluetat e apostujve) u la një shtres verniku origjinal më tepër se në vendet e tjera. V kësaj u lanë kuadrate të vogla të paprekura për treguar gjendjen para pastrimit. Dizenfektimi kurat i panove u krye duke injektuar ksilamon i cili ësh i depërtueshëm në shtresën e drurit.

Së fundi u bë plotësimi i pjesëve të drurit që mu gonin. Duke u bazuar në ekzaminimin radiografik hoqën copat e bezes (30 x 3 cm dhe 35 x 6 cm) vendosura për arsye se ikonat e fundit do të jenë djegur, më vonë ato janë plotësuar me pjesë dr dhe për të plotësuar kuadratin janë ngjitur beze pikturuara të cilat plotësonin pjesën tjetër të piktur së përzhitur nga djegia.

Këto ndërhyrje i dhanë ikonabartësit një pam tjetër duke i rikthyer pikturës mjaft nga vlerat histori e artistike origjinare (Fig. 22,23 para dhe pas resta rimit, Fig. 24, 25 para dhe pas restaurim

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 21



Fig. 22



Fig. 23

Pjesa qendrore «Lutja» është nga më të arriturat. Vendin kryesor në të e zë krishtin pantokrator. Në krah të tij janë të pikturuara Shën Mëria dhe Joan Pagëzori. Të tri portretet janë realizuar me shije të thellë artistike. Format e qarta, vizatimi shumë elegant, ngjyrat e ngrohta si dhe psikollogjia e tyre krijojnë portrete me vlerë. (Fig. 26).

Tek figura e Shën Mërisë shohim mantelin vishnje të thellë ku palat janë të ndërtuara dhe zhvillohen në mënyrë organike të cilat kalojnë nga supi dhe mbështjellin mëngën e dorës. Ato janë dhënë



Fig. 24



Fig. 25

DO NOT COPY



Fig. 26

nëpërmjet linjave të mprehta ndërsa tek fustani i pikturuar me blu në jeshil palat varen herë me linja të drejta e herë me linja të valëzuara duke dhënë kështu një lëvizje të lehtë të trupit. Të njëjtat vlera i vërejmë dhe te figura e Joan Pagëzorit me portret të shqetësuar me flokë të ngritura dhe shikim të gozhduar.

Të gjitha figurat në dy panotë anësore na japin lëvizje plot hijeshi. Portretet në përgjithësi paraqesin tipa të cilat piktori i ka realizuar me mjeshtri si nga vizatimi i saktë ashtu edhe nga ngjyrat. Psikologjia dhe gjendja e tyre shpirtërore transmetohen nëpërmjet shikimit të tyre të kjartë dhe të përqendruar. Veshjet e apostujve pikturohen me ngjyra të bukura, të fuqishme. Dy ëngjëjt që qëndrojnë prapa Krishtit janë portrete në miniaturë të cilët ruajnë karakterin stilitik në vizatim e në formë, por nga trajtimi koloristik blu në smerald i shohim të shkëputura nga gama e përgjithshme e krejt tablosë që përmban kryesisht gamën e ngrohtë.

TAB I



1



4



2



5



3



6

DO NOT COPY

MUSTAFA ARAPI

DO NOT COPY

LA CONSERVATION ET LA RESTAURATION DE LA PARTIE CENTRALE DE L'ICONOSTASE DE L'EGLISE EVANGELIQUE DANS LA CITADELLE DE BERAT

La plupart des icônes de cet iconostase déposées aux fonds du Musée Mediéval de Korça sont considérées comme des oeuvres d'Onuphre, notre illustre peintre du Moyen Age.

La partie supérieure de l'iconostase est constitutée de trois panneaux: le centre avec la scène de la Supplication (98 x 77 cm), l'aile droite avec quatre apôtres (144,5 x 53 cm) et l'aile gauche avec cinq apôtres (182 x 54 cm). Les panneaux sont en bois de noyer. Ils ne sont pas en bon état étant endommagés en bonne partie par les rongeurs qui ont créé par ci par là des surfaces spongieuse et une fente verticale qui traverse tous le panneau de haut en bas. Les panneaux sont entourés d'un encadrement à motifs gravés en forme de nattes.

Le vernis étalé sur toute la surface et de façon uniforme est noirci et décomposé: il est en gemmes sur la couleur et lézardé sur l'or. Au premier cas le vernis trouvant une surface plus rêche a créé une liaison meilleure que celle du second cas où il a trouvé la couche lisse de l'or. Les contractions du vernis sont suivies dans quelque cas par l'enlèvement de la couche de couleurs. Cet état de l'iconostase exigeait une intervention immédiate de restauration.

Pour mener à bien l'intervention de restauration on a fait d'abord des observations et examens qui ont mis en vue une coupe verticale dans la première icône dont un tiers est détaché et la disparition du panneau des deux derniers apôtres. L'observation à la lampe ultraviolette a mis en vue deux taches noires derrières la figure du Christ et des retouches en noir au pied droit du Christ et à la croix du premier apôtre.

La peinture des deux derniers apôtres a été examinée rayons X (röntgen). L'examen a bien précisé la limite de la retouche effectuée à base colorée collée sur la peinture originale. Avant l'intervention de restauration d'oeuvre a subi un examen physico-chimique. Enfin les trois parties ont été photographiées à lumière par devant, derrière et de côté.

Par l'analyse il a résulté que le grunt était de sufate de calcium, le vermis à bas résineuse et le toile en fils de lin dur tressés en garniture (fig. 18, 19). L'analyse de la stratification des couches a été faite au microscope binoculaire de haute puissance. L'analyse spectrale des pigments à la fluorescence des rayonx X effectuée dans le Laboratoire de l'Institut de Physique nucléaire à donné ces résultats:

Les Pigments	Les éléments constituants						
	Hg	Cu	Ca	Cr	Fe	Po	Sr
Rouge	+	—	—	—	—	+	—
Couleur griatre	+	+	—	—	+	—	—
Brun	—	—	+	—	—	+	—
Bleu	—	—	—	+	+	+	—
Vert	—	+	—	—	—	+	—
Or	—	—	+	—	+	+	+

En examinant les perforations les jaleries, les canaux et les reclages causés par les insectes on a constaté trois sortes de trous bien apparantes sur la surface de l'or et de la peinture. Les trous d'un diamètre de 1,3 mm et de 2 mm sont causés par les insectes Xestobium rufovillosum *ou* Hylotropus bajalus *et* dactus. *A part des matières formant l'objet en entier, l'analyse a aidé à préciser l'ordre des interventions de conservation et de restauration.*

Ne présentant pas d'intérêt on a enlevé d'abord les diadèmes métalliques de la tête de la Sainte Marie et celle de Saint Jean-Baptiste. Le placement de ces diadèmes était beaucoup plus tardif et sans critères. Elles couvraient partiellement les têtes ce qui prouve que les peintures étaient d'abord conçues sans diadèmes métalliques. Ensuite la consolidation du grunt et des autres couches sur le panneau a été faite au moyen de papier poreux mouillé dans de la gélatine mêlée avec de l'eau dans un rapport de 1 à 5, à la température 50° Celsius. Aux endroits où l'on constatait de enflures ou des poches on a fait des injections au moyen des syringues. Après cela on a complète la surface par une solution de gélatine et de Crète dans un rapport de 2 à 1 pour la rendre lisse et plane.

On a fait quelques épreuves pour choisir la solution qui serait employée pour nettoyer la peinture du vernis décomposé. La solution plus convenable a été une solution équilibrée de diméthylène de formamide et d'acétate d'amyle. Le nettoyage s'est poursuivi par carrés au moyen de chiffons de coton. Pendans le nettoyage du vernis on a enlevé aussi les retouches.

Aux endroits où la couche de peinture était déchue (comme par exemple chez les silhonettes des apôtres) on a laissé une couche de vernis original plus épaisse que pour les autres endroits. A part cela on a laissé intacts quelques petits carrés pour témoigner de l'état avant le nettoyage. La désinfection curative des panneaux a été effectuée en injectant de la xilidine pénétrante dans la couche de bois.

Enfin on a complété les parties de bois qui manquaient. Les pans de toiles (30 x 3 cm et 35 x 6 cm) sont enlevées. L'examen radiographique a résulté que ces pans de toiles sont placés parce que les dernières icones ont dû être brûlées et pour compléter l'autre partie de la peinture flambée les icones sont remplacées par des parties de bois et tous le panneau est complété par ces pans de toiles peints.

Ces interventions ont donné un autre aspect à l'iconostase tout en restituant à la peinture beaucoup de ses valeurs historiques et artistique originales.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Nr. 1 1984

monumente
MATERIALE

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ Skënder ALIU

VENDBANIME TË FORTIFIKUARA NË PLLAJËN E KOLONJËS E NË RRJEDHËN E SIPËRME TË LUGINËS SË OSUMIT

Pllaja e Kolonjës megjithëse e rrethuar nga të gjitha anët me male e kodra të larta nuk është e izoluar nga territoret fqinje. Lugina e Osumit ka shërbyer si një arter nëpërmjet të cilit kalonte rruga që lidhte bregdetin me Maqedoninë duke kaluar nëpër pllajën e Kolonjës dhe Qafën e Kazanit. Ndërsa një rrugë tjetër natyrore që niste nga lugina e Vjosës ndiqte luginën e Langaricës, përshkonte grykat e Barmashit dhe nëpërmjet Qafës së Qarrit futej thellë në Pellgun e Korçës e prej këtej lidhej me Ohrin.

Kushtet natyrore, kryqëzimi i rrugëve dhe më vonë pozita strategjike dhe e mbrojtur që zinte kjo krahinë në truallin ilir kanë kushtëzuar jo vetëm lindjen e jetës në periudha mjaft të hershme (neolit i mesëm mijvjeçari IV-III p.e.r) por edhe ngritjen e një sistemi të tërë fortifikimesh të vendosura rreth pllajës së Kolonjës dhe luginës së sipërme të Osumit (fig. 1). të cilat janë bërë objekt studimi në këtë artikull. Të parat janë kalaja e Hollmit, Gradeci i Bejkovës, Kalaja në Juglindje të fshatit Bejkovë, Kalaja e Borovës, Gradishta e Barmashit, Gradeci i Vrepckës si dhe kalaja e Leshnjës (Kolonjë). Prej tyre nuk do të trajtohen në këtë shkrim kalaja e Hollmit për të cilën ka një studim të mëparshëm si dhe kalaja e Leshnjës (Kolonjë) që i takon periudhës së vonë antike. Ndërsa vendbanimet e fortifikuara që ndodhen pranë rrjedhës së sipërme të Osumit janë Kalaja e Luarasit, e Boshanjit dhe e Leshnjës. (Vithkuq).

Kalaja e Bejkovës.

Kalaja e Bejkovës ndodhet mbi njërën nga majat e vargut kodrinor që shtrihen në jugperëndim të fshatit Bejkovë (fig. 2). Kodra ka një lartësi prej 1080 m mbi nivelin e detit dhe rreth 120 m nga rrëza e saj. Një vend i sheshtë në anën lindore të kodrës, sot tokë e punuar pa gjurmë rrënojash thirret «Fshati i Bullgarëve».

Maja e kodrës rrethohet nga një mur i thatë që përfshin një sipërfaqe në formë elipsi (fig. 3) ndërsa dy mure të tjerë (fig. 4) duke u nisur nga ky rrethim zbresin gjatë shpatit jugor të saj deri në buzën e një gremine shkëmbore (fig. 5) në rrëzë të së cilës rrjedh një përrua që mban emrin «Prroi i Virkës». Gjithë pjesa jugore e shpatit të kodrës që kufizohet nga ky përrua i cili krijon një mbrojtje të fuqishme natyrore është lënë pa mure mbrojtëse. Muret e rrethimit të sipërm janë ndërtuar me gurë mesatarë krejt të papunuar me përmasa rreth 30 x 40 cm. Ato janë shumë të dëmtuara, nuk ngrihen në lartësi dhe vetëm në disa vende mund të kapen faqet anësore nga ku mund të përcaktohet gjërësia e tyre rreth 2.80 m. Nga materiali i shumtë i rrëzuar kuptohet se këta mure kanë qenë më të lartë se ata që mbrojnë shpatin jugor të kodrës. Për shkak të grumbujve të gurëve të rrëzuar nuk mundëm të kapim as edhe ndonjë gjurmë hyrje në këtë rrethim. Me mure të kësaj natyre ka qenë mbrojtur edhe shpati jugor i kodrës. Njëri prej tyre ish në këndin jugperëndimor të rrethimit të

1) S. Aliu, **Një qytezë e re ilire në Shqipërinë Juglindore (Rrethi i Kolonjës),** Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, Vëll. II. Tiranë 1969, fq. 353-373.

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2



Fig. 3



Fig. 4

sipërm dhe pas një kthese të harkuar përfundon në buzë të kanionit shkëmbor. Ndërsa tjetri bashkohet me rrethimin e sipërm më në veri duke krijuar për një pjesë të këtij rrethimi një mbrojtje të dyfishtë si dhe e zgjeron sipërfaqen e mbrojtur të vendbanimit në këtë zonë të përshtatëshme.

Ndryshe nga pjesët e tjera të fortifikimit muri që mbronte shpatin e kodrës nga ana e perëndimit ruhet më mirë. Për një gjatësi prej rreth 100 m lartësia e tij arrin 1-1.40 m (fig. 6). Teknika e ndërtimit është e njëjtë me atë të rrethimit të sipërm veçse gurët janë pak më të mëdhenj. Ata janë mbledhur në natyrë, duke mos ju nënshtruar asnjë farë përpunimi. Gjatë vendosjes në mur, midis tyre janë krijuar zbrazëti të mëdha që nga një herë mbushen me gurë më të vegjël. Gjërësia e mureve arrin në 2.40 m. Faqja e tyre e jashtme bie me pjerrësi të lehtë mbi terrenin. Njëra nga hyrjet ndodhet pranë rrethimit të sipërm ndërsa një tjetër shtrihet në jug të së parës, por gjërësia e tyre nuk mund të matet pasi paturat janë të prishura.

Vendbanimi i fortifikuar i Bejkovës ka qënë banuar dendur. Gjurmë rrënojash të banesave hasen edhe jashtë murit rrethues. Brenda rrethimit të sipërm ruhen gjurmët e një banese drejtëkëndëshe me mure guri të thatë. Nga sa kuptohet nga qeramika e gjetur mbi sipërfaqe dhe mungesa e gjurmëve të ndërtimeve të mëvonshme, Bejkova bën pjesë në ato vendbanime që nuk vazhduan të jetojnë gjatë. Disa fragmente qeramike prehistorike të gjetura brenda rrethimit të sipërm si vegje horizontale të brimuara si dhe vegje brinore të shtypura me gisht janë elemente që datohen nga fundi i epokës së bronxit deri në periudhën e hershme të hekurit, kohë së cilës i përket edhe vetë fortifikimi, që ka më shumë mundësi të jetë ndërtuar gjatë shekujve XI-X p.e.r.

Kalaja e Gradecit në fshatin Bejkovë

Me emrin kalaja e Gradecit njihet një kodër e lartë në formë piramide që ngrihet në veri të fshatit Bejkovë (fig. 7). Kodra ka një lartësi prej 1199 m nga niveli i detit dhe rreth 200 m nga rrëza e saj. Ajo zë një pozicion qendror dhe mbizotërues në pllajën e Kolonjës, dhe ka terren të përshtatëshëm për një qendër të banuar. Muri mbrojtës rrethonte pjesën më të lartë të kodrës në formën e një elipsi (fig. 8). Nga veriu ndiqte konturin e një kurrizi shkëmbor që përkon me lartësinë më të madhe të kodrës, ndërsa nga jugu zbriste në një kuotë më të ulët, duke i lënë vend shtrirjes së vendbanimi nga kjo anë më e përshtatëshme, ku ndodhen katër taraca të mëdha

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6



Fig. 7



Fig. 8



Fig. 9

natyrore. Muri ruhet vetëm në gjendjen e gjurmëve sa dhe gjërësia e tij nuk mund të matet. Sidoqoftë kuptohet se nuk ka patur një trashësi më të madhe se 2 m dhe është ndërtuar me gurë kave të përmasave të vogla lidhur me një llaç të dobët me shumë gëlqere. Në çukën më të lartë (1199 m) që ndodhet në anën perëndimore dallohen gjurmët e një kulle të veçuar drejtëkëndëshe e cila ka shërbyer për vrojtim. Prej këndej nga perëndimi shihet krejt pllaja e Kolonjës deri në rrëzë të maleve të Gramozit, ndërsa nga veriu vargu i kodrave që e kufizojnë atë. Në shpatin jugor të kodrës kapen gjurmët edhe të një muri tjetër prehistorik pa llaç i cili mbronte një sipërfaqe mjaft më të madhe nga ajo e fortifikimit të përmendur.

Muret me llaç të Gradecit, nga sondazhi i bërë rrëzë tyre në anën lindore, datohen në antikitetin e vonë. Kësaj kohe i përket edhe kulla e veçuar. Nga sondazhi u vërtetua gjithashtu se vendbanimi kishte një jetë të gjatë duke nisur nga periudha e hershme e hekurit deri në mesjetën e mesme. Gjithashtu u konstatua se mbi murin e antikitetit të vonë që ndërtuar në një periudhë tjetër një mur guri i lidhur me llaç balte i cili duket se i përket mesjetës së hershme.

Gradishta e Barmashit

Gradishta e Barmashit ndodhet mbi një kodër me lartësi 1158 m nga niveli i detit, përmbi fshatin Barmash, buzë rrugës automobilistike që të çon nga Erseka në Leskovik (fig. 9). Kodra është shkëmbore, ngrihet rreth 150 m mbi fshatin dhe zë një pozitë të rëndësishme strategjike. Prej saj kontrollohet lugina e Langaricës, e cila krijon të vetmen rrugë natyrore që lidh fushën e Korçës me Leskovikun e Permetin.

Maja e kodrës ka qenë e rrethuar me një mur të ndërtuar me gurë të thatë (fig. 10) nga i cili mund të ndiqen gjurmë të shkëputura nga ana lindore si dhe trakte më të plota nga veriu, më tej gjurmët e tij humbasin.

Fortifikimi i sipërm që formonte një farë akropoli si në kalanë e Bejkovës, rrethonte një sipërfaqe eliptike me gjatësi 190 m dhe gjërësi 80 m. Ndërsa një mur tjetër duke u lidhur me këtë të fundit në anën juglindore, përfshinte një pjesë të shpatit lindor të kodrës ku ndodhet një shesh mjaft i përshtatëshëm për banim dhe pastaj drejtohej nga veriu ku rrethonte majën e një kodre fqinje e cila ndahet prej të parës nga një qafë e lartë. Sheshi në shpatin lindor duket se rrethohej me një mur të veçantë i cili bashkohej me rrethimin e sipërm në anën verilindore, por gjurmët e këtij muri janë fare të pakta dhe jo shumë të sigurta. (fig. 11).

Nga rrethimi i jashtëm ruhet mirë vetëm muri i anës jugore që ka një gjatësi prej 50 m si dhe muri që kthen në drejtim të veriut në një gjatësi prej rreth 150 m. Pjesët e tjera të planimetrisë mund të plotësohen nga trakte të shkëputura dhe deri diku me hamendje për shkak të pyllit të dendur që mbulon krejt pjesën e sipërme të kodrës. Si përfundim mund të themi se fortifikimi i Barmashit rrethonte dy maja të ndara nga një qafë e lartë të një kodre si dhe një pjesë të shpatit lindor të saj duke qenë njëra nga majat e fortifikuara më vete. Gjithashtu një mur tërthor mund të ketë ndarë më vehte pjesën e mbrojtur të shpatit lindor.

DO NOT COPY



Fig. 10



Fig. 10



Fig. 11



Fig. 12

Për teknikën e ndërtimit mund të gjykojmë nga trakti i ruajtur në anën jugore të rrethimit të jashtëm (fig. 12). Gjërësia e murit është 1.80 m por në lartësi ai nuk ruhet më tepër se 2-3 rradhë gurësh. Muri është ndërtuar me gurë të vegjël dhe mesatarë (30--40 m gjatësi). Për të krijuar faqet anësore janë zgjedhur gurë pak më të mëdhenj me faqe të rrafshta, ose janë përpunuar lehtë për të tillë duke synuar ti japin krejt murit vertikalitet. Por sidoqoftë fugat e takimit të gurëve të faqeve janë lënë të papërpunuara. Muret e ndërtuar me gurë të lidhur në të thatë të kalasë së Barmashit megjithëse të tillë na paraqiten me një teknikë më të përparuar në krahasim me kalanë e Luarasit, Bejkovës etj.

Pjesa e sipërme e kodrës është fortifikuar edhe një herë në kohën e vonë antike me mure guri të lidhur me llaç. Muret e kësaj periudhe nuk janë vendosur mbi muret e vjetër, por rreth 30 m brenda tyre duke përfshirë një sipërfaqe më të vogël nga rrethimi i sipërm i fortifikimit të parë (fig. 11). Muret e antikitetit të vonë janë krejtësisht të rrënuara, megjithatë ato mund të ndiqen në gjithë gjatësinë por trashësija e tyre nuk mund të përcaktohet. Llaçi i përdorur për lidhjen e gurëve ka ngjyrë të bardhë nga përdorimi me shumicë i gëlqeres dhe është mjaft i fortë. Përveç mureve rrethuese, brenda sipërfaqes së mbrojtur hetohen dhe gjurmë muresh të tjera që mund të kenë qenë të banesave ose ambienteve të

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 13

ndonjë garnizoni. Në këtë pjesë të kalasë gjendet me shumicë qeramikë që datohet në antikitetin e vonë, si fragmente vorbash, tjegullash etj. Varre të kësaj periudhe (shek. IV) të mbuluar me tjegulla të mëdha solene janë zbuluar edhe në rrëzë të kodrës, në fshatin e sotëm Barmash.

Barmashi është nga ato qendra që vazhduan të jetojnë edhe në mesjetë. Dëshmi për këtë është gjetja, si rezultat i një sondazhi të vogël i disa fragmenteve vorbash mesjetare bashkë me një monedhë të Leonit VI. (886-912).

Fig. 14



DO NOT COPY



Fig. 15



Fig. 17

Kalaja e Gradecit në fshatin Vrepckë.

Gradec thirret një kodër në perëndim të fshatit Vrepckë. Nga perëndimi kodra bie me një faqe të thiktë shkëmbore mbi një përrua të thellë duke e bërë këtë anë praktikisht të pangjitëshme (fig. 13).

Rënia shkëmbore vazhdon pjesërisht edhe nga jugu, ndërsa nga veriu ajo konturon pjesën e poshtme të shpatit të kodrës që zbret me pjerrësi të butë. Pjesa më e lehtë për tu ngjitur në kala ndodhet nga lindja. Këtu kemi të bëjmë me një qafë të lartë q lidh kodrën e Gradecit me vargun e kodrave fqinj që kanë një shtrirje veri-jug.



Fig. 16

Muri mbrojtës në këtë anë zë një pjesë të qa fës që lidh të dy kodrat, duke përfshirë brenda tij nj terren pak a shumë të rrafshtë me gjërësi rreth 2 m dhe gjatësi 80 m. Në të dy skajet nga veriu dh jugu ai kthen në drejtim të kodrës dhe mbështetet n faqet shkëmbore të saj. Krahu verior ka një gjatës prej 46 m ndërsa ai jugor 23 m. Hyrja për në kal ndodhej nga ana veriore dhe formohej nga një ha pësirë e krijuar midis murit me drejtim veri-jug dh atij që kthehej nga perëndimi. (fig. 14).

Muri mbrojtës është ruajtur vende-vende deri n lartësinë e disa rradhë gurësh, por gjërësia e tij nu mund të matej në asnjë vend. Ai ka qenë ndërtua me gurë të thyer të papunuar të vendosur mbi njër tjetrin pa përdorur ndonjë mjet lidhës.

Nga muri që mbyll qafën deri ku fillon pjerrësia e vërtetë e kodrës ruhen gjurmë muresh të pesë tara cave me gjërësi 3-4 m të ndërtuar me gurë të papunuar të lidhur në të thatë. Lidhja midis taracave realizohej nëpërmjet rampave të pjerrëta të cilat nga njëra anë lehtësonin mjaft ngjitjen dhe nga ana tjetër midis zgjatimit paralel të dy skajeve të mureve të taracimit krijonin hyrje anësore të mbrojtura mirë. Ky sistem taracash përfundon me një mur mbrojtës me gjatësi 113 m i cili bashkonte në rrugën më të shkurtër dy faqet shkëmbore të kodrës, nga veriu dhe jugu. Muri në fjalë është ndërtuar me gurë më të vegjël të lidhur me llaç dhe i përket një periudhe më të vonë me sa duket shek. të IV të e.s. (fig. 14). Në këtë periudhë ai është i vetmi fortifikim nga dora e njeriut i vendbanimit duke ua besuar krejt pjesët e tjera mbrojtjeve natyrore. Pas murit

DO NOT COPY



Fig. 18



Fig. 20

me llaç sistemi i taracave është më i plotë dhe ruhet mirë. Ato zenë krejt shpatin verior si dhe atë juglindor duke u ngjitur deri në majë të kodrës (fig. 15). Në shpatin verior numërohen 14 taraca me gjërësi mesatare 6-8 m. Muret e tyre janë ndërtuar me gurë të papunuar të madhësive mesatare, kanë një gjërësi 1.5-3 m dhe ruhen po në atë lartësi. Lidhja midis taracave edhe këtu realizohet nëpërmjet rampave të pjerrta, ndërsa në shpatin juglindor hetohen 9 taraca të tilla me gjërësi mesatare prej 5 m. Përveç taraca-



Fig. 19

ve të gjata që ndjekin vijat rrushkulluese të terenit, në këtë pjesë të kodrës vërehen edhe taraca të vogla të izoluara që krijonin xhepe të mbështetura te shkëmbinjtë dhe komunikonin me pjesën tjetër të vendbanimit nëpërmjet një hyrje të thjeshtë. Këto taraca të vogla ishin llogaritur për ndërtimin e një banese. Të tërheq vëmëndjen fakti se muret rrethues të tyre ngrihen mbi nivelin e terenit edhe nga ana e brendshme.

Në pjesën më të lartë të kodrës ndodhet një rrethim i veçantë të cilin po e quajmë «akropoli». Akropoli zë një sipërfaqe në formë elipsi me gjatësi 45 m dhe gjërësi 22 m. Ana perëndimore është lënë e pa rrethuar nga muret duke ia besuar mbrojtjes natyrore. Hyrja ndodhet nga verilindja dhe formohet nga zgjatimi paralel i dy skajeve të murit rrethues (fig. 16). Nga krahu i djathtë hyrja kufizohet nga një mur me gjërësi 1.4 m, ndërsa nga e majta prej ndërprerjes së murit lindor që ka një gjërësi prej 3 m dhe prej një kthese këndrejtë që bën ai në drejtim të brendësisë së fortifikimit duke krijuar në këtë mënyrë një korridor me gjatësi 6 m. Gjërësia relativisht e madhe e hyrjes, dhe mungesa e blloqeve të mëdhenj prej guri të bëjnë të mendosh se mbulesa e saj ka qenë realizuar me konstruksion druri. Muret e akropolit në përgjithësi kanë një gjërësi prej 3 m, lartësia e ruajtur maksimale e tyre në anën e jashtme arrin 3 m (fig. 17) ndërsa brenda vende-vende deri në lartësinë 1.5 m ose rrafsh me tokën. Për të patur njohuri më të plota për fillimet e jetës dhe vazhdimësinë e saj në këtë vendbanim dhe për të datuar muret mbrojtëse e të taracimit të cilat të shqyrtuara nga teknika e ndërtimit nuk do të na jepnin ndonjë rezultat, u kryen disa sondazhe arkeo-



Fig. 21

logjike. Njëri në akropol dhe dy të tjerë në taracat e shpatit verior. Sondazhi në akropol me përmasa 2 x 1.5 m u krye në faqen e brendshme të murit lindor. Thellësia deri në tokën sterile arriti në 50 cm. Nga sondazhi doli se muri rrethues ishte ndërtuar mbi shkëmb. Materiali arkeologjik më i hershëm i



Fig. 22

përkiste periudhës helenistike. Jeta vazhdonte edhe gjatë periudhës së pushtimit romak deri në shek. IV të e.s. Qeramika përbëhej nga fragmente pitosash pjatash, vegje e grykë amforash, peshore, enësh me parete të holla të tipit «terrasigillata», fragmente enësh masive prej bronxi etj. Me interes ishte dhe gryka e një pitosi me vulë ku shënohej emri AMYN(TA), ky emër i stampuar mbi grykat e pitosave është i rëndomtë për pellgun e Kolonjës, ai është gjetur gjatë gërmimeve arkeologjike në Kamnik dhe në kalanë e Hollmit dhe datohet në shek. IV-III p.e.r[1] ndërsa në qendra të tjera arkeologjike të vendit tonë kjo vulë është gjetur mbi tjegulla në qytetin ilir të Dimalit në shtresat kulturore që i përkasin shek. III-II p.e.s.[2]. Sondazhi tregoi se pjesa e sipërme e fortifikimit është banuar intensivisht në shek. II p.e.s. deri në shek. IV të e.s. Ndërsa dy sondazhe të tjera nuk na dhanë rezultatet e pritura. Kjo të bën të mendosh se taracat kanë qenë shfrytëzuar edhe si toka buke apo për mbajtjen e bagëtisë etj. Megjithatë vendbanimi i fortifikuar i Vrepckës na paraqitet me tipare të veçanta për gjininë e vet. Ky krijim është rezultat i shprehive të veçanta në fushën e ndërtimit të një fisi të caktuar që banonte këtë zonë, me tradita që në kohët më të hershme prehistorike si dhe i rrethanave konkrete ekonomike të vendbanimit në fjalë.

Kalaja e Borovës

Kalaja e Borovës e njohur me emrin «Çuka e Borovës» ndodhet në të majtë të rrugës automobilistike që të çon nga Erseka për në Leskovik posa kalon fshatin Borovë. Kodra mbi të cilën ndodhen rrënojat e kësaj kalaje është e ulët me një majë shkëmbore dhe bie me një faqe me pjerrësi të butë në drejtim të Jugut dhe perëndimit, ndërsa ana lindore e veriore janë më të aksidentuara (fig. 18) (fig. 19). Muret mbrojtës janë shumë të dëmtuara; ndiqen me vështirësi dhe vetëm pjesërisht. Më mirë ruhen rrënojat e disa banesave.

Në majën shkëmbore të kodrës ruhen gjurmët e një ndërtimi me mure të lidhur me llaç që ndoshta i përkasin një kulle vrojtimi të antikitetit të vonë (fig. 20). Muri mbrojtës kapte gjysmën e lartësisë së kodrës nga perëndimi ndërsa nga jugu rrëzën e saj. Pjesa shkëmbore në veri dhe verilindje duket se janë lënë të pa fortifikuara. Gjërësia e murit mbrojtës prej 2.30 m i ruajtur rrafsh me tokën, mund të kapet

1) S. Aliu, **Një qytezë e re ilire në Shqipërinë Juglindore (rrethi i Kolonjës)** «Konferenca e II e Studimeve Albanologjike», Tiranë 1969, fq. 354-357.
2) B. Dautaj, **Zbulim i qytetit ilir Dimal;** Iliria, 11, 1972, fq. 139.

DO NOT COPY

vetëm në anën jugore. Ai ka qenë ndërtuar me gurë të palatuar ndoshta të përpunuar pak pasi në të dy anët e murit krijojnë linja mjaft të rregullta paralele midis tyre. Po këtu hetohen gjurmët e një ndërtimi drejtëkëndësh që mund të ketë qenë një banesë.

Muret e këtij ndërtimi (fig. 21) të ruajtura në lartësi 1.30 m kanë një trashësi prej 1. m, hapsira e tij e brendshme është 4. x 4.20 m, si mur i brendshëm ka shërbyer faqja e një shkëmbi. Gjurmë hyrje nuk dallohet. Muret janë ndërtuar me gurë të papunuar të vendosur në të thatë ku boshllëqet e krijuara midis tyre janë mbushur me kujdes me gurë më të vegjël. Faqja jugore e kodrës deri në rrëzë të murit zihej nga banesa të tilla. Ato janë një kthinëshe e me planimetri drejtkëndëshe. Gjurmët e një banese takohen edhe jashtë murit rrethues.

Nga qeramika e gjetur mbi sipërfaqe predominon ajo e periudhës së parë të hekurit por nuk mungon edhe qeramika e periudhës helenistike. Në gjendjen e sotme të njohjes nuk mund të themi me siguri se cilës kohë i përkasin ndërtimet e mësipërme qoftë muri rrethues apo banesat. Ka mundësi që ato t'i takojnë periudhës qytetare ilire, gjë që përforcohet dhe nga zbulimi i një varreze pranë këtij vendbanimi e cila dha materiale të shumta të shekujve IV-II p.e.r.



Fig. 23



Fig. 24

Kalaja e Luarasit

Kalaja e Luarasit ndodhet rreth 3 km në lindje të fshatit Luaras të rrethit të Kolonjës. Terreni që shtrihet rreth saj, mjaft piktoresk formohet nga një sërë kodrash që bien me shpate të buta të përshtatshme si për blegtori ashtu edhe për bujqësi. Më në lindje rreth 10 km nga kalaja kalon lumi i Osumit. Kalaja e Luarasit është studjuar më parë nga kolegu ynë K. Zheku.[3)]

Kodra e kalasë është e vetmja kodër shkëmbore në këtë zonë, dhe njihet nga banorët me emrin «Guri i Madh». Faqja jugore e kodrës bie thikë mbi terrenin nga një lartësi prej 50 m (fig. 22). Shkëmbi i thepisur vazhdon të rrethojë kodrën pjesërisht edhe nga

3) K. Zheku, **Gjurmë të një vendbanimi prehistorik ilir të fortifikuar te Guri i Madh i Luarasit, Rrethi i Kolonjës.** «Shtëpi muze dhe monumente kulture. Tiranë 1981, fq. 112-117.

Artikulli merret kryesisht me përshkrimin e qeramikës së gjetur në sipërfaqe e cila klasifikohet në dy grupe, prehistorike dhe e antikitetit të vonë. Në artikull jepet dhe një skicë planimetrike në të cilën fortifikimi që zë majën e kodrës është orientuar në një mënyrë që nuk shfrytëzon rënien shkëmbore nga jugperëndimi. Në të nuk shënohen muret e antikitetit të vonë që rrethonin pjesën e sipërme të kodrës as edhe kulla e veçuar që ndodhet në pjesën dominuese të saj. Tek rrethimi i poshtëm K. Zheku nuk dallon një ndarje të dytë pranë rrëzës së shkëmbit. Fortifikimi i poshtëm datohet para shek. IX. p.e.s.

DO NOT COPY



Fig. 25



Fig. 26



Fig. 27

lindja. Sheshi që shtrihet rrëzë shkëmbit është gjetu i përshtatëshëm për zhvillimin e një vendbanimi t kohës së neolitit të mesëm (sipas një sondazhi t kryer në këtë vend). Kodra e mbronte vendbanimi nga erërat veriore duke u dhënë banesave një orien tim të përshtatëshëm nga Juglindja. Këto kushte u pëlqyen edhe banorëve të mëvonshëm të cilët e rre thuan vendbanimin me mure mbrojtëse (fig. 23).

Muri rrethues i jashtëm mbron një sipërfaqe t sheshtë rrëzë kodrës me përmasa 100 x 320 m (fig 24). Të dy skajet e tij mbështeten në shkëmbin e the pisur, njëri nga ana jugore dhe tjetri nga lindja Muri ka një gjërësi prej 2.5 m dhe ruhet vende-vende deri në lartësinë 2 m. Ai është ndërtuar duke ven dosur gurë të mëdhenj për krijimin e faqeve ndërsa për mbushjen e bërthamës janë përdorur gurë shu më të vegjël dhe çakull, për lidhjen e tyre nuk është përdorur asnjë mjet. Gurët për ndërtim janë marrë në vend pa u përpunuar të formuar nga proçeset e alterimit të shkëmbit të kodrës. Edhe sot ruhet një rezervë e madhe materiali në rrëzë të kodrës e kri juar që nga koha e braktisjes së vendbanimit. Gurët që formojnë faqet anësore të murit janë vendosur në mënyrë krejt të çrregullt duke dalë prej tyre maja--maja dhe nuk krijojnë sipërfaqe pak a shumë të rrafshta (fig. 25).

Brenda këtij rrethimi të madh ruhen gjurmët edhe të një rrethimi tjetër, muri i të cilit është më pak i ruajtur (fig. 26). Ai ndodhet vetëm 30-40 m larg rrëzës së kodrës duke u mbështetur në një skaj në murin rrethues të jashtëm (nga veri-perëndimi) dhe në skajin tjetër në shkëmbin e kalasë duke përfshirë një sipërfaqe 160 x 40 m. Nuk mund të përcaktohet me saktësi se cili nga këto dy rrethime ka qenë më i hershmi pasi nuk ruhen gjurmë të mjaftueshme në vendin e takimit të dy mureve. Më e mundëshme është që rrethimi i brendëshëm të jetë më i hershmi dhe pas zgjerimit të vendbanimit materiali i tij është integruar në ndërtimin e ri. Territori që përfshihej në rrethimin e brendshëm nuk ishte aq i përshtatëshëm për banim dhe nga ana tjetër nuk ofronte kushte të favorshme mbrojtjeje. I vetmi avantazh ishte se ai e kishte gurin pranë, gjë që do të lejonte sajimin e një fortifikimi në një periudhë të shkurtër kohe dhe me forca të pakta. Në sheshin që përfshihet nga këto rrethime takohen fragmente qeramike jo vetëm të neolitit por edhe të epokës së bronxit duke filluar që nga bronxi i mesëm.

Për plotësimin e këtij fortifikimi është shfrytëzuar edhe maja e kodrës, trakte muresh prehistorike nuk ruhen të dokumentuara por nga qeramika del se ajo ka qenë banuar së paku që nga periudha e her shme e hekurit. Muret mbrojtës në majën e kodrës

DO NOT COPY



Fig. 28

i përkasin antikitetit të vonë. Ato përfshinin një sipërfaqe në trajtë elipsi me gjatësi rreth 100 m dhe gjerësi 80 m duke rrethuar vetëm anën verilindore dhe veriperëndimore të kodrës, më pak të mbrojtur nga natyra, ndërsa anët e tjera që binin me faqe të thikta shkëmbore janë lënë të pa fortifikuara. Muret kanë një gjerësi prej 1.80 m dhe janë ndërtuar me gurë të vegjël të lidhur me llaç (fig. 27). Në pjesën më të madhe ato ruhen pothuajse në rrafshin e tokës. Në mesin e murit verilindor ruhen gjurmët e një banese katërkëndëshe e cila i mbështetet atij nga ana e brendshme. Banesa ka një gjerësi prej 9 m e gjerësi 6 m, pranë saj dallohen shpatullat ansore të një kulle që projektohet jashtë murit. Në skajin verior të fortifikimit ruhen gjurmët e një banese tjetër të ndërtuar me mure guri të lidhura me llaç, me planimetri drejtëkëndëshe (5 x 10 m). Hyrja për në kala krijohej midis skajit të murit që rrethonte majën e kodrës nga veriperëndimi dhe shkëmbit të thepisur në jugperëndim. Në qoftë se në linjën e murit antik të vonë ka patur më parë një mur prehistorik, kjo hyrje lidhte fortifikimin në majë të kodrës me vendbanimin e fortifikuar në rrëzë të saj. Përveç ndërtimeve mbrojtëse të përmendura, në pjesën më të lartë të kodrës ka patur një kullë të veçuar vrojtimi rrethore, tani krejt e rrënuar. Nga gjurmët e ruajtura kuptohet që kulla ka patur një diametër të brendshëm prej 3 m. Grumbulli i gurëve i krijuar nga rrënimet e mureve të kullës arrin një lartësi prej 4 m. Kjo tregon se kulla ka qenë mjaft e lartë. Në anën verilindore të kodrës ruhet një tumë, ndërsa në afërsi të vendbanimit janë fiksuar edhe 7 tuma të tjera. Duke u nisur nga vendosja në teren të sheshtë, nga teknika e ndërtimit dhe kryesisht nga qeramika, mendojmë se këto ndërtime mbrojtëse i përkasin periudhës së mesme apo të vonë të bronxit. Në periudhën e hershme të hekurit mund të jetë fortifikuar maja e kodrës dhe si zakonisht pika të tilla strategjike u rifortifikuan gjatë antikitetit të vonë, në kushtet e dyndjes së popujve dhe të krizës së sistemit skllavopronar.

Kalaja e Boshanjit[4]

Kalaja e Boshanjit ndodhet në krahun e djathtë të rrugës automobilistike që të çon nga Korça në Ersekë, mbi një kodër të lartë shkëmbore në perëndim të fshatit Boshanj.



Fig. 29

4) Për kalanë e Boshanjit shih. Gj. Karaiskaj, **Kalaja e Boshanjit** në rrethin e Kolonjës, «Tradita ndërtimore në Shqipëri», Tiranë 1981, 62-64.

DO NOT COPY

Kodra është pjesë e një vargu të tërë kodrinor që njihet me emrin «Mali i Zi», ajo bie me shpate të pjerrëta nga të gjitha drejtimet me përjashtim të anës lindore, e cila ka një pjerrësi më të butë. Në rrëzë të kodrës nga kjo anë shtrihet lugina tektonike e Lubonjës dhe akoma më në lindje kalon rrjedha e sipërme e Osumit. Shpatet e kodrës e sidomos pjesa e sipërme e saj janë të veshura me pyje pishash e dushqesh por megjithatë midis tyre mund të ndiqet traseja e një muri rrethues, i ndërtuar me gurë gëlqerorë të thyer të lidhur në të thatë.

Muri ka një gjërësi prej 2 m ruhet mesatarisht në lartësinë 1.5 m dhe rrethon një sipërfaqe e cila ka formën e një trekëndëshi me perimetër 420 m (fig. 28). Në territorin brenda murit rrethues të kalasë hetohen vende-vende grumbuj gurësh të papunuar pa shenja llaçi të cilët duhet ti përkasin rrënojave të banesave.

Nga veriperëndimi kodra e kalasë lidhet me kodrat fqinje me anën e një qafe shumë të lartë dhe dominohet prej tyre. Në këtë mënyrë këtu krijohet pika më delikate ku sulmi mund të kryhej më lehtë. Për t'iu shmangur këtij rreziku në këtë vend është ndërtuar një kullë rrethore e vetmja në gjithë fortifikimin (fig. 29). Ajo është ndërtuar me të njëjtën teknikë me atë të murit rrethues.

Kulla ka një diametër të brendshëm prej 4 m dhe gjërësi muresh 2 m. Gjurmët e hyrjes për në kullë me gjërësi 1.2 m dallohen nga ana e brendshme e fortifikimit. Ndërsa hyrja për në kala me gjërësi 2 m ndodhet nga Jugu, ku të dy paturat e saj ruhen në lartësinë e dy rradhë gurësh.

Muri rrethues i sipërm nuk ndjek një linjë të drejtë por me valëzime të lehta sipas terrenit. Ai është ndërtuar me gurë të vegjël dhe mesatarë të thyer me përmasa rreth 0.40-0.70 m gjatësi dhe 0.30 m lartësi. Faqia e tyre e rrafshtë është vendosur nga ana e jashtme e murit dhe boshllëqet që formohen midis gurëve janë mbushur me kujdes me gurë të vegjël. Shkëmbi nga janë nxjerrë gurët ka patur karakter shtesor kështu ata nuk kanë lartësi më të madhe se 0.30-0.35 m.

Një karakteristikë tjetër e këtij muri është se thellësia e futjes së gurëve të faqeve në brendësi është më e madhe se gjatësia edhe lartësia e tyre (fig. 28). Kjo e bënte murin më të qëndrueshëm duke e lidhur më mirë me bërthamën e tij të përbërë nga gurë të vegjël dhe mesatarë të hedhur njëri mbi tjetrin pa ndonjë rregull.



Fig. 30

Mbi sipërfaqen e kalasë nuk u gjet qeramikë ose objekte të tjera arkeologjike. Duke mos patur të dhëna të tjera ndihmëse do të përpiqemi ta datojmë kalanë e Boshanjit në bazë të teknikës së ndërtimit dhe të ndonjë elementi arkitektonik.

Teknika me gurë të papunuar të lidhur në të thatë është një karakteristikë kryesisht për periudhën prehistorike, por në vartësi të kushteve social-ekonomike të vendbanimeve, ajo vazhdon në mjaft raste edhe gjatë antikitetit dhe madje deri në kohën e vonë antike.

Por zakonisht në fortifikimet e antikitetit të vonë të ndërtuara me këtë teknikë, nuk takojmë kulla; madje edhe në ato me mure të lidhura me llaç në zona të thella malore, ku linja e murit ndiqte konturin e çrregullt të terrenit, kullat mungojnë ato janë dukuri e rrallë. Për këtë kalaja ka më tepër mundësi të jetë ndërtuar në kohën antike e sidomos në shek. III-II p.e.s., kur kjo krahinë ishte nën kërcënimin e vazhdueshëm jo vetëm Maqedon por edhe të Romës. Ka mundësi që kalaja të ketë shërbyer dhe si vendstrehim për raste rreziku.

Kalaja e Leshnjës[5]

Kalaja e Leshnjës ndodhet mbi një kodër shkëmbore në verilindje të fshatit Leshnjë (Rr. i Korçës) e cila njihet me emrin «Maja e Manastirishtes». Kodra mbi të cilën është ndërtuar kalaja, paraqet në pjesën e sipërme një kurriz shkëmbor, jo aq të përshtatshëm për një vendbanim të përhershëm se sa

5) Për kalanë e Leshnjës shih Gj. Karaiskaj, Dh. Dine, **Kalaja e Leshnjës,** «Tradita ndërtimore në Shqipëri», Tiranë 1981, fq. 86-89, në këtë artikull jepet për herë të parë planimetria e kalasë.

DO NOT COPY

për një vendstrehim në raste rreziku. Kjo shpjegon ndofta dhe mungesën e qeramikës në këtë territor. Në këtë përfundim, të çon edhe ekzistenca e një vendbanimi të hapur, mbi disa taraca natyrore në shpatin e një kodre, e cila nuk ndodhet më larg se 300-400 m nga kalaja dhe ka vazhduar të jetojë në bazë të qeramikës së gjetur, nga periudha e parë e hekurit deri në shek. II p.e.r.

Nga kalaja dominohet lugina që formohet nga rrjedha e sipërme e Osumit e cila ndodhet në rrëzë të kodrës së kalasë nga ana jugore e saj. Në të dy anët e lumit gjenden parcela të vogla të përshtatëshme për zhvillimin e bujqësisë, por në përgjithësi vendi rreth e qark është kodrinor që përcakton dhe karakterin kryesisht blegtoral të vendbanimeve të tij.

Muret rrethuese të kalasë që mbronin kurrizin e kodrës rrethonin një territor me gjatësi 150 m dhe gjërësi 20-30 m (fig. 30). Ato ruhen më mirë nga jugperëndimi ku kapen dhe konturet e një kulle katërkëndëshe, e vetmja që hetohet në këtë fortifikim. Lartësia e mureve tek kulla dhe pranë saj është ruajtur në 1.5 m, por sasia e madhe e materialit të rrëzuar nga këto mure tregon se lartësia e tyre ka qenë mjaft më e madhe.

Muret janë ndërtuar në faqet e jashtme me blloqe gurësh të mëdhenj që arrijnë përmasa deri në 1.5 m gjatësi dhe 0.50-0.70 m lartësi ndërsa brendësia e murit është mbushur me gurë të thyer me përmasa të vogla. Gurët e faqeve pasi janë nxjerrë nga gurorja janë punuar lehtë me çekiç për ti dhënë atyre forma pak a shumë drejtkëndëshe por fugat nuk janë punuar me kujdes kështu që gurët nuk puthiten mirë midis tyre duke krijuar zbrazëti të konsiderueshme, dhe në pamjen e parë të japin përshtypjen e një fortifikimi të periudhës së parë të hekurit. Kulla e vetme e kalasë është ndërtuar në pjesën më pak të mbrojtur të kodrës nga mundet të ketë qenë dhe hyrja, që në këtë rast është më pranë vendbanimit të hapur. Kulla ka një gjërësi ballore 8 m. Ajo projektohet prej murit rrethues nga ana lindore 3 m ndërsa nga perëndimi vazhdon të vijë drejtë me një gjatësi prej 12 m ku vërehet një kthesë tjetër këndrejtë e murit. Pas kësaj kthese muri vazhdon në linjë të drejtë edhe për disa metra deri në shpatin e kundërt të kodrës ku bashkohet me murin rrethues verior. Nga veriu muri mund të ndiqet pa ndërprerje, por ruhet mjaft i rrënuar, ndërsa nga linja me përjashtim të kullës dhe të një trakti ngjitur me të mund të kapen vetëm trakte të shkëputur. Faqja e tij e brendshme nuk mund të hetohet në asnjë vend kështu që nuk mund të përcaktohet gjërësia e mureve, por sidoqoftë nga gjurmët e ruajtura mund të thuhet se ato kanë qenë mbi 2 m të gjërë. Megjithëse në pamje të parë kalaja të krijon përshtypjen e një fortifikimi prehistorik. Teknika për tu dhënë blloqeve forma katërkëndëshe nëpërmjet një punimi të vrazhdë tregon për një shkallë më të përparuar në ndërtimin e mureve të saj. Nga ana tjetër në këtë fortifikim është e pranishme një kullë drejtkëndëshe mjaft e zhvilluar si dhe linja të drejta me kthesa drejtkëndëshe të mureve rrethuese.

Lidhja e faqes lindore të kullës me atë të murit rrethues është bërë në një mënyrë të tillë që të kujton, fortifikimet antike, blloqet në forma që i afrojnë katërkëndëshit, ndërthuren njëri me tjetrin në vendin e takimit për të krijuar një lidhje më të mirë të murit me kullën. Po të nisemi thjesht nga teknika e ndërtimit do ta datonim këtë kala në periudhën kalimtare nga periudha e parë e hekurit në antikitet. Nga ana tjetër kulla është një element që mund të shtyjë këtë datim akoma më tepër në drejtim të antikitetit. Por po të kemi parasysh që kalaja e Leshnjës është ndërtuar në një zonë të thellë malore, në një territor kur vetëm në ndonjë rast të rrallë janë përdorur ndërtime mbrojtëse me mure gurësh krejt të latuar (Symiza) si dhe faktin që ky fortifikim është përdorur me më tepër mundësi si një vend strehimi, ku muret rrethuese nuk bënin pjesë në formulimin arkitektonik të qendrës së banuar atëhere mund të mendojmë për një datim relativisht të vonë të kalasë së Leshnjës, në periudhën që përfshin shek. IV-III p.e.s.

PËRFUNDIME

Nga materiali i shqyrtuar më sipër del se ndërtimet mbrojtëse të pllajës së Kolonjës e të rrjedhës së sipërme të Osumit i përkasin një zone gjeografike e etnografike të përcaktuar nga kufij të qartë natyrorë ku banonte në kohë të lashta një nga nënfiset e Dasaretëve.

Vendbanimet e fortifikuara që shtrihen në pllajën e Kolonjës e qarkojnë këtë të fundit në formën e një kurore nga Veriu, Lindja dhe Jugu, duke mbikqyrur dhe rrugën që kalonte nëpër grykën e Barmashit në Leskovik e Përmet. Këto vendbanime zotëronin një terren të përshtatëshëm bujqësor e blegtoral. Edhe vendbanimet e fortifikuara që shtrihen përgjatë rrjedhjes së sipërme të Osumit (Luarasi, Boshanji, Leshnja) janë të lidhura me këtë trevë, me ndryshimin që ato zotëronin një zonë me karakter më tepër blegtoral.

Kalaja e Luarasit komunikon lehtë me pllajën e Kolonjës ndërsa ajo e Boshanjit duke u ndodhur mbi vargun kodrinor të quajtur «Mali i Zi» bën pjesë njëkohësisht në fortifikimet që lidhen drejtpërdrejtë me këtë pllajë, prej saj vrojtohet, jo vetëm malësija e

DO NOT COPY

Vithkuqit por edhe krejt pllaja e Kolonjës me fortifikimet e saj deri sa shikimi ndalet në malet e Gramozit. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për kalanë e Leshnjës (Rrethi i Korçës) e cila nëpërmjet kalasë së Bellovodës, të tërhequr disi në brendësi të zonës malore të Vithkuqit krijon një pikë kontakti midis sistemit fortifikues të Pllajës së Kolonjës dhe atij të Pellgut të Korçës[6].

Ndërtimet mbrojtëse të Pllajës së Kolonjës e të rrjedhës së sipërme të Osumit lidhen tipollogjikisht me fortifikimet ilire e në mënyrë të veçantë me ato të Pellgut të Korçës, duke patur një sërë veçorisht nga ndërtimet mbrojtëse të Greqisë arkaike e klasike. Por këto fortifikime duke i përkitur një zone etnografike disi të veçuar na paraqiten edhe me veçoritë e tyre lokale. Një tip të veçantë për këtë periudhë prehistorike përbën kalaja e Luarasit, ndërsa për antikitetin Vrepcka.

Luarasi dallon nga fortifikimet e tjera si nga formulimi planimetrik ashtu edhe nga teknika e ndërtimit. Ai shtrihet në teren të sheshtë rrëzë një kodre shkëmbore në vend që të ndërtohej mbi këtë të fundit nga ana tjetër gurët e përdorur për ndërtimin e murit janë krejtësisht natyrorë, pa shenja thyerje dhe nuk formojnë faqe të rrafshta. Duke u nisur nga këto veçori do të mendonim që jo vetëm që fortifikimi fushor i përket një periudhe më të hershme (bronxi i mesëm, bronxi i vonë) por edhe se ai duhet të jetë ndërtuar në një kohë kur vendbanimet e fortifikuara ishin të rralla, veglat e punës e bënin të kushtueshëm punimin, e gurit, dhe përballimit të mjeteve dhe mënyrave të atëhershme të sulmit, do tu mjaftonte edhe një fortifikim fushor i këtij tipi. Për këto arsye nuk u pa e nevojshme të sakrifikohej në drejtim të komoditetit të një vendbanimi për të siguruar një mbrojtje më të fuqishme. Por kodra që ngrihej në anë të këtij vendbanimi do tu shërbente banorëve të periudhës së hershme të hekurit të cilët kishin nevojë për një siguri më të madhe në kushtet e reja të krijuara në atë kohë.

Fortifikimet e tjera prehistorike të kësaj krahine që i përkasin fundit të epokës së bronxit ose fillimit të periudhës së hekurit përfaqësojnë forma planimetrike të njohura për fortifikimet ilire të kësaj periudhe që i takojnë edhe në Pellgun e Korçës. Nga form më e thjeshtë kur muri mbrojtës rrethonte në trajtën një elipsi majën e një kodre (Hollm, Gradeci i Bejko vës) kalohet në fortifikimet me dy rrethime ku i pari z majën e kodrës ndërsa i dyti shpatin e saj, si në ka lanë në jug lindje të fshatit Bejkovë, e cila është ngjashme me formulimin planimetrik të kalasë së Be llovodës e të Podgorijes në rrethin e Korçës[7]. Më n fund Gradishta e Barmashit na paraqitet e ndarë n tre pjesë ku pjesën më të mbrojtur e zë rrethimi majës së kodrës, rrethimi i dytë kap shpatin jugo të saj ndërsa i fundit syprinën e kodrës fqinjë. N këtë rast kemi një ndarje në dy pjesë të territorit q përfshinte rrethimi i dytë, të cilat veçohen nga cilë sitë e ndryshme mbrojtëse të terrenit, si i tillë Bar mashi bën pjesë në fortifikimet me shumë rrethime si Kalaja e Trojanit[8] dhe Qyteza e Karosit[9].

Nga vendbanimet e fortifikuara që i përkasi periudhës qytetare ilire, një tip të veçantë përbë kalaja e Gradecit në Vrepckë, vendbanime të till të taracuara kaq dendur me mure mbajtës e ramp të pjerëta që i lidhin ato, janë të rralla në botë antike dhe i hasim në territore të largta prej vend tonë si në gadishullin Iberik[10]. Por ne kemi nj shembull që i paraprin këtij tipi në një trevë kufi tare me Kolonjën, kalanë e Dedejanit në rrethin Përmetit, fortifikim i periudhës së vonë të bronxit, ndërtuar mbi disa taraca me mure mbrojtës[11]. Pi kat e tjera të kontaktit me fortifikimet ilire mund shohim në numërin e madh të rrethimeve, karakteri stikë tek fortifikimet prehistorike.

Ndryshe nga vendbanimet e fortifikuara të Gre qisë në të cilat edhe gjatë antikitetit klasik e më vo në muri mbrojtës qoftë edhe i jashtëm integront dhe shtonte mbrojtjet e paracaktuara nga natyra në Vrepckë ky i fundit përfshin krejt vendbanimin taracuar duke u vendosur në rrëzë të kodrës. Në qoftëse do të ndiqej parimi i parë, vendbanimit d ti mjaftonte rrethimi i akropolit ose muri mbrojtë i jashtëm do të kalonte në vendin e atij të antikite tit të vonë. Një veçori tjetër në fortifikimet e periu dhës qytetare ilire në pllajën e Kolonjës paraqet tek nika e ndërtimit e cila ndjek traditën e fortifikimev prehistorike, këtë e dëshmon më së miri Gradeci

6) Gj. Karaiskaj-Dh. Dine, **Vep. cit,** fq. 86-89.
7) Gj. Karaiskaj-P. Lera, **Fortifikimet e periudhës së parë të hekurit në rrethin e Korçës,** «Kuvendi i Parë i Studimeve ilire (Tiranë 15-20 Shtator 1972)»,Tiranë, 1974, vëll. I, fq. 263-290.
8) Gj. Karaiskaj-P. Lera, **Vep.cit,** fq. 263-290.
9) I. Koçi, **Qyteza e Karos (Qeparo),** Buletin Arkeologjik 3, 1971, 181-183.
10) M. Morini, **Atlante di storia e dell'urbanistica,** Milano 1963, fq. 3.
11) N. Bodinaku, **Kontribut për hartën arkeologjike të rrethit të Përmetit,** «Sesion Shkencor mbi rezultatet e gërmimeve arkeologjike për vitin 1978», Tiranë 1978.

DO NOT COPY

Vrepckës, dhe një sërë fortifikimesh të tjera si kalaja e Boshanjit, Leshnjës (rr. i Korçës) etj. Evolucioni i ndërtimeve mbrojtëse nga prehistoria në antikitet nuk mund të ndiqet nëpërmjet përsosjes së teknikës së ndërtimit të mureve por nëpërmjet zhvillimit të sistemit fortifikues në ndonjë rast (Vrepcka) dhe të përdorimit të kullave në raste të tjera (Boshanji, Leshnja). Duke u nisur nga kjo veçori lokale e teknikës së ndërtimit që është karakteristike në një masë të madhe edhe për pellgun e Korçës nuk duhet të mendojmë për mungesën e fortifikimeve antike, as edhe të qyteteve në këtë zonë, por këto qytete nuk duhen lidhur me doemos me ndërtime muresh mbrojtëse me gurë të latuar.

Në antikitetin e vonë kemi përsëri një sërë fortifikimesh. Në të shumtën e rasteve rifortifikohen vendbanimet e vjetra si Luarasi, Barmashi, Vrepcka, Gradeci i Bejkovës, Hollmi etj. Fortifikimi më tipik është ai që rrethon konturin e çrregullt të majës së një kodre në të shumtën e rasteve nga një mur pa kulla. Në pikën dominuese të terrenit ndodhet një kullë e veçuar për vrojtim, drejtëkëndëshe apo rrethore. Një tip të tillë fortifikimi e takojmë në kufirin verior të pellgut të Korçës, në kalanë e Bllacës. Në ndonjë rast si në Vrepckë fortifikimi është më i thjeshtë një mur bllokon pjesën e pa mbrojtur nga natyra të një kodre, dhe së fundi midis këtyre fortifikimeve takojmë në Hollm një kështjellë të vërtetë garnizoni me formë të rregulltë gjeometrike, me përmasa të vogla me një kullë që mbronte hyrjen si dhe me një sterë brenda kështjellës.

Pllaja e Kolonjës pati një jetë intensive edhe gjatë mesjetës. Në burimet dokumentare të shek. XI përmendet Tema e Kolonjës[12] dhe po në këtë kohë Kolonja si qytet[13] ku në fillim të shek. XII gjatë luftrave normano-bizantine kish vendosur kampin perandori Aleks Komneni[14]. Në fund të shek. XII fillimi i shek. XIII përmendet provinca e Kolonjës[15] e cila në vitin 1259 pushtohet nga perandoria bizantine e Nikes.[16],

Në vitin 1328 Androniku i II Paleologu midis të tjerave pushton dhe krahinat e Kolonjës[17]. Nga të dhënat e mësipërme del qartë se në mesjetë kemi një qytet me emrin Kolonjë si dhe një krahinë që ka marë emrin nga ky qytet, siç ndodh me Devollin (Deabolis), Drinopolin etj. Gjatë kësaj periudhe për një kohë krahina e Kolonjës ka qenë nën sundimin e shtetit Bullgar. Por ky sundim ka patur karakter administrativ dhe jo etnik. Një burim i mirë për të dëshmuar këtë fenomen është mikrotoponimia. Toponimi me origjinë mesjetare «Fshati i Bullgarëve» pranë kalasë së Bejkovës tregon se popullsia e huaj formonte ishuj të vegjël me kufij të qartë etnikë e mikrogjeografikë. Duke qenë të tillë ata u bënin përshtypje vendasve dhe për këto arsye këto mikrotoponime janë ruajtur deri në ditët tona nga ana tjetër gjetja e një monedhe të Leonit VI (886-912) në Barmash, tregon se kjo krahinë vazhdonte ti mbante lidhjet me Bizantin edhe gjatë shek. IX-X. Nga Kolonja sot na është ruajtur vetëm emri i krahinës por jo i qytetit i cili mund të ketë qenë braktisur shumë kohë më parë. Ky qytet zinte një pozitë qendrore e mbizotëruese në krejt pllajën e Kolonjës si i tillë ai duhet kërkuar pranë qendrës së sotme të krahinës Ersekës. Nga dy vendbanime prej të cilave kemi dëshmi të sigurta të vazhdimësisë së jetës në mesjetë të cilat janë Barmashi dhe Gradeci i Bejkovës (4-5 km në veri të Ersekës) ky i fundit i plotëson më mirë kushtet. Ai ze një pozitë qendrore e dominuese në krejt pllajën e Kolonjës, ka një orientim të mirë dhe terren të përshtatshëm për shtrirjen e një qyteti mesjetar.

DO NOT COPY

12) Cedrenus tek K. Bozhari – F. Liço. **Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë,** Tiranë 1975, fq. 36.
13) Po aty, fq. 36.
14) Zonarae, **Burime tregimtare,** fq. 137
15) Cedrenus **Burime tregimtare,** fq. 36
16) Pachymeris, **Burime tregimtare,** fq. 196.
17) Cantakuzenus, **Burime tregimtare,** fq. 219.

Gjerak KARAISKAJ – Skënder ALIU

DO NOT COPY

CITES FORTIFIEES SUR LE PLATEAU DE KOLONJË ET DANS LA PARTIE SUPERIEURE DE LA VALLEE D'OSUM

RESUME

Le Plateau de Kolonjë, bien qu'entouré de montagnes et de collines, n'est pas isolé des territoires voisins. La vallée d'Osum a servi d'artère, où passait la route, reliant la côte avec la Macédoine, passant à travers le Plateau de Kolonjë et le Col de Kazan. Une autre route naturelle partait de la vallée de Vjosë, suivait la vallée de Langaricë, traversait les coles de Barmash et à travers le Col de Qarri s'enforçait dans le region de Korçë.

Les conditions naturelles, le croisement des routes et plus tard la position stratégique et bien protégé que tenait cette région dans le territoire illyrien, ont conditionné non seulement la naissance de la vie à la période du néolithique moyen, IVe-IIIe millénaire av. n. ère, mais également l'édification de tout un système de fortifications, situées autour du Plateau de Kolonjë et de la vallée supérieure d'Osum, et qui sont l'objet de cette étude. Les premières sont la forteresse de Hollm, le Gradec de Bejkovë, la forteresse au Sud-Est du village de Bejkovë, la forteresse de Borovë, Gradishtë de Barmash, Gradec de Vrepckë ainsi que la forteresse de Leshnjë (Kolonjë). Tandis que les cités fortifiées qui se trouvent près du cours supérieur d'Osum sont le château de Luaras, celle de Boshanj et celle de Leshnjë (Vithkuq). De ceux-ci, dans cet article, on va examiner la forteresse de Hollm, qui a déjà été l'objet d'une autre étude, et la forteresse de Leshnjë (Kolonjë).

La forteresse de Bejkovë se situe sur l'un des sommets de la chaïne de collines s'élevant au Sud-Ouest du village de Bejkovë. La colline a une hauteur de 108L m au dessus du niveau de la mer et de 120 m à partir de son pied. Les murs de protection entourent le sommet de la colline et son flanc sud (fig. 2, 3). Les murs du flanc descendent jusqu'au bord d'un précipice, au fond duquel coule le torrent de Virkë (fig. 5). Les murs, d'une épaisseur de 2,40-2,80 m, sont construits en pierres sèches non taillées. A l'intérieur de la fortification ainsi qu'à l'extérieur on relève des traces d'habitations construites selon la même technique que celle des murs d'enceinte. Les restes de céramique qu'on a découverts en surface appartiennent à l'époque du bronze allant jusqu'à la période basse du fer. La fortification a été probablement construite au cours des XIe-Xe siècles av. n. ère.

La forteresse de Gradec dans le village de Bejkov ce situe sur une haute colline au Nord-Est du château d Bejkovë (fig. 7). Il a une position centrale et domine le Platea de Kolonjë et possède un terrain convenant à un centre ha bité.

La partie supérieure de la colline est entourée d'un mu datant de la haute antiquité, à l'intérrieur duquel se conse vent les traces d'une tour solitaire rectangulaire (fig. 8). Su le versant sud de la colline, on s'aperçoit des traces d'u autre mur, préhistorique, qui entourait une superficie beau coup plus grande que celle de la fortification de la haute ant quité. D'un sondage fait près du mur d'enceinte supérieur il été prouvé que ce centre habité avait eu une vie longue, com mençant à la période basse du fer et allant jusqu'au milieu d moyen-âge. On a constaté de même que sur le mur de la haut antiquité à une période ultérieure il avait été construit un autr mur en pierres liées de mortier de boue, qui apartenait a moyen-âge.

Gradishtë de Barmash se trouve sur une colline d'une hau teur a 1158 m à partir du niveau de la mer, au dessus du vi lage de Barmash, au bord de la route qui mène d Ersekë Leskovik (fig. 9). La forteresse occupe une position d'impo tance stratégique en dominant la vallée de Langancë, l'uniqu voie naturelle qui relie le plateau de Kolonjë à Leskovik et Përmet.

Un mur de 1,80 m d'épaisseur (fig. 10), construit de pie res sèches non taillées, entourait le sommet de la colline, un partie de son flanc Est, ainsi qu'un terrain plus au moins pl au col qui lie la colline de Gradishtë avec la chaine de colline dans la direction nord. La cité fortifiée de Barmash est divisé en trois parties par des murs de cette nature (fig. 11). La parti supérieure de la colline a été fortifiée de nouveau à l'époqu de la haute antiquité de murs en pierres liées de mortier, les quels entourent une superficie moins grande que l'enceinte d la période précédente. Dans cette partie de la fortification o s'aperçoit des restes d'habitations et de céramiques de l haute antiquité. Des tombes de cette période (IVe siècle de è ère), couvertes de grandes tuiles solens, ont été découverte aussi au pied de la colline, au village actuel de Barmash Après un sondage archéologique on a découvert aussi de

DO NOT COPY

fragments de terrines médiévales ainsi qu'une pièce de monnaie de Léon VI.

La forteresse de Gradec au village de Vrepckë se trouve à l'ouest du village sur une colline, dont les versants rocheux tombent à pic sur ses trois côtés (fig. 13). Seulement le côté Est de la colline, là où celle-ci se lie au moyen d'un col élevé avec la chaîne des collines voisines, s'étendant dans le sens nord-sud, et ayant une largeur de 80 m, est moins abrupt. Le terrain plat qui se trouve à ce col a une largeur de 40 m. Il a été fortifié d'un mur en pierres sèches non taillées, dont il ne reste que peu de traces. Un mur d'enceinte se trouve au sommet de la colline, entourant une surface de 45 x 22 m (fig. 14), (fig. 17). Dans la haute antiquité, ce centre habité était protégé par un mur de pierres, liées avec du mortier, de 113 m de long. Le mur se trouve à la mi-hauteur de la colline sur le côté sud et unit deux parties rocheuses. La cité est en terrasses avec des murs de soutènement de 1.5-3 m de large et 2-3 m de haut, datant de la première phase de construction et faits de pierres sèches (fig. 15). Les terrasses se lient entre elles au moyen de rampes escarpées. D'un sondage fait à l'enceinte supérieure, il est ressorti que celle-ci date approximativement de la fin des IVe-IIIe siècles avant notre ère. La vie y avait continuée même au cours de la période de l'occupation romaine, jusqu'au IVe siècle de notre ère.

La forteresse de Borove se situe sur la gauche de la route automobile menant d'Ersekë à Leskovik, à proximité du village de Borove. Les ruines de la cité se trouvent sur une basse colline, au bord de la route (fig. 18). Les murs protecteurs sont très endommagés. On poursuit leur traces avec beaucoup de difficultés et seulement en partie. Les ruines de quelques habitations à une pièce sont mieux conservées. Le mur d'enceinte, aussi bien que les murs des habitations sont faits de pierres seches cassées non taillées (fig. 19). A gauche de la colline se conservent encore les traces d'une construction aux murs liés avec du mortier, appartenant peut-être, à la haute antiquité La céramique de surface date de la première période du fer et de celle hellénistique. Près de la cité, on a découvert un cimetière des IVe-IIe siècles avant notre ère.

La forteresse de Luaras se trouve environ à 3 km à l'Est du village de Luaras, près de la vallée d'Osum. La colline de forteresse est la seule colline rocheuse de cette zone, et les indigènes la connaissent sous le nom de la Grosse Pierre («Guri i Madh»). La face sud de la colline tombe à pic d'une hauteur dhe 50 m (fig. 20). La place au pied du rocher a été trouvée convenable pour le développement d'une cité du moyen néolitique. La colline protégeait la cité des vents du Nord. Les habitations donnaient ainsi vers le Sud-Est. A l'époque du bronze moyen au haut, la cité a été entourée de murs en pierres sèches naturelles de 2,5 m de large (fig. 21-22). Les extrémités du mur s'appuient au pied de la colline. Un mur antérieur protégeait une superficie plus petite au pied de la colline. Au sommet de la colline, il y a encore des ruines d'une fortification datant de la haut antiquité avec une tour ronde. Les objes en céramiques découverts témoignent que le sommet de cette colline était habité même au cours de la période basse du fer. Sur la partie Est de la colline se trouve un tumulus. De même, a proximité de la cité sont désignés sept autres tumulus.

La forteresse de Boshanj se situe, sur la droite de la route automobile menant de Korçe à Erseke, sur une haute colline rocheuse, à l'ouest du village de Boshanj.

Les murs protecteurs d'une largeur de 2 m, étant conservés à une hauteur moyenne de 1,5 m, entourent une surface en forme de triangle d'un périmètre de 420 m (fig. 26). A la plus haute partie de la colline, là où au moyen d'un col elle se lie aux collines voisines s'élève une tour ronde jointe aux murs (fig. 27). Les murs sont faits de pierres sèches cassées. Par certaines particularités de la technique de construction et par la présence de la tour, la fortification en question doit appartenir aux IIIe-IIe siècles avant notre ère.

La forteresse de Leshnje se situé sur une colline rocheuse au dessus de la vallée d'Osum, au nord-est du village de Leshnjë (District de Korçë). La colline sur laquelle est construite la forteresse a une crête rocheuse, qui ne pourrait convenir à une cité ancienne, mais plutôt à un refuge au cas de danger. C'est ce qui explique le marque d'objets en céramique dans ce territoire, ainsi que l'existence d'un centre habité ouvert, à proximité de la fortification, qui a existé depuis la première période du fer jusqu'au IIe siècle avant notre ère. Les murs d'enceinte du château, qui protégeaient le dos de la colline, incluent un territoire long de 150 m et large de 20-30 m (fig. 29). Ils sont mieux conservés sur le côté sud-ouest, où l'on remarque aussi les contours d'une tour rectangle, unique dans cette fortification.

Les murs sont en blocs de pierre, ayant jusqu'à 1,5 m de long et 0,50-0,70 m de haut. A première vue ces murs donnent l'impression d'une fortification de la première période du fer. Mais, si on les examine attentivement, on s'aperçoit de signes de ratinement. Les jointures aux coins des murs, les lignes droites, l'existence de la tour etc. font dater le château des IVe-IIIe siècèles avant notre ère.

De l'examen du matériel il ressort que les constructions de fortification du plateau de Kolonjë et du haut cours d'Osum, relèvent d'une zone géographique et éthnographique aux limites naturelles nettes, où habitait, dans les temps anciens, une des branches de la tribut des Dasart. Les cités fortifiées du plateau de Kolonjë, entourent celle-ci en forme de couronné par le Nord, l'Est et le Sud, et contrôlent ainsi les routes qui relient ce plateau a la region de Korçë (Holln), et de même la route qui passait par le Col Barmash, pour aller vers Leskovik et Përmet. Ces centres habités possédaient un terrain convenable à l'agriculture et à l'élevage. Les centres fortifiés se situant le long du cours supérieur d'Osum, (Luaras, Boshanj, Leshnjë), représentent plutôt une zone d'élevage.

Typologiquement, les constructions de défense se lient avec les fortification illyriennes, et de façon particulière avec

DOWNCOPY

celles de region de Korçë, tout en ayant une série de particularités, par rapport aux fortifications de la Grèce archaïque et classique. Mais, appartenant à une zone ethnographique quelque peu à part, ces fortifications présentent des traits locaux particuliers. La forteresse de Luaras constitue un type particulier pour la période préhistorique, tandis que la forteresse de Vrepckë pour l'antiquité.

La forteresse de Luaras diffère des autres fortifications par sa formulation planimétrique et sa technique de construction. Il s'étend sur un terrain plat au pied d'une colline rocheuse et non au sommet de cette dernière. D'autre part les pierres, utilisées pour la construction des murs, sont tout à fait naturelles, sans être cassées et sans faces plates. Ces particularités nous mènent à penser que cette fortification de plaine date d'une période antérieure (bronze moyen, haut bronze), et qu'elle a dû être construite à une époque, où les cités fortifiées étaient encore rares, où le traitement de la pierre coûtait cher, en raison du manque d'outiles de travail, où une fortification de ce type suffirait à affronter l'attaque ennemie secondée des moyens de guerre de ce temps-là. C'est pour ces raison-là qu'on n'a pas cru nécessaire de sacrifier une cité commode pour une défense plus puissante. Mais la colline qui s'élevait à côté de cette cité allait servir aux habitants de la période basse du fer, lesquels avaient besoin d'une sécurité plus grande, dans les nouvelles conditions de l'époque.

Les autres fortifications préhistoriques de cette région, lesquelles apartiennent à la fin de l'âge du bronze et au début de l'âge du fer, présentent des formes planimétriques caractéristiques aux fortifications illyriennes de cette époque, qu'on relève aussi dans la region de Korçë. De la forme la plus simple, où le mur d'enceinte enture le sommet d'une colline (Hollm, Gradec de Bejkove), on passe aux fortifications à double enceinte (le premier mur d'enceinte entoure le sommet de la colline, tandis que le second ses versants), comme c'est le cas la forteresse au sud du village de Bejkove, dont la formulation planimétrique ressemble à celle de forteresse de Bellovode et de Podgorice, dans la région de Korçë. Gradishtë de Barmash, enfin se présente divisé en trois parties: la partie la plus fortifiée est l'enceinte du sommet de la colline, la seconde enceinte inclue son versans Sud, et la troisième la partie supérieure de la colline voisine. Le territoire inclu dans la seconde enceinte se subdivise en deux parties, selon les qualités défensives du terrain. En tant que tel, Barmash fait partie des fortifications à plusieurs murs d'enceinte, comme le château de Trajan et la Cité de Karos.

Parmi les cités fortifiées de la période citadine illyrienne, le château de Gradec à Vrepckë constitue un type particulier. De telles cités en terrasses, aux nombreux murs de soutènement, et des rampes qui les relient entre eux, sont rares dans le monde antique. On les rencontre dans des territoires loin de notre pays, comme dans la presqu'île Ibérique. Mais nous avons un cas qui précède ce type, dans une région aux confins de Kolonjë: la forteresse de De dejan, fortification de la fin de l'âge du bronze, construite sur certaines terraces aux mu de souténement.

Différemment aux cités fortifiées de la Grèce, où le mu d'enceinte, même durant l'antiquité classique et plus tard, inte grait et renforçait la défense naturelle même lorsqu'il éta extérieur, à Vrepckë ce mur inclue toute la cité en terrasses, e son emplacement est au pied de la colline. Si l'on suivait l premier principe, la cité se suffirait de l'enceinte de l'acropol ou bien le mur d'enceinte extérieur passerait à l'emplacemer de celui de la haute antiquité. La technique de constructio constitue une autre particularité des fortifications de la péric de citadine illyrienne dans le plateau de Kolonjë. Elle poursu la tradition des fortifications préhistoriques. Ceci est très bie témoigné par Gradec de Vrepckë et par un série d'autre fortifications comme la forteresse de Boshanj, Leshnjë (régio de Korçë) etc. L'évolution des constructions de défense, de l préhistoire à l'antiquité, ne peut être ressentie à travers l'amé lioration de la technique de construction des murs, mais dan quelque cas à travers le développement du système de forti fication (Vrepckë) et de l'usage de tours dans d'autres ca (Boshanj, Leshnjë). Partant de cette particularité locale de l technique de construction, qui dans une large mesure caracté rise aussi la region de Korçë, on ne doit pas penser a manque de fortifications antiques, ni de cités dans cette zone mais celles-ci ne doivent pas être nécessairement liées à l constructions de murs d'enceinte en pierres taillées.

Dans la haute antiquité, les cités anciennes, comme Lua ras, Barmash, Vrepckë, Gradec de Bejkovë, Hollm etc. ont été fortifiées de nouveau. La fortification la plus typique est celle qui, dans la plupart des cas, entoure le contour irrégulier du sommet d'une colline d'un mur sans briques. A l'endroit qu domine le terrain, s'élève une tour d'observation, rectangulaire ou ronde. On trouve un tel type de fortification même aux li mites Nords de la region de Korçë, dans la forteresse de Bllace. Dans certains cas, comme à Vrepckë, la fortification est plus simple. Un mur bloque la partie dépourvue de défense naturelle d'une colline. Et finalement, parmi ces fortifications à Hollm, on trouve un vrai forteresse de garnison, de forme géométrique régulière, aux petites dimensions, avec une tou pour la défense de l'entrée et une citerne à l'intérieur.

Le plateau de Kolonje a connu une vie intensive même au cours du Moyn-Age. Les sources documentaires du XIe siècle mentionnent le Thème de Kolonjë et, en même temps, la ville de Kolonjë, où, au début du XIIe siècèle, au cours des guerres entre normands et byzance, l'empereur Alex Comnène avait établi son campement. A la fin du XIIe siècle est mentionnée la province de Kolonjë, laquelle en 1259 est occupée par l'empire byzantin de Nika. En 1328, Andronic II Paléologue conquiert aussi la région de Kolonjë. Des données ci-dessus il ressort clairement qu'au Moyen-Age, il existe une ville portant le nom de Kolonjë, ainsi qu'une région qui a emprunté son nom à cette ville, de même pour Devoll (Deabolis), Drinopol etc. A cette époque-là, pendant un certain temps, la région de

Kolonjë a été sous la domination de l'Etat bulgare. Cette domination a eu un caractère administratif et non ethnique. Des ilôts de population albanaise sont nettement déterminées et conservés depuis le Moyen-Age, dans les micro-toponymes du pays. Tel le micro-toponyme de «Village des Bulgares», désignant un lieu sans traces de ruines au pied de la colline de la forteresse, au Sud-Ouest du village de Bejkove. D'autre part la découverte d'une pièce de monnaie de Léon VI (886-912) à Barmash témoigne que cette région continuait à entretenir des liens avec Byzance même au cours des IXe et Xe siècles.

De Kolonjë, il ne reste plus aujourd'hui que le nom de la région, mais pas celui de la ville, qui a bien pu être abandonné longtemps avant. Cette ville devait occuper une position dominante et centrale dans tout le plateau de Kolonjë. En tant que telle, elle doit être cherchée près du centre actuel d'Ersekë. Des deux cités, dont on a des témoignages certains sur la continuité de la vie, durant le Moyen-Age, et notamment de Barmash et de Gradec de Bejkove (à 4-5 km au Nord d'Ersekë), ce dernier remplit mieux les conditions requises. Il occupe une position centrale et domine tout le plateau de Kolonjë, il est bien orienté et possède un terrain convenant à l'étendue d'une ville médiévale.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

KISHAT E SHQIPËRISË SË MESME E TË VERIUT
(Vijim)

Kisha e Manastirit të Shën Ndout në Kepin e Rodonit.

Në Kepin e Rodonit të njohur me emrin Muzhli i Skënderbeut, në një qafë të ulët në mes dy kodrave pranë bregut të detit në pjesën veriore të tij ruhen rrënojat e kishës së Shnandout. Pranë saj dikur ishin rrënojat e një manastiri, sot të mbuluara, të cilin na e kumton Ipen[1]. Të dhënat historike për monumentet e kultit të Rodonit i kemi fillimisht për shën Anastasinë «banorët e Shën Anastasisë» që përmendet në dokumenta të viteve 1324 dhe 1325[2]. Së dyti përmendet Shën Kolli i Rodonit, si manastir në një akt trashëgimie[3]. Së treti, Shën Mëria si Manastir, që ndodhet jo pranë bregut, një kishë e bukur e zbukuruar mirë pa mure mbrojtëse dhe që kishte një shtëpi pranë[4]. Nga të gjithë autorët veç këtyre tre kishave numërohet në Rodon dhe Manastiri i Shnandout si e katërta kishë e tij, megjithëse për të mungojnë të dhënat burimore. Kjo kishë ishte ndër kuvendet më të vjetra françeskane, që ju dha misionit në vitin 1599[5] dhe që njihej me emrin e Shën Mërisë, por që në të festohet Shën Antoni. Për të thuhet gjithashtu se e ndërtoi e motra e Skënderbeut për murgeshat e Shën Kiarës dhe u shkatërrua në mezin e shek. XIX nga tërmeti.[6] Nga të dhënat e mësipërme si dhe për faktin që kisha e Shnandout nuk takohet ndër dokumenta dhe se aty nuk njihen gjurmë kishash të tjera veçse për tre, ne do të ishim të prirur të identifikojmë kishën e Shnandout me manastirin e vjetër të Shën Mërisë. Përsa i përket të dhënës që manastiri në fjalë ishte jo pranë detit, ne mendojmë se kjo e dhënë mund të justifikohej po të mendonim se marinarët që përmend

1) Th. Ippen, **Denkmäler vershiedener alterstuffen in Albanien,** W.M.B.H.,X.X-1907, 34, fig. 57.

2) A. Ducellier, **Gjendja e Kepit të Rodonit në fillim të shek. XV sipas disa dokumentave Raguziane,** Studime Historike, 1, 1977, 123 dhe **A. Alb,** 1, 694 1324, **A. Alb:** II, 317. (137).

3) **A. Alb,** II, 615, Rrënojat e tij ndodhen jo larg nga vendi i quajtur kodra e Lulit: H. Myrto, **Hartë e monumenteve dhe e gjurmëve antike dhe mesjetare të Rrethit të Durrësit,** Monumentet 2(22) 1981, 61.

4) Kjo kishë përmendet së pari nga K. Jireček, **Die Lage und Vergangenheit der Stadt Durazzo in Albanien,** «Illyrische-Albaniche. Forchungen», München-Leipzig, 1916, 154. Ducellier, **Vep. cit,** 124-125. Për këtë mendohet të jetë në vendin e quajtur kodra e Kepit. H. Myrto. **Vep.cit.** 61.

5) D. Fabianich **Storia dei frati Minori dai primordi della loro istituzione in Dalmazia e Bossiana fino ai giorni nostri,** Zara 1863, I, 314. Si të tillë e përmend edhe M. Skura, **Relacione** 3/II, 317.

6) Th. Ippen, **Vep.cit.** 37.

e dhëna e vitit 1418, mund të kenë ardhur aty nga një rrugë e çfardoshme.

Kisha që ruhet me mure të rënuara në tërë lartësinë e tyre, paraqet një vëllim paralelpipedi me planimetri drejtkëndëshe dhe përbëhet nga narteksi, naosi dhe ambienti i altarit[7]. Si në brendësi të kishës ashtu edhe në anën e jashtme të saj rrënojat e mureve mbulohen nga një shtresë e konsiderueshme dherash dhe mbeturinash ndërtimi që arrijnë deri në nivelin e dritareve të absidës.

Narteksi është këndrejtë në plan, me brinjë më të gjatë atë veri-jug. Dy hapësira mbuluar me hark të mprehtë janë në anët veriore e jugore, nga të cilat ajo nga veriu është murosur në një kohë të vonë duke krijuar një hapje më të vogël mbuluar me arkitra guri. Përsa i përket hyrjes në anën perëndimore, duke qenë ky mur i rënuar në pjesën qendrore nuk mund të gjykojmë për formën e saj të dikurshme. Në brendësi të narteksit në muret verior dhe jugor ka harqe të mprehta të verbër, të cilët mbështeten jo në pilastra por me gurë të nxjerrë ndaj njeri tjetrit. Të katër muret e narteksit vijojnë në lartësi pa gjurmë të mbulesës. Ipen na thotë që në këtë vend kemi një kullë të manastirit dhe se narteksi është pjesë e ndërtimeve të manastirit d.m.th. muret e tij vazhdojnë[8]. Sot ne mundëm të dallojmë vetëm një vazhdim të tillë në qoshen jugperëndimore, ku kemi një shpatull porte të njëkohëshëm me murin jugor të kishës.

Nga narteksi hyhet në naos nëpërmjet një porte me shpatulla dhe arkitra guri të gdhendur. Në arkitra gjejmë të gdhendur një kryq dhe nën të gërmat I.H.S. Duket mjaft qartë se aty fillimisht ka patur një hyrje të gjërë e të lartë mbuluar me hark të mprehtë e cila muroset më vonë duke lënë portën e mësipërme. Në takimin e dy mureve duket suvaja e pikturuar që mveshte shpatullat e hyrjes fillestare.

Një hark i mprehtë tërthor ndan naosin nga ambienti i altarit. Ai është ndërtuar me tulla që këmbehen me gurë çmërsi. Ndërsa naosi ka qenë mbuluar me çati druri, ambienti i altarit ruan pjesërisht mbulesën me qemer me formuese lindje-perëndim. Qemeri është ndërtuar me tulla të trasha të vendosura sipas rrezeve. Ai duket që është ndërtuar mbi kallëp druri, duke vendosur në vendin e mbetur bosh të kyçit gurë çmërsi në formë pyke në rolin e shtërnguesit.

Në muret veriorë e jugorë të kishës kalojnë mb pilastra harqe të verbër me profil të mprehtë. Në n ket e formuara në këtë mënyrë në brendësi të naos kemi dy dritare për ndriçim. Dritaret sot janë të dëm tuara por dikur kanë qenë dyshe, me kolonë tullas në mes. Deri vonë ruhej e plotë ajo në lindje të mu rit verior.[9] Një dritare e vogël drejtëkëndëshe mbu luar me arkitra guri ndodhet e murosur në pjesën sipërme të murit që ndan naosin nga narteksi.

Në murin lindor ndodhet absida gjysëm rre thore, në brendësi dhe në anën e jashtme. Ajo dh pjesa jugore e murit pranë janë të rrënuara. Kësht ruhen vetëm dy nga tre dritaret e dikurshme të absi dës, të ngushta dhe të ulta, që mbulohen me har tullash. Me interes është edhe mbulesa prej çere sfere e konkës së absidës, ndërtuar me tulla të ven dosura sipas paraleleve. Mbi muraturë shihen d shtresa pikture murale.

Në anën e jashtme kisha karakterizohet ng harqet e mprehtë mbi pilastra që kalojnë përgjat mureve verior e jugor. Të tilla janë tre që i takoja naosit dhe narteksit, si dhe një tjetër jo i plot ambientit të altarit. Në këtë të fundit sot muret jan më të trashë si rezultat i një muri mbushës ndërmje pilastrave. Kjo dallohet si në pjesën e rrënuar në tokë të anës jugore ashtu edhe në anën veriore k muri ruhet tërësisht.[10]

Në anën jugore ruhen të plota pilastri nga perë ndimi që siç pamë vijonte në drejtim të jugut dhe pi lastri pranë tij. Pilastri i tretë është i dëmtuar, po lexohet mjaftë kjartë. Mbi pilastrat ngrihen harqet mprehtë, nga të cilët ai i narteksit është në nivel më të lartë. Harqet janë të ndërtuar me gurë çmërsi që këmbehen me tulla dhe rrethohen me një shirit tullash. Fusha brenda tyre është një nike, e futur nda sipërfaqes së murit. Në narteks kemi një hyrje mbuluar me hark të mprehtë, ndërsa në dy niket e naosi nga një dritare mbuluar me hark, që përsa gjykohet nga gjurmët e mbetura duhet të kenë qenë e dyfishtë. Muratura e kësaj pjese të poshtme ku ndodhen niket dhe pilastrat në harqe është me gurë shtufi e lidhur me llaç gëlqereje me rërë të ashpër. Në fugat ashtu dhe ndërmjet rradhëve kemi copra tullash e tjegullash. Mbi nivelin e mbarimit të harqeve ngrihen dy rradhë ndërtuar me teknikën e klusonazhit prej gurësh çmërsi të skuadruar dhe tullash të mëdha e

7) P. Thomo, **Kalaja e Sknëderbeut në Kepin e Rodonit,** «Studime historike», 4. 1967, 113-139.
8) Th. Ippen, **Vep. cit** 52 (Kulla) Fig. 58. (plani).
9) P. Thomo, **Vep. cit,** foto 2.12.
10) **Po aty,** foto 2.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

të trasha. Mbi këtë radhë kemi muraturë me gurë shtufi, e cila nga materialet e përdorura, mënyra e ndërtimit dhe fuga e kontrollit tregon se është një shtesë më e vonë. Kjo gjë dallohet dhe në murin verior dhe aty mbi rrjeshtin e sipërm të klusonazhit i vetmi i plotë, ndërsa i poshtmi është pjesë ndërmjet harqeve. Nga fotografia e botuar prej T. Ipenit shohim se si në narteks ashtu edhe mbi kishë ka patur një shtesë të vonë prej të cilës ruheshin muret dhe një dritare.

Për të shpjeguar ndryshimet dhe shtesat që i janë bërë në kohë pjesës së sipërme të kishës na ndihmoi vrojtimi i pjesës së mbetur pa u rrënuar në murin lindor. Në pjesën mbi absidë, në nivelin që i takon në brendësi qemerit që mbulon ambientin e altarit kalojnë sipas profilit të qemerit dy shirita tullash të trasha që vizitojnë në këtë mënyrë një hark të mprehtë. Fusha nën të është ndërtuar me tulla ndërsa mbi të duket qartë një fugë e pjerrët që ndan këtë pjesë të vjetër nga shtesat më të vona të ndërtuara me gurë shtufi. Çatia e vjetër rezultonte në këtë mënyrë mjaft pjerrët dhe me sa duket ishte ngritur më vonë disa herë. Gjurmë jo të qarta të këtyre ndryshimeve duken dhe mbi harkun që ndan naosin nga ambienti i altarit. Në këtë mënyrë kisha rezulton e mbuluar me çati dy ujse mbi strukturë druri mbi naos dhe mbi qemer në zonën e ambientit të altarit. Në muret e reja të shtesës të sipërpërmendur shihen dhe sot gjurmë të vendosjes së trarëve të çatisë.

Pa gërmimet në brendësi të kishës dhe jashtë mureve të saje nuk mund të flitet për organizimin e brendësisë dhe për hollësira të tilla si format dhe madhësitë e dyerve apo vendin dhe murin e altarëve[11]. Gjithashtu gërmimet do të na sqarojnë më mirë dhe për lidhjen e kishës me manastirin që me sa duket bëhej në pjesën e narteksit.

Përsa i përket datimit të kishës Ipen mendon se ajo është ndërtuar në mezin e shek. XV[12]. P. Thomo megjithëse nuk shprehet prerazi për këtë e mendon kishën si ndërtim të kohës së Skënderbeut duke e lidhur me gojdhanat e përmendura më lart.[13] Dyselie mendon se manastiret e Rodonit duhet të jenë të shekujve XIV-XV[14]. Duke qenë të prirur të identifikojmë kishën e Shën Ndout me atë të manastirit të Shën Mërisë, që përmendet së pari në vitin 1418, mendojmë se kemi të bëjmë me një ndërtesë të shek. XIV.

Në pikpamje të arkitekturës, monumenti paraqet vlera si një ndërtesë që i takon arkitekturës romaniko-gotike që dëshmohet nga ndërtimi planimetrik e vëllimor dhe prania e pilastrave në mure, së bashku me strukturën me harqe të mprehta. Me mjaft interes është përdorimi i teknikës së klusonazhit, si një brez dekorativ që flet për lidhjen me ndërtimet bizantine të Durrësit dhe zonave përreth dhe për rrënjët e kësaj teknike në traditën ndërtimore të mjeshtrave ndërtues vendas. Një brez i tillë dekorativ haset edhe në muret e kalasë ndërtuar në mezin e shek. XV nga Skënderbeu.[15]

Kisha e Shën e Premtes në Çetë të Kavajës

Përmendjen më të vjetër të kësaj kishe në dokumentacionin historik e kemi në vitin 1691 në një akt të kryepeshkopatës të Ohrit ku flitet për këtë kishë.[16] Ajo njihet deri më sot për ikonostasin me ikona, vepër e piktorit Kostandin Shpataraku i cili i ka pikturuar në vitin 1767.

Kisha ndodhet në një kodër në lindje të qytetit të Kavajës në fshatin Çetë. Ajo përbëhet nga narteksi, naosi dhe ambienti i altarit. Në pikpamje të ndërtimit volumor kisha përbëhet prej dy vëllimesh paralelopipedike mbuluar me çati dyujse. Pjesa kryesore dhe më e madhe i takon narteksit dhe naosit, ndërsa vëllimi më i vogël absidës. Kisha është monumenti i vetëm që ruhet plotësisht në vendin tonë nga ndërtimet romaniko-gotike si dhe ndërtesa më në jug të vendit nga ky drejtim arkitektonik.

Kisha ka sot katër dyer. Hyrja kryesore për në kishë duket se ka qenë ajo nga perëndimi, e cila është zvogëluar nëpërmjet murosjes. Një hyrje tjetër e vjetër është në anën jugore. Ajo ka shpatullat dhe arkitraun prej mermeri të profiluar të marra me sa duket prej ndërtesash antike, mbase të Durrësit. Për të lehtësuar arkitraun, mjeshtrat ndërtues kanë vendosur mbi të një hark shkarkues të ulët. Po me hark është pjesa e brendshme e mbulesës së portës. Një portë tjetër ndodhet në perëndim të kësaj. Ajo është hapur më vonë çka kuptohet nga murosja e re e shpatullave dhe linja e harkut që e mbulon, me mu-

11) Th. Ippen, **vep.cit,** jep në planimeri tre altarë, një përpara absidës dhe dy të tjera në muret verior e jugor.
12) **Po aty, 37.**
13) P. Thomo; **Vep.cit,** 113-114.
14) A. Ducellier, **Vep.cit,** 125. . .
15) P. Thomo, **Vep.cit,** 115-117.
16) H. Gelzor, **Der Patriarchat von Achrida Geschichte und Urkunden,** Leipzig, 1902 47-48.

rin mbi të, i cili është murosja e njërës dritare. Porta e katërt është në anën verilindore të kishës. Ajo mbulohet me hark dhe ka shpatullat të pjerrura ndaj anës së jashtme. Kjo portë shërbente për të lidhur kishën me një ambient sot të rrënuar.

Nga porta perëndimore sot hyhet në narteksin dy katësh me strukturë druri në formë tribune. Në katin e dytë hipet me një shkallë druri të pjerrët me qoshen veriperëndimore. Për nga mënyra e ndërtimit dhe formulimin arkitektonik kuptohet që narteksi është një shtesë e vonë brenda vëllimit të dikurshëm të naosit. Një dritare është hapur më vonë. Dyshemeja e narteksit që vijon deri në një pjesë të naosit është shtruar me tulla. Kati i dytë i narteksit ndriçohet nga një dritare dyshe në murin perëndimor.

Naosi ndahet nga ambienti i altarit nëpërmjet ikonostasit prej druri. Dyshemeja e tij është me pllaka të skuadruara guri gëlqeror dhe ka në pjesën qendrore një rozetë po me pllaka guri. Naosi si dhe narteksi janë me tavan të suvatuar mbi rrjetë kallamash.

Në pjesën e poshtme të murit verior ka dy nike mbuluar me hark të ulët, ndërsa në anën jugore janë dy dritaret e vetme që ndriçonin naosin. Nga ato ajo më nga perëndimi është murosur tërësisht kur është hapur porta nën të, ndërsa dritarja tjetër është zvogëluar së tepërmi nëpërmjet murosjes. Në formën e tyre të vjetër dritaret janë të gjëra e të larta, mbuluar në anën e jashtme me arkitra të rrafshët prej gurësh të skuadruar. Në anën e brendshme dritarja është mbuluar me hark. Me gurë çmërsi janë edhe shpatullat e dritareve. Ato janë të pjerrëta nga të dyja anët sipas karakteristikave të dritareve gotike.

Nga naosi me një këmbë shkallë hipet në ambientin e altarit të formuar nga vëllimi mbrapa ikonostasit dhe vëllimi i absidës drejtëkëndëshe. Aty ku fillon absida është tryeza e altarit[17] ndërtuar me gurë të lidhur me llaç. Si diakonikon shërben një kamare në anën jugore të absidës. Në anën veriore, kur kisha është kthyer për ritin ortodoks në fundin e shek. XVII si protezis është ndërtuar një bllok murature me një nike.

Absida është mbuluar me qemer cilindrik me prerje harku të mprehtë me formuese lindje perëndim. Harku në dukje i këtij qemeri është lënë pa suvatuar dhe është me gurë të skuadruar. Absida ndriçohet nga një dritare e ngushtë me shpatulla të pjerrta dhe mbuluar me hark të mprehtë.

Muret anësorë të kishës janë ndërtuar me gurë shtufi të vendosur me rradhë me tendencë horizontaliteti duke patur mjaft rrallë copra tullash apo tjegullash. Këto të fundit janë vendosur për gjatë fugave, njëra mbi tjetrën dhe në ndonjë rast klliç. Muret janë relativisht të trashë (1.20 m) dhe përforcohen me një sërë pilastrash karakteristike për arkitekturën romaniko-gotike, por me sa duket të pa nevojshme për këtë kishë të mbuluar me çati druri.[18]

Muri perëndimor i kishës, që për nga trajtim duhet konsideruar pamja kryesore e kishës, ka katë pilastra që e ndajnë atë në tre zona. Dy pilastra e mezit të vendosur më afër njëri tjetrit lidhen me një hark, ndërtuar me gurë të skuadruar që nënvi zon hyrjen kryesore për në kishë. Kjo portë e mbu luar me hark të mprehtë në një kohë të dytë isht zvogëluar nëpërmjet murosjes. Ndërmjet këtyre d pilastrave në pjesën e sipërme ndodhet dritarja dy she e mbuluar me hark të ulët që ndriçon narteksin Shpatullat e saja janë të pjerrta ndërsa dhe ka n mes një kolonë guri. Muri perëndimor në pjesën sipërme përfundon me fronton dhe nuk ruan gjurm kornize.

Muri jugor ndahet nga 5 pilastra në katër pje së. Pilastrat janë të ndërtuara me gurë të skuadruar çmërsi si për lehtësi ndërtimi, sepse gdhenden m lehtësi, ashtu dhe për efekt dekorativ, për tu dallua në tërësinë e njëtrajtëshme të murit. Pjesa e sipërm e këtij muri në një lartësi prej 30 cm është rindërtua me gurë e tulla dhe ka vende-vende në dukje nj pjesë të trarëve të çatisë që mbështeten në të. Mur sot përfundon me një kornizë rasash të holla guri.

Muri verior i kishës dallohet në disa aspekte ngo jugori. Ai ka vetëm dy pilastra njërin në këndin veri perëndimor dhe tjetrin në mes gjatësisë së murit. Në anën më nga lindja të këtij muri ka qenë një ambien nga i cili sot ruhen pjesët e poshtme të mureve që lidheshin me këtë mur të kishës. Ky ambient ka qenë rënuar dhe rindërtuar. Për këtë tregojnë themelet reja më të ngushta, pranë atyre të vjetra. Ambient lidhej me anën e portës që përmendëm e cila hape në anën e brendshme.

Në anën lindore të kishës pilastrat e qosheve janë më të gjëra dhe shkojnë deri në fillimet e absidës. Absida është drejtëkëndëshe në plan dhe mbulohet me çati dy ujse. Muret veriore dhe jugore të sa përfundojnë me kornizë horizontale, ndërsa muri lindor me fronton. Kornizat e vjetra ruhen vetëm në mu-

17) Si pllakë e tryezës ka qenë përdorur një stelë varri e periudhës romake e përmbysur që sot ruhet në Muzeun Arkeologjik të Durrësit.

18) Hëpërhë në monument nuk gjejmë të dhënë për të vendosur një mbulesë të harkuar mbi muret sepse pjesët e sipërme të mureve janë të ribëra.

BOTIMET

ret verior dhe jugor të absidës dhe janë me gurë të skuadruar çmërsi që kanë një profilim të lehtë të lakuar në pjesën e poshtme. Muret e absidës janë ndërtuar me të njëjtën teknikë të mureve të kishës dhe me gurë të skuadruar çmërsi në qoshet të vendosur rregullisht e që këmbehen njëri së gjati e tjetri tërthor. Dritarja e vetme e absidës është në mes të faqes lindore është e ngushtë dhe e lartë dhe mbulohet me arkitra guri një copëshe.

Në pikpamje të arkitekturës kisha paraqitet e thjeshtë, me vëllim dhe hapsirë të brendshme që përftohen njëherësh. Ajo ka arkitekturën karakteristike të kishave të urdhërave domenikane e françeskane që shihet si në ndërtimin planimetrik e vëllimor me sallë mbuluar me çati druri dhe ambientin e altarit drejtkëndor mbuluar me qemer ashtu edhe në trajtimin e thjeshtë të brendësisë e anës së jashtme. Ajo i takon sferës së arkiteturës romaniko-gotike dhe lidhet me kohën e përhapjes së kishës katolike në këto anë. Karakteristike për këtë arkitekturë është absida drejtkëndëshe mbuluar me hark të mprehtë që e takojmë në Shën Stefanin e Shkodrës, forma e dritareve, pilastrat në muret e trasha. Në këtë kishë bien në sy format e rënda të dritareve, harku pak i çrregullt i qemerit të absidës dhe pilastrat që janë të panevojshme. Këto sipas mendimit tonë dëshmojnë se kisha është ndërtuar nga mjeshtra që nuk e njohin mirë këtë arkitekturë.

Përsa i përket kohës së ndërtimit të kishës ne nuk kemi asnjë të dhënë dokumentare. Po kështu nuk njohim dhe emrin e saj të dikurshëm. Duke u bazuar në të dhënat që ofron arkitektura e saj ne do ta lidhnim atë me vendosjen e urdhërave të mësipërme në zonën e Durrësit dhe për këtë mendojmë se kisha e Çetës është ndërtuar në fundin e shek. XIII.

Kisha e Shën Mërisë në Shënmëri të Krujës.

Rrënojat e kishës së Shën Mërisë ndeshen në një pyllë të vogël selvish në jug të fshatit të sotëm Shënmëri, emri i të cilës flet qartë se është marrë nga kisha. Selvitë kanë mbuluar tërë territorin rreth kishës madje janë dhe në brendësi të rrënojave, duke bërë që të mos duken qartë mbeturinat e manastirit të dikurshëm që e njohim që nga udhëtarët e gati një shekulli më parë.[19]

Ipen jep një planimeri të kishës së bashku me një skicë të pikturu [20]. Nga rrënojat e kishës ruhen muri lindor me absidën, muri verior, arkada veriore e pjesërisht ajo jugore dhe mbeturinat mbuluar me gurë të mureve jugor e perëndimor. Edhe dyshemeja e kishës është mbuluar me mbeturina të rrëzuara të mureve.

Në gjendjen e sotme kisha paraqet një bazilikë tre nefshe me arkada mbi pilastra drejtkëndore. Hyrja për në kishë ka qenë në anën perëndimore. Mundet që të ketë patur një hyrje të dytë në anën jugore, për të cilën mund të flitet vetëm pas gërmimeve. Gjithë muri perëndimor i kishës ruhet i rrënuar me një lartësi të vogël dhe faqet e tij mund të dallohen vetëm në anën veriore ku shihet dhe pilastri në mur i arkadës veriore.

Muri verior ruhet në tërë lartësinë e tij dhe është i ndërtuar me gurë të çrregullt gëlqeror lidhur me llaç gëlqereje. Ai shërben edhe si mur mbajtës i terenit, që është në nivel më të lartë se dyshemeja e kishës. Muri jugor dallohet veçse në pak vende sepse është i rrëzuar.

Muri lindor i kishës ruhet gati në lartësinë e dikurshme. Ai ka në qendër absidën gjysëm rrethore. në murin e së cilës ruhen gjurmë pikturash, sinjaturat e të cilave janë me gërma latine[21]. Absida është e lartë dhe mbulohet me qemer çerek sfere me profil të lartësuar. Në qendër të saj është një dritare e vogël drejtëkëndëshe me shpatulla të pjerrta pak të nxjerra në vendin ku duhet të ishte skeleti i xhamave. Një nike e vogël e harkuar është në të majtë të absidës. Duke vrojtuar murin lindor shohim se pjesa që i takon nefit verior është vazhdim i murit verior pra i një dore me të. Në të kemi një nike me një dritare të vogël e cila ka shpatullat dhe mbulesën me gurë çmërsi. Ky mur ka një fugë vertikale në vend me takimin me arkadën veriore, që do të thotë se është shtuar më vonë, pra i takon një faze tjetër ndërtimi, më të vonë.

Duke vrojtuar në anën e brendshme të kishës murin lindor pranë absidës, dallojmë një fugë tjetër vertikale, e cila ngrihet 2 m nga niveli i dyshemesë së kishës. Kjo fugë nga ana veriore ka dhe tulla, të cilat takohen shpesh edhe në murin e anës veriore. Në brendësi të fugës në një pjesë ku kanë rënë gurët, pamë që ajo është fillimi i sipërfaqes së harkuar së një abside që rezulton në këtë mënyrë më e vjetër Në të ruhen dy shtresa pikture. Kësaj pjese të vjetër muri i bashkangjitet duke u ngritur dhe mbi të muri më i ri i absidës së sotme i cili i takon në këtë mënyrë fazës së dytë të ndërtimit. Muri më i vjetër, faza

19) Th. Ippen, **Stari spomenici u Albaniji,** Glasnik Z.M.B.H.XII.1900, 3, 4; 518-520.
Po ai **Denkmaler vershiedener alterstuffen in Albanien,** W.M.B.H.X, 1907-28-30.
20) Th. Ippen, **Stari.... Fig. 12** (plani), fig., 13 (absida)
21) **Po aty,** (fig. 13). Edhe so tshquhet S. AMBRIUS.

PO NO COPY

e parë e ndërtimit, është dhe në një pjesë të pilastrit, që lidhet me të, me një trashësi 58 cm, ndërsa pjesa tjetër e pilastrit me trashësi 70 cm, ndahet nga muri i hollë me një fugë të qartë takimi.

Muri lindor i nefit jugor ka një fugë të qartë takimi me murin në vazhdim të absidës. Muri i fazës së dytë në këtë fugë ka një qoshe të rregullt të ndërtuar me gurë çmërsi e tulla. Dhe muri i absidës ka tulla të vendosura në radhë e në ndonjë vend dhe vertikalisht. Kësaj faze të dytë i takon dhe një pjesë e pilastrit që vijon nga muri lindor me trashësi 68 cm. Kurse shtesa e re ka trashësi 85 cm. Në këtë pjesë të vjetër dallojmë dy fuga të drejta vertikale. Njëra lartë shpatull e ndonjë dritare të mundshme, tjetra poshtë e lartë 220 cm, shpatull e ndonjë dere të murosur më vonë.

Periudhës së tretë ndërtimore i takojnë në këtë mënyrë nefet anësore dhe ndërtimi i arkadave mbi pilastra. Secila arkadë ka pilastrat në murin perëndimor, dy pilastrat e lira me prerje drejtëkëndëshe dhe pilastrat në murin lindor. Nga arkadat ruhen vetëm ajo nga jugu. Muret e pilastrave janë ndërtuar me gurë gëlqeror duke patur edhe gurë çmërsi nëpër qoshet. Në pilastrin e lirë më nga lindja ruhen dhe fillimet e harkut mbi të. Në një nga pilastrat jugor ruhen ende gjurmë të vogla të pikturës murale. Në këtë mënyrë kemi të qartë arkitekturën e kishës e cila nga një kishë një nefshe kthehet më vonë në një kishë më të madhe po një nefshe, dhe në një kohë të tretë një bazilikë trenefshe mbi pilastra. Përsa mund të gjykohet nga rrënojat e murit lindor dy nefat anësore janë mbuluar me çati druri në nivel më të ulët se çatija e nefit qendror.

Kisha e Shën Mërisë paraqet interes të veçantë si një dëshmi arkitekturore që mbart gjurmë të disa fazave ndërtimore e disa duar pikturimi. Me interes është kthimi i saj në një kishë të ritit katolik siç dëshmojnë pikturat e absidës. Po kështu një dëshmi me vlerë përbën përdorimi në fazën e tretë ndërtimore të një tipi të vjetër që lidhet me traditën e provincave në ndërtimin e bazilikave.

Në mungesë të të dhënave historike apo mbishkrimore datimi i këtij monumenti paraqitet i vështirë. Fazën e tretë të ndërtimit që lidhet me peshkopatën katolike të Krujës[22] do ta datonim si të gjysmës së dytë të shek. XVIII. Në këtë rast kisha do të mund të identifikohej me kuvendin e françeskanëve në Bret, fshat aty pranë të cilin e përmend Marin Skura në relacionet e tij të gjysmës së dytë të shek. XVII[23], ku nuk përmendet fshati Shënmëri. Nga faza e tjera të ndërtimit faza e parë duhet ti takojë shek. XI-XII sepse në murin e absidës arrijnë të vihen dy shtresa pikture dhe mundet shek. XII-XIII faza e dytë. Zmadhimi i kishës një nefshe. Për datimin e fazës së dytë dhe për pasojë të asaj të parës mund të cakto tohen kufij më të hershëm në se do të vërenim që në muret me gurë të absidës nuk përdoret klusonazh por vendosja e gurëve në mes tullave një teknikë më e vjetër.

Kisha e Shelbuenit në Rubik.

Ngrihet mbi një breg shkëmbor në hyrje të Rubikut. Pranë kishës janë dhe konakët e kuvendit të dikurshëm, një ndërtesë relativisht e re. Ndërtesa e kishës përbëhet nga pjesa e vjetër në rolin e ambientit të altarit dhe pjesa e re, naosi.

Kapeles së vjetër, i është prishur muri perëndimor për të krijuar lidhje me naosin e ri të kishës. Muratura e kapeles është me gurë gëlqeror pak të punuar e lidhur me llaç gëlqereje me rërë të ashpër të vendosur me rradhë horizontale ndërsa në absidë janë përdorur dhe gurë çmërsi. Nga vrojtimi i mureve në lartësi shihet qartë në brendësi një fugë horizontale që ndan në dy duar ndërtimi kapelen. Në anën lindore, mbi absidën gjysëm rrethore në plan dhe e mbuluar me hark të mprehtë një tra vjetër ndan të dy faqet. Mbi të ngrihet muratura e re që përfundon me një kornizë të dalë nga faqja e murit që qarkon të tre muret e kapeles. Mbi këtë kornizë kemi mbulesën me qemer cilindrik me prerje gjysëm rrethore e formuese lindje-perëndim.

Në murin lindor në të dy anët e absidës kemi dy nike gjysëm rrethore mbuluar me çerek sfere. Një kamare është në brendësi të absidës në anën veriore të saj. Kapela ndriçohet nga tre dritare në murin e absidës. Shpatullat e dritareve vinë duke u ngushtuar në anën e jashtme ndërsa mbulesat e tyre janë me hark rrethor jo të rregullt. Një dritare tjetër e mbuluar me arkitra druri ndodhet në anën jugore. Shpatulla lindore e saj ruan ende gjurmë të zbukurimit të dikurshëm me pikturë murale.

22) I këtij mendimi është edhe Th. Ippen, **Stari...** 520. Me sa duket prej këndej me pushtimin turk, peshkopët vendosën në Shën Venerandën e Kurbinit, krahinë më e sigurt. Vrejtja që Kordinjano i bëri Shuflait për këtë na duket e drejtë. F. Cordignano, **Antichi monastiri benedittini e le loro benemerenze sociali,** la Civilta Cattolica, tomo 80, 1929, vol. IV 505-506.

23) **Relacione,** 3/II në të cilën thuhet që ishte argëtim i peshkopit të Krujës si dhe dokumentim 63.

PO-TO-OBY

Në anën e jashtme absida paraqet vlerat e kishës si në anën ndërtimore ashtu edhe atë estetike. Ajo ndahet në tre pjesë, prej katër pilastrash të vogla që ngrihen mbi një bazament. Mbi secilin nga pilastrat dhe në mes tyre ngrihen harqe gjysëm rrethi duke krijuar një dekor harqesh që ndërpresin njëri tjetrin. Në secilin nga niket e formuara ndodhet njëra nga dritaret e sipërpërmendura. Në pjesën e sipërme absida që i takon e gjitha ndërtimit të vjetër, përfundon me një kornizë rasash guri.

Duke shqyrtuar arkitekturën e kapeles bindemi se ajo është ndërtuar sipas tipareve romanike. Për kohën e ndërtimit të saj kemi para së gjithash përmendjen e saj në vitin 1166 si «San Salvatori Arbanensis»[24]. Gjithashtu në pikturën e vjetër ruhet një mbishkrim latinisht në vitin 1272 data e pikturimit të kishës.[25] Duke u nisur nga këto të dhëna dhe nga ato që ofron vetë ndërtesa ne mendojmë që kisha e Rubikut duhet të jetë një ndërtim i gjysmës së parë të shek. XII, duke dëshmuar në këtë mënyrë për futjen e kishës katolike në zona deri atëhere në mvartësi të kishës ortodokse të Durrësit.

Kalaja e Shurdhahut – Shkodër

Në kalanë e Shurdhahut-Sarda mesjetare, ruhen një numër kishash të rënuara mjaft prej të cilave ju njihen edhe emrat. Ato i takojnë një periudhe të gjatë kohore, dhe lidhen me peshkopatën e Sardës që përmendet së pari ndër dokumenta në vitin 1199[26] ndërsa si qytet në vitin 1198.[27]

Peshkopata e Sardës-«Sardicensis» vijon të përmendet në dokumentacionin kishtar deri në fund të shek. XV., kur pushon së qeni dhe i nënshtrohet asaj të Sapës.[28]

Për kishat e Shurdhahut gjatë mesjetës së vonë na flasin shumë udhëtarë. Kështu Marin Bici në vitin 1620 përmend peshkopatën e Sapës dhe Sardenjës.[29] Në vitin 1621 Gjec Bardhi përmend famullinë e Shën Mërisë në Shurdhah[30]. Në vitin 1531 Shurdhahun, ndërkohë të braktisur, e viziton Gjergj Bardhi, peshkop i Sapës, i cili përmend kishën e atjeshme të mbulueme me përkujdesjen e tij, që me sa duket ishte po ajo e Shën Mërisë, siç përmendet në vitin 1641 nga Frang Bardhi[31]. Në Shurdhah numërohen sot rrënojat e 11 kishave emrat e të cilave kanë qenë ruajtur deri vonë si kisha e Zojes, e Shnandoit, e Shën Palit, e Shën Kollit, e Shën Todorit e Shën Pjetrit etj.

Studjuesit e qytetit dhe monumenteve të tij vendosin në periudhën kohore të mesjetës së hershme deri në shek. XI-XII tre kisha: të emërtuara e I, VI dhe XI (ndërtesa VI) të tjerat i takojnë kohëve më të vona.[32]

Kisha e I ndodhet disa dhjetra metra larg murit rrethues të qytetit. Ajo është me planimetri drejtëkëndëshe me përmasa 7.6 x 2 m. Prej saj ruhet pak e ngritur mbi tokë absida gjysëm rrethi ndërsa muret veriore, jugore dhe perëndimore ku ndodhet hyrja e vetme për në kishë janë në nivelin e tokës. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë gëlqerorë të çrregullt dhe të lidhur me llaç gëlqereje. Sipas materialit të varreve pranë kjo është datuar në mesjetën e hershme.[33]

Kisha XI. Paraqet një ndërtesë një nefshe, të cilës i mungojnë absida në anën lindore. Përbëhet nga naosi (9.70 x 5.30 m) dhe narteksi (1.50 x 5.30 m).

24) **A. Alb,** I, 93, viti 1166.

25) Th. Ippen, **Jos nesto o Starim Crkvama u Sasu i Rubigu,** Glasnik Z.M.B.H, XIV, 1902, 3,4,554. Dh. Dhamo. **Piktura e vjetër murale e kishës së Rubigut,** S.H.. 2.1964, 87-96. ku saktësohen interpretimet e derisotme për këtë problem, si dhe një përshkrim i ndërtesës me fazat e saj të ndërtimit

26) E dhëna e botuesve të **Acta e Diplomata,** se kjo peshkopatë përmendet së pari që në shek. VI nuk na duket e saktë. Për mendimin tonë me këtë dokument kemi të bëjmë me Serdikën, **A.Alb,** I, 42. Përmendjen e parë të saj në mesjetë e kemi në vitin 1199. **A.Alb,** I, 120.

27) **A.Alb,** 113, viti 1198.

28) **A.Alb,** 249 (viti 1260) 352 (viti 1276), 500 (1278, 1280, 1186) 516 (viti 1291). **A.Alb,** II, 270 (viti 1370) 354 (viti 1379) 568 (viti 1396).

29) Relacione, 3/1, 205 edhe Pjetër Budi në vitin 1621 pohon të njëjtën gjë (po aty) 297.

30) **Po aty,** 293.

31) **Po aty,** 411, Relacione 3/11, 199.

32) H. Spahiu-D. Komata, **Shurdhahu – qytet i fortifikuar i mesjetës së hershme,** Iliria, III-1974, përmendim 10 kisha. Atyre u duhet shtuar edhe ndërtesa VI, e cila është një kishë, që me banesat pranë përbën një tërësi me rëndësi. Shih për këtë Gj. Karaiskaj, **Të dhëna mbi arkitekturën dhe punimet e konservimit në kalanë e Shurdhahut (Sarda),** «Monumentet» 10, 1975, 138.

33) H. Spahiu-D. Komata, **Vep.cit,** 306-308, fig. 32.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Nga kisha ruhet dyshemeja e shtruar me pllaka të rregullta guri. Në anën lindore ruhet një shkallë që shpinte në ambientin e altarit pjesa më e madhe e të cilit bashkë me gjithë murin lindor nuk ruhet më. Në naos hyhet nëpërmjet një porte në murin perëndimor që i lidh me narteksin, si dhe nga porta në murin verior. Kjo portë perëndimore për sa gjykohet nga vrimat me shpatullat dikur mbyllej me katarah. Në vet narteksin hyhet nëpërmjet portës në anën jugore. Në dyshemenë e narteksit janë ndërtuar varre. Varre të tjerë janë gërmuar pranë murit jugor të kishës.

Muret e kishës që ruhen 0.75-1.85 m janë të ndërtuara me gurë pak të punuar e të vendosur në rreshta horizontalë. Në brendësi kisha ka qenë e suvatuar me llaç gëlqereje. Nga trashësia e vogël e mureve (rreth 0.50 m) kuptohet që kisha ka qenë e mbuluar me çati druri (gjatë gërmimit janë gjetur tjegulla solene dhe një gozhdë hekuri). Studjuesit e monumentit nga inventari i gjetur në varret e datojnë këtë kishë si të shek. XI[34].

Kisha VI. Ruan të plota në këmbë absidën dhe muret anësorë pranë saj deri në lartësinë e plotë 5.60 m, që i takon kornizës. Në planimetri kisha është drejtëkëndëshe, me gjërësi 4.10 m ndërsa gjatësia lëviz nga 13.90 m në murin verior në 12.70 m në murin jugor. Dyshemeja e kishës e shtruar me pllaka guri të çrregullta. Në naos hyhet nga dera në anën perëndimore. Kisha ndriçohej nga një dritare e ngushtë dhe e lartë mbuluar me hark rrethor në absidë dhe një dritare e rënuar në murin jugor edhe ajo mbuluar me hark rrethor. Më vonë kishës i shtohet një narteks 1.80 m i gjërë në të cilin hyhej me një portë në anën jugore. Në brendësi të tij, nën dyshemenë e dikurshme, ishte ndërtuar një qimiter mbuluar me qemer.

Muratura e kishës është ndërtuar me gurë të punuar të formave të rregullta por me lartësi të ndryshme të rreshtave. Kjo teknikë duket më mirë në kornizën e absidës ku dallohen fugatura e punuar me simetri për të nënvizuar formën katërkëndëshe të gurëve. Çatia e kishës duhet të ketë qenë me struktura druri mbuluar me rrasa guri si dhe absida. Për nga teknika e ndërtimit kjo është datuar në shek. XI-XII[35].

Disa nga kishat e Shurdhahut janë ndërtuar drejtpërsëdrejti mbi pjesë të murit rrethues të sipërm të qytetit kur ai ishte lënë jashtë përdorimit.

Kisha VIII e emërtuar kisha e Zojes (Kisha Shën Mërisë në dokumentacionin historik) ruhet m mure 4.40 m të larta deri në nivelin e çatisë së dikur shme me dy kullime uji mbuluar me rrasa guri. Ki sha është drejtëkëndëshe dhe e zgjatur me plani metri. Në kishë hyhet nëpërmjet dy dyerve, njëra n anën jugore dhe tjetra në anën perëndimore. T dyja këto mbulohen me harqe guri. Kisha ndriçohe nga tre dritare të vogla në murin jugor dhe një dri tare dyshe në absidë, mbuluar me arkitra guri një co pë. Dyshemeja e kishës ka qenë e shtruar me pllak guri, dhe në ambientin e altarit ruhet edhe tryeza tij.

Nën kishën që ruhet sot H. Spahiu dhe D. Ko mata[36] kanë vërejtur një kishë më të vjetër nga cila dallohet absida që del jashtë së resë në anër veriore. Nga kjo kishë e vjetër Gj. Karaiskaj dallo murin verior dhe një pjesë të murit perëndimor t përfshirë në kishën e re. Pra kisha e vjetër ishte gjatë sa kjo e fundit por pak më e gjërë në anër veriore.[37]

Në kishën e re janë dalluar dy duar ndërtimi që përbëjnë fazën e dytë dhe të tretë për kishën. Fazë më të hershme (e dyta) i takon muri perëndimor (ba shkë me pjesët e kishës së vjetër) dhe pjesë të mureve jugore e veriore (8.50 m). Fazës së tretë i takojnë pjesët e tjera (11.30 m) të këtyre të fundit dhe absida. Një vendosje e tillë relative shihet në takimin e dy mureve ku më i voni i mbivihet më të vjetrit.

Periudhës së dytë të ndërtimit i takon muri ku është vendosur guri me datën 1564. Në të janë dy nga tre dritaret e murit jugor të gjëra dhe mbulua me hark gjysëm rrethor. Dritarja e tretë në murin më nga lindja është në formë frëngjije dhe mbulohet me arkitra guri. Gj. Karaiskaj mendon se kisha e periudhës së dytë, ajo nga perëndimi ka qenë më e shkurtër sepse ska gjurmë të sajat në absidë. Për të sqaruar këtë mendojmë se do të duhen gërmime ose sondazhe. Të gjitha muret e kishës janë me gurë të papunuar të vendosura në reshta thuajse horizontale.

Ndërsa guri me datën 1564 daton fazën e dytë ndërtimore, kishën e vjetër studjuesit e saj e vendosin në fundin e shek. XIV-fillimin e shek XV. duke e lidhur edhe me lënien pas dore të rrethimit të sipërm të qytetit. Është me interes se kjo rënie e jetës së qytetit mund të hetohet edhe në dokumentacionin kishtar. Kështu peshkopata e Sardës duke filluar nga mezi i shek. XIV përmendet dhe si e Pultit të

34) **Po aty,** 292. Gj. Karaiskaj, **vep.cit,** 139.
35) **Po aty,** fig. 13 (15, 139-140, H. Spahiu-D. Komata, **vep. cit,** 287, fig. 25.
36) **Po aty,** 288.
37) **Vep.cit,** 137-138. fig; 8-11, i cili dallon dhe dy fazat e ndërtimit të kishës së re.

Poshtëm[38] «Polatum Minoris», për të vijuar deri në vitin 1491 kur shuhet përfundimisht dhe i nënvihet asaj të Sapës. Faza e tretë ndërtimare sipas tyre duhet ti takojë shek. XVII-XVIII. Të gjitha këto ndërtime që lidhen me rënien e përgjithshme të qytetit dhe braktisjen e tij shihen dhe nën nivelin e teknikës së ndërtimit.

Kisha IX. Paraqet një kapele të rënuar që ngrihet pranë portës së rrethimit të sipërm, duke përfshirë pjesë të murit[39]. Kjo gjë shihet dhe në trashësinë më të madhe të murit jugor (1.0 m) ndaj mureve të tjerë më të hollë e të ndërtuar rishtaz për kishën (0.55--0.70 m). Ajo ka në planimetri formën e një drejtëkëndëshi me përmasa 9.12 x 3.70 m. Nga mbetjet kuptohet që kemi të bëjmë me një ndërtesë të papunuar e lidhur me llaç gëlqereje dhe që datohet në këtë mënyrë në fundin e shek. XIV-shek. XV.

Kisha X, ndodhet në zonën më të lartë të qytetit pranë mureve të dyta të rrethimit. Në plan paraqet një drejtëkëndësh me përmasa 13.5 x 4 m. Muri verior i kishës është pjesë e murit të dikurshëm të kalasë. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë gëlqerorë dhe lidhen me llaç gëlqereje. Hyrja për në kishë është në anën jugore.

Është me rëndësi të vërehet në kishat e Shurdhahut, përdorimi përherë i të njëjtës tipologji-kishës një nefshe me planimetri të stërgjatur dhe mbuluar me çati druri.

Kisha e Shën Kollit në Zejmen (Lezhë)

Ndodhet në kodrat shkëmbore mbi fushën e Zejmenit 1 orë larg nga kisha e Pllanës, në veri të saj. Ajo përmendet që në vitin 1610 nga ana e Marin Bicit, i cili e quan një kishë jo shumë të madhe që ruan piktura të bëra nga piktorët që kaluan andej «në tërë Shqipërinë». Ai përmend edhe hajatin e jashtëm të ndërtuar mirë që zë 200 veta.[40] Edhe B. Orsini e përmend atë në vitin 1620.[41]

Kisha e Shën Kollit të Zejmenit ruhet me gjurmë të rindërtimeve të shumta që ka pësuar në kohë. Nga studimi i teknikave të ndërtimit të pjesëve të ndryshme të mureve dhe shqyrtimi i fugave që dallohen në to. Këto rindërtime vështirë se mund të shpjegohen nga që gjurmët janë të pakta. Në planimetri ajo paraqet një drejtëkëndësh të zgjatur me absidën gjysëm rrethore në anën lindore. Në anën perëndimore të saj ka një narteks me tribunë në katin e dytë. Si në anën perëndimore ashtu edhe në atë veriore, kishës i është shtuar një hajat i hapur mbi pilastra. Në anën lindore në një pjesë të vogël të anës veriore hajati mbyllet me një mur i cili lidhet me fugë të qartë me murin e kishës.

Pjesët më të vjetra duket se duken në murin verior, në zonën më në lindje të tij. Madje edhe aty ka fuga të pashpjegueshme dhe riparime të pjesëshme të faqeve të mureve. Në këtë pjesë ruhen dy pilastra dhe tre harqe mbi to. Në pilastrin më nga perëndimi ruhen thembra dhe fillimi i një harku tërthor i murit. I vetmi shpjegim që ne mund të japim, do të ishte se kisha e vjetër ka qenë me pilastra dhe harqe në muret gjatësorë, dhe e mbuluar me qemer dhe harqe tërthorë. Harqet që ruhen janë ndërtuar me gurë çmërsi. Po të tilla i gjejmë dhe në thembrën që ruhen nga harku tërthor. Për vjetërsinë e këtij muri flet dhe qenia e gjurmëve të dy shtresave të mbivëna pikturës murale.

Muri nga jugu, ai lindori së bashku me absidën gjysëm rrethore, janë të rinjë dhe të ndërtuar me gurë shtufi e gëlqeror të lidhur me llaç në ngjyrë të kuqërremtë. Qoshet janë me gurë shtufi të skuadruar. Dy dritare janë në murin jugor, ato janë të mëdha dhe mbulohen me arkitra druri është ngritur një tribunë në të cilën hipej me shkallë druri. Në të dy qoshet e murit perëndimor dallojmë brenda murit dy pilastra në formën e shkronjës «L». Dyshemeja e kishës është e shtruar me pllaka të rregullta guri.

Për kohën e ndërtimit të kishës duke u nisur nga elementet e pjesës më të vjetër mendojmë se ajo i takon shek. XIV, ku ndërtohen kisha të tilla si në Blinisht, Kakariq e gjetkë. Rindërtimet e shumta që ka pësuar kisha i takojnë kohëve të fundit të periudhës së pushtimit turk.

Durrësi

Nga numri jo i vogël i kishave paleokristiane dhe atyre të ndërtuara rishtas gjatë mesjetës, në qytetin e Durrësit, sot ruhen vetëm dy, emrat e të cilave ne nuk i njohim. Njëra është kapela e amfiteatrit dhe mozaikët e vet që autorë të ndryshëm e datojnë nga

38) **A.Alb,** II, 91, (viti 1351).
39) H. Spahiu-D. Komata, **vep. cit,** 288, fig. 26.
40) **Relacione,** 3/1; 131. Pasbizantine.
41) **Po aty,** 401.

FOTOKOPJI

fundi i antikitetit të vonë deri në fillimin e shek. X[42], tjetra bazilikë nën xhaminë e Fatihut, ndërtuar gjatë shek. X me rindërtime të fundit të shek. XII[43]. Veç tyre kemi një dokumentacion historik një sërë kishash si në qytet ashtu dhe në rrethet e afërta të tij.

Së pari po përmendim Katedralen e Shën Astit dhe Isabrit, që dëshmohet në vitin 1383[44]. Kishën e Shën Andresë pranë portit e njohim sepse perandori Aleks Komneni ja dha venecianëve në vitin 1082.[45] Nga një dokument shitjeje të vitit 1246 njohim kishën e Kryqit të Çmuar e Jetëdhënës[46]. Kolonia e amalfitanëve kishte në qytetin e Durrësit kishën e Shën Mërisë (Sancta Maria Malfitanorum)[47]. Atyre duhet t'ju shtojmë dhe gjurmët e gjetura nga L. Rei pranë kullës B që sipas traditës i përkisnin kishës së Shën Kollit. Rei gjeti nëpërmjet një sondazhi dhe pjesë të dyshemesë dhe një absidë të një kishe tjetër, që duket se vinte nga antikiteti i vonë me rindërtime të mesjetës së hershme.[48]

Në dokumenta përmendet pranë Durrësit manastiri i Shën Theodhorit të Ilicetës[49] si dhe ai i Shën Gjergjit[50]. Në vitin 1359 përmendet kisha e Shën Eustathit[51]. Shuflai na jep edhe kisha të tjera. «San Demetrius Plumsis», «Sancta Venere Managastis», «San Lorenzon» pranë qytetit, si dhe Shën Pjetrin e Ortodoksëve.[52]

Me hyrjen në fund të shek. XIII në qytetin e Durrësit e rrethet e tij të urdhërave të domenikanëve dhe françeskanëve ndërtohen prej tyre disa kisha. Njohim nga dokumentat në vitin 1304 Shën Domenikon[53].

Kapela e Amfiteatrit. Njihet më tepër për dy panelat e tij me mozaik me vlera artistike, që së bashku me gjurmët e afreskut përbëjnë dëshmi historike të dorës së parë, që siç thamë datohen që nga fundi i shek. VI – shek VII deri në fillimin e shek. X. Ajo është ndërtuar në strukturat e Amfiteatrit duke shfrytëzuar galeritë e tij. Muret e saj ngrihen mbi pjesët e vjetra drejtpërdrejtë mbi muret me teknikë të përzierë të shkallares, ç'ka tregon se pjesët e gurta ndërkohë ishin marrë. Muret e reja janë ndërtuar me gurë me tulla. Me tulla janë harqet që mbulojnë dritaren dyshe të absidës dhe pjesët mbi të, si dhe pjesët e sipërme të mureve jugor dhe verior të cilët ruajnë dhe gjurmë rindërtimesh. Në këtë pjesë tullat janë vendosur në radhë ndërmjet gurëve dhe ndërmjet tyre.

Në planimetri kisha është drejtëkëndëshe dhe vjen duke u ngushtuar sipas galerive të amfiteatrit. Në pjesën perëndimore të saj ndodhen dy panelet e mozaikut njëri në murin jugor dhe tjetri në atë perëndimor. Në kishë hyhet nga ana veriore dhe jugore. Përpara hyrjes veriore është vaska e pagëzimit, ndërsa pranë asaj jugore kemi varre. Gjatë gërmimit arkeologjik janë zbuluar monedha të shumta të shek. XI-XII çka tregon se kisha ka qenë në përdorim deri atëhere.

Bazilika nën xhaminë e Fatihut

Është zbuluar me një sërë sondazhesh në terenin pranë dhe në brendësi të vet xhamisë, e cila është ndërtuar në fillim të shek. XVI pas pushtimit të Durrësit nga turqit. Nga ndërtimet e vjetra ruhen mbetje të absidave, të pilastrave dhe pjesa më e madhe e murit perëndimor e rindërtuar me teknikën e klusonazhit, që i takon shekujve XIII-XIV. Bazilika ka në anën lindore tre absida, qendrorja trekëndëshe në plan, dy të tjerat gjysëm rrethore. Nëpërmjet arkadave mbi pilastra bazilika ndahet në tre nefe. Duhet të shënojmë formën thuajse kuadratike në plan të kishës dhe mungesën e ambienteve të altarit të formuar qartë. Për këto veçori e kemi datuar si të shek. X. Vetë kërkimet arkeologjike mund të hedhin dritë të plotë në këtë monument.

---

42) V. Toci, **Amfiteatri i Durrësit,** «Monumentet» 2/1981, 37-42, N. Thierry mosaique a Dyrrachium, Cahiers Archeologiques, XVIII, 1968, 227-229. H. Nallbani, **Mozaiku i kishës Amfiteatrit në Durrës,** Monumentet 7-8, 1974, 111-116.

43) A. Meksi, **Dy bazilika mesjetare të panjohura,** Monumentet 13/1977.

44) A. Ducellier, **La façade...,** 32, Shën. 185.

45) **Po aty,** 32 **A.Alb,** I, 67.

46) **A.Alb,** I, 181, A. Ducellier, **Vep.cit,** 32.

47) K. Jireçek, **Die Lage und Vergangenheit der Stadt Durrazzo in Albanien,** Illurische-Albaniche Forchungen, I, 1916-159.

48) L. Rey, **Fouilles de la Mission française a'Apollonie d'Illyrie et a Durrazo,** Albania I, 29-30.

49) **A.Alb,** I, 246 (viti 1258) A. Ducellier; **Vep.cit,** 196.

50) **Po aty,** 208, shën. 280.

51) **A.Alb,** II, 42.

52) M. Sufflay, **Die Kirchezustande...,** 258, 263.

53) **Po aty,** 278.

Botim

Ndër gjurmët e kishave të Durrësit do të përmendim atë që gjeti Leon Rei në qendër të qytetit ku nga sondazhet e viteve të fundit kanë disa elemente që flasin për një bazilikë paleokristiane me rindërtime të shek. IX e rënuar nga një tërmet i rëndë mundet ai i vitit 1273. Veç kësaj me rëndësi janë një sërë kapitelesh monaiko-gotike si dhe një gur kyç i harqeve të një qemeri me brinjë që bashkarisht flasin për një lulëzim të kësaj arkitekture në Durrës gjatë shekujve të fundit para pushtimit turk.

Lezha

Qendra e vjetër peshkopale e Lezhës përmendet vetëm në fund të shek. VI.[54]. Në mesjetën e hershme përmendjen e parë e kemi në listat peshkopale të Leonit VI në fillim të shek. X. (rreth viteve 902-907)[55] dhe që atëhere kjo qendër vijon të përmendet gjatë gjithë mesjetës së mesme e të vonë.

Sot në Lezhë gjenden mbetjet e tre kishave, katedralja e shën Kollit në të cilën kanë qenë varrosur Skënderbeu[56] rrënojat e kishës së Shën Gjergjit buzë Drinit dhe kisha e shën Munciatës po buzë Drinit në anën e majtë të rrjedhjes së tij e rindërtuar në fund të shek. XIX. Nga të dhënat e udhëtarëve dhe misionarëve të shek. XVII mësojmë se në Lezhë kishte ndërkohë 5 kisha. B. Orsini në vitin 1629 veç tre të mësipërmeve përmend dhe Shën Sebastianin dhe Shën Mërinë e Borës[57].

Kisha e Shën Gjergjit ruan mbetje të muraturës, që bën të mundur të kuptohet ndërtimi i saj bazikal tre nefëshe. Muret e saj janë ndërtuar me gurë. Në absidën gjysëm rrethore në lindje të saj shihet dhe një brez tullash, që na lejon ta datojmë kishën në shek. V-VI. Mbetja në këmbë e mureve pranë qytetit e për më tepër përmendja e saj në shek. XVII flet për vijimin e përdorimit të saj në kohë, sigurisht me rindërtime të ndryshme. Sidoqoftë të dhëna të plota për këtë monument dhe historinë e tij do të japin vetëm gërmimet arkeologjike në të.

Katedralja e Shën Kollit

Ndodhet në qytetin e poshtëm, pranë mureve lindore në një terren pak të pjerrët. Në plan paraqet një kishë një nefshe me përmasa 18,0 x 8.0 m. Në anën lindore nga gërmimi doli në dritë absida e rrënuar me kthimin e kishës në xhami, në shek. XVII, e cila rindërtohet po në shek. XVII, pas një periudhe braktisjeje të saj.

Gjatë gërmimit rezultuan dhe dy faza më të vjetra. Nga e para ruhej absida, muret lindor dhe verior të ndërtuar me gurë e llaç gëlqereje dhe dysheme e shtruar me harasan ngjyrë të kuqe. Mbi të kemi themelet e një kishe tjetër të periudhës mesjetare të cilën F. Prendi e mendon të jetë rënuar në mesin e shek. XV. Kisha e sotme duhet të jetë ndërtuar rreth vitit 1459 në të cilën dhe u varros Skënderbeu[58]. Kjo kishë siç rezulton nga të dhënat historike duhet të jetë rënuar në fund të viteve 40 të shek. XVII.

Muret e kishës janë ndërtuar me gurë të çrregullt gëlqeror dhe të lidhur me llaç gëlqereje. Kisha ndriçohet vetëm nga tre dritare të ngushta mbuluar me hark të mprehtë në murin jugor. Një dukuri të tillë e kemi vërejtur edhe në kishën e Shën Venerandës në Pllanë. Me interes të vërejmë një fragment të harkuar e të gdhendur me gjethe akanthi të përdorur mbi portën e hyrjes. Duket se vjen nga ndonjë dritare të kishës më të vjetër ose i takon një cihoriumi. Mendojmë se duhet datuar përpara shek. XII.

Veç monumenteve të sipërpërmendura, në Shqipërinë e Veriut dhe të mesme njohin gjurmë ndërtesash të tjera kulti, të cilat ende nuk janë studjuar si duhet. Po përmendim së pari kishën e Shënlliut në afërsi të Ishmit që përmend Th. Ippen.[59] Kisha paraqet një ndërtesë me mure të rënuara e ndërtuar me gurë mesatarë të vendosur në rreshta me tendencë horizontaliteti. Në absidë dallohet një dritare e ngushtë edhe pak a shumë e lartë. Me interes janë dhe fragmentet e pikturës me sinjatura latinisht (SCS,

54) **A.Alb,** I 40 (viti 592).

55) H. Gelzer, **Ungedruckte und ungenugend veroffentliche texte der Notitiae Episcopatum,** Abh.d.I.Cl. Akad. Wiss, bd XXI, 1901, 557-558.

56) F. Prendi, **Vendvarrimi i Skënderbeut,** Konferenca e II e Studimeve Albanologjike, vol. I, 1969, 241-248. Në këtë kumtesë parashtrohen argumentat për identifikimin e xhamisë Selimie me katedralen e Lezhës si dhe të dhënat e kërkimeve arkeologjike në të. Në të shih dhe literaturën e gjërë për këtë monument.

57) **Relacione** 3/1, 401.

58) Rezultatet e gërmimit dhe interpretimi i tyre, jepen siç thamë tek F. Prendi, **vep; cit,** 244-247.

59) Th. Ippen, **1907,** 38-40, fig. 64-66.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

NICEPH). Monumenti duket se duhet të jetë Shënlliu i Shporajt që përmendet në dokumentacionin historik e shek. XVII[60]. Po Ippen na kumton për rrënojat e kishës së Shën Mehillit të Delbënishtit në pyllin në mes të Milotit dhe Delbënishtit[61].

Me mjaft interes janë dhe rrënojat e zbuluara në vitet e fundit në qytetin e Peshkopisë. Kemi të bëjmë me një kishë të shek. XII-XIV ku vërehen në mure teknikat me tulla ndërmjet gurëve në pjesën e poshtme dhe ajo e kluosonazhit. Për mendimin tonë kjo kishë do lidhur me peshkopatën e Dibrës në mvartësi të Ohrit që përmendet në këta shekuj.[62]

Studimi i ndërtimeve të kultit në trevat e Shqipërisë së Mesme e të Veriut, sigurisht mbi bazën e të dhënave të përftuara në teren dhe nga monumentet e botuara, na krijon një tablo të qartë të arkitekturës së tyre. Në mvartësi të shkallës së zhvillimit të tyre, të përfshirjes në drejtimet e mëdha të arkitekturës mesjetare e të zhvillimit të përgjithshëm historik të vendit, do të dallonim dy periudha kryesore. Periudha e parë që përfshin mesjetën e hershme shkon deri në shek. XII, periudha e dytë i takon shekujve XIII-XV. Në mesjetën e hershme kemi përdorimin e ndërtimeve të antikitetit të vonë qoftë dhe duke i rindërtuar dhe ndërtime të reja të thjeshta e të varfëra. Në përputhje kjo me kushtet historike dhe shkallën e zhvillimit ekonomik të vendit. Me rimëkëmbjen e vendit nga pasojat e rënda të dyndjeve sllave, fillojnë të rindërtohen mjaftë nga kishat e periudhës së mëparshme ashtu dhe të ndërtohen kisha të reja, sigurisht të thjeshta dhe me dekor të varfër. Dallimi këtu duhet bërë nga ndërtimet e Durrësit, një qendër me rëndësi për vetë perandorinë, me një numër të madh monumentesh paleokristiane që ishin në përdorim rindërtoheshin apo merreshin për model për ndërtimet e reja. Po kështu kanë ndërtesat e tyre të kultit dhe qendrat peshkopale që riorganizoheshin me sa duken njëherazi me riorganizimin administrativ të zonës në fillim të shek. IX.

Nga parashtrimi i monumenteve rezulton që në këto treva ndërtimet një nefshe përbëjnë tipin mbizotërues në përdorim. Ato ndryshojnë nga kishat një nefshe të trevave të tjera të vendit që janë të përmasave të vogla, kapela në kuptimin e plotë të fjalës, arrijnë përmasa të mëdha, madje të tilla janë dhe katedralet. Në të njëjtën kohë mjaft prej tyre përbëjnë arritje arkitekturore (Shën Stefani Shkodër, Vau i Dejës). Ndërsa në periudhën e parë kishat e Veriut janë të thjeshta dhe në mjaft raste kapela, në periudhën e dytë shumë prej tyre paraqiten në formë të zhvilluara arkitekturore. Kjo dukuri haset dhe në disa kapela (Vau i Dejës, Rodon) gjë që nuk ndodh në Shqipërinë e Jugut.

Numri më i madh i monumenteve që parashtrum am i takon periudhës së dytë, shekujve XIII-XV. Në këtë periudhë, sidomos mbas pushtimit anzhuin të viteve 70-80 të shek. XIII, ndërhyrja e kishës katolike vjen përherë e duke u shtuar dhe kështu në pikpamje të arkitekturës shtohen elementet e arkitekturë romaniko-gotike. Nëse në periudhën e parë kemi të bëjmë me ndikime të tyre siç është rasti i kishës së Ribigut, në periudhën e dytë si në veri nëpërmjet kryepeshkopatës së Tivarit, ashtu edhe në Shqipëri të Mesme nëpërmjet Durrësit kemi ndërtime të mirëfillta të arkitekturës romaniko-gotike. Në mjaft prej rasteve janë ndërmjetësa urdhërat françeskane e domenikane të cilat ndërtojnë mjaft manastire në qendrat kryesore e në brendësi të vendit deri në zonat e Durrësi (Shkodër, Rodon, Çetë). Lidhjet me arkitekturën perë ndimore duhet pra ti shohim në dy anë. Fillimisht s ndikime ndaj një arkitekture tradicionale dhe më von si veprimtari ndërtimore të shkollave arkitekturore t bregdetit Dalmatin jugor e Shqipërisë Veriore e asa të Durrësit. Ndërtimet e tyre përfshihen në arkitektu rën romaniko-gotike, sipas së cilës ndërtohen gjat mesjetës së mesme faltoret e ritit katolik në Itali t Jugut prej nga vinë ndikimet dhe në raste të veçanta merren modelet. Kështu dhe tek ne nuk kemi arki tekturë gotike të mirfilltë, por arkitekturë romanike me element dhe strukturë të gotikut. Pikërisht këto elemente dhe forma të vonuara janë mjetet e kë tyre shkollave.

Karakteristika të tyret janë teknika e ndërtimit me gurë, fillimisht pak të punuar e më vonë të skuadru ar sidomos në qoshet dyert e dritaret duke qenë më të gjatë se të lartë, por që gjatë shek. XV tentojnë drejt formave katrore, muret me pilastra që lidhen me harqe të verbër, harqet e qemeret me profil të mpreh të, ngritja vertikale e godinës, mungesa e kupolave dhe përgjithësisht format njënefshe.

Krahas tyre kemi një numur të madh ndërtimesh të thjeshta, ndërtime të mjeshtrave popullorë që i ta

60) **Relacione,** 3/II, 317.
61) Th. Ippen, **1901,** 521.
62) **A.Alb,** I, 78 (1107). Nuk jemi dakord me K. Frashërin që sheh aty Stetaniakën mesjetare. **Në gjurmë të qyteteve Peneste,** Studime Historike, 4, 1975, 142, shën 52, Për këtë problem jemi shprehur në **Monumentet në një vepër historike,** Monumentet 2-1982, 147 me literaturën përkatëse në shën. 39.

kojmë gati në gjithë fshatrat, ku me këtë arkitekturë lidhen vetëm harqet e mprehtë të dritareve.

Siç parashtruam në fillim të artikullit, të dhënat për arkitekturën paleokristiane në këtë trevë, duke përjashtuar Durrësin dhe rrethet e tij, janë të mangëta. Megjithatë mund të themi që në ndërtimet e Shqipërisë së Veriut me karakteristika të qarta tipologjike një nefshe dhe teknikën e ndërtimit me gurë, duhet të shihen rrënjët e traditës më të vjetër, traditë kjo që vjen dhe pas pushtimit turk në gjithë bregdetin jugor të Dalmacisë dhe Shqipërinë e Veriut. Është me interes të biem këtu thënien e Frang Bardhit se kishat e Veriut «janë të vogla, pa këmbanore, me piktura të stilit bizantin, pa dysheme, me derën kryesore drejt perëndimit». Kjo arkitekturë është kushtëzuar dhe nga niveli i përgjithshëm i zhvillimit ekonomik dhe rrethanat politike, kështu që elementet e traditës nuk lanë vend për futjen e arkitekturës bizantine të shek. XI-XIV, njëlloj si në zonat e vjetra të Shqipërisë. Nga ana tjetër duhet patur paraysh se Veriu i shkëputet perandorisë bizantine në fund të shek. XII, ndërsa në aspektin kishtar një gjë e tillë kishte ndodhur edhe më parë. Në zonat pranë Durrësit ku kanë bashkëjetuar të dy ritet dhe arkitektura bizantine pati arritje të dukshme, vërejmë përdorimin e teknikës së kluosonazhit dhe në kisha me arkitekturë romaniko-gotike (Rodon) e deri në ndërtime mbrojtëse si në kalanë e Rodonit dhe atë të Krujës.

Të përfshira ndërmjet Kryepeshkopatave të Durrësit dhe Tivarit trevat e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut paraqesin një tërësi arkitekturore me tipare të njëjta si në ndërtimin planimetriko-vëllimor ashtu edhe teknikën e ndërtimit, rezultat i traditave arkitekturore, kushteve të njëjta ekonomike shoqërore e nivelit të njëjtë kulturor. Ndër këto dy qendra kryesore, sidomos në periudhën e dytë roli i Durrësit bëhet gjithnjë e më i ndjeshëm. Kjo arkitekturë takohet që nga rrethet e Durrësit, e Krujës, Lezhës, Shkodrës e deri në Shas, Ulqin, Rotec e Tivar, në zonat ku shqiptarët si popullsi dhe mjeshtra ndërtues përbëjnë shumicën.

PO NOT COPY

DO NOT COPY



KISHA E SHENANDOUT

RODON - DURRES





DO NOT COPY



KISHA E SHEN E PREMTES

ÇETE – DURRES





DO NOT COPY



KISHA E SHEN MERISE

SHENMERI - KRUJE









DO NOT COPY



KISHA E SHELBUEMIT

RUBIK





KAPELA E AMFITEATRIT

DURRES



BAZILIKA E XHAMISE FATIHUT

DURRES

DO NOT COPY



SHURDHAH

SHKODER - KISHA Nr. I



KISHA Nr. VI





DO NOT COPY

SHURDHAH

KISHA Nr. VIII





KISHA Nr. VIII





KISHA Nr XI

DO NOT COPY

KISHA E SHEN KOLLIT

ZEIMEN - LEZHE





PLANIMETRIA

PLANIMETRIA





Aleksandër MEKSI

DO NOT COPY

LES EGLISES DE L'ALBANIE CENTRALE ET DU NORD (SUITE)

L'église du Monastère de Shnandou au Cap de Rodon

Les ruines de cette église se trouvent au bord de la mer, au côté Nord du Cap de Rodon. Elle n'est pas mentionnée dans les documents historiques du XIIIe et XIVe siècles, où figurent celles de Saint-Anastase, de Saint-Nicolas et de Sainte-Marie. En 1599, cette église a été donnée à la mission des franciscains et était connue sous le nom de Sainte-Marie et plus tard, puisqu'on y célébrait la fête de Saint-Antoine, elle a pris le nom qu'elle continue à porter de nos jours.

L'église est à planimétrie à une nef et se compose du narthex et du volume de l'autel. La nef et le narthex sont couverts d'un toit en bois, tandis que l'autel est couvert d'une voûte cilyndrique à profil aigü. Aussi bien dans l'intérieur que sur le côté extérieur, dans les murs latéraux passent des arcs aigus sur pilastres. Dans les niches formées ainsi dans le naos il y a des arcs aigus. Une fenêtre se trouve dans l'abside semi-circulaire. L'église est construite en pierres et en briques. La partie supérieure des murs est à cloison. En identifiant cette église avec le monastère de Sainte Marie mentionné en 1418, nous pensons qu'elle a été construite au XIVe siècle.

L'église de Saint-Vendredi à Çeta de Kavaja

Elle est mentionnée en 1691 dans un act de l'archevêché d'Ohrid. Elle comprend deux volumes couverts d'un toit à deux versants. Le plus grand volume est couvert d'une charpente en bois, alors que le plus petit, celui de l'autel – l'abside rectangle, est couvert d'une voûte à arc aigu. L'église a deux entrées sur le côté sud, dont l'une a été construite plus tard. et une au côté nord. Deux fenêtres donnent sur le côté sud. Les murs sont construits de pierres ponce, avec pilastres et assez rarement avec des morceaux de briques. L'architecture de l'église appartient à l'architecture romano-gothique et coïncide avec la propagation de l'église catholique dans ces zones. Elle est liée à l'architecture des ordres dominicain et franciscain. C'est pour cette raison que nous pensons qu'elle a été construite à la fin du XIIIe siècle.

L'église de Sainte-Marie à Sainte-Marie de Kruja

Ses ruines se trouvent au milieu des cyprès au sud du village portant le même nom. Elle présente une bazilique à trois nefs avec arcades sur pilastres. Sont encore conservés le mur nord, le mur est et des parties d'arcades. Des études effectuées il résulte que l'église appartient à trois phases de construction. A la première phase il appartient une partie de l'abside et le pilastre est de l'arcade nord, lorsque l'église n'avait qu'une nef; plus tard, l'abside et l'église à une nef même ont été agrandies; tandis qu'à la troisième phase revient sa transformation en bazilique. Intéressante est sa transformation en église du rite catholique comme le témoignent les peintures de l'abside. La première phase date des XIe-XIIe siècles, la seconde phase des XIIe-XIIIe siècles et la troisième de la seconde moitié du XIIIe siècle.

L'église de Shelbuen à Rubik

L'ancienne église mentionnée comme Saint Salvatore Arbanensis en 1166, joue le rôle du volume de l'auteur dans la nouvelle église du siècle passé. Le décor de son abside à arcs interrompus témoigne de constructions de l'architecture romanique.

Les églises du château de Shurdhah – Shkodër

Dans le château de Shurdhah – Sarda médieval sont conservées les ruines de 11 églises. Ce sont des églises à une nef, avec des absides circulaires couvertes de toits de bois, construites en pierres non taillées. Parmi elles, les églises I, XI et VI datent du bas moyen-âge. Quelques-unes des autres églises sont construites directement sur des parties du mur d'enceinte supérieur de la ville, lorsqu'il était hors d'usage. Elles ont été bâties fin XIVe siècle – début XVe siècle.

DO NOT COPY

L'église de Saint-Nicolas à Zejmen de Lezha.

Elle conserve les traces de nombreuses reconstructions. Les parties les plus anciennes, celles appartenant au mur nord, sont du XIVe siècle. Elles témoignent d'une église à arcs dans les murs longitudinaux, arcs circulaires et à converture en voûtes.

Durrës

Du grand nombre de constructions, qu'on connait de la documentation historique, dans la ville de Durrës, on conserve du moyen-âge: la chapelle de l'amphithéâtre, la basilique sous la mosquée de Fatih et une série de fragments architectoniques de l'église romanico-gothique comme des chapiteaux et des parties de couvertures en voûtes.

Lezha

On n'y conserve que les restes de l'église de Saint-Nicolas où a été enterré Scanderbeg. Des fouilles il résulte trois églises posées l'une sur l'autre. La plus ancienne appartient au milieu du moyen-âge, la seconde a été ruinée au milieu du XVe siècle et la dernière a été construite vers l'année 1459. C'est une église à planimétrie à une nef avec entrée sur le côté ouest et avec trois fenêtres étroites au mur sud.

L'étude des édifices de culte, dans les régions de l'Albanie du Nord, effectuée certes sur la base des données acquises sur place et sur les monuments déjà connus, nous donne un tableau net de leur architecture. Selon le degré de développement, de leur inclusions dans les grands courants de l'architecture médiévale et le développement général historique du pays, on distinguerait deux périodes principales. La première période va du bas moyen-âge jusqu'au XIIe siècle; la seconde période appartient aux XIIIe-XVe siècles. Dans le bas moyen-âge on relève l'utilisation des constructions de la haute antiquité, soit en le reconstruisant, soit en construisant de nouvelles constructions simples et pauvres, ceci, étant en conformité avec les conditions historiques et avec le degré du développement économique du pays. Avec la reprise du pays après les invasions slaves, on commence à reconstruire une partie des églises de la période précédente, et à bâtir de nouvelles églises, certainement simples et au décor humble. Il convient ici de les distinguer des édifices de Durrës, qui était un centre important pour l'Empire même, et qui avait un grand nombre de monuments paléo-chretiennes, dont on se servait, qu'on reconstruisait ou qu'on prenait de modèle pour les nouvelles constructions. De même, les centres épiscopaux, qui se réorganisent au même temps que s'opère la réorganisation administrative de la zone au IXe siècle.

De l'examen des monuments, il ressort que dans ces régions, les édifices à une nef constituent le type dominant en usage. Ces églises diffèrent des églises à une nef des autre contrées du pays, qui ont de petites dimensions des chapelle dans toute l'acceptation du mot, elles atteignent de grande dimensions, comme des cathédrales. En même temps certaine d'entre elles présentent des réalisations architecturales (Sain Stéphane, Shkodër, Vau i Dejës). Si dans la première période les églises du Nord sont simples et dans pas mal de cas de chapelles, dans la seconde période beaucoup d'entre elles présentent des formes évoluées architecturales. Ce phénomène apparait même dans certaines chapelles (Vau i Dejës, Rodon) ce qui n'arrive pas dans l'Albanie du Sud.

La plupart des monuments qui ont été soumis à l'analyse appartiennent à la seconde période, aux XIIIe-XVe siècles Dans cette période, surtout après l'occupation anjouine des années 70-80 du XIIIe siècle, l'influence de l'église catholique s'accroit et en conséquence les éléments de l'architecture romanico-gothique se multiplient dans notre architecture. Si dans la première période il ne s'agit que de leur influence, comme c'est le cas de l'église de Rubik, dans la seconde période, tant au Nord, par l'intermédiaire de l'archevêché de Tivar, qu'en Albanie Centrale, au moyen de Durrës, il y a des constructions pour lesquelles sont intermédiaires les ordres franciscains et dominicains qui entreprennent la construction de plusieurs monastères dans les centres principaux et à l'intérieur du pays, jusqu'aux zones de Durrës (Shkodër, Rodon, Çetë). Les liens avec l'architecture occidentale doivent donc être considérés de deux façons. Au début comme des influences sur une architecture traditionnelle et plus tard comme une activité de construction des écoles d'architecture de la côte dalmate sud, de l'Albanie du Nord et de Durrës. Leur construction s'inclue dans l'architecture romanico-gothique, selon laquelle, au cours du moyen-âge moyen, se construisent les temples du rite catholique en Italie du Sud, d'où proviennent les influences et d'où l'on prelève les modèles dans des cas particuliers. Ainsi, chez nous, n'y a-t-il pas d'architecture gothique proprement dite, mais une architecture romanique à éléments et à structure gothique. Ces éléments et ces formes sont notamment les moyens de ces écoles.

Leurs caractéristiques sont la technique de construction en pierres, au commencement peu taillées et plus tard bien taillées surtout aux côtés, aux portes et fenêtres. Ces pierres sont plus longues que hautes, mais pendant le XVe siècle elles tendent à prendre des formes carrées. Les murs sont aux pilastres reliés à des arcs pleins, les arcs et les voûtes sont au profil aigu, l'édifice s'élève verticalement, les coupoles et en général les formes à une nef manquent.

A côté, il y a un grand nombre de constructions simples réalisées par des maitres populaires dans presque tous les villages. Le seul trait commun entre ces constructions et celles mentionnées plus haut sont les arcs aigus des fenêtres.

Comme on l'a déjà souligné au début du présent article, les données sur l'architecture paléo-chrétienne, dans cette contrée, à l'exception de Durrës et ses environs, sont moindres.

On peut toutefois dire que c'est dans les constructions de l'Albanie du Nord, aux caractéristiques nettes typologiques à une nef et réalisées selon la technique de construction en pierres, qu'il faut voir les racines de la tradition la plus ancienne, tradition qui, après l'occupation turque, s'étend sur toute la côte sud de Dalmatie et de l'Albanie du Nord. Il convient de citer ici Frang Bardhi qui a dit que les églises du Nord sont petites, sans clocher, avec des peintures de style byzantin, sans plancher, leur entrée principale donne sur l'Ouest. Cette architecture est conditionnée aussi du niveau général du développement économique et de la conjoncture politique. Les éléments de tradition n'ont pas permis la pénétration de l'architecture byzantine du XIe-XIVe siècles, comme dans les zones anciennes de l'Albanie. Il faut d'autre part tenir compte du fait que le Nord se détache de l'empire byzantin à la fin du XIIe siècle, tandis que sur le plan religieux, ceci était advenu bien avant. Dans les environs de Durrës, où ont coexisté les deux rites et où l'architecture byzantine a eu des applications évidentes, on s'aperçoit de l'utilisation de la technique du cloison même dans des églises de l'architecture romanico-gothique (Rodon) et dans les constructions de défense comme dans le château de Rodon et celui de Krujë.

Etendues entre l'Archevêché de Durrës et de Tivar, les contrées de l'Albanie Centrale et du Nord présentent une entité architecturale aux traits communs, tant dans la construction planimétrique et volumétrique, que dans la technique de construction, ceci étant le résultat des traditions architecturales, des conditions économiques et sociales et du niveau culturel similaires. De ces deux centres principaux, le rôle de Durrës devient de plus en plus grand, surtout dans la seconde période. Cette architecture se trouve depuis les régions de Durrës, Krujë, Lezhë e Shkodër, jusqu'à Shas, Ulqin, Rotec et Tivar, zones où les albanais, en tant que population et maîtres constructeurs, constituent la majorité.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

BEP JUBANI

MONUMENTE ARKEOLOGJIKE NË MBISHKODËR

«Mbishkodër» është makrotoponimi gjeografik që përmbledh fushën dhe një pjesë të maleve në veri të qytetit të Shkodrës. E përmendur për herë të parë nga humanisti i shquar shqiptar Marin Barleti[1], ky toponim ruhet i gjallë edhe sot në të folmen e vendasve.

Fusha ndodhet në një lartësi 10-200 m mbi nivelin e detit. Pjesa e fushës në drejtim të liqenit të Shkodrës, dhe ajo në drejtim të Gruemirës e të Kastratit ka toka të buta, më të përshtatshme për bujqësi. Pjesa tjetër nuk është pjellore, vende-vende bile ka pamjen e një toke të varfër, me gurë të shumtë. Në këtë zonë, gjatë verave të viteve 1981--1983, kemi kryer disa ekspedita përnjohëse, me qëllim kryesor që të vihen në dukje qendrat arkeologjike që ruan krahina e Shkodrës. Për qendrat arkeologjike të këtij rrethi, në vitet e paraçlirimit[2] janë botuar disa të dhëna, megjithatë ekspeditat e tre vjeteve të fundit kanë zbuluar shumë monumente dhe qendra të reja, të rëndësishme arkeologjike.

Me qenë se qendrat e zbuluara arkeologjike (fig. 1) i përkasin në pjesën më të madhe periudhave të veçanta kronologjike e kulturore, jemi përpjekur t'i japim të renditura sipas kohës që i takojnë.

1) **Egsh.** Thellë në këtë fshat, në faqen lindore të malit të quajtur «Qetat e Sheut», ndodhet një shpellë e madhe, e quajtur «Shpella e Hurdhës», ndodhet aty ku përzihen Gurra e Kurtajve me Sheun e Rrjollit në afërsi të madhe me bregun e përroit. Shpella ka një hyrje të gjërë dhe është mjaftë e gjatë. Ka një pozicion të mbrojtur shumë mirë nga erërat (fig. 2). Në afërsi të hyrjes dalluam një shtresë kulturore jo shumë të trashë, të përbërë prej dheu, kocka kafshësh dhe vegla pune prej stralli. Materialet e mbledhura në dheun e shkriftosur të shpellës i takojnë periudhës së mezolitikut. Disa objekte lenë të dyshohet për gjurmë më të hershme në shpellë, ndoshta edhe të periudhës paleolitike. Është shpella e parë mezolitike që zbulohet në vendin tonë. Shpella ka pasur dëmtime natyrore rrëshqitje të shtresave të dheut dhe të shkëmbenjve nga pjesët më të larta të saja.

Në anën tjetër të Sheut të Rrjollit, në të majtë të tij, ka edhe shpella të tjera si Shpella e Thatë, ajo e Kaçurrelit, shpella e Çel Dukës etj. që ka mundësi të përmbajnë materiale arkeologjike.

2) **Shkrel, fshati Dedaj**[3]. Në tokat e këtij fshati, në drejtim të Lohes dhe të Zagorës, shtrihet një nekropol i gjërë ilir, i përbërë prej më se 40 tumash, të ngritura kryesisht prej gurësh (Tab. I. 1). Tumat në përgjithësi janë me përmasa mesatare, po ka edhe tuma me diametër rreth 5-6 m ose të tjera me diametër mbi 25 m. Tumat janë të ndërtuara kryesisht prej gurësh mali e gurë tarracore, me pak përzierje dheu. Në dy raste, në majë të tumave, shihen edhe tani vonë varre ciste, të punuara me pllaka gurësh.

Në vitin 1979 janë bërë gërmime të rastit në 5 tuma; nga kontrolli i tyre në 1981 del që materialet e mbledhura i takojnë periudhës së bronxit të hershëm. Vetëm në njërën nga këto tuma, në gropën e

1) M. Barleti, **Historia e Skënderbeut,** Tiranë 1967, f. 156.

2) Një përmbledhje e këtyre të dhënave lexuesi mund ta gjejë në bibliografinë e L. Reit, **Repertoire topo-bibliographique des antiquites, de l'Albania,** «Albania», Paris 1928, fq. 45-49;

3) Njoftimin për këtë varrezë e ka dhënë arsimtari i fshatit Zamir Tafilica.

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

bërë në mesin e saj, mblodhëm 170 copa enësh, të teknikave të ndryshme të punimit, e me motive të shumta që i takojnë kulturës ilire Kotorac-Cetina të bronzit të hershëm (Tab. II, 9). Në vitin 1983 kemi zhvilluar gërmime të rregullta arkeologjike, u hapën 3 tuma në të cilat u zbuluan qindëra copa enësh të kësaj kulture.

3) **Gradiskije.** Nën një strehë të madh guri, në thellësi rreth 1 m, gjatë punimeve të rastit janë zbuluar dy sëpata shqiptare-dalmate (fig. 3). Sëpatat kanë qenë të futura në një enë balte me faqe të lustruara.

4) **Boks.** Në malin që ndodhet rrëzë këtij fshati, në fushën e Shtojt e fshehur në mes shkëmbenjëve është gjetur një sëpatë shkodrane (fig. 4) që ruan disa elemente të reja në formë, që e lidhin mirë me sëpatat shqiptare-dalmate.

5) **Dragovojë.** Përreth këtij fshati, në fushën e Pustopojës ruhen disa tuma. «Suka e Lalës» është e tëra e ndërtuar prej gurësh, kurse «Suka te lugu i Çokut» është më shumë e grumbulluar me dhe. Anash saj janë «Suka e Shegës», «Suka e Trojeve» dhe tuma të tjera.

6) **Kosani.** Në këtë fshat ruhen 4 tuma. Tri prej tyre janë të vogla dhe të ngritura kryesisht prej dheu. Tuma tjetër, më e madhja, ka një veçori që nuk vërehet në asnjë tumë të vendit tonë. Tuma është e ngritur e tëra prej gurësh tarracorë, të rrumbullakuar, në përmasa sa të zë dora (Tab. I, 2). Në pjesën e qendrës dhe anave duhet të ketë edhe përmbajtje dheu. Në brendësi, tuma ka edhe përmbajtje çakëlli. Diametri i tumave është 24-40 m.

Në tokat e quajtura «Kiza», ndodhet një vendbanim shumë i hapët ilir që shkon deri në breg të liqenit, por që siç duket nga kanalizimet bujqësore të kryera aty, shtresën kulturore nuk e ka shumë të trashë. Në tokën e punuar të vendbanimit gjenden barqe amforash dhe enësh ilire ngjyrë gri në të zezë, tulla me trashësi 4,2-4,5 cm (Tab. III, 37-39).

7) **Kodrat e Moksetit.** Në këtë vend ruhen tri tuma prej dheu, të përmasave rreth 20 m. Në anët e gropave të bëra në dy tuma u zbulua një copë kafkë e djegur, një fund amfore tryeze e shek. VI-V p.e. sonë, barqe enësh ilire mjaft të trasha, gri në të zezë, me punim mjaft të dobët, dhe copa balte me gjurmë të mureve të shtëpiave dhe i një fragmenti ene të vogël të punuar me çark këmbe.

8) **Gruemirë.** Në tokat e quajtura «Kasare», në të djathtë të Sheut të Rrjollit, ruhen tri tuma dheu e gurësh. Një kanal i hapur në një tumë tregon se në to ka edhe varrime të periudhës qytetare ilire. Sipas të dhënave kur janë hapur për herë të parë



Fig. 3



Fig. 4

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6





Fig. 7

këto toka, janë zbuluar varre të mbuluara me tjegulla të mëdha.

9) **Lohe e poshtëme.** Gjatë punimeve bujqësore, rrëzë malit, është zbuluar një vegël bujqësore hekuri, objekt i rrallë në gjetjet ilire (fig. 5), e ngjashme me ato të zbuluara në Melgush të Shkodrës, e shek. III-II, p.e.s.[4].

10) **Marshej.** Materialet më të hershme të mbledhura në këtë vend i takojnë shek. VI-V p.e.sonë dhe vazhdojnë deri në shek. IV të e.sonë. Materiali më i hershëm përfaqësohet nga copa amforash korintike, një fund kiliku dhe buzë tasi (Tab. II, 12-14) të shek. VI-V p.e.sonë. Këta dy të fundit janë në ngjyrë të kuqërremtë. Shekujt III-II p.e.sonë i takon një peshore balte, kurse me pushtimin romak lidhen disa copa amforash (Tab. II, 12). Në qytezë ruhen gjurmët e dy çisternave për ujë në pjesën veriore dhe në atë jugore. Përmasat e tyre janë përkatësisht 9 x 3.50 m dhe 9 x 2 m. Muret, me gjërësi rreth 0.60 m, janë të suvatuara në pjesën e brendëshme me gëlqere, të përzierë me pluhur tullash.

Në tokat e quajtura «Çokaj» janë zbuluar dy sopata hekuri[5] të mesjetës së zhvilluar (fig. 6,7).

4) M. Dibra, **Një depo me vegla bujqësore ilire nga fshati Melgush i rrethit të Shkodrës,** «Iliria», 1981, 1, fq. 235, Tab. I, 1, 5.

5) Një sëpatë e ngjashme është gjetur në Elbasan, N. Ceka, L. Papajani – **Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike** «Monumentet» 1970.

DO NOT COPY

11) **Grizhë.**[6] Në zonën e këtij fshati ndodhen disa qendra arkeologjike të periudhave të ndryshme.

a) Rrëzë malit të quajtur Burgu i Baliajve ruhen katër tuma të ngritura në pjesën më të madhe me gurë të thyer mali (Tab. I, 3). Tumat kanë diametër 16-30 m. Njëra prej tyre dallon për nga forma elipsoidale. Ajo i është mveshur shkëmbit natyral. Në anën lindore tuma ka edhe një zgjatje gurësh në trajtë dromosi. Në vendet ku tumat janë zhveshur nga gurët sipërfaqësorë duket edhe përmbajtja e çakellit në tumë. Ato janë të paprekura. Në njërën tumë, në majë të saj, në mes gurësh të sipërfaqes, u gjetën 3 copa enësh ilire të hekurit të hershëm. Afër shtëpiave, në lagjen Baliaj, ruhet një tumë tjetër por prej dheu me diametër rreth 14 m. Para disa vjetësh në të është hapur një gropë në faqet e së cilës u gjetën copa enësh ilire të shek. VI-V p.e.sonë dhe një fund kiliku i ngritur, i zbukuruar në pjesën kupacore me rrathë koncentrikë verniku të zi. Në të ruhen gjurmë rituale të gërvishtjes me thua dhe ciflosje.



Fig. 8a

b) **Burgu i Gorajës**[7] Mbi majën e malit omonim ndodhet një vendbanim i fortifikuar ilir (fig. 8). Muret mbrojtëse ruhen mirë në faqen verilindore të kodrës dhe në perëndim të saj, megjithëse ka gjurmë të tyre edhe në pjesë të tjera. Në të gjitha rastet më mirë ruhet faqja e jashtme e mureve. Muret në shikim të parë duken që janë të tipit të Gajtanit, megjithatë në shumë vende ndryshojnë, sepse kanë një punim guri më të mirë e më të rregullt, me sheshim të faqeve. Gurët, në faqen që mbetet në brendësi të murit, janë të papunuar dhe vetëm disa prej tyre kanë faqe të rregullt. Foletë e shkëmbit ku është vënë guri i murit janë mbushur, për nivelim janë përdorur gurë të vegjël. Në këto mure dallohen edhe gurë transversalë, përforcues të trashësisë së mureve.

Gurët e faqeve të murit kanë forma të shrregullta, por ka prej tyre edhe me forma katërkëndëshe. Në pjesën jugperëndimore të qytezës ka edhe gurë të punuar, të pa vënë në murë, ashtu si edhe gurë të thyer, të dalë nga punimi i gurit. Përmasat e gurëve të murit janë 1.30 x 0.80 m, 0,93 x 0,27 m, 0.35 x 0.37 m etj.

Në qytezë ka një shesh të mirë, megjithatë shtresa kulturale e saj, siç duket është mjaftë e hollë. Në sipërfaqe është mbledhur material arkeologjik që shkon në kufitë nga shek. VI-V p.e.sonë deri



Fig. 8b

6) Vrojtimet arkeologjike në këtë fshat u bënë sipas të dhënave gojore të arsimtarit Rrok Kurti.

7) Në këtë zonë ndeshet veçanërisht shpesh toponimi «Burg» gjithnjë i shoqëruar me mbiemrin përkatës, Malësorët me këtë fjalë (ndoshta me prejardhje kelte) kuptojnë majë mali, ku njerëzit qëndrojnë për të luftuar, ose majë mali ku pushojnë barinjtë.

DO NOT COPY

në shek. II të e.sonë. Më të hershme janë amforat korintike (Tab. II, 4-8) dhe amfora të tjera të fillimit të pushtimit romak (Tab. II, 2). Në një nga vegjat korintike duket edhe një shenjë e punuar me vernik të zi (Tab. II, 7). Disa gryka amforash janë të lyera tërësisht me vernik të zi, të hollë. Qeramika lokale është e përfaqësuar më pak barqe ngjyrë gri, me vegje dyvegjakeshe ngjyrë të kuqërremtë dhe barqe tasash të së njëjtës ngjyrë që duhet të lidhen me prodhimtarinë e shek. VI-V p.e.sonë të Shkodrës. Është gjetur edhe një buzë ene, me faqe ngjyrë gri (brumi është kafe) me motivin shiritor me gropëza (Tab. II, 4-5) që si paraqitje duket se lidhet me shumë me periudha më të hershme, ndoshta me periudhën e bronxit. Kujtojmë këtu se në malin e Qytezës ndodhet një shpellë, në drejtim të «lugut të lugjeve» që ndoshta ka qenë banuar më herët.

Në sheshin e qytezës u gjetën edhe gurë mokrrash katërkëndëshe, një monedhë e Shkodrës e shek. III-II p.e.sonë, pjesë peshoresh prej balte të pjekur, copa enësh me vernik të zi të shkëlqyeshëm të shek. IV-III p.e.sonë etj.

c) Në fshatin Grizhë, gjatë mesjetës, rreth shek. XV-XVII, siç duket ka pasur një banim të dendur, prandaj edhe në disa vende gjenden gjurmë të ndryshme banimesh. Në lagjen Gjorm i poshtër, në tokat e quajtura «Qehaja», ndodhet një vendbanim shumë i gjërë. Për nga hapësira që zë është vendbanimi më i madh i hapur mesjetar që kemi ndeshur deri tani në Mbishkodër. Sipas vendasve, dikur këtu dukeshin edhe rrënojat e banesave. Me shumicë këtu gjenden copa tjegullash dhe copa tullash të trasha 3-3.5 cm. Qeramika e vogël është më e pakët, ndeshen zakonisht pjesë vorbash me faqe të kuqërremta, me njolla të zeza e thërmia të shumta kuarci. Një pikë e banuar e kësaj kohe ndodhet edhe në vendin e quajtur Këtosh (Kça, Kçar, Gërçar), me materiale të pakta qeramike.

ç) Në lagjen Dudë të Grizhës ruhen rrënojat e një kishe mesjetare, me gurët e murit të latuara me forma katërkëndëshe. Përmasat e godinës janë 10 x 7 m. Në anën lindore të ndërtesës duken edhe gjurmët e absidës. Këtu përreth kanë qenë edhe «Varret e Dudës». Materiali i gjetur është i pakët, qeramika e kuqërremtë me shumë kuarc.

d) Në juglindje të Burgut të Gorajës, jo shumë larg tij, ndodhet «Kodra e Gjodedës»[8], kodër e butë shkëmbore. Në të ruhen gjurmë të një vendbanimi mesjetar, të shek. XV-XVII, këto janë rrënoja banesash të cilat dikur kanë zënë një hapësirë të madhe të kësaj kodre. Në ograjat e quajtura «Shkoza» është një ndërtesë elipsoidale e punuar me mure të thatë (fig. 9), me gurë të mëdhenj, të thyer, ndonjë herë edhe me një farë latimi. Ka edhe gjurmë banesash katërkëndëshe. Në vendet e banesave gjendet qeramikë e kuqërremtë, okër, me pak gri në të zezë dhe qeramikë me zmalt ngjyrë kafe të çelët (Tab. II, 16-19).

Vendbanimi ka qenë i rrethuar me mure mbrojtës, me lidhje gurësh në të thatë. Trashësia e murit shkon rreth 1.50 m.

12) **Grudë.** Në tokat buzë liqenit ndodhet një tumë që mban emrin «Suka e Begoviqëve» me përmasa mbi 2 m lartësi e diametër rreth 30 m (Tab. I, 4). Tuma është ndërtuar me dheun e arës, me shumë zhavor. Në një kanal të bërë u gjet profili i një dyvegjakeje shpatullartë e shek. VI,-V, p.e.sonë.

13) **Grilë.** Në tokat e këtij fshati ruhen 4 tuma të ndërtuara prej dheu. Gjithashtu, në një vend në afërsi të serave të fshatit, ka qenë një pus i vjetër. Kooperativistët janë përpjekur për ta pastruar, por gjatë punimeve kanë ndeshë në një këmbanë mesjetare, paraturke, që nuk i lejon të vazhdonin punimet. Këmbana ruhet akoma sot në thellësi të pusit.



Fig. 9

8) Në këtë toponim ndoshta duhet të gjejmë gjurmët e një toponimi më të vjetër, por të ndryshuar, kodra e Qytetzës.



Fig. 10

14) **Vorfë**[9]. Në perëndim të fshatit të shënuar ndodhet qyteza, një vendbanim i fortifikuar ilir. Kjo qytezë ka një veçori se muri rrethues shkon jo vetëm në majën e malit, por ai qarkon edhe një tarracë që është shumë poshtë majës së malit, duke krijuar kështu kuptimin e dy mjediseve të mëdha të këtij vendbanimi, me qytezën e sipërme dhe atë të poshtëme. Edhe këtu si në fshatin Grizhë ruhet kryesisht faqja e jashtëme e mureve me mbushjen e brendëshme të tyre. Teknika e punimit të gurëve të murit është e ngjashme më shumë me disa pjesë të



Fig. 11

mureve të qytezës së Burgut të Gorajës. Në të dy këto vendbanime vërehet një farë punimi më i mirë i gurëve, kryesisht me sheshimin e dy faqeve horizontale (fig. 10). Ndoshta në këto dy vendbanime duhet të kërkojmë një fazë të ndërmjetme kohore në mes mureve të Gajtanit dhe atyre të periudhës së lulëzimit të kulturës qytetare ilire për pellgun e Shkodrës. Në këtë qytezë duken edhe gjurmë muresh të lidhura me llaç gëlqereje, që i përkasin ndoshta periudhës së vonë antike.

Shtresa kulturore në vendbanimin nuk është e trashë. Nga gjetjet sipërfaqësore janë mbledhur buzë amfore korintike të shek. V. p.e.sonë, dhe amfora të shek. II-I p.e.sonë (Tab. III, 32). Ndeshen copa solenesh, zgjyrë hekuri. Në një vegje amfore duket gërvishtja rituale me thua.

15) **Rrafsh – Vorfë.** Në vendin e quajtur Pirove është një vendbanim i hapët, i mesjetës së zhvilluar (Tab. II, 15) ndoshta edhe me një banim më të hershëm të periudhës antike të vonë. Mbështetemi për këtë në copat e qeramikës së gjetur në këtë vend. Vendbanimi është shtrirë edhe në malet Ndrukej. Sipas të dhënave gojore, në këtë fshat janë zbuluar edhe varre me tjegulla të mëdha.

16) **Kalldrun.** Kjo qendër është e njohur me gërmimet arkeologjike të kryera në vitin 1963[10], të cilat zbuluan një varrezë të shek. III-II të e.sonë. Këto punime u kryen në tokat e quajtura «Snavraçe», ku dhe sot gjenden në sipërfaqe copa tjegullash të vogla (Tab. II, 25-26), bashkë me to u zbulua edhe një shatë hekuri (fig. 11) i dalë në sipërfaqe nga punimet bujqësore.

Përtej fushës së Snavracës, ngjitur me të, ndodhet një vend i quajtur «Suka e Cenit» në të cilën u zbuluan copa amfore të shek. II-I p.e.sonë dhe mjaft forma enësh të shekujve të parë të e.sonë (Tab. II, 20-23), që i përkasin një vendbanimi të vogël të hapët, të kësaj kohe. Gjetja këtu shpesh herë e qeramikës së zbukuruar me krehër (Tab. II, 20), qeramika e cila në shek. IV të e.sonë punohet me shumicë në të gjithë Shqipërinë e Veriut, jep edhe kohën, kur u zhvillua jeta në këto dy pika. Këtu u gjetën edhe copa enësh të lyera me zmalt në ngjyrë ulliri të çelët, ndeshen copa tullash 4 cm të trasha. U gjet edhe një monedhë bronxi e shek. IV të e.sonë.

Shtresa kulturore në këtë vendbanim, sipas vrojtimeve në kanalet bujqësore të fushës, duket se nuk është shumë e trashë, rreth 40 cm.

9) Njoftimin fillestar për këtë qytezë e kemi marrë nga arsimtari Dedë Ashta.
10) S. Anamali, D. Komata, **Varreza e Kalldrunit (Koplik)** «Kumtari i Muzeut Popullor të Shkodrës», Shkodër 1978, 3-4, fq. 96.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 12

Në këtë fshat ndodhet edhe një vendbanim i vogël i mesjetës së zhvilluar, ku u zbuluan copa tjegullash, barqe vorbash ngjyrë okër, gozhda hekuri etj. Vendbanimi ndodhet buzë rrugës që të çon në fshatin Flakë.

17) **Stërbeq.** Në tokat e quajtura «Gropa» në perëndim të fshatit Jubicë, në një arë, gjenden barqe amforash të shek. II-I p.e.sonë, ashtu si edhe copa qeramike të shek. IV të e.sonë[11]) (Tab. III, 33, 34, 36). Afër këtyre tokave gjendet një kodër në pamjen e një tume të madhe, ku bëhen varrimet e fshatit sot. Këtu mendohet se ka qenë një kishë e madhe.

18) **Potgorë.** Në majë të malit të këtij fshati ndodhet «Qyteza e Potgorës» vendbanim i shek. IV të e.sonë (fig. 12). Qyteza ka një terren shumë të thyer. Në krahun perëndimor të saj ruhen gjurmët e dy mureve të ngritura në puthitje me njëri tjetrin, me trashësitë 1.38 m dhe 0.80 m (fig. 13). Muret ruhen me lartësi 2 m. Përmasat e gurëve të mureve janë 0.48 x 0.20 m dhe 0.20 x 0.15 m. Duket një përpjekje për t'i punuar gurët në formë katërkëndëshi. Gurët janë të lidhura në mur me llaç gëlqereje.

Gjetjet arkeologjike janë të pakta, si barqe amforash të kuqërremta, disa edhe me kanelyra të theksuara si në vendbanimin e Kalldrunit, dhe më pak copa tjegullash. Varreza e kësaj qyteze ndodhet në vendin e quajtur «Zalli i Banushit». Këtu para rreth 15 vjetësh është zbuluar një varr i punuar mjaft mirë, me gurë të lidhur me llaç gëlqereje dhe i suvatuar përbrenda, me gjatësi rreth 2.40 m. Materialet e mbledhura nga arsimtari Loro Mazi, përbëhen shin nga enë qelqi dhe fibula bronxi, kokë qepe të shek. IV të e.sonë.

19) **Koplik.** Në të dalë të qytetit, në drejtim t Hanit të Hotit, majtas, ndodhet një kodër natyrore me diametër rreth 100 m, në tokat e quajtura Ku llolle. Gjetjet e shumta të copave të tjegullave tre gojnë se aty ka qenë një vendbanim mesjetar. Copa e enëve të gjetura janë të pakta. Përkrah qeramikës së zakonshme (Tab. III, 50) gjenden edhe copa t lyera me glazura kafe të çelët, në ngjyrë mjalti. Ndë to ka edhe copa enësh të thjeshta me çark këmbe në ngjyrë gri të çelët dhe të kuqërremta.

Në tokat e quajtura «Puçela» gjatë punimeve bujqësore janë zbuluar tuba dheu. Këtu ka qenë një burim natyror, e vetmja çezmë, në fushën e Mbishkodrës, kështu që me sa duket këta tuba i përkasin ndonjë ujësjellësi të nëndheshëm.

Në Culaj të Koplikut, ndodhet një kodër natyrore, në forma tume, që ka qenë e banuar rreth shek. IV-III p.e.sonë. Në kanalizimet bujqësore të kryera u zbuluan copa kantari të lyera me vernik të zi të shkëlqyeshëm, barqe enësh vendase të punuara



Fig. 13

11) Është gjetur edhe një thikë e vogël, me një formë krejt të veçantë, sepse thumbin që kapesh në dorezë e ka në pjesën më të ngushtë të thikës (Tab. III, 35). Me sa duket objekti ka patur formën e ndonjë biçaku.

DO NOT COPY



Fig. 14

me çark këmbe, me faqe roze okër dhe copa enësh ilire ngjyrë të zezë karbon të shek. VI-V p.e.sonë.

20) **Koplik i sipërm.** Në fushën e quajtur «Nën Sukë» ndodhet një vendbanim i hapët i mesjetës së zhvilluar rreth shek. XV-XVII. Qeramika e zbuluar (me ngjyrë të kuqërremtë) është e pakët.

Në vendin që mban toponimin «Ndërkishë» flitet ka qenë një godinë kulti mesjetar. Ruhen pjesë muresh me qoshe të latuara, të lidhura me llaç gëlqereje. Në këtë vend gjenden copa vorbash (Tab. II, 16).



Fig. 15



Fig. 16

21) **Lepurosh.** Buzë rrugës automobilistike, në pyllin e gështenjave janë zbuluar varre të mesjetës së hershme shqiptare, me ndërtim shumë të rregullt. Varret janë me pllaka guri (fig. 14). si ato të Komanit, pllakat janë të përmasave 0,50 x 0,30 m. Gjërësia e një varri të zbuluar përgjysëm, rastësisht, është 0.50 m.

22) **Letaj.** Në majë të malit ndodhet «Qyteza e Letajve», një qendër që ka shërbyer, me sa duket, më shumë për t'u mbrojtur në raste të veçanta, se sa për banim të përhershëm, që duhet të jetë e shek. XV.

Maja e malit, sidomos ajo e faqes lindore, është e fortifikuar me një mur të thatë, 1.80 m të gjërë,



Fig. 17



Fig. 18

i punuar me dy faqe gurësh, të mëdhenj, të pa latuar, me përmasa 0.47 x 0.60 m, 0,80 x 0,60 m. Brendësia e murit është mbushur me gurë më të vegjël, të thyer. Në qytezë nuk duket të jetë e formuar ndonjë shtresë kulturore prandaj themi që ajo duhet të ketë patur më shumë karakter mbrojtës, në raste të veçanta sulmesh të jashtëme.

Banesat e fshatit ruhen, poshtë faqes perëndimore të qytezës, aty afër ku ndodhet edhe kroi i Letajve, i punuar me gur të latuar (fig. 15). Janë një sërë taracash, kullosa, ku gjenden copa qeramike të mesjetës së zhvilluar, në ngjyrë kuqërremtë, poroze dhe tjegulla e zgjyrë hekuri. Në toka të tjera të këtë fshati, të quajtura «Trojet e Letajve» megjithëse nu duken gjurmë banesash, ka mjaft copa enësh mesjetare (Tab. III, 40, 41, 42). Letajt kanë pasur edh godinën e tyre të kultit që ruhet në forma rrënojash në fushë (fig. 16). Më mirë ruhet faqja lindore, rret 35 m e gjatë. Muret janë të trasha 0,60 m. Duke edhe harku i një porte të mbyllur, me gjërësi rreth 2,5 m. Është kishë mesjetare, para pushtimit osman e përmendur edhe nga burimet historike të kohës, ndërtesë e prishur nga pushtuesit.

23) **Linaj.** Në kryqëzimin e dy rrugëve që të çoj në nga Linaj për në Gruemirë, në vendet e quajtu «Muret» dhe «Kopshtijet» ruhen dy vendbanime t mesjetës (XV-XVII); në vendbanimin e parë duke planimetri banesash (fig. 17, 18). Njëra nga ato, m formë katërkëndëshe është e gjatë rreth 24 m, m dy mjedise të ndara me mure. Muret kanë trashës 0,80 m, të punuar me gurë e lidhje llaç gëlqereje Ka edhe ndërtime elipsoidale me mure të punuar m gurë të thyer, pa lidhje llaçi. Vendbanimi ka qenë rrethuar me mure mbrojtës, të gjërë 1,80 m, i punuc me gurë të mëdhenj, vetëm të thyer me dy faqe. N këtë fshat mesjetar ruhen edhe dy gryka çisternas njëra katërkëndëshe dhe tjetra e rrumbullakët. N vendbanim ka mjaft gjetje copash të ndryshme enës (Tab. III 43-48).

24) **Kurtaj.** Në lagjen Gjilaj është një vendba nim i mesjetës së zhvilluar. Në brazdat e punuara t arës ka material të ndryshëm qeramik të kësaj koh (Tab. III, 49, 53, 54); në këtë fshat banorët venda mbajnë mend që janë zbuluar varre me tjegulla.

DO NOT COPY



1



2



3



DO NOT COPY



DO NOT COPY

TAB. III



DO NOT COPY

Bep JUBANI

MONUMENTS ARCHEOLOGIQUES A MBISHKODËR

DO NOT COPY

Le macrotoponyme «Mbishkodër» inclue la plaine et une partie des montagnes au Nord de la ville de Shkodër. Mentionnée pour la première fois par le célèbre humaniste albanais Marin Barleti, ce toponyme est encore vivant dans le parler des habitations de cette région.

Au cours des étés 1981-1983, on a entrepris des expéditions dans cette zone, afin de mettre en évidence les sites archéologiques qui y sont conservés. Avant la libération, certaines données sur les sites archéologiques de la région de Shkodër ont été publiées, de façon sommaire, par L. Rey dans son Répertoire topo-bibliographique. Toutefois les expéditions entreprises ces trois dernières années ont découvert de nombreux monuments et d'autres sites archéologiques importants, dont les principaux sont examinés dans cet article.

1) Egsh. *Dans un recoin de ce village se trouve une grande caverne appelée «Shpella e Hurdhës». Cette caverne est assez profonde et dispose d'une grande entrée. Elle est bien protégée des vents (fig. 2). A proximité de l'entrée on a distingué une couche culturelle pas très épaisse, faite de terre, d'ossements d'animaux et d'outils en silex. Les objets découverts datent de la période du mezzolitique. Certains objets laissent à penser à des traces antérieures, probablement même de la période paléolitique. C'est la première caverne mezzolitique découvrte dans notre pays.*

2) Shkrel, *village du Dedaj. Là s'étend un vaste nécropole illyrien, composé de plus de 40 tumulus principalement élévés avec des pierres. Les tumulus sont de taille moyenne mais, il y en a qui ont un diamètre d'environ 5-6 m et d'autres de plus de 25 m. Les tumulus sont faits de pierres avec un mélange de terre. Dans deux cas, au sommet des tumulus, on voit toujours des tombes cistes, construites avec des plaques de pierres.*

En 1979, on a entrepris des fouilles dans 5 tumulus. De l'examen des objets effectué en 1981, il ressort qu'ils appartiennent au bas âge du bronze. Rien que de l'un de ces tumulus, du trou creusé au milieu de lui, on a retiré 170 récipients de la culture illyrienne Kotorac-Cetina de la même époque (tabl. I, 4). En 1983, des fouilles régulières ont été entreprises dans ces tumulus; on a fouillé 3 tumulus et l'on a découvert des centaines de récipients de cette culture.

3) Kosan. *Dans ce village sont conservés 4 tumulus. Le plus grand tumulus est fait de pierres arrondies de petite taille (Tabl. V, 2). Dans la partie centrale et sur les côtés il paraît avoir aussi de la terre.*

4) Grizhë. *Dans ce village il y a quelques centres archéologiques de diverses périodes.*

a – Au pied de la montagne appelé Burgu i Baliajve sont conservés quatre tumulus, construits dans la plus grande partie en pierres de montagne (Tab. V, 3). Les tumulus ont un diamètre de 16-30 m. A l'Est de l'un de ces tumulus se trouve une saillie de pierres en forme de dromos.

b – Burgu i Gorajës. *Au sommet de la montagne portant le même nom se trouve une cité fortifiée illyrienne (fig. 8). A première vue, les murs semblent être du type de Gajtan (fig. 9, 10), en tout cas, à divers endroits ils diffèrent, ayant des pierres mieux taillées et régulières, aux faces horizontales applaties.*

c – Dans le village de Grizhe, au Moyen-Age, vers le XVe-XVIIIe siècles, il y a eu une cité habitée, c'est pourquoi dans certains endroits on relève diverses traces d'habitations. Dans le quartier de bas Gjorm se trouve une cité vaste ouverte; il s'agit de la plus grande cité médiévale qu'on a découvert jusqu'à ce jour à Mbishkodër. Dans le quartier de Bude de ce village sont encore conservées les ruines d'une église médiévale en pierres polies de forme rectangulaire. Les dimensions du bâtiment sont de 10 x 7 m. Au Sud-Est du Burgu i Gorajes, pas très loin se trouve «Kodra e Gjodedës», cité médiévale des XVe-XVIIe siècles. Des ruines d'habitations rectangulaires, et éllypsoïdales sont encore conservées. La cité a été protégée d'un mur d'enceinte en pierres sèches.

5) Vorfe. *Dans ce village se trouve un centre habité illyrien. Cette cité a une particularité: le mur d'enceinte non seulement va jusqu'au sommet de la montagne, mais il entoure aussi une terrasse, qui se trouve bien plus bas que le sommet de la montagne, en créant ainsi deux grands milieux de cette cité, la cité supérieure et celle d'en bas. Les murs ressemblent à ceux de la cité de Burgu i Gorajës, surtout par l'aplatissement des deux faces horizontales (fig. 12, 13). Dans ces deux cités, il faut probablement chercher une phase tem*

porelle intermédiaire entre les murs de type Gajtan et ceux de la période de l'épanouissement de la culture citadine illyrienne dans la région de Shkodër. On y conserve également des traces de murs liés avec du mortier de chaux, appartenant probablement à la haute période antique.

6) Potgore. Au sommet de la montagne de ce village se situe «la cité de Potgore», centre habité au IVe siècle de notre ère (fig. 15). Les murs ne sont pas bien conservés; leur épaisseur est de 1,38 et 0,80 m.

7) Lepurosh. Dans la forêt des châtaigneurs de ce village on a découvert des tombes du bas moyen-âge albanais, des tombes du type de Koman, avec des plaques de pierre. (tabl. V, 5).

8) Letaj. Au sommet de la montagne se trouve la cité des Letaj. C'est un centre qui apparemment a servi plutôt à la défense à des cas particulièrs, qu'à l'habitation permanente. Il doit dater du XVe siècle, (fig. 17). Le sommet de la montagne, surtout celui de la face Est, est fortifié d'un mur en pierres sèches, de 1,80 m de large, dont les deux faces sont faites de grosses pierres, avec des éclats de pierres dans les intervalles.

Les habitations du village médiéval se situent sur la partie inférieure de la face occidentale de la cité, à l'emplacement de la fontaine médiévale (fig. 18) et des ruines de l'église, laquelle, d'après les sources médiévales, a été détruite par les envahisseurs ottomans.

9) Linaj. Au croisement des routes menant de Linaj à Gruemirë, sont conservés deux centres habités. L'un deux a encore les traces des habitations en forme rectangle et ellipsoïdale. On y relève aussi les traces d'une citerne. Toute la cité a été entourée de murs protecteurs de 1,80 m de large, faits en grosses pierres sèches. Cette cité est similaire et contemporaine de Kodra e Gjodedës à Grizhe.

10) A Gradiskije, dans une profondeur d'environ 1 m, on a découvert deux haches albanaises dalmates (fig. 3). Les haches avaient été mises dans un récipient de terre.

11) A Boks, enfouie parmi les rochers, a été découverte une hache de Shkodër (fig. 4), conservant de nouveaux éléments de forme, la reliant bien aux haches albanaises dalmates.

12) En Basse Lohe, on a découvert un outil de travail illyrien des IIIe-IIe siècles avant notre ère (fig. 5).

13) Dans de nombreux villages de Mbishkodër sont conservés de nombreux tumulus, comme à Dragovojë, à Kodrat e Moksetit, à Gruemirë, à Grudë, à Grile etc.

14) A Marshej, apparaissent nettement deux citernes des premiers siècles de notre ère. Après les fouilles faites dans le terrain de la cité on a accumulé peu de matériel archéologique, le matériel le plus ancien est lié aux VIe-Ve siècles avant notre ère et allant jusqu'aux premiers siècles de notre ère.

15) Il y a à Mbishkodër même certains centres habités ouverts datant des IIe-Ie siècles avant notre ère et de IIIe-IVe siècles de notre ère, et notamment à Kalldrun, à Sterbeg, à Kosani etc.

16) Nombreux sont aussi les cités ouvertes de la période de Scanderbeg et des premiers siècles de l'occupation ottomane, à Koplik, à Koplik i Sipërm, à Rrafsh Vorfe, à Kurtaj, etc.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

PUNIMET E RESTAURIMIT NË VITIN 1982

Restaurimi i Kishës së Kosinës në Përmet (A. Meksi) Kisha e Shën Mërisë në Kosinë të Përmetit, paraqet një variant të rrallë të kishave të tipit kryq i brendashkruar me kupolë me narteks, të quajturin «tip Nerezi».

Ndërhyrja restauruese në të filloi me një sërë punimesh me karakter çlirues. Fillimisht u bë çveshja e tamburit të kupolës nga suvatimi i vonë që tregoi se tamburi është tetë faqesh me kupola tullash në qoshet, mbi të cilat ngrihen harqet zbukuruese me tulla. Mbi to kalon një friz me tulla kurriz peshku, mbi të cilën vijon korniza dhëmbë sharrë. Tamburi rezulton me dritare dhe nike, që këmbehen njëra me tjetrën. Pastrimi i çatisë nxorri qartë në dukje formën e vjetër me krahët e kryqit për naosin, me çatitë e ambienteve këndore në nivel më të ulët. Nga pastrimi i mbushjeve të mbulesës së narteksit doli se fillimisht mbulesa me tjegulla ka qenë cilindrike, të tilla janë dhe frizat e korniza. Duke patur të qartë ndryshimet që monumenti kishte pësuar në kohë nisi çveshja nga mbivëniet e vona, ndërtimi i çative me tjegulla, në nivelet e dikurshme, ripunimi i kornizave dhëmbë sharrë.

Punimet e restaurimit në Kalanë e Krujës (Gj. Frashëri). Punimet e vitit 1982 në kalanë e Krujës ishin punime të natyrës urbanistike në lagjen Kala, konservime të rrënojave të mureve të kështjellës, kalasë dhe banesave të dala nga pastrimet e dherave etj.

Zbulimi dhe përforcimi i mureve rrethuese të kalasë vazhdoi në anën jugore, ku buzë tyre u evidentuan një sërë planimetrish banesash të shek. XVI-XIX. Nga pastrimet dhe gjurmimet e mëtejshme gjatë vitit 1982, në kështjellë u verifikuan disa mure të tërthortë që tregojnë se kështjella ka qenë e pajisur në anën e brendshme të saj gjatë shek. XII-XV me ambiente banimi dhe depo të mbuluara me qemere.

Në kështjellë u zbuluan edhe gjurmët e një faltoreje. Sipas të dhënave statigrafike materialit ndërtimor dhe arkeologjik përreth, rezulton se ajo i përket shek. të V-VI. Në muret e brendshme të kapeles u hetuan tri duar pikture murale (shek. VI deri në shek. XII). Po këtu u zbuluan dhe u restauruan një numër banesash që vinë gjithashtu nga shek. XVI-XVIII. U rindërtua edhe çezma në hyrje të kalasë. Sipas mbishkrimeve të gjendura çezma ka qenë ndërtuar fillimisht në vitin 1455, dhe rindërtuar në vitin 1834. Në vitin 1928 ajo është rindërtuar për të tretën herë, por duke i humbur krejtësisht vlerat e saj origjinale. Prej çezmës së vjetër ne mundëm të fiksojmë vetëm katër gjurmët e bazamenteve të kollonave. Për rindërtimin e saj në altimetri shërbeu analogjia tradicionale me çezmat monumentale të qyteteve mesjetare shqiptare.

Punimet restauruese në Kështjellën e Ishmit (Gj. Karaiskaj)

Kështjella e Ishmit ka formë planimetrike katërkëndëshe me përmasa 100 x 40 m. Rreth mezit të këtyre mureve hapen dy porta që qëndrojnë përballë njëra-tjetrës. Kështjella përforcohet nga 5 kulla prej të cilave njëra rrethore, tre drejtkëndëshe dhe një poligonale.

Para fillimit të punimeve të restaurimit të vitit 1982 kështjella ruhej në gjendje të keqe, disa nga kullat paraqisnin rrezik shembje ose degradimi të mëtejshëm: muri jugperëndimor si rezultat i presionit të dherave nga brenda, ishte mënjanuar në anën e jashtme, kreshta e mureve rrethuese dhe e mureve të kullave si rezultat i dekompozimit të llaçit, i shkëputjes së gurëve vinte gjithnjë duke u ulur.

Studimi i arkitekturës dhe teknikës së ndërtimit të kësaj kështjelle tregoi se ajo përbëhet nga një periudhë ndërtimi që i takon viteve 1572-1574 për pasojë gjatë punimeve nuk do të prekeshin gjurmë që mund të shërbenin si dëshmi dokumentare për ecurinë e kësaj kështjelle në kohë. Punimet filluan me ndërtimin e një bazamenti të ri për kullën nr. 2. U rindërtuan

BONO JOOP

pjesërisht faqet e kullës 3. Për të eliminuar rrezikun e shembjes së murit ai u çlirua nga presioni i dherave duke hapur një kanal me skarpatë rrëzë tij nga faqja e brendshme. Për të mos lejuar degradimin e mëtejshëm të mureve nga pjesët e sipërme u fiksuan gurët e lëvizshëm me llaç bastard. Për të evituar rrezikun e zhdukjes së elementeve përbërës të këtij fortifikimi u evidentua dhe u përforcua muri i kullës Nr. 5 duke u ngritur në 0.40 m lartësi.

Restaurimi i hamamit të Kalasë së Elbasanit (V. Shtylla). Ky hamam është nga objektet më të vjetra më të ruajtura të kësaj gjinije në vendin tonë. Ai është ndërtuar në fundin e shek. XVI sikurse dhe hamami i Pazarit po në Elbasan. Hamami i Kalasë ka disa faza ndërtimi. Pjesa më e vjetër është seksioni i burrave të cilit në një fazë të dytë iu shtua edhe pjesa e grave. I fazës së tretë të objektit e fundit të shekullit të kaluar ose fillimit të shekullit tonë, është ambienti i hyrjes.

Në pjesën me kupola u revizionua krejtësisht mbulesa e kupolave. Për ajrimin e ambienteve, simetrikisht nga të dy anët e jashtme në mezin e mureve gjatsorë u hapën vrima që komunikonin me hipokaustin nëpërmjet të cilave kalonte korenti i ajrit. Veç kësaj në ambientin e hyrjes u krye çlirimi i monumentit duke synuar në heqjen e shtesave të vona.

Restaurimi i hamamit të vogël në lagjen 29 Nëntori (Parucë – Shkodër). Hamami i ndërtuar në vitin 1739, përbëhet nga një godinë dy katëshe, nga një ambient përdhes për pirje çaji me çati dy ujse, depoja e banjës, e së fundi nga volumi i gurtë me disa elemente me qemere, ku kryhej larja. Gjatë vitit 1982 u hapën vrima jashtë mureve në nivelin e hipokaustit, dhe u krye riparimi i mbulesës së kupolave.

Punime restauruese në ikonobartësin e kishës së «Gjithë Shenjtorëve» në Himarë
(B. Tabaku, E. Aliaj)

Ikonobartësi i kësaj kishe paraqitej shumë i dëmtuar nga brejtësit e drurit veçanërisht në pjesët fundore. Shumë nga panotë kishin pësuar deformime, çarje etj. Skeleti konstruktiv i ikonobartësit nuk ruhej. Numërimi i kollonave të poshtme tregoi se ikonobartësi mbështetej mbi 16 kollona. Së pari u montua pjesa e harqeve mbi ikonat e mëdha, pasi këto ishin të ndërtuara prej një dërrase të vetme 5 cm të trashë dhe si gjatësi përfshinin 1 deri 2 pjesë harkore.

Për të përcaktuar qartë vendin e tyre si dhe distancat midis pjesëve njëra nga tjetra u montua brezi i zbukurimit të hapësirave ndërharkore i cili ishte edhe ky prej një dërrase të vetme dhe përfshinte 2-3 harqe. Për gjetjen e saktë të vendit shërbyen edhe vrimat e ndryshme të gozhdëve, prerjet e dërrasave, fallcot etj.

Mbas montimit u organizua pastrimi mekanik e kimik i pjesëve të ikonobartësit me bisturi, pinceta prej druri, furçe, pambuk si dhe me solucion të holluar alkalin alkooli dhe amoniaku me 5% ujë. Pas sistemimit të pjesëve u krye dizinfektimi.

Sipas të dhënave të banorëve të moshuar të fshatit thuhet se ky ikonobartës është bërë në periudhën e sundimit të Ali Pashë Tepelenës. Në ikonobartës kanë punuar mjeshtra skalitës që vinin nga rrethi i Korçës dhe Kolonjës duke punuar për 3 vjet brenda në kishë. Kjo përputhet me faktin e njohur të lulëzimit të kësaj mjeshtërie në rrethin e Korçës e Kolonjës.

Konservimi i pikturës murale në kishën e Shën e Premtes në Përmet (S. Mihalçka)

Kisha e Shën e Premtes, ndërtuar në vitin 1766 ndodhet në jug-perëndim të qytetit, në lagjen Varosh. Nevoja e domosdoshme për konsolidimin e suvasë në pikturën murale, që rrezikonte të shkëputej i dha shkas ndërhyrjes restauruese në gjithë pikturën e Kishës së Shën e Premtes.

Naosi i kishës, është zbukuruar tëri me pikturë murale. I pikturua është edhe hajati, faqia veriore dhe lindore. Në faqen perëndimore të naosit në pjesën e sipërme ndodhet mbishkrimi i piktorit me kohën e pikturimit të kishës në vitin 1808 nga Terpo Zografi nga Korça. Piktura është me teknikë të përbërë, në të njomë dhe në të thatë, me ngjyra tempera. Dëmtimi më i madh që i ka ardhur monumentit ka qenë vërshimi i ujit të përroit që kalonte në anën jugore, në vitin 1964. Uji preku drejtë për së drejti suvanë e pikturua duke i shkaktuar asaj dëmtime të rënda. Analiza tregoi se struktura e argjilit të depozituar mbi të përbëhej nga 39% silic dhe 4.9% alumin dhe nuk përmbante elemente alkalinë. Kjo tregon se ajo nuk ishte një argjil i pastër por më tepër baltë me grimcime të mëdha. Fakti i ngjitjes me shtratin piktural shpjegohet me largimin e ujit.

Gjatë etapës së parë të punimeve përveç konsolidimeve të buzëve të suvasë në naos u krye edhe ngjitja e suvasë me anë të injektimeve me kazeinë dhe gëlqere, ulje e suvasë së deformuar, qepje të çarrash, mbushje boshllëqesh me llaç, konsolidimi i su-

vasë me qendrën e gjysëm kupolës së nefit verior, pastrime të shtresës së gëlqeres që kish mbuluar pikturën. Në etapën e dytë të punimeve në bazë të njohjes më të thellë të dëmtimeve u ndërmorën punime më të komplikuara.

Një provë pastrimi u bë në figurën e «Krishtit të kryqëzuar» brenda në nike. Në përgjithësi shtrati piktural ishte në gjendje të mirë por i mbuluar nga shtresa të dëndura tymi dhe vende-vende nga argjili i holluar. Për këtë u përdor letra e lagur për zbutjen e lavazhit me tampona uji ose të sapunosur, të cilat dhanë rezultat të mirë duke pastruar të gjithë figurën deri në mesin e saj. Në këtë etapë të punimeve u bë zhvendosja dhe vendosja e suvasë së pikturuar në faqen jugore të naosit.

Pas kësaj u bë përforcimi i suvasë së pikturuar me pëlhurë e cila do të mbante suvanë pas çvendosjes dhe filloi çbllokimi i murit nga ana e prapëme duke përdorur sharrimin dhe bisturinë për shkëputjen e suvasë. Pasi u çbllokua suporti suvaja mbeti e pa dëmtuar në pëlhurë dhe e mbështetur në planshetën e përgatitur qysh më parë. Veprimi i dytë ishte vendosja e suvasë së një suporti të ri. Pasi u përgatit ky suport në gurët e zhvendosur u vendos suvaja në vendin e caktuar duke ju përshtatur nivelit të murit.

Restaurimi i një banese dy-familjare në fshatin Gur i Bardhë të rrethit të Matit (L. Suli). Banesa në shqyrtim ndodhet thuajse në qendër të fshatit, pikërisht në vendin ku thuhet se ka patur trojet e veta gjuhëtari patriot Pjetër Budi. Banesa e ndërtuar në vitin 1870 ngrihet mbi një truall me pjerësi relativisht të madhe i cili ka kushtëzuar kompozimin volumor me gjysëmkat. Të dy seksionet janë të bashkangjitura për dy familje, duke formuar një ndërtim me hajat simetrik. Gjendja teknike e mjaft elementeve përbërës në prag të studimit për restaurimin e monumentit, nuk ishte e mirë. Gjatë hapjes së objektit kur u dha mundësia e njohjes së plotë, doli në pah forma origjinale e dritareve të mbrojtura me kafazlie druri të mbrojtur me kapakë drase të jashtëm. Të dy oxhakët e ndërtuar në murin tërthor të kthinave të banimit ishin mbyllur. Gjatë çveshjes së suvasë dualën dhe gjurmët e formulimit të oxhakëve, prandaj u pa e udhës që ata të rindërtoheshin. Një ndërtim që i përkiste një faze të dytë, ishte furra e pjekjes në brendësi të shpisë së seksionit të dytë. Ajo u ruajt duke bërë konsolidimet përkatëse. Banorët që ndërtuan banesën i kanë kërkuar mjeshtrit një zgjidhje me perspektivë siç është rasti i dy dyerve që kishte fillimisht kthina e banimit me qëllim që më vonë me çfaqjen e nevojës për strehimin e çifteve të rinj, këto kthina të ndaheshin me mure tërthor të hollë, duke pasur secila kështu komunikim më vehte. Duke pasur parasysh nevojat e sotme të banorëve që përputhej me qëllimin perspektivë të banorëve të parë, u vendos që muri i hollë tërthor i seksionit të parë të lihej, njëkohësisht të rindërtohej ai i seksionit të dytë.

Restaurimi i rrugës «Justin Godard» në Vlorë (E. Riza – D. Nikaj) Ansambli i kësaj rruge përsërit karakteristikat e arkitekturës qytetare të kësaj periudhe, në të cilën krahas vazhdimit të ndërtimit të banesave individuale brenda muresh rrethues, përhapet ndërtimi i ngjeshur i ansambleve përbri rrugëve kryesore, duke u zhvilluar kompozimi në formë vargu, me ndërtime dy e tre katëshe. Ndërtimet dalin drejtpërdrejt në rrugë, duke marrë kështu pjesë në formulimin e saj. Në ansamblin e rrugës «Justin Godard» kemi katin përdhe të zënë nga dyqane, ndërsa kati, apo katet e sipërme janë ndërtuar për banim. Ansambli në fjalë përbën një dëshmi me vlerë edhe historike, sepse pikërisht në të janë zhvilluar ngjarje të rëndësishme të lidhura me ngritjen e flamurit, luftës antiimperialiste të 1920 si dhe të viteve të Luftës Nacionalçlirimtare.

Ansambli përveç dëmtimeve të pjesëshme në sipërfaqe, dhe madje në disa struktura të ngritura me teknikën e skeletit të drurit, paraqiste edhe disa ndryshime në pjesë të ndryshme të tij. Për pjesët e humbura të disa ndërtesave natyrisht që nuk shtrohej çështja e rindërtimit të tyre, ndërsa për pjesët e ndryshuara, u vendos që ato të rikthehen në gjendjen e parë. Lidhur me elementet arkitektonike dekorative të dëmtuar u ndoq parimi i ruajtjes maksimale të pjesëve origjinale, duke rindërtuar pjesërisht, apo në raste të rralla tërësisht, ndonjë element të dëmtuar shumë rëndë. Praktikisht këta tre kritere u vunë në bazën e hartimit të projektit të restaurimit të këtij ansambli.

Punimet e restaurimit në pazarin e Korçës. (K. Kallamata) Në pazarin e Korçës, një nga ansamblet më të rëndësishëm të arkitekturës popullore, u kryen punime restaurimi në këto drejtime: punime konstruktive, punime veshëse-dekorative, punime elementesh drusorë.

Në dyqanin nr. 14 në Bllokun nr. 1 të Pazarit të Korçës, dykatësh me katin e sipërm mbuluar me qemer cilindrik, u krye hidroizolimi i qemerit. Në vendet e der-

POWERED BY

dhjes së ujërave në fasadë kishte një lagështi të konsiderueshme, dhe si pasojë gurët e kornizës së poshtme ishin prishur. Fillimisht u krye zbulimi i qemerit dhe kanaleve anash tij, të cilët ishin shtruar në pjesën e poshtme me tulla dhe gëlqere me një pjerrësi rreth 5-8%. Kanalet anësore u veshën me llamarinë në formën e një ulluku të mbyllur në pjesën fundore. Në dyqanin Nr. 1 në bllokun 15 u krye zëvëndësimi i kollonave, duke përdorur për lidhjen e gurëve kunja hekuri dhe gëlqere. Pas tyre u zëvëndësuan bordurat poshtë vitrinave dhe më tej vitrinat sipas modelit origjinal dhe së fundi qepenat metalike me palosje. Gjatë zëvëndësimit u ruajtën të gjitha detajet dhe hollësitë sipas origjinaleve.

Në dyqanin nr. 2 të bllokut 17 u krye rikonstruksioni i çatisë, i tavanit të katit të sipërm, i dyshemeve dhe suvatimet e brendëshme. Gjatë çveshjeve në njërin nga muret e katit të sipërm u zbulua një pikturë murale (4 x 2 m) që paraqiste një pamje të Pazarit të Korçës.

Në monument u vunë re ndërhyrje të thella në trajtimin e jashtëm të tij si edhe një degradim në pjesën e sipërme të suvasë. Duke u mbështetur në gjurmët e ruajtura origjinale u pa me vend që të ripërtërihej gjendja origjinale e fasadës perëndimore e pilastrave prej tulle, e strehës dhe e disa pjesëve të muraturës. Në vende të ndryshme u lanë fragmente të vjetra të cilat ishin në gjendje teknike të mira.

Restaurimi i banesës së Roza Sumës (Sh. Prifti) Banesa e Sumajve ndodhet në mes të Shkodrës. Është banesë e tipit me çardak në gjithë ballin me ambientet e banimit në rradhë të dytë. Në gjendjen e sotme nga kjo banesë ruhet vetëm krahu i djathtë mbasi krahu i majtë nuk ekziston fare. Nga të dhënat gojore tipologjia dhe karakteristikat që ajo trashëgon mund të themi që është banesë e fundit të shek. XVIII dhe fillimit të shek. XIX. Banesa ka qenë me shkallë dy rampëshe me qemer.

Në kohë banesa ka pësuar ndryshime. Në një fazë të dytë asaj në pjesën e mbrapme i janë shtuar dy ambiente: oda e mirë dhe një tjetër i vogël. Ambienti i odës së mirë ruan karakteristikat e plota të një ambienti të fillimit të shek. XIX me të gjithë hollësirat dekorative. Ai është shumë i formuar si i tillë dhe mjaft i pasur për nga mjeshtria e gdhendjeve, përfaqsues tipik në gjininë e vet.

Punimet e restaurimit në këtë banesë u panë si një nevojë e domosdoshme për të garantuar me kohë ekzistencën e saja. Ajo paraqitej e dëmtuar veçanërisht në pjesën e çatisë edhe të strehës. Po ashtu të dëmtuar ishin dhe elementet e çardakut. U pat parasysh ruajtja në maksimum e elementit të vjetër, dhe ripërtëritja e pjesëve munguese apo të dëmtuara.

Qoshku u ripërtërit i gjithi. Odës së zjarrit ju restauruan dritaret kafazlije druri të cilat ruheshin mjaft mirë si dhe suvatimi i faqeve të odës. dhe u restauruan dhe elementët e drunjtë në dhomën e mirë.

Zona muze rreth shtëpisë së Partisë dhe restaurimi i saj (R. Ballauri) Shtëpia e Partisë përfshihet brenda një lagjeje të Tiranës, ku ngrihen shumë banesa përdhese njëkatëshe, kryesisht të ndërtuara në dekadat e para të shekullit tonë. Edhe zona-muze përreth saj formohet nga pesë banesa të tilla, nga të cilat katër janë njëkatëshe dhe vetëm një është me dy kate. Që të gjitha janë përdhe dhe njëra prej tyre ngrihet me këmbë shkallë. Këto ndërtim kryesisht janë bërë në vitet 20 këtij shekulli.

Gjatë Luftës Nacionalçlirimta këto banesa të vogla strehuan il galët dhe u bënë çerdhe të lëv zjes Antifashiste, këto banesa vunë në mbrojtje shtetërore qys në vitin 1976, duke formuar kësht një zonë-muze rreth Shtëpisë ku themelua Partia. Si koncept ark tektonik, të gjitha banesat përko në me njëra tjetrën dhe tek gjitha ato ndjehet ndikimi i ndë timeve fshatare një katëshe Shqipërisë së Mesme. Gjendja tyre ishte e keqe dhe në to u kry një ndërhyrje restauruese. U rua tën gjithë strukturat e mureve pr qerpiçi, por edhe disa mure m tulla. Pothuaj se gjithë lënda drunjtë e çative, u zëvendësu mbasi kishte një degradim të pl të. Nga punimet në dru u ruajtë pak elemente në gjendje të mir Kurse kalldrëmet me gurë lun dhe disa elemente të mëparshm si pusi në oborr, shkallët e hyrje në njërën nga këto banesa os portat e hyrjes që u ritrajtuan gjat restaurimit ndihmuan shumë për t krijuar mjedisin e kërkuar. Pu nimet e restaurimit vazhduan tr vjet në përfundim të tyre monu menti rifitoi vlerat arkitektonik dhe estetike. Kështu zona-muz rreth Shtëpisë Partisë, si një mje dis urban i fillimit të shek. XX fi toi edhe shumë vlera ambientale Me restaurimin e bërë u përftua grupim banesash karakteristike t kësaj kohe të vendosura njër pas tjetrës që komunikojnë t gjitha në të njëjtën mënyrë m rrugën. Por mbi të gjitha u ruaj tën vlerat e mëdha historike të la gjes ku u themelua Partia Komu niste Shqiptare.

A. BAÇE

DO NOT COPY

DO NOT COPY

LES TRAVAUX DE RESTAURATION EFFECTUES EN 1982

La restauration de l'Eglise de Kosina à Përmet

L'Eglise de la Sainte Marie à Kosina de Përmet présente une variante rare des églises du type croix circonscrite à la coupole avec narthex, le dit «type Nerezi».

L'intervention de restauration a commencé par une série de travaux de déblayage. D'abord on a enlevé la couche supérieure du crépi du tambour de la coupole, ce qui a mis en relief que le tambour était octogonal flanqué de coupoles en briques surmontées d'arcs décoratifs en briques.

Au dessus il y a une frise en briques concavées suivie d'un cadre en crénaux. Le tambour est pourvu de fenêtres et de niches qui altérnent les unes avec les autres.

Le déblayage du toit a mis en relief l'ancienne forme avec les ailes de la croix pour le naos et les toits des milieux angulaires d'un niveau plus bas. Le déblayage du plafond du narthex a mis en relief que la couverture en tuiles a été d'abord cylindrique comme les frises et l'encadrement aussi.

Tenant compte des modifications que le monument avait subies avec temps en a commencé par le déblayage des parties rajoutées, la construction des toits en tuiles aux niveaux d'auparavant, la reconstruction des encadrements en crénaux, etc.

A. Meksi

Les travaux de restauration à la Forteresse de Kruja

Les travaux effectués en 1982 dans la Citadelle de Kruja étaient des travaux de nature urbanistique dans le quartier de la forteresse, des conservations des ruines des murs du château, de la forteresse et des habitations découvertes par le déblayage etc.

La découverte et le renforcement de l'enceinte de la forteresse se sont poursuivis dans la partie méridionale. Au pied de ces murs on a remarqué une série de planimétrie d'habitations des XVI-XIXème siècles, Les déblayages et les recherches ultérieures pendant l'année 1982 ont mis en évidence quelques murs transversaux qui montrent que pendant les XII-XVème siècles la forteresse était dotée de milieux d'habitation et d'entrepôts couverts de voûtes.

